



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR 19 PRILL DHE 4 MAJ 2017**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 19. APRILA I 4. MAJA 2017. GODINE**

**PRILL/MAJ - APRIL/MAJ
2017**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Interpelanca e kryeministrit të Kosovës Isa Mustafa, sipas kërkesës së deputetes Donika Kadaj-Bujupi, e mbështetur edhe nga 15 deputetë nënshkrues, për çështjen e shfrytëzimit të thëngjillit dhe minierën e Sibocit,
4. Interpelanca e ministrit Blerand Stavileci, sipas kërkesës së deputetit Visar Ymeri, i mbështetur edhe nga 15 deputetë nënshkrues, në lidhje me Kontratën e privatizimit të Kompanisë së Distribuimit të Energjisë Elektrike,
5. Debat parlamentar sipas kërkesës së deputetes Teuta Haxhiu, e mbështetur edhe nga 9 deputetë tjerë nënshkrues, në lidhje me moszbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga Qeveria e Republikës së Kosovës,
6. Debat parlamentar sipas kërkesës së deputetëve Bekim Haxhiu dhe Xhevahire Izmaqi, të mbështetur edhe nga 8 deputetë tjerë nënshkrues, në lidhje me shkeljen e të drejtave të punëtorëve në Kosovë.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Interpelacija premijera Kosova Isa Mustafa, na zahtev poslanice Donika Kadaj-Bujupi, podržana od 15 poslanika potpisnika, o korišćenju uglja u rudniku u Sibovcu,
4. Interpelacija ministra Blerand Stavileci, na zahtev poslanika Visar Ymeri, podržan od 15 poslanika potpisnika, u vezi ugovora o privatizaciji Kompanije za distribuciju električne energije,
5. Parlamentarna rasprava, na zahtev poslanice Teuta Haxhiu, podržane od 9. ostalih poslanika potpisnika, u vezi sprovođenja preporuka Narodnog advokata od strane Vlade Republike Kosova,
6. Parlamentarna rasprava, na zahtev poslanika Bekim Haxhiu i Xhevahire Izmaqi, podržanih od 8. ostalih poslanika potpisnika, u vezi kršenja prava radnika na Kosovu.

Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 14 prill 2017.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

E dini që kjo pikë zgjat 30 minuta, rregullat i dimë të gjithë, po fillojmë sipas paraqitjes së deputetëve.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot në këto deklarime do të paraqes një shqetësim, të cilin disa herë e kam paraqitur në këtë foltore dhe në Kuvend për mungesën e infrastrukturës sportive dhe tani edhe moszbatimin e legjislacionit të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës për të ndihmuar dhe avancuar sportin më tutje.

Po bëhen katër vjet, në fakt, tre vjet prej se është zhvilluar ndeshja e parë miqësore ndërkombëtare mes Kosovës dhe Haitit dhe prej atij renovimit të asaj periudhe kohore në Stadiumin Olimpik “Adem Jashari” nuk është vendosur asnjë gozhdë tjetër dhe nuk është bërë asnjë punë, e për më keq, edhe ajo çka është rindërtuar nuk është mirëmbajtur si duhet dhe tani klubet tona e rrezikojnë seriozisht që të mos licencohen më 1 qershor për t’i zhvilluar ndeshjen ndërkombëtare në kuadër të një kompeticioni, të cilën sportistët tanë me vite të tëra e kanë pritur në kuadër të ligës së UEFA-s. Kjo është shumë shqetësuese, sepse ne edhe sot, në pamundësi për zhvillimin e këtyre ndeshjeve në stadiumin e Prishtinës, i cili është në fazën e renovimit, po ekziston problemi aktual, sepse edhe në atë të Mitrovicës për tre vjet nuk është investuar.

Edhe pse Kuvendi i Kosovës vitin e kaluar në ndryshim-plotësimin e buxhetit të vitit 2016 ka ndarë 760 mijë euro dhe Qeveria e Kosovës ka ndarë 500 mijë euro nga fondi rezervë, asnjë nga ato mjete nuk janë investuar në stadiumin “Adem Jashari” dhe kjo kërkon vërtet një llogaridhënie të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Përveç kësaj, këto ditë ne kemi hasur kërkesa të vazhdueshme dhe pyetje të sportdashësve dhe të atyre të cilët në vazhdimësi po kërkojnë të dinë pse nuk po fillon zbatimi i dy ligjeve esenciale që i ka aprovuar Kuvendi i Kosovës. Kemi të bëjmë me Ligjin për sponsorizim dhe Ligjin për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në sport, e për të cilat ligje institucionet qeveritare, në këtë rast Ministria e Kulturës, Rinisë dhe e Sportit ka qenë e obliguar të nxjerrë udhëzimet administrative për zbatimin e këtyre ligjeve.

Për më keq, Ministria e Financave i ka dhënë sugjerime administratës tatimore që të mos respektojë Ligjin për sponsorizime dhe të vazhdojë të bëjë ose të punojë sipas akteve normative të vjetra, para aprovimit të këtij ligji.

Prandaj, po kërkohet edhe një herë një vëmendje e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit që të plotësojë aktet normative, për të cilat është e obliguar, sepse me këto akte normative vërtet do të ndëshkoheshin ata të cilët sot po atakohen dhe po abuzojnë me një segment shumë të rëndësishëm të sportit, e në veçanti me këto dukuri negative, të cilat kanë qenë prezentë, duke paraqitur edhe dhunën, edhe dukuri të tjera negative të kurdisjeve dhe trukimeve të ndeshjeve sportive që kanë qenë aktuale këto ditë dhe kjo do të parandalohet me ato ligje, të cilat ne i kemi aprovuar në Kuvend të Kosovës.

Ligji për sponsorizim është bërë për të avancuar sportin dhe për të ecur përpara e për ta ndihmuar zhvillimin e sportit.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe e Sportit dhe Ministria e Financave dhe Administrata Tatimore duhet ta kenë për bazë këtë ligj për zhvillimin e sportit dhe jo t'i bëjnë pengesa, ngërçe e t'u krijojnë probleme sponsorëve, e në veçanti klubeve dhe federatave për zhvillimin e tyre.

Kërkoj një vëmendje vërtet më serioze të këtyre institucione, sepse marrja pjesë në garat ndërkombëtare kërkon edhe llogaridhënie të vetë institucioneve, të cilat garojnë, në këtë rast të federatave sportive dhe këto federata sportive dhe klubet do të zhvillohen atëherë kur kemi një zbatueshmëri të ligjeve, të cilat ne i kemi aprovuar në Kuvend, me të vetmin qëllim që sporti të avancohet dhe të zhvillohet.

Kërkoj edhe një herë një angazhim serioz të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit që investimet në stadiumin "Adem Jashari" t'i bëjë me urgjencë që klubet më 1 qershor, kur të vijjnë zyrtarët e UEFA-s për licencim të infrastrukturës, ato të jenë të gatshme dhe kjo do jetë në interesin e të gjithë sportistëve dhe në interesin e përfaqësimit të Kosovës në arenën ndërkombëtare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Blerim Grainca e ka fjalën. Atëherë Sadri Ferati, sipas renditjes, po nuk e ke shtypur. Veç deklarohuni a jeni në emër të grupit, apo në emër personal? Personal, në rregull.

SADRI FERATI: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Të nderuar kolegë,

Unë me këtë rast dua të ngre një shqetësim, por edhe një mbështetje për një situatë që ka ndodhur në mes të natës të së shtunës dhe mëngjesit të së dielës në Kodrën e Minatorëve, ku

sipas të gjitha gjasave është vënë një zjarr në të vetmin institucion që shqiptarët marrin shërbime atje, në ndërtesën e Mjekësisë Familjare, ku së bashku është edhe shkolla fillore, pra i vetmi institucion ku shqiptarët marrin shërbime.

Dhe, për çudi, reagimi ka qenë fare i vogël, përveç se policia e Kosovës që ka shkuar sipas detyrës zyrtare dhe ka bërë shikimin, asnjë mbështetje, asnjë zë i ngritur nga të gjitha institucionet, as nga ato qendrore, e as nga ato lokale.

Unë dua të përkujtoj për ata që pak dinë për atë situatë, që ata qytetarë atje e kanë përjetua një ankth që nga paslufta e deri tash, sidomos situata 2000- 2002, edhe deri para dy vjetëve ata edhe natën nuk kanë mundur të marrin shërbime, po mendoj ka qenë rrezik që edhe të vdesin edhe të mos mundet dikush asnjë ndihmë t'ua japin.

Viteve të fundit ka pasur një relaksim dhe një rritje të lirisë së tyre, ndërsa tash një dorë e keqe, sipas të gjitha dyshimeve, ajo është një zjarrvënie e qëllimshme.

Prandaj, ata qytetarë të cilët jetojnë bukur të izoluar, atëherë kur kanë pritur që shteti i Kosovës do të bëjë më shumë për punësimin e tyre, për investime në infrastrukturë, për aq shumë që ka nevojë, atje shihet se dikujt i pengon ajo liri që e kanë fituar ata dhe ajo bashkëjetesë që po ndërtohet atje.

Prandaj, edhe një herë bëj thirrje nga kjo foltore që të vazhdojë përcaktimi dhe përkushtimi dhe rezoluta që i kemi nxjerrë këtu në këtë Parlament për vazhdimin e ndikimit të kualitetit të jetës së qytetarëve atje, në punësimin në infrastrukturë dhe aq më parë, një zë i ngritur që atje të mos lejohen të përsëriten situata të tilla.

Atje thjesht është një mbijetesë e shqiptarëve në atë pjesë, ndërsa një mbështetje më e madhe e institucioneve edhe një herë dëshmon të gjithë atyre që u pengojnë dhe që dëshirojnë ta atakojnë këtë bashkëjetesë që nuk do të kenë sukses.

Ndërsa qytetari shqiptar atje, sikur edhe deri tash duhet të vazhdojnë të shprejnë se Parlamenti i Kosovës, Qeveria e Kosovës, institucionet lokale do të jenë me ta, do t'u sigurojnë edhe një siguri, por edhe një mirëqenie më tutje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kush e do fjalën, Albin Kurti, në emër të grupit.

ALBIN KURTI: Meqenëse nuk më mjaftojnë pesë minuta, versionin e gjatë të fjalimit do ta dorëzoj me shkrim.

Qytetarë të Republikës,
Deputetë të Kuvendit,

Edhe në Kosovë kemi emra biznesmenësh që për një kohë të shkurtër i kanë shumëfishuar pronat e të ardhurat e tyre në mënyrë eksponenciale, duke tejkaluar edhe Bill Gates-in e Steve Jobs-in në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Mirëpo, te ne në Kosovë Bill Gates dhe Steve Jobs janë dy vëllezër, Blerim dhe Shkëlqim Devolli. Ata janë pasuruar shpejt dhe shumë përtej imagjinatës së tyre dhe përtej njohurive tona, thua se kanë bërë ndonjë inovacion në fushën e teknologjisë informative porsì Gates e Jobs.

Për pak vjet këta u bënë pronarë të kompanive më të fuqishme në vend, si fabrika e miellit “M&Sillosi”, qumështorja “VITA”, “Princ Caffè”, fabrika e sfungjerit “Comodita doppio”, fabrika e lëngjeve “Tango”, “Z-Mobile”, Qendra e homologimit, Terminali doganor në Prishtinë, në Pejë e Mitrovicë, Birra e Pejës, thuhet se edhe televizioni Klan Kosova është i tyre, etj. etj.

Cili ishte inovacioni i këtyre vëllezërve? Çka zbuluan ata që u pasuruan kështu? Çudisë Devolli nuk i mungon shpjegimi, por hetimi. Kosova është shtet i kapur jo vetëm pse është polici e kapur, gjyqësi e kapur, prokurori e kapur, RTK e kapur, shëndetësi e kapur, arsim i kapur, por edhe pse është ekonomi e kapur.

Të gjithëve na kujtohet ‘pronto’ biseda e Adem Grabovcit me Shkëlqim Devollin, ku Grabovci i thotë Devollit: “Këqyre se s’muja me të thirrë... m’u ka zbraz krejt fyti...”, ndërkohë që Devolli i përgjigjet: “U bo, shef, qe po t’i çoj...”. Shtrohet pyetja: a iu ka tharë fyti vetëm një herë Grabovcit, apo nuk i kanë publikuar ‘pronto’ ankesat e tjera për tharje fyti? Cilido variant është më i keq se tjetri. Dhe, së dyti, Devolli i thotë Grabovcit “shef”, e jo anasjelltas. E shef do të thotë shef kuzhine apo shef fisi apo shef klani apo shef firme.

Përderisa në këtë qeveri e kuvend kemi politikanë që përfaqësojnë kapitalin ekonomik, si puna e Ramiz Kelmendit dhe Margarita Kadriut, te Devollët kemi situatën e përmbysur: ata janë biznesmenë që përfaqësojnë kapitalin e ‘pronto’ politikanëve. Devollët janë arketipi i biznesit paravan të kapjes ekonomike të shtetit.

Devollët kanë krijuar monopol në shumë fusha. Ata po i shkatërrojnë fushat tona bujqësore dhe bujqit tanë s’kanë më levërdi të mbjellin për shkak të importit të grurit për ushqimin e kafshëve prej rezervave shtetërore të Serbisë, e të cilat Devollët po ia sjellin jo vetëm Kosovës, por po ia çojnë edhe Shqipërisë. Kanë rënë të ardhurat dhe fitimet në fabrikat e bluarjes në Kosovë e Shqipëri. Autostradën e kombit Devollët e kanë bërë autostradë të krundeve dhe rezervave serbe për konsumatorët shqiptarë.

Kjo e shkatërron bujqësinë e Kosovës, sidomos prodhimin vendor të grurit dhe misrit, sepse çmimi i grurit në Kosovë tani sillet nga 13-15 centë, pra më lirë se krundet tona.

Nga “Devolli Commerce” gjatë okupimit të “Devolli Company” e sot të “Devolli Group”, prodhimi që bëjnë është bërë i parëndësishëm krahasuar me dallaveret që bëjnë. “Serbia deformon tregun”, “Mielli i bukës kontrabandohet si miell biskotash”, “Mashtrimi me tarifat doganore” janë tituj të zakonshëm kur mediet shkruajnë për Devollët. Mirëpo jo edhe Klan Kosova, i cili dikur ishte fabrikë reale prodhuese e amortizatorëve për automjetet, kurse tash pas privatizimit është fabrikë virtuale televizive për amortizimin e pakënaqësisë së qytetarëve.

Ekzistenca e “Z-Mobile” është produkt i krimit të organizuar me pjesëmarrje të një numri të madh individësh. Për këtë Prof. Ismet Hamiti ka bërë një kallëzim penal te Prokurori i Shtetit. Qartazi, klani ‘Pronto’ ka kurdisur fitoren e Devollëve në tender. Për shkak të kurdisjeve të këtilla pronarë të vërtetë të bizneseve që figurojnë në emër të Devollëve janë kurdisësit, pra klani ‘Pronto’.

Terminalet doganore, në anën tjetër, janë dorëzim i pastër i shtetit. Kur privatizohen doganat, privatizohen edhe doganierët, shumë prej të cilëve tash më shumë punojnë për Devollët e Ramiz Kelmendin e Margarita Kadriun, sesa për Republikën tonë.

Qeveria e sotme, deputetë të Kuvendit të Kosovës, sikurse edhe çdo tjetër para saj ishte dhe është në shërbim të ‘tajkunëve’. Neve na nevojitet një qeverisje e re me shtet zhvillimor, ku qeveria është e afërt me biznesin e vogël dhe të mesëm në përgjithësi, por jo tepër e afërt veçanërisht me ‘tajkunët’ e monopoleve.

Isa Mustafa, si kryeministër, nuk e bën dot këtë. Ai nuk po merret me ekonomi, por me demarkacionin e Thaçit. Zaten, e ka të vështirë të merret me ekonomi Isa Mustafa, sepse magjistraturën dhe doktoratën i ka në kundërshtim me njëra-tjetrën: magjistraturën e ka në frymën e socializmit vetëqeverisës të Kardelit, kurse doktoratën e ka për lidërsip e menaxhment brenda orientimit neoliberal. E, që të dyja këto janë të gabueshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Tema për të cilën unë sot do të flas ka të bëjë me një numër shumë të madh të banorëve të komunës së Deçanit, por edhe të Gjakovës, të cilët po afrohet gati një vit që kur u përballën me sëmundjen gungore të kafshëve dhe të cilët asnjëherë nuk u subvencionuan, përkundër premtimeve të vazhdueshme të Qeverisë, përkatësisht Ministrisë së Bujqësisë.

Pra, vetëm në komunën e Deçanit banorët pësuan humbje në total 196 kafshë, prej tyre lopë mbi 18-muajshe gjithsej 156, dema mbi 18-muajsh 7, mështjerra 9-18 muajsh 7, mëza prej 9 deri 18 muaj 8 dhe viça nën 9 muaj gjithsej 18. Pra, familjet, të cilat u përballën me këtë lloj sëmundjeje, shumë prej tyre kishin edhe ferma, u detyruan t’i mbyllin. U mbyllën, në fakt, për shkak të

dëmeve shumë të mëdha. Qysh në fillim ata u përballën edhe me sigurimin e vaksinave për shkak të vonesave shumë të mëdha të Qeverisë, përkatësisht të ministrisë përkatëse. Ata i morën vaksinat edhe nga shtetet fqinje, me çmime shumë të larta.

Qeveria u kishte premtuar që për secilën kafshë do të kompensoheshin me nga 1 mijë euro. Kurrë nuk u kompensuan, pra po afrohet një vit dhe kjo Qeveri vetëm i mashtrroi dhe që për shumë banorë të fshatrave, po i përmend disa prej tyre: Lumbardhë, Carrabreg, Llukë e Ulët, Llukë e Epërme, Drenoc, Baballoç, Isniq, Strelle, Rastovicë, Libushë, Dubovik, Parmaqan, Prilep, Beleg, Deçan, Vranoc i Vogël, Lloqan, Sllukë, Glllogjan, Voksh, Papiq, Pobërgjë, shumë fshatra të tjera në komunën e Deçanit: Dobrosh, Nivokaz, Rracaj, Smolicë e shumë e shumë të tjera.

Prandaj, nuk është pak që familjet, të cilat vërtet kanë pasur ndoshta edhe një burim jetese, edhe për shkak se kanë punuar shumë dhe kanë investuar nga buxheti i familjes për të ngritur fermat e tyre, Qeveria i la pa përkujdesje dhe asnjëherë nuk i kompensoi. Prandaj, edhe një herë, të nderuar, kjo qeveri e papërgjegjshme dhe e pandërgjegjshme, e cila në momente të caktuara di shumë mirë të pretojë dhe përkundrazi, pas një viti edhe sot e kësaj dite asnjëherë nuk doli për t'i kompensuar dëmet e shkaktuara...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bajrami e ka fjalën.

VALDETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

E kemi thënë disa herë se ky koalicion do të jetë përbërja më e dëmshme që ndonjëherë e ka pasur vendi ynë. Kjo për faktin se që nga momenti i parë është dëshmuar se bashkimi juaj u bë për t'i realizuar tri çështje, ose ndryshe të themi, tri vendime, të cilat vetëm një nga ato arritët ta realizoni: krijuat një gjykatë etnike, e për të tjerat s'po jeni në gjendje të merrni vendime.

Prandaj, është koha kur duhet shkuar në zgjedhje të parakohshme. Pa dashur që t'i listoj dështimet e njëpasnjëshme, apo më mirë të themi, mashtrimet, të cilat i bëtë gjatë fushatës, e që kurrë nuk ishit në gjendje t'i përmbushni. Por, nuk jeni të vetmit ju këtu që po e dëmtoni të ardhmen e shtetit dhe të qytetarëve, sepse në këtë drejtim kontribut shumë të madh është duke dhënë edhe zoti Thaçi, me iniciativa të cilat do t'i kushtojnë vendit, por edhe qytetarëve. Iniciativa që edhe ai e di shumë mirë se janë vetëm llafe, sepse kështu ka vepruar çdoherë. Iniciativa sikur ajo e reformës zgjedhore, iniciativë për ushtrinë, e tash e ka rifilluar edhe serinë e iniciativave për padi.

Ju kujtohet kur pati premtuar se do të padiste Dik Martin për shpifje, e që nuk ndodhi kurrë. Së fundmi është duke luajtur me të ardhmen e shtetit, sepse të luash me idenë, të cilën ky njeri e deklaroi publikisht, e që në të vërtetë ose nuk e di, ose këshilltarët që i ka nuk e dinë, se në vendin tonë ka pasur spastrim etnik. Të deklarohet “presidenti” i vendit se në Kosovë nuk ka pasur spastrim etnik, por ka pasur përpjekje për spastrim etnik, kjo përfundimisht nuk duhet lejuar, sepse me këto deklarata të tija të pamenduara mirë, të paanalizuara mirë, do t’i kushtojnë Kosovës dhe të ardhmes sonë, sepse e gjithë bota e di se kush ka kryer gjenocid dhe spastrim etnik në Kosovë, e nëse ju nuk e dini, zoti Thaçi, se çka cilësohet spastrim etnik, është mirë t’i shkarkosh ata këshilltarë, por edhe është koha që të japësh dorëheqje, sepse e ardhmja e shtetit nuk guxon të përdoret për çështje individuale dhe ju me ndihmën e madhe që mund ta bëni është më mirë të mos flisni për këtë çështje, derisa nuk e dini saktë se çka ka ndodhur në vendin tonë, sepse koston do ta paguajë shteti dhe qytetarët.

Padia ndaj Serbisë nuk guxon të përdoret për çështje personale nga askush prej nesh, por as nga ju, sepse këtë nuk e meriton as qytetari dhe askush tjetër. Prandaj, kjo çështje duhet të jetë kauzë kombëtare dhe me shumë kujdes duhet të analizohet, por edhe sinqerisht me këto deklarime të tij e kanë dëmtuar shumë të ardhmen e vendit dhe çdo gabim i zotit Thaçi do ta përdorë Serbia për poenët e saj që do t’i hyjnë në favor.

Për ata që nuk janë të informuar si duhet, dëbimi i 1 milion shqiptarëve nga Kosova është fakt që ka ndodhur dhe besoj që vetëm kjo do të mjaftonte të dinin dhe të mos deklaroheshit se kinse ‘ka pasur përpjekje për spastrim etnik’, por ka pasur spastrim etnik. Prandaj, duhet të keni kujdes se çka, si dhe pse deklaroheni, sepse i vetmi populli është ai i cili do të paguajë dëmet tuaja, e kjo nuk duhet lejuar prej asnjërit prej nesh. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Kadriu e ka fjalën.

MARGARITA KADRIU: Të nderuar,

Përderisa klasa politike kosovare është duke u marrë me vetveten, shteti pësoi humbjen e madhe të radhës në Gjykatën e Arbitrazhit. Siç shihet, tanimë po ikin edhe gati 40 milionë euro të tjera nëpërmjet arbitrazhit, gjë që s’po i dhemb asnjërës palë.

Para se më shumë se tetë muajsh pikërisht nga kjo foltore e ngrita alarmin para qytetarëve, Qeverisë dhe deputetëve kolegë, se buxheti i taksapaguesve kosovarë po rrezikohet nga një skemë e kundërligjshme, kërcënuese dhe atë për 450 milionë euro, përfshirë edhe shpenzimet e mbrojtjes. Jo vetëm që e ngrita këtë çështje, por propozova edhe rekomandimet, të cilat në mungesë kuorumi një herë ose herën e parë nuk kaluan, por që më asnjëherë tjetër nuk u vendosën në rend dite për të marrë votën tuaj. Por, atë çka qytetarët morën ishte lajmi për vendimin e radhës të Gjykatës së Arbitrazhit, ku “Z-Mobil” iu aprovua kredia për hiç më pak se

edhe për 40 milionë euro të tjera shtesë. ‘Qershia mbi tortë’ pritet të vijë së shpejti me vendimin për “AXOS”-in kundër Telekomit të Kosovës, respektivisht kundër Qeverisë së Kosovës.

Prej kërkesës sime për aprovimin e rekomandimeve kaluan hiç më pak se 8 muaj, e fakti se tanimë shkuan edhe 40 milionë euro të tjera, siç duket edhe sot për zyrtarët e lartë nuk është ndonjë arsye për të marrë masa. A do të mbajë ndonjëherë dikush në këtë shtet jo vetëm përgjegjësi politike, por edhe juridike dhe penale për këto zhvatje që po i bëhen buxhetit? Natyrisht, si gjithnjë është taksapaguesi i varfër ai që e paguan faturën e çdo dështimi, ndonëse do të duhej të kishim një llogaridhënie konkrete të zyrtarëve përgjegjës pas një hetimi serioz të Prokurorisë Speciale të Shtetit.

Po të reagojmë me kohë apo po të votoheshin rekomandimet e propozuara, ku i bëhet ftesë Prokurorisë për të hetuar dhe për të zbardhur të vërtetën lidhur me paditë në fjalë, pra në momentin që dy paditësit: kompanitë që kanë ngritur padi, do të ishin në një proces hetimor, edhe qëndrimi i Arbitrazhit do të relativizohej me mundësinë për ta hedhur poshtë si të pabazë padinë e ngritur. U bëj thirrje të gjitha partive politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës, si dhe deputetëve të pavarur që urgjentisht sot t’i votojmë rekomandimet, ku mes të tjerash kërkohet: Qeveria e Republikës së Kosovës të kërkojë nga Prokuroria që menjëherë të fillojë hetimin për të verifikuar nëse zyrtarët e përfshirë në këto procedura të prokurimit kanë vepruar në përputhje me ligjin dhe për këtë të njoftojë me prioritet dhe shpejtësi Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Pa adresuar përgjegjësinë, pavarësisht prej pozicionit të secilit zyrtar, pavarësisht rangut që e ka, nuk do të kemi transparencë dhe drejtësi. Buxheti pësoi në dy vendime të fundit, ku humbjet janë dhe po i afrohen shifrës prej 50 milionë eurosh, ndërkaq pritet vendimi dhe për afro 400 milionë euro të tjera të shtetit. Pyetja pa përgjigje mbetet: kush janë fajtorët? Kush janë autorët e këtij krimi të planifikuar? Përgjegjësit, kushdo qofshin ata, duhet të përballen me pasojat ligjore, kështu do të krijojnë një precedent pozitiv, në mënyrë që askush të mos guxojë të synojë e të planifikojë ta dëmtojë buxhetin e shtetit. Në fund, një përgjigje për Albin Kurtin dhe...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zonja Selviqe Halimi e ka fjalën.

SELVIQE HALIMI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë sot dola para jush të shtroj një çështje, për të cilën jam autorizuar në emër të disa qytetarëve lidhur me kontrollin e preparateve të pastrimit që përdorim ne në shtëpitë tona, përdoren nëpër restorante, kafene dhe në ambiente të tjera.

Fjalën e kam konkretisht për mjetet e pastrimit që janë në gjendje të lëngët, të ngurtë dhe pluhur dhe në gjendje të tjera të gazit. Problemi qëndron kryesisht me detergjentin për pastrimin e rrobave. Të nderuar qytetarë, unë po e ngre shqetësimin tuaj, duke kërkuar nga Qeveria, gjegjësisht Ministria e Tregtisë dhe Industrisë që të vërë prioritet kontrollin e detergjenteve, sepse ato sot nuk janë brenda parametrave dhe standardeve për sa i përket cilësisë dhe përbërjes. Fakti qëndron se secila grua në shtëpi që përdor detergjente, qofshin ato me çmime më të ulëta apo çmime më të larta, po ballafaqohet me gurëzimin e detergjenteve nëpër kutitë e rrobalarëve dhe me mbetjen e detergjenteve nëpër rroba.

Sugjerimi im fillestar për ato gra, të cilat më autorizuan të flas, ishte: shpërlani rrobat disa herë, me qëllim që të largoni detergjentet nga rrobat, për faktin se mbetja e detergjenteve në rroba dhe përdorimi i rrobave të tilla është i dëmshëm për shëndetin e njeriut. Andaj, këtu kërkoj nga Qeveria, gjegjësisht ministria përkatëse që me një shpejtësi në kohë të bëjë planin dinamik dhe të vërë në kontroll se a i plotësojnë këto detergjente standardet, e në veçanti edhe ato aromatike, të cilat nga mosdija qytetarët i përdorin si aromatizues të shtëpive, mirëpo përmbajtja gjegjësisht përbërja e tyre është jashtë parametrave të lejuar. Gjegjësisht në këtë mënyrë po shkaktohet një dëmtim i shëndetit qytetar dhe ne në Kuvend asnjëherë nuk merremi me problemet e përditshme qytetare, por vetëm me problemet, të cilat ne personalisht apo në interesin politik i cilësojmë si të dëmshme.

Mirëpo, përditshmëria qytetare është pak më ndryshe, kërkon më shumë vëmendje nga ne dhe Qeveria. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Grainca e ka fjalën. Nëse nuk paraqiten të tjerë, e përfundoj listën, nëse jo, atëherë e ndërpres sipas kohës së caktuar.

BLERIM GRAINCA: I nderuar zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Këto ditë vërtet kanë qenë aktuale shumë tema të karakterit nacional dhe tema të mëdha, për të cilat jemi marrë dhe kemi folur të gjithë, mirëpo unë sot dola këtu të flas për një problem të natyrës së shëndetësisë, më konkretisht, për spitalin e planifikuar tash sa kohë për t'u ndërtuar në regjionin e Ferizajt.

Të gjithë ju e dini se vendimi për të ndërtuar një spital të tillë është marrë para 4-5 vjetësh, mirëpo fatkeqësisht një spital i tillë akoma nuk ka filluar. Për mua si deputet i asaj zone vërtet është një projekt i rëndësisë së veçantë, jo që lidhet vetëm me shëndetin e qytetarëve, por edhe me sigurinë nacionale, për arsye se shëndeti duhet të jetë një prej prioriteteve të vendit tonë, por ka edhe efekte të mëdha ekonomike, për arsye se një shumë e madhe e parave të qytetarëve të asaj zone, të komunave Ferizaj, Shtime, Kaçanik, Han të Elezit, përfundojnë në bizneset e

Republikës së Maqedonisë. Janë me dhjetëra miliona euro, të cilat si rezultat i neglizhencës sonë, përfundojnë në Maqedoni dhe në vendet përreth.

Ky projekt ka filluar moti dhe fillimisht është thënë se është problem prona ku duhet të ndërtohet. Pastaj buxheti, pastaj procedurat dhe së fundi na rezultoi se problemi kryesor është shpallja e tenderit, apo, më mirë të themi, shpallja e fituesit për realizimin e këtij projekti. Para një kohe, u shpall një tender, ku fitues ishte kompania e nëntë me radhë. Pastaj u anulua dhe së fundi prapë, për të humbur edhe disa muaj me fillimin e sërishëm të procedurave.

Për mua është me interes të dimë nëse po zvarritet kjo punë si rezultat i ndikimeve politike për ta marrë faturën e suksesit, a po zvarritet ndërtimi i këtij spitali si rezultat i ndikimit të kompanive private që kanë biznese, më konkretisht spitaleve private, apo po shtyhet me qëllim që të eksportojmë para kesh dhe ndikimi që e kanë spitalet rajonale.

Unë mendoj se është koha e fundit që dikush, më mirë të them Ministria e Shëndetësisë, që fatkeqësisht nuk është këtu të na japë një shpjegim zyrtar përse s'po fillon kjo, kur do të fillojë dhe edhe sa kohë qytetarët e kësaj zone duhet të presin se kush do të shpallet fitues për ndërtimin e këtij spitali.

Është momenti i fundit që dikush të na japë këtë informatë për arsye se unë këto ditë kam provuar të marr edhe nga kolegët deputetë të të dy subjekteve qeveritare, edhe nga kolegët tjerë, edhe nga specialistë të kësaj fushe, por askush nuk di ta thotë asnjë fjalë të vetme pse po shtyhet përfundimisht ky projekt.

Prandaj, shpresoj që spitali të fillojë më shpejt, për arsye...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Kanë kaluar më shumë se pesë muaj nga vdekja në rrethana të pasqaruara dhe shumë të dyshimta të Astrit Deharit në Burgun e Prizrenit.

Astriti përfundoi në burg bashkë me pesë aktivistë të tjerë, si pasojë e një procesi të montuar politik, me qëllim të shpalljes së Lëvizjes “Vetëvendosje” si organizatë terroriste nga ky pushtet i kriminalizuar. Ai vdiq në kohën kur po mbahej padrejtësisht në burg dhe kur jetën e sigurinë e tij e kishte në dorë një institucion shtetëror, fatkeqësisht i kapur nga krimi.

Astriti u mor në burg me urdhra politikë dhe u soll në shtëpi me arkivol. Qeveria dhe Ministria e Drejtësisë e kanë përgjegjësinë kryesore pse Astrit Dehari vdiq në burg. Hetimet e pavarura janë

sabotuar qëllimisht nga pushteti politik. Procesi i hetimit është dëmtuar përfundimisht, kur para dy javësh e humbi jetën, në rrethana po ashtu të dyshimta, Naser Makolli, që ishte dëshmitari kyç në rastin e zbardhjes së vdekjes së Astritit. Naseri e ndante të njëjtën dhomë të burgut me Astritin dhe ishte i pari që e gjeti atë në momentet e fundit të jetës. Ai kishte dëshmuar se Astriti dy javët e fundit të jetës së tij ndihej i frikësuar dhe i kërcënuar.

Në vende demokratike, vdekja e një dëshmitari të rëndësishëm në duart e pushtetit bëhet problem i madh politik, kurse te ne krejt ky problem tejkalohej me dy fjalë, që janë “infeksion i zorrëve”.

Dua me këtë rast t’i bëj tri pyetje dhe mendoj se përgjigjet në këto tri pyetje janë kyçe për ta kuptuar të vërtetën për vdekjen e Astrit Deharit.

Pyetja e parë: Kush dha urdhër nga pushteti që të burgosej Astrit Dehari?

Pyetja e dytë: Kush i fabrikoj provat në Polici që ai të arrestohej padrejtësisht?

Dhe, pyetja e tretë: Kush pranoi në Gjyqësor që të bëhet instrument i pushtetit për eliminimin politik të Lëvizjes “Vetëvendosje”?

Zonja dhe zotërinj,
E vërteta do të dalë në shesh kurdoherë.

KRYESUESI: Fjalën e ka Shukrije Bytyqi, pastaj Labinotë Demi, Vjosa Osmani dhe Fatmir Shurdhaj.

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit, kryesues!
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Të nderuar kolegë deputetë,
Çështje që do të ngre sot është një kërkesë e qytetarëve të komunës së Malishevës.

I nderuar kryeministër,
Shikuar në prizmin historik, komuna e Malishevës ishte e lidhur me rajonin e Prizrenit. Ne nuk kemi dhe nuk ndiejmë asgjë të keqe për rajonin e Gjakovës, mirëpo ne jemi të thirrur ta mbrojmë interesin e qytetarëve në aspektin ekonomik, emocional, gjë që është edhe vlerë demokratike, të cilën ne duhet ta mbrojmë duke pasur parasysh se këta qytetarë dhe ne jemi të zgjedhur përfaqësues legjitimë në zgjedhjet lokale 2013. Kjo është një kërkesë e asamblistëve të Komunës së Malishevës, mbajtur në Kuvendin Komunal, më 26.11.2014.

Domethënë, këto janë shqetësimet e qytetarëve dhe banorëve të Malishevës, ku të gjithë përfaqësuesit e fshatrave i janë drejtuar Kuvendit Komunal, që ata presin përgjigje pozitive në kthimin në regjion të Prizrenit.

Edhe kryeministri i Republikës së Kosovës gjatë qëndrimeve disa herë në komunën e Malishevës ka premtuar që kërkesën e qytetarëve do ta ketë parasysh dhe se qytetarët e Malishevës do t'i kthehen regjionit të Prizrenit. Prandaj, presim që kjo të realizohet sa më shpejt. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Labinotë Demi e ka fjalën.

LABINOTË DEMI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni që sot para jush të ngre shqetësimin e madh, të cilin ua shkaktoi banorëve të fshatit Llabjan të Novobërdës një qytetar serb i Kosovës.

Në aktin e dhunës e të terrorit të shkaktuar, ky qytetar e kishte demoluar në masë të madhe objektin e një shkolle, objektin e xhamisë së fshatit, si dhe një ambulancë private. Krejt kjo ndodhi në ditën kur në vendin tonë u dha një alarm për brishtësinë e gjendjes së sigurisë në vend, respektivisht në prag të festës së Pashkëve, kur Policia ishte koncentruar për mbikëqyrje kryesisht pranë kishave.

Personi që e kishte kryer këtë akt terrorist nuk ishte hera e parë që vepronte diçka të tillë, sipas burimeve të Policisë. Ndërsa, ne derisa jemi mësuar që komunitetit serb sa herë që i mbetet hatri nga ndonjë fjalë e jona, përfaqësuesit tanë përkujdesen që t'u shtohet gjithmonë një dozë imuniteti, duke na përkujtuar ta ruajmë kushtetutshmërinë dhe ta kultivojmë tolerancën ndëretnike e ndërjetare. Por, çuditërisht në rastin e përmendur nuk dëgjuam as edhe një deklaram të vetëm për ta dënuar këtë akt terrorist, me përjashtim të dënimit të këtij akti nga deputetët e Listës serbe.

Ndërkohë, gjithmonë në sensin e jetësimit të kushtetutshmërisë, më lejoni të theksoj edhe një tjetër rast të mosrespektimit të saj në masë të madhe. Në ditën kur të gjitha institucionet e vendit po pushonin për respektimin e kësaj date të Kushtetutës, përkatësisht festës së saj, deri sa po vija nga Gjilani në Prishtinë pashë shumë nxënës në Graçanicë që shkonin në shkollë e ktheheshin nga shkolla. Kjo tregon se ky komunitet as nuk e respekton ditën, festën e Kushtetutës së vendit, por as pushimin pranveror të paraparë nga Ministria e Arsimit e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Andaj, në të ardhmen, kur të flasim për kushtetutshmërinë dhe respektimin, ose jo respektimin e saj le të mendojmë për të gjithë pa dallim. Vërejtjet e shumta që morëm pikërisht në ditën e

Kushtetutës për jofunksionalizimin e saj duhet të debatohen kur dhe ku duhet, por përderisa e tillë është në fuqi, e tillë edhe duhet të respektohet, pa dallim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Osmani e ka fjalën.

VJOSA OSMANI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë,

Diskutimi im i sotëm mund të konsiderohet nga shumëkush si ndërhyrje në drejtësi, megjithatë ky Kuvend i Kosovës ka diskutuar për raste të shumta, kur grupe të caktuara politike, apo anëtarë e aktivistë të partive politike kanë përfunduar me burg dhe janë gjykuar për krime të caktuara dhe ka pasur anëtarë të këtij Kuvendi që nuk janë pajtuar me ato vendime gjyqësore.

Mirëpo, akoma në këtë Kuvend, përkundër diskriminimit sistematik që bëhet ndaj grave në Kosovë, përkundër rritjes së numrit të dhunës në familje, si ato të raportuara, por edhe shumë raste të tjera, për të cilat shoqëria jonë është e vetëdijshme, por nuk raportohen, nuk është diskutuar dhe nuk kemi arritur që të shkojmë përtej retorikës së përdorur më 8 Mars.

Para disa ditësh u gjykua personi, i cili e vrau Zejnepe Berishën, duke e therë atë mbi njëzet herë me thikë para syve të fëmijëve të saj dhe po ashtu duke e lënduar edhe vajzën e saj, e cila tentonte ta mbronte nënën nga të therurat e babait të saj, i cili e kishte torturuar për gjashtëmbëdhjetë vjet me radhë.

Zejnepja, ashtu si edhe Diana Kastrati, si edhe shumë “Diana” e “Zejnepe” të tjera, kishte kërkuar mbrojtje nga shteti dhjetëra herë. Shteti asnjëherë nuk i kishte dalë në mbrojtje, sepse edhe kur kërkuan mbrojtje, edhe tani kur u gjykua vrasësi i Zejnepes, jeta e një gruaje nuk është konsideruar e barabartë me jetën e një burri. Madje, është banale të lexohen arsyetime se kinse paska pasur arsye për vrasje të tilla, sepse nuk ka arsyetim. Nuk ka arsyetim për dhunë ndaj bashkëshortit, e sidomos për vrasje të bashkëshortit para syve të fëmijëve.

Prandaj, të nderuar kolegë, jo vetëm që nuk është ndërhyrje në drejtësi kjo që po flas unë sot, por mosreagimi ynë si Kuvend i Kosovës dhe si shoqëri do të lejojë ndërhyrje të mëtejme në drejtësi për raste të tilla, siç ishte rasti i Dafina Zhubit, ku vrasja e saj tani e konstatuar nga ekspertë zviceranë ishte konsideruar vetëvrasje, siç është rasti i Dianës me arratisjen e vrasësit të saj dhe me pengimin e ekstradimit të tij.

Pra, ju ftoj që për raste të tilla ta ngremë zërin si Kuvend dhe si shoqëri dhe të debatojmë për të gjetur një zgjidhje, e cila parimin e barazisë para ligjit, të përcaktuar në Kushtetutën tonë, do ta jetësojë në të gjitha gjykatat dhe në të gjitha institucionet tjera të sigurisë. Përndryshe, nuk e di edhe sa kohë do të kalojë që të mbushemi mend si shoqëri dhe të mos flasim, pra, vetëm...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Shurdhaj e ka fjalën.

FATMIR SHURDHAJ: I nderuar nënkryetar,

Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ka kohë që Qeveria e Kosovës po tenton t'i nivelojë pagat, e unë dua të ngre një çështje, që është shumë e rëndësishme kur kemi të bëjmë me pagën minimale.

U bënë shtatë vjet që paga minimale me kërkesat e sindikatës në Këshillin Ekonomiko-Social kanë mbetur 170 euro, e cila nuk i plotëson as kushtet minimale vetëm për një njeri për jetesë brenda muajit, duke llogaritur 52 ushqime të të ushqyerit të njeriut. Ndërsa, të gjitha rekomandimet që japin partnerët ndërkombëtarë këtu thonë se kemi ngritje ekonomike, gjithashtu edhe Qeveria që disa vjet thotë se kemi ngritje ekonomike 3 - 4%.

Nëse, ka ngritje ekonomike 3 - 4%, pse paga minimale të mbetet 170 euro?

Këtë tendencë që kjo pagë të mbetet kështu e kam vërejtur edhe në deklaratimet e ministrit Abrashi, i cili e udhëheq Këshillin Ekonomiko-Social në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Kjo është shkelje e të drejtave të punëtorëve, sepse këtë shans fatkeqësisht po e shfrytëzon sektori privat dhe po i shkel të drejtat e punëtorëve maksimalisht.

Unë mendoj që Qeveria e Kosovës, në këtë rast Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale me partnerë e dikastere të Qeverisë dhe partnerë të tjerë socialë, me Odën Ekonomike dhe Sindikatën, duhet ta rishqyrtojë pozicionin e pagës minimale 170 euro, sepse janë pjekur të gjitha kushtet që paga minimale të ngrihet në 220 euro, sipas kërkesës së sindikalistëve, që është bërë që shtatë vjet me radhë.

Kërkoj që të mos shkelen të drejtat e punëtorëve. Kërkoj nga Qeveria e Kosovës që seriozisht ta rishqyrtojë pagën minimale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pika e parë e rendit të ditës është shteruar.

2. Koha për pyetje parlamentare

Në bazë të nenit 45, paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit koha për pyetje parlamentare zgjat 60 minuta.

Për këtë seancë i kemi 22 pyetje parlamentare. Po fillojmë me pyetjet, për të cilat ministrat janë në sallë dhe pastaj me të tjerat. Në qoftë se vijnë, vazhdojmë me të tjerët, në qoftë se jo, deputetët janë të lirë t'i lexojnë pyetjet e tyre sipas radhës.

Fillojmë me pyetjen e parë. Deputetja Mexhide Mjaku-Topalli, pyetje për ministrin Lutfi Zharku. Zonja Topalli, e keni fjalën.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër,

Në vitin 2013, bizneset në qytetin e Ferizajt janë ftuar për konsultim në lidhje me ndërtimin e rrethrotullimit tek ura e madhe në Ferizaj dhe në atë kohë projekti ka qenë që rrethrotullimi të ndërtohet në sipërfaqe të tokës. Të gjitha bizneset janë dakorduar për shkak se nuk janë cenuar interesat e asnjë biznesi.

Po ashtu, ka qenë një qasje e papenguar te rrethrotullimi.

Sipas këtij projekti tashmë që është ndryshuar, bizneset nuk do të kenë mundësi të zhvillojnë veprimtarinë afariste, kur dihet se këtyre personave të bizneseve u janë dashur 30 vjet të arrijnë deri këtu si dhe 250 punëtorë do të mbeten pa punë.

Pyetja ime është kështu: Duke e ditur se në disa qytete janë ndërtuar disa rrethrotullime për interesa të bizneseve, për t'u mundësuar bizneseve hyrje-dalje për qarkullim më të lehtë, a do të bëni të mundur që në hyrje të qytetit të Ferizajt, që rrethrotullimi të ndërtohet në sipërfaqe të tokës dhe jo mbi tokë, siç është planifikuar, dhe pse po ndodh ky ndryshim?

KRYESUESI: Zoti Zharku, e keni fjalën.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar nënkryetar,

Ministër,

Deputetë,

E nderuar deputete Topalli,

Më lejoni në fillim të sqaroj se rrugët nacionale dhe rajonale, në bazë të Ligjit mbi rrugët, janë në kompetencë ekskluzive të Qeverisë, gjegjësisht të Ministrisë së Infrastrukturës dhe është përgjegjësi e saj projektimi, ndërtimi, rekonstruktimi dhe mirëmbajtja e tyre.

Në këtë aspekt, komunat nuk kanë të drejtë të punojnë projekte për rrugë që nuk janë në kompetencë të tyre.

Përkundër kësaj, në frymën e bashkëpunimit, Ministria e Infrastrukturës ka pranuar nga Komuna e Ferizajt një projekt preliminar, gjegjësisht ideor, i cili i është përcjellë Bankës Evropiane për

Rindërtim dhe Zhvillim, por i njëjti nuk është pranuar nga ata dhe është kërkuar nga Ministria e Infrastrukturës që të hartohet projekti i ri detal.

Ministria e Infrastrukturës, nëpërmjet kompanisë së kontraktuar për hartimin e projekteve, vitin e kaluar ka hartuar projektin detal për zgjerimin e këtij segmenti të rrugës nacionale.

Projekti është hartuar në bazë të normave teknike në fuqi dhe duke i kushtuar kujdes të veçantë qasjes së bizneseve në këtë rrugë, por duke marrë për bazë dendësinë e trafikut, gjegjësisht numrin e frekuentimit të automjeteve nëpër këtë segment rrugor që sillet rreth 24 deri 25 mijë automjete në ditë.

Kryqëzimi që ju i referoheni ka qenë vetëm një projekt ideor dhe nuk ka qenë i studiuar nga aspekti i frekuentimit të automjeteve që vijnë nga katër drejtimet e rrugëve.

Siç e dini, në këtë vend kryqëzohen dy rrugë nacionale: ajo Prishtinë - Shkup dhe Gjilan - Ferizaj.

Prandaj, zgjidhja me dy nivele bën të mundur qarkullimin e papenguar të automjeteve në këtë kryqëzim, kurse zgjidhja në nivel do të përcillet me vështirësi. Kurse në orët më të ngarkuara të trafikut do të mund të shkaktonte edhe bllokim të rrugëve të brendshme të qytetit të Ferizajt.

Siç jemi të gjithë dëshmitarë, ky kryqëzim që është ndërtuar para 50 vjetëve, kur frekuentimi i automjeteve ka qenë tejet i vogël, edhe sot është në dy nivele. Prandaj, zgjidhja aktuale e projektuar në esencë vetëm e avancon zgjidhjen aktuale, duke mundësuar qasje më të mirë, më të shpejtë dhe më të sigurt për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion.

Më lejoni në fund të konfirmoj, ashtu siç e pohoni edhe ju, se Ministria e Infrastrukturës po i kushton kujdes të veçantë kërkesave dhe shqetësimeve të të gjithë banorëve dhe bizneseve që preken nga investime në infrastrukturën rrugore në secilin rast veç e veç për të gjetur zgjidhje optimale.

Edhe çështja që ju e keni ngritur, që në esencë ka të bëjë vetëm me një biznes, është shqyrtuar në detaje nga ekipi i ekspertëve në ministri dhe e njëjta i është përcjellë edhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për shqyrtim, duke marrë parasysh se ky institucion është instanca e fundit për aprovimin e projektit dhe presim përgjigjen e tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja deputete?

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: I nderuar ministër,

Unë këtu kam ankesat nga 25 biznese, e jo vetëm të një biznesi dhe në emër të tyre flas, në emër të 25 bizneseve që janë përreth, në pjesën për ku po flasim.

Ndërsa, çështja që desha të vazhdoj është: Në seancën e kaluar nga kryeministri ne e morëm një përgjigje se jeni duke bërë, apo jeni duke e shqyrtuar këtë çështje për të gjetur një zgjidhje si për çështjen tek ura në Ferizaj, po ashtu edhe në fshatin Gurëz. Kështu që unë prita nga ju që do të kemi ndonjë përgjigje se ju jeni duke punuar për të mirën dhe për interesat e të gjithë këtyre banorëve, si të qytetit të Ferizajt, po ashtu edhe të qytetit të Vitisë.

Për arsye se edhe këta janë banorë dhe kanë të drejtë t'i gëzojnë të drejtat e tyre dhe unë po pres nga ju të më japin një përgjigje më ndryshe...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: E nderuar deputete,

Çështjen e dy qasjeve kyçe në autostradë e ka sqaruar në seancën e fundit kryeministri, natyrisht unë nuk kam çka t'i shtoj. Çështjet që i përmenda i kemi marrë të gjitha masat, e kemi edhe ankesën që ju e përmendët, për atë arsye e përmenda që ne i kemi kryer të gjitha konsultimet në ministri, është avancimi i zgjidhjes aktuale dhe e kemi përcjellë në BERZH, për shkak se ata e financojnë.

Me gjithë dëshirë nëse Banka Evropian për Rindërtim dhe Zhvillim, unë dhe gjithë ministria natyrisht do t'i zbatojmë rekomandimet që i jep Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Faton Topalli ka pyetje për ministrin Ferat Shala.

FATON TOPALLI: Faleminderit!

I nderuar ministër,

Mes fshatit Komogllavë dhe Gurëz të komunës së Ferizajt ekziston një deponi transite e mbledhje së mbeturinave, e cila është vendosur në këtë lokacion prej vitit 2004.

Në këtë deponi mbledhen të gjitha plehrat e komunës së Ferizajt dhe prej aty duhet të transportohen pastaj në Gjilan.

Mjerisht, kjo deponi nuk ka funksionuar asnjëherë, është paraparë të hiqet dhe ka ngjallur vazhdimisht protesta të banorëve të dy fshatrave.

Deponia është çështje e Komunës së Ferizajt, por ajo kundërmon dhe vështirëson jetën e qytetarëve në të dy vendbanimet.

Pas protestave që janë zhvilluar aty nga aktivistët të Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe qytetarët e dy fshatrave, është hequr për një muaj me radhë, pra ka funksionuar dhe tash ka kohë që prapë nuk funksionon. Ajo vetëm që kundërmon, por edhe e ndot ambientin dhe qëndrimi aty është i pamundshëm për banorët dhe ata janë ankuar vazhdimisht. Pra, nuk është vetëm çështje a i takon komunës apo jo, pra është edhe çështje e ndotjes së ambientit.

Në emër të banorëve të dy fshatrave dua t’ ju pyes a e keni të njohur këtë problem dhe nëse po, çka keni ndërmarrë për zgjidhjen e tij apo çfarë do të ndërmerrni?

KRYESUESI: Zoti ministër Shala, e keni fjalën.

MINISTRI FERAT SHALA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Topalli,

Po, jemi të informuar për problematikat ndotëse të deponisë transfer në Gurëz dhe mbështetur në kompetencat që ka Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor, me trupat e saj inspektuese ka vizituar disa herë çështjen e gjendjes mjedisore të deponisë.

Ju saktësisht e dini që deponia menaxhohet nga kompania për menaxhimin e deponive, që është institucion tjetër dhe ka një hierarki tjetër, pra është ndërmarrje publike që nuk i përgjigjet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, megjithatë në kuadër të pjesës së menaxhimit mjedisor ne kemi kryer të gjithë hapat inspektues dhe kemi dhënë rekomandimet. Kemi pasur raste kur edhe kemi ngritur plotë padë për mosmenaxhimin e mirë dhe gjendjen jo të mirë të kësaj deponie transfer, e cila është në shërbim të komunës së Vitisë, Shtërpcës, Ferizajt, Kaçanikut dhe Hanit të Elezit.

Realisht, ne si ministri e kemi vlerësuar se kjo deponi duhet të rrisë shkallën ose ta përmirësojë shkallën e menaxhimit, pra nga instancat menaxhuese dhe do realisht investime mbi 700 mijë euro, në bazë të vlerësimit që kanë bërë inspektorët dhe ekipet profesionale të Ministrisë së Mjedisit, për t’u kthyer në gjendje të pranueshme dhe mirë të menaxhueshme.

Mungojnë, sipas informacioneve që kemi, investimet në këtë deponi dhe aktualisht deponia nuk ka leje mjedisore për shkak të mospërbushjes së këtyre kritereve dhe standardeve, pra një dokument që duhet të pajiset nga ne, për shkak të këtyre defekteve edhe nuk është pajisur.

Shpresojmë dhe besojmë që organet përgjegjëse të KMDK-së të pushtetit lokal dhe instancave të tjera që janë direkt të lidhura me menaxhimin e kësaj problematike, të marrin masa, të pajisen edhe me leje dhe të jenë në nivel të shërbimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ke pyetje shtesë, zoti Topalli?

FATON TOPALLI: Ju po pajtoheni që aty ndotet ambienti dhe thatë që keni bërë rekomandime. Pyetja ime shtesë është: çfarë do të bëni në qoftë se këto rekomandime nuk do të implementohen? Për arsye se e dini që as rekomandimet e Kuvendit të Kosovës nuk po implementohen.

Dhe e dyta, para 3-4 javësh kemi biseduar për ujësjellësin në fshatin Greme dhe për ndërtimin e tij, respektivisht përzierjes së ujit të kanalizimit me shpimin që është bërë aty për ujësjellës.

Ndërsa kemi biseduar edhe për çështjen e kundërmimit të kanalizimeve të Ferizajt, në fshatin Varosh. Unë dje kam qenë në Varosh dhe kam parë që deri tash nuk është ndërmarrë asgjë në këtë drejtim, a mund të më përgjigjeni edhe në këtë pyetje?

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI FERAT SHALA: I nderuar deputet,
Sikur në çdo rast tjetër, ne do të zbatojmë ligjin, ajo është përgjegjësi jona.

E dyta, sa i përket problematikave të përmirësimit, ne vetëm këtë vit kemi donacion mbi 8 milionë euro të dhëna nga Qeveria gjermane dhe tani jemi shumë afër fillimit të një procesi të madh në rehabilitimin e deponive që i kanë këto problematika, sepse gjendja e kësaj situate, e këtij sektori është jo e mirë, por shpresojmë që do të ndërmerren masa mbi bazën e linjave buxhetore.

Sa i përket pyetjeve të tjera, janë ekskluzivisht përgjegjësi e pushteteve lokale dhe janë adresuar gabim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haskuka ka pyetje për ministrin Shala.

MYTAHER HASKUKA: Faleminderit!

Çështja, sipas Ligjit nr. 04/L-027 për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, neni 2, pika 2 cakton që “shteti është përgjegjës për organizimin e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, si sistem unik dhe integral shtetëror”.

Po ashtu, sipas nenit 4, pika 1, detyra themelore e sistemit të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera janë zbulimi i monitorimeve dhe hulumtimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, parandalimi i fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera.

Në lagjen Rexhaj, në fshatin Korishë të Prizrenit, që nga viti i kaluar ka pasur rrëshqitje të dheut dhe aty një lagje e tërë është e rrezikuar nga rrëshqitja e dheut.

Disa shtëpi tanimë kanë dëmtime strukturale në beton dhe këto familje janë detyruar të flenë tek të afërmit e tyre, nga se nuk kanë siguri të flenë në shtëpitë e tyre.

Për këtë gjendje asamblistët e Lëvizjes “Vetëvendosje” në Komunën e Prizrenit kanë paralajmëruar dhe kanë kërkuar intervenim urgjent, por shumë pak është bërë deri më tani dhe gjendja është përkeqësuar gjatë dimrit dhe sidomos tani me këto të reshura të fundit.

Pyetja për ministrin është: a jeni në dijeni për gjendjen në këtë lagje dhe për rrezikun që u kanoset qytetarëve nga rrëshqitja e dheut? Nëse po, cilat janë veprimet që i ka ndërmarrë Qeveria apo do t’i ndërmarrë për sigurinë e qytetarëve dhe për mbrojtjen e tyre nga fatkeqësitë natyrore sipas ligjit të lartshënuar? Faleminderit!

KRYESUESI: Ministër, e keni fjalën.

MINISTRI FERAT SHALA: Faleminderit, kryesues!

I nderuar deputet,

Saktësisht më 16. 8. 2016 Inspektorati i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Departamenti për Emergjencë pranë Kuvendit Komunal të Prizrenit si dhe Drejtoria për Emergjencë të nivelit qendror kanë inspektuar zonën, kanë marrë të gjitha hapat, kanë konstatuar situatën dhe janë dokumentuar të gjitha problematikat dhe shkalla e rrezikshmërisë.

Mbi bazën e informacioneve që kemi, pushteti lokal ka ndërmarrë hapa, ka pastruar zonën, ka krijuar një situatë emergjente tjetër dhe realisht është duke u monitoruar nga të gjitha nivelet, edhe ai lokal edhe ai qendror, dhe situata është nën kontroll. Priten investime, janë krijuar edhe disa investime lehtësuese dhe siguroese, kanale drenazhuese për largimin e ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore, e kështu me radhë dhe jemi duke e monitoruar situatën.

Kemi identifikuar edhe familjet potencialisht që mund të rrezikohen, numrin e anëtarëve, shkallën dhe janë dhënë rekomandime që pushteti lokal, Drejtoria e Emergjencave dhe pushteti qendror të jenë më afër kësaj. Faleminderit!

KRYESUESI: Pyetje shtesë, zoti Haskuka?

MYTAHER HASKUKA: Faleminderit, ministër!

Për këto po e dimë që vitin e kaluar ka pasur disa intervenime aty, por unë pas Vitit të Ri kam pasur ankesa nga qytetarët që jetojnë në atë lagje që prapë ka filluar rrëshqitja, ngase punët që janë bërë kanë qenë të pamjaftueshme për ta ndalur rrëshqitjen e dheut aty, ngase është dashur minimum edhe nja dy vende të çelen drenazhe ose bunar që të tërhiqet uji dhe të krijohen pena për mbrojtjen e lagjes nga rrëshqitja e dheut, për atë e kam bërë këtë pyetje. Faktikisht është dashur ndoshta edhe një herë të bëhet një inspektim tash pas Vitit të Ri dhe të përcaktohet gjendja e re që është krijuar në atë fshat. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

MINISTRI FERAT SHALA: Kundër shqetësimeve që janë të drejta, por që janë adresuar tashmë, pushteti lokal është duke punuar, kanë planet e veta, masat sanuese, kështu së paku kemi informacione dhe ne do ta monitorojmë dhe gjithsesi që do ta inspektojmë në moment që do të jetë më i përshtatësh dhe do të koordinohemi me pushtetin dhe institucionet e tjera që shkalla e rrezikut të zvogëlohet apo të sanohet fare. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Shqipe Pantina, pyetje për ministrin Lutfi Zharku.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit!

Zoti ministër,

Besoj e dini edhe ju se aeroporti i Prishtinës është ndër të vetmit, nëse jo i vetmi në Evropë për ku nuk ka transport publik, do të thotë qytetarët për të shkuar deri atje i duhet çdo herë të paguajnë taksi ose të shkojnë me transportet e tyre private.

Pyetja ime për ju, e cila është shtruar qysh nga janari, në fakt, është: pse nuk ka kompani të licencuara që ofrojnë transport publik për në aeroport dhe kur prisni të rregulloni çështjen e transportit publik për në Aeroportin e Prishtinës? Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar nënkryetar,

Kryeministër,

Ministra,

Deputetë,

E nderuar deputete Pantina,

Ministria e Infrastrukturës që nga fillimi objektiv të saj e ka pasur ofrimin e shërbimeve të transportit rrugor të udhëtarëve për Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” nga të gjithë qytetet e Kosovës, e në veçanti nga Prishtina nëpërmjet autorizimit të operatorëve të transportit.

Bazuar në autorizimet ligjore që derivojnë nga Ligji për transportin rrugor, Ministria e Infrastrukturës më 20 maj 2016 ka shpallur gjithsej 18 rende të udhëtimit për operim në relacionin Prishtinë - aeroport dhe anasjelltas, në çdo orë duke filluar nga nisja nga ora 5:00 në mëngjes deri në 23:00 në mbrëmje, kur do të jetë kthimi i fundit nga aeroporti.

Shpallja e përzgjedhjes së operatorit të transportit për këtë linjë është bërë më 20 korrik 2016.

Megjithatë, duhet të theksohet se këto nisje nuk janë funksionale ende për shkak të trajtimit të disa çështjeve që lidhen me shfrytëzimin e hapësirës së aeroportit nga ana e operatorëve të transportit rrugor që ushtrojnë veprimtarinë e transportit të rregullt me autobus.

Aeroporti Ndërkombëtar “Adem Jashari” ka ngritur shqetësimet në lidhje me aspektin e sigurisë në aeroport gjatë operimit apo qëndrimit të autobusëve dhe ka propozuar që këto çështje të rregullohen me marrëveshje direkte me operatorë të transportit.

Në anën tjetër, ne si ministri konsiderojmë se këto çështje duhet të rregullohen nëpërmjet një marrëveshjeje bashkëpunimi apo memorandum-mirëkuptimi në mes të ministrisë dhe aeroportit, të cilën pastaj do të ishin të obliguar ta respektojnë të gjithë operatorët e transportit të autorizuar nga ministria.

Qasja e këtillë e ministrisë bazohet në faktin se linjat janë pronë e ministrisë në përputhje me Ligjin për transportin rrugor, e jo të operatorëve të transportit, kurse siç e cekta në fillim, ne planifikojmë të kemi linja direkte edhe na qytete të tjera.

Aktualisht, ekspertët e të dyja palëve kanë finalizua memorandumun e mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Aeroportit Ndërkombëtar “Adem Jashari”, në të cilën do të bëhet rregullimi i të drejtave dhe obligimeve të të gjithë operatorëve.

KRYESUESI: Zoti, Berisha, ulu në vend... edhe juve që jeni ulur po jua tërheq vërejtjen se ju nxjerr jashtë nëse bisedoni me deputetë, nuk jeni të bisedoni me deputetë.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: ...memorandumi është nënshkruar nga ana jonë dje, në realitet presim që këto 2-3 ditë ta nënshkruajë edhe aeroporti dhe të fillojë zbatimin e linjës. Faleminderit!

KRYESUESI: Po, pyetje shtesë ka zonja Pantina?

SHQIPE PANTINA: Faleminderit!

Në fakt, ministër, këtë pjesën e fundit nuk arrita as ta dëgjoj përgjigjen, përveç asaj që thatë një memorandum është nënshkruar dje. Kur pritët që tash të funksionalizohet dhe a do të fillojë para

fillimit të zezonës së pushimeve verore, kur pritet të ketë fluks më të madh të udhëtarëve, gjegjësisht qytetarëve tanë që vijnë për ta vizituar vendlindjen?

KRYESUESI: Urdhëro, zoti ministër!

MINISTRI LUTFI ZHARKU: Zonja deputete,

Memorandumi nga ana e ministrisë është nënshkruar dje, e kemi dërguar në aeroport, ne presim që ata sot, eventualisht gjatë javës ta nënshkruajnë. Në përputhje me ligjin operatori duhet të fillojë brenda pesë ditësh të funksionojë, ne presim që javën e ardhme të fillojë, nëse çdo gjë shkon në rregull nga ana e aeroportit. Përndryshe, e ndërpremë këtë proces nëse operatori nuk e mban linjën, e ndërpremë këtë proces, shpallim linja të reja, do të ketë shpallje të reja për linja të reja apo për operatorë të rinj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Topalli ka pyetje për ministrin Lutfi Zharku.

FATON TOPALLI: Faleminderit! Unë dua të shtroj një pyetje, e cila në fakt, është shtruar edhe më herët, por nuk ka ndonjë përgjigje konkrete.

Grupi i deputetëve të Ferizajt ka bërë një kërkesë pranë Qeverisë së Kosovës, me sa e di, kërkesa i është drejtuar kryeministrit në lidhje me autostradën për Han të Elezit dhe ka të bëjë me daljen e Ferizajt për këtë autostradë. Dëmtohen shumë biznese në Ferizaj, duke përfshirë edhe fshatrat përreth sa i përket kësaj çështjeje.

Prandaj, do të dëshiroja të na thoni edhe një herë dhe saktësisht a do të krijohet mundësia, ngase ju jeni përgjegjësi kryesor, zoti ministër. Prandaj, po pyes prej jush a do t'i krijoni mundësi Ferizajt dhe fshatrave përreth që të kenë qasje në autostradë? Të keni parasysh që Ferizaj është qendër e biznesit, të keni parasysh që është njëri prej tri qyteteve më të mëdha në Kosovë dhe do të ishte shumë keq që të mbetet qyteti i Ferizajt dhe fshatrat përreth pa hyrje në autostradë.

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: Faleminderit, nënkryetar!

Kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

Ministra,

Deputetë,

I nderuar deputet Topalli,

Kësaj pyetje i është përgjigjur kryeministri javën e kaluar, unë veç mund ta konfirmoj atë që e tha kryeministri. Do ta mbledhim komisionin ndërministror dhe do të shqyrtohet kërkesa e deputetëve të Ferizajt. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shitesë, nuk keni. Faleminderit! Zoti Abdyl Ymeri ka pyetje për kryeministrin Isa Mustafa, e keni fjalën.

ABDYL YMERI: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Kolegë deputetë,

Kontrata në mes të Telekomit të Kosovës dhe “Dardaphone. net” apo “Z-Mobile” e nënshkruar në janar të vitit 2009 po shihet që ka qenë e dëmshme dhe problematike për Telekomin e Kosovës.

Kjo kontratë, e cila themeloi operatorin virtual “Z-Mobile” parashihte që këtij operatori t’i jepeshin 200 mijë numra, ndërsa raporti të hyrave mes dy kompanive do të ndajë 73% për “Z-Mobile” dhe 27% për Telekomin e Kosovës.

“Z-Mobile” arriti brenda një kohe t’i shesë 200 mijë numra dhe bëri kërkesë për një bllok prej 100 mijë numrash të rinj. Kjo kërkesë u refuzua nga bordi i drejtorëve, mirëpo “Z-Mobile” e pakënaqur në refuzimin e kërkesave të parashtruara dhe mosrespektimin e kontratës më 14.04.2015 u ankua në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit.

Tani më kemi vendimin e Gjykatës së Lartë Angleze, me selinë në Londër, e cila ka hedhur poshtë ankesën e Telekomit të Kosovës ndaj vendimit të Tribunalit të Arbitrazhit të Odës Ndërkombëtare të Tregtisë.

Vendimi për shkelje të kontratës, i vërtetuar nga kjo gjykatë, konsiston në katër pika themelore, për të cilat arbitrit ndërkombëtarë kanë gjetur shkelje nga Telekom i Kosovës: mosfurnizimi me simkartela, mosfurnizimi me numra, mosformimi i shërbimeve 3G dhe 3GJ dhe ulja e cilësisë së shërbimeve.

Zoti kryeministër,

Cilat masa i keni ndërmarrë që të mos të vijë deri te kjo dhe çka do të ndërmerrni tani pasi që kemi një vendim përfundimtar, i cili do ta dëmtojë rëndë ndërmarrjen Publike Telekomit i Kosovës, kur dihet se Qeveria e Kosovës është pronare e 100% të aksioneve të kësaj ndërmarrjeje. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti kryeministër Mustafa, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: I nderuar deputet,

Në seancën e kaluar, në të vërtetë para një seance të Kuvendit unë kam dhënë një përgjigje lidhur me këto çështje, edhe lidhur me Telekomin e Kosovës dhe me rastin e “Dardaphonit”. Është konstatuar si Kosova do të paguajë një dëm të madh nga paraja publike prej rreth 30 milionë eurosh për shkak të disa procedurave, të cilat as për mua si kryeministër, as për Qeverinë nuk janë akoma të qarta, as vendimi i Gjykatës së Arbitrazhit.

Janë duke u zhvilluar tani procedurat në drejtësinë kosovare lidhur me këtë, prej të cilave unë tani nuk mund të them se çfarë rezultatesh mund të marrim, por rezultati më i keq do të jetë që për shkak të papërgjegjësive Kosova dhe paraja publike do të humbë. Do t’i humbim rrafsh 30 milionë euro, për të cilat nuk kemi reagim publik, kemi 2-3 pyetje të deputetëve, po s’ka asnjë reagim publik për këtë problem, i cili është problem shumë i madh për ne.

Tani në qoftë se mua më shtrohet pyetja se çfarë ka ndërmarrë Qeveria ose çfarë kam ndërmarrë unë, ka qenë në përgjegjësinë e Telekomit të Kosovës, sepse është organizatë e pavarur publike që ata të kujdesen për kontratat që i lidhin dhe ta marrin përgjegjësinë ligjore dhe juridike për veprimet e tyre, edhe bordi i kësaj kompanie publike, edhe menaxhmenti i kësaj kompanie publike të sigurojnë mbrojtje adekuatë në Gjykatën e Arbitrazhit, sepse dikush do të përfitojë këtu. Unë nuk e kam të qartë kush do të përfitojë prej këtyre 30 milionë eurove, edhe unë si kryeministër, edhe Qeveria do të kërkojmë përgjegjësi ligjore për shkak të një kontrate, e cila duhet të vlerësohet se a ka qenë në rregull apo s’ka qenë në rregull, sa ka qenë e arsyeshme të bëhet një kontratë e tillë me “Dardaphone” atëherë kur është bërë dhe cilat arsye e kanë shtyrë Telekomin të pranojë një kontratë të tillë dhe pse janë humbur ose po humben 30 milionë pasuri publike.

Në qoftë se dikush më pyet se çfarë do të ndërmarrë Qeveria ose çfarë barre do të ketë Qeveria, unë mund të them se Qeveria nuk do ta marrë asnjë barrë të kësaj, sepse është kompania publike, e cila është e pavarur dhe e cila do ta marrë përgjegjësinë për veprimet e saj, por se prona publike do të dëmtohet për 30 milionë euro tash për tash. Çka do të bëhet, të themi, përfundimisht me vendimet që duhet t’i marrin organet e drejtësisë, është punë tjetër.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Ymeri?

ABDYL YMERI: Faleminderit!

Zoti kryeministër,

Tani më i kemi humbur 5 milionë euro në tenderin e pasaportave, 30 milionë euro me “Z-Mobile”, çka do të ndodhë nëse e humbim edhe kontestin gjyqësor me AXOS-in? Kjo po i bie që nga këto raste, si do që t’i quani, afëra, dështime, apo diç tjetër, Buxheti i Kosovës apo taksapaguesit kosovarë do të dëmtohen me miliona euro, përfshirë këtu edhe shpenzimet enorme për të paguar avokat, këshilltar transaksionesh, e çka do të jetë. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Po ajo që do të ndodhë mendoj se duhet të ndodhë përgjegjësia penale dhe përgjegjësia politike e gjithë atyre që janë shkaktarë të këtyre humbjeve. Tjetër përgjigje unë nuk kam si kryeministër, por duhet të përgjigjet dikush pse ne i humbim 5 milionë e 300 mijë në procesin e pasaportave dhe më shumë se këto, jo vetëm 5 milionë, sepse edhe një shumë është paguar përpara, që ka shkuar për asgjë. Pse duhet t'i humbim 30 milionë për Telekomin, dhe në qoftë se e humbim pse e humbim një shumë për të cilën unë tash nuk mund të paragjykoj se do t'i humbim në relacion me AXOS-in, sepse aty janë marrë të gjitha masat që ne ta angazhojmë kompaninë, e cila do të na mbrojë si Kosovë në këtë arbitrazh, dhe unë s'kisha për ta hapur diskutimin për të, sepse procesi është në vijim. Prandaj, çdo diskutim këtu mund të ndikoj në këtë proces, mirëpo për të gjitha këto raste unë mendoj që duhet të pasojë përgjegjësia juridike dhe përgjegjësia politike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër! Deputetja Shukrije Bytyqi, pyetje për ministrin Arsim Bajrami.

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit, kryesues!

Gjimnazi i Specializuar Matematikor është një aset kombëtar i formuar në bazë të marrëveshjes së mirëkuptimit ndërmjet tri institucioneve relevante, MASHT-it, Universitetit "Hasan Prishtina" dhe Komunës së Prishtinës me numër 135/01-2, datë 27. 8. 2014. Dhe, ky gjimnaz ballafaqohet me shumë probleme.

Pyetja që unë do t'ia bëj ministrit të Arsimit është: Pse ministër edhe sot e kësaj dite ky aset kombëtar e ka vetëm një person, staf menaxheria, administrator, sekretar, e gjithçka tjetër?

Pse asnjë institucion nuk i ka përmbushur zotimet e marra nga marrëveshja?

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

I nderuar zoti kryeministër,

Të nderuar deputetë,

E nderuar deputete Bytyqi,

Më lejoni të ju informoj që Gjimnazi i Specializuar Matematikor është duke u trajtuar si një gjimnaz elitari i interesit të veçantë publik edhe mbi bazën e marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Komunës së Prishtinës dhe Universitetit të Prishtinës.

Dhe, më lejoni të tregoj se çfarë ne kemi ndërmarrë këto vite për ta mbështetur këtë gjimnaz.

E para, ne këtë gjimnaz e kemi shpallur si një gjimnaz të specializuar për të cilin do të jetë përgjegjës Ministria e Arsimit, pra e kemi ngrehur në nivel republikan dhe do ta mbështetim në vazhdimësi që ky gjimnaz të ndërtohet si një shkollë e specializuar e nivelit shtetëror, sepse përfshin nxënësit nga tërë territori i Republikës së Kosovës.

E dyta, të gjithë nxënësit e këtij gjimnazi, pra janë rreth 120 nxënës, janë nxënës të subvencionuar dhe ata tani më të gjithë e kanë marrë gjithë bursën shtetërore nga Ministria e Arsimit, bursë kjo e cila është e mjaftueshme për t'iu mbuluar shpenzimet e transportit nga cilado pjesë e Kosovës dhe shpenzimet e ushqimit. Domethënë, ata të gjithë tani në konto e kanë bursën, të cilën unë e kam akorduar pas vizitës këtij gjimnazi si shenjë mbështetjeje.

E treta, ne jemi duke e përfunduar Kurrikulën e specializuar për këtë gjimnaz, në mënyrë që ky gjimnaz ta ruajë traditën elitare dhe t'i stimulojë nxënësit që jo vetëm të shkojnë në këtë gjimnaz, por pastaj edhe t'i vazhdojnë studimet për matematikë, të cilat paraqesin interes të veçantë publik.

Dhe, veprimi i katërt, ne jemi duke punuar në gjetjen e stafit të përhershëm, pra mësimdhënësve të përhershëm, sepse aktualisht ky gjimnaz mbështetet tërësisht nga Katedra e Matematikës e Fakultetit të Shkencave Matematiko-Natyrore mbi bazën e marrëveshjes së Universitetit të Prishtinës dhe ne jemi të interesuar që të gjejmë një staf të përhershëm dhe së shpejti do ta kemi një zgjidhje, kur ky gjimnaz do t'i ketë mësimdhënësit e vetë, qoftë edhe ata universitarë, me kontrata të përhershme, në mënyrë që vërtet këtyre nxënësve t'ua ofrojmë një mësimdhënie çfarë e kërkon një gjimnaz i shkollës së mesme, sepse nuk mund të pretendojmë që t'ua ofrojmë një mësim akademik çfarë afrohet në Katedrën e Matematikës.

Dëshiroj të ju siguroj që Ministria e Arsimit në tërësi do ta mbështesë këtë gjimnaz edhe nëpërmjet një këshilli drejtues, i cili funksionon dhe i cili tani merr vendime.

Unë i kam vizituar edhe prindërit e nxënësve, edhe këshillin drejtues, mësimdhënësit dhe nxënësit, për të treguar përkushtimin që vërtet ky gjimnaz ta vazhdojë traditën tani për disa dekada, që të jetë një shkollë e talenteve, një shkollë elitare, e cila do të mundësojë që ne vërtet të kemi nxënës të mirë, që nesër do të jenë edhe mësimdhënës të suksesshëm.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë?

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit!

Po, ministër, vërtet është që ky është një aset kombëtar dhe është e mira kjo që shkollë tani i ka 118 nxënës, prej tyre domethënë gjenerata e parë sivjet janë maturantë. Por, ne e kemi ngrehur këtë çështje që dy vjet me radhë, domethënë mësimi nuk ka filluar me kohë, kanë pasur problem me pagesa të mësimdhënësve, dhe unë dua të ju pyes juve se pse ende këta nxënës nuk kanë

literaturë, nuk konvikt banimi dhe nuk kanë mensë ushqimi? E di që janë diskutuar disa gjëra, edhe ne kemi biseduar me prindër dhe e kemi vizitua edhe shkollë, por shqetësimi i prindërve është që nxënësit janë të moshës shumë të re dhe u duhet edhe një konvikt banimi dhe realisht edhe në marrëveshje është ashtu që nxënësit që janë aty ta kenë një banim të përhershëm. Dy nxënës janë prej Preshevës. Unë konsideroj që është një aset kombëtar, e jo ndoshta vetëm shtetëror.

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINITRI ARSIM BAJRAMI: E nderuar deputete,

Ju siguroj se jam jashtëzakonisht i familjarizuar me këtë gjimnaz, edhe duke i takuar nxënësit dhe prindërit, dhe vendimi që unë kam sjellë është një paketë stimulative që përfshin bursën, e cila është solide për nxënësit e shkollës së mesme, përfshin ushqimin falas në qendrën e studentëve dhe ne do të punojmë që nga viti i ardhshëm të përfshijë edhe vendosjen falas në konvikt.

Nuk ka qenë e mundur që pas 10 vjetëve ndoshta lënie pas dore të këtij gjimnazi, menjëherë t'i akomodojmë të gjitha kërkesat, por dy kërkesa fundamentale, ajo për bursë shtetërore dhe ajo për ushqim janë e siguruar. Të gjithë do ta marrin kartelën elektronike me të cilën do të kenë qasje në mensën e studentëve dhe do t'i kenë tri ushqime falas, dhe këtu po premtoj që nga viti i ardhshëm ata do ta kenë edhe një pavijon në konvikt, në mënyrë që t'i akordojmë së paku 30 dhoma për këta nxënës, në mënyrë që ta rritim numrin e nxënësve, sepse janë pak vetëm katër paralele, dëshirojmë të kemi më shumë paralele, sepse e them të drejtën ne e kemi një mungesë interesimi të studentëve për t'u regjistruar në drejtim të matematikës dhe mësimdhënësit e matematikës janë deficitarë për ta ngritur cilësinë dhe për ta pasur sukses në vlerësimin e ardhshëm ndërkombëtar të tekstit PISA 2018, pilotimi i të cilit do të fillojë në këtë javë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bajrami, pyetje për ministrin Arsim Bajrami.

VALDETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues!

Çështja që sot dua ta ngre ka të bëjë me personelin akademik në Universitetin e Prishtinës, zoti ministër.

Të lutem, a mund të na e shpjegoni procedurën e zgjedhjes së personelit akademik në Universitetin e Prishtinës, konkretisht a bëhet mbi baza partiake, apo ka politika gisht në këtë çështje?

KRYESUESI: Ministër, e keni fjalën.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, e nderuar deputete Bajrami!

Zgjedhja e stafit akademik në universitetet publike është çështje e rregulluar tërësisht me Ligjin për arsimin e lartë dhe me statutin e universiteteve publike dhe është një çështje që bën pjesë në autonominë akademike, secili universitet kudo brenda hapësirës evropiane është autonom dhe i pavarur në përcaktimin e kriterëve për zgjedhjen e mësimit dhe në avancimin, duke i respektuar në tërësi dispozitat ligjore.

Meqenëse ju kërkuat që unë t'i shpjegoj këto procedura, më lejoni të ju tregoj se çdo mësimit zgjidhet mbi bazën e konkursit publik dhe janë tri nivele të zgjedhjes.

Niveli i parë është vetë fakulteti, apo njësia akademike, ku formohet komisioni recensues dhe komisioni recensues pastaj voton dhe rekomandon zgjedhjen apo avancimin e cilitdo staf mësimit.

Niveli i dytë është universiteti apo komisioni për politikën akademike, që është një mekanizëm, i cili i rishikon zgjedhjet sa i përket plotësimit të kushteve ligjore dhe standardeve që e përcakton në mënyrë autonome universiteti.

Dhe, niveli i tretë është Senati i Universitetit të Prishtinës.

Ministria e Arsimit në tërësi e respekton autonominë dhe nuk përzihet në politikën e zgjedhjes dhe avancimit të stafit. Mirëpo, ne i trajtojmë ankesat që mund t'i paraqesë stafi akademik, i trajtojmë në mënyrë ligjore nëpërmjet Inspektoratit dhe në qoftë si u referoheni edhe rasteve mediale që janë ngrehur ndoshta gjatë këtij viti, ju siguroj që secili rast që ka ardhur në Ministrinë e Arsimit është trajtuar dhe ne i kemi rekomanduar Senatit të Universitetit marrjen e masave kudo që kemi parë shmangien e këtyre procedurave të parapara me Ligjin për arsimin e lartë dhe me statutin e universiteteve publike.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja Bajrami?

VALDETE BAJRAMI: Po, kryesues!

Faleminderit ministër për këto shpjegime!

Por, mua më intereson në Fakultetin Ekonomik, zoti ministër, kemi pasur një konkurs ku ka konkurruar edhe një koleg i juaji nga Kabineti qeveritar. Fatkeqësisht sot nuk është këtu.

Zoti Hoti ka qenë aplikues ose kandidat në konkursin e datës 24. 11. 2016 me numër të protokollit 3/671, e fare nuk ka pasur pjesë hyrje që të tregojë se ku është bazuar ky konkurs. Në Fakultetin Ekonomik i ka marrë katër lëndë, ministër! Katër lëndë të rregullta në Fakultetin Ekonomik dhe mbi të gjitha në komision kanë qenë dy anëtarë të partisë së tij. A është ky një konflikt interesi, por edhe kisha pasur dëshirë që të ishte vetë ministri këtu dhe të tregonte se si

mund t'i kryejë të gjitha punët, a thua?! Ministri i suksesshëm, profesor i rregullt në Universitetin e Prishtinës, prandaj unë po besoj që nuk do fjalë dhe nuk do koment, edhe ju zoti Mustafa po më shisni...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër Bajrami, e keni fjalën!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, e nderuar deputete!

Nëse i referoheni ministrit të Financave, profesor Avdullah Hotit, ju kujtoj se ai është mësimitdhënës tani e disa vite në Fakultetin Ekonomik. Sigurisht bëhet për rizgjedhjen e tij, ai është i barabartë sikur çdo kandidat tjetër, trajtohet në mënyrë të barabartë.

Sa u përket angazhimeve të tij në fakultet, kjo është çështje ligjore, çështje e Statutit të Universitetit, dhe mendoj se vetë fakulteti dhe universiteti janë të obliguar që të vendosin për aspektet ligjore të angazhimit të mësimitdhënësve në njësitë akademike.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Shukrije Bytyqi, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit, kryesues!

Çështja që do ta ngre është lidhur me shqetësimet e qytetarëve të komunës së Malishevës, duke e ditur se edhe më tutje Malisheva është një zonë endemike ku jeta e qytetarëve është e rrezikuar nga virusi i etheve hemorragjike “Krime Kongo” dhe duke ditur se ky është problem edhe i Qeverisë qendrore, jo vetëm i nivelit lokal, edhe pas takimit që ju kryeministër keni zhvilluar me kryetarin e Komunës së Malishevës, me gjithë premtimet që do të ndani mjete për dezinfektim, ju nuk e keni bërë një gjë të tillë.

A ka logjikë që ta leni të vetme komunën e Malishevës të përballet me këtë çështje shumë problematike?

Atje për tre vjet rresht nuk është shënuar fatmirësisht asnjë vdekje nga virusi i etheve “Krime Kongo” duke iu falënderuar angazhimit të madh të qeverisjes lokale.

Zoti kryeministër,

Cila është arsyeja që këtë vit ju nuk keni ndarë asnjë cent për dezinfektimin selektiv të zonave endemike.

KRYESUESI: Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit, zonja deputete!

Tash unë mund të them se nga buxheti, përkatësisht nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë për këtë destinim janë ndarë 665 mijë euro, që akoma është agjenci në kuadër të Zyrës së Kryeministrit dhe këto mjete janë të destinuara për repelimin e kafshëve. Tanimë ka përfunduar faza e parë dhe është paraparë që sot të fillojë faza e dytë, dhe është vlerësuar nga Komisioni Ndërministror, i cili po punon në këtë fushë se kjo është masa më e mirë që mund të japë efekte, jo vetëm në Malishevë, por edhe në komunat të tjera, sepse me këtë masë është paraparë që të trajtohen 44 fshatra të Malishevës, 34 fshatra të Rahovecit, 13 fshatra të tjera të vijës administrative me komunën e Malishevës, e po ashtu edhe 6 fshatra që ndërlidhen me këta kufij.

Unë kam biseduar edhe me ministrin e Shëndetësisë dhe me ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për këtë çështje, e kam biseduar edhe me kryetarin e Komunës së Malishevës para 3 javësh ose një muaj, ka qenë në zyrën time. Ne jemi të gatshëm në çdo moment që është e nevojshme të ndajmë mjete, qoftë Ministrisë së Bujqësisë, qoftë Ministrisë së Shëndetësisë, edhe 350 mijë euro në qoftë se kërkohet që ta bëjmë spërkatjen, por mbetet pastaj në kompetencën e këtij grupi ministror që të vlerësojë lidhur me masat që duhet të ndërmerren. Do të jemi të gatshëm që nga rezerva buxhetore të intervenojmë për çdo nevojë, në mënyrë që ta parandalojmë çdo rrezik që mund të paraqitet në Malishevë. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: A ka pyetje shtesë?

SHUKRIJE BYTYQI: Po! Faleminderit!

Kryeministër, është e vërtetë që Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës e ka ndarë një pjesë të buxhetit dhe është bërë repelimi i kafshëve, tani ka filluar faza e dytë. Por, nuk është e mjaftueshme të bëhet vetëm repelimi i kafshëve, duke e ditur shqetësimin e qytetarëve dhe duke i ditur pasojat që kanë humbur jetën 18 njerëz pas luftës për shkak të këtyre etheve.

Prandaj, ju edhe e keni premtuar. Është shumë e domosdoshme të bëhet edhe spërkatja e sipërfaqeve dhe ju i keni premtuar bashkë në takim edhe me ministrin e Bujqësisë kryetarin të Komunës se do të ndani mjete, se nuk është i mjaftueshëm buxheti i Komunës së Malishevës për spërkatjen e sipërfaqes të theksuar të fshatrave të komunës së Malishevës.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë deputeti Lahi Brahimaj, pyetje për ministrin Arsim Bajrami.

LAHI BRAHIMAJ: Faleminderit, kryesues!

Pyetja ime është për ministrin e Transportit, i cili u largua: Ministër, keni premtuar se autorruga Prishtinë-Pejë do të përfundojë në afate kohore, e tash një kohë të gjatë nuk vërehet se është duke u punuar në këtë rrugë nga Llozica në drejtim të Pejës.

Pyetja është: A mund të na tregoni se kur do të fillojnë punimet dhe a ka një afat kohorë se kur do të përfundojë?

Dhe si pyetje shtesë: Ka mbi dy vjet që kjo autorrugë në drejtim të Dukagjinit, afro 4-5 kilometra te Kijeva janë të shtruara që 2 vjet dhe e mbyllur me barriera që nuk shfrytëzohet më shumë se dy vjet. Ndërsa në rrugën prej Dollcit në drejtim të Gllaverës çdo vit ka aksidente me fatalitet, sigurisht se do të ishte më mirë këto kilometra të shkojnë në Dollc.

Ndërsa kur është fjala për të prerë shirita, para dy vjetësh ministri me kryeministrin dhe presidentin me vrap shkuan për ta prerë shiritin e rrugës në drejtim të Ferizajt për në Fushë-Kosovë, e pas 6 muajve ajo rrugë u shemb mbi Vetërnik dhe ka mbi dy vjet që nuk shfrytëzohet. A të riparohet kjo rrugë dhe kur?

KRYESUESI: Zoti deputet, t'i mund ta kesh bërë edhe pyetjen e tillë, por unë ju them që më 14. 4. 2017 keni bërë pyetje për ministrin e Arsimit, z. Bajrami, lidhur me shkollën "Gjergj Fishta" në Jagodë të Klinës e të tjera, por nuk po shkoj më tutje. Kaq kisha, meqë ministri tjetër nuk është këtu.

Brahimaj, urdhëro!

LAHI BRAHIMAJ: Këtë pyetje e kam bërë më 23 shkurt dhe asnjëherë nuk më është lexuar emri për ta lexuar këtë pyetje.

Ndërsa pyetjen për ministrin e Arsimit e kam bërë më 14 prill dhe atë nëse më jepet mundësia do ta lexoj.

KRYESUESI: Po!

LAHI BRAHIMAJ: Faleminderit!

I nderuar ministër,

Pyetja ime është u drejtohet për shkollën "Gjergj Fishta", e cila ndodhë në Jagodë të Klinës. KA mbi dy vjet që tualetet aty nuk janë në shfrytëzim, ndërsa nxënësit janë të detyruar të dalin në mal që t'i kryejnë nevojat e tyre. Janë të rrezikuar nga gjarprit dhe fatkeqësitë tjera.

Është i njëjti problem në shkollën e Doblidarës “Dëshmorët Lleshi”, shkollë e cila u ndërtua me donacion dhe më nuk u bë asnjë investim në të. Kanë pëlçitur gypat e ujësjellësit aty dhe kabllot e rrymës kanë dalë, e nxënësit rrezikohen nga fatkeqësi nga rryma.

Kurse në shkollën e Cërmjanit në 100-vjetorin e saj i ke premtuar karriget dhe tavolina shtesë në fjalën që e ke pasur publike, prej atëherë që dy vjet nuk u bë diçka. A mund të na thuash diçka për këto?

KRYESUESI: Ministri Bajrami e ka fjalën.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Faleminderit!

I nderuar deputet Brahimaj,

Më lejoni t’i jap përgjigjet në pyetjet e parashtruara.

Fillimisht dëshiroj të jua përkujtoj se menaxhimi i shkollave dhe i infrastrukturës është tërësisht një kompetencë e pushtetit komunal dhe e autoritetit komunal, sidomos mirëmbajtja e këtyre shkollave është kompetencë e kryetarëve të komunave, drejtorëve komunalë dhe ju inkurajoj që t’i takoni drejtorët komunalë të këtyre shkollave dhe kryetarët e komunave dhe të kërkonit që ata të ndajnë mjete për mirëmbajtjen e këtyre shkollave.

Ndoshta është lajmi i mirë që sivjet komisioni i granteve e ka akorduar grantin e ri specifik për arsim, i cili është rritur për 6 milionë dhe shkollat do të marrin buxhet shtesë për mirëmbajtjen dhe renovimin e shkollës.

Sa i përket shkollës “Ali Hasi”, është e vërtetë se ne kemi qenë bashkë në kremtimin e 100-vjetorit dhe është e vërtetë se ne kemi premtuar inventar, nuk kemi pasur një kërkesë specifike dhe ju inkurajoj që ta inkurajoni drejtorin e shkollës që të vijë në Ministrinë e Arsimit dhe ne plotësisht do ta mbështetim këtë shkollë me inventar, sepse inventarizimi është një përgjegjësi e Ministrisë së Arsimit dhe ne ndihmojmë, dhe e kemi një kontratë afatgjate për t’i ndihmuar të gjitha shkollat me inventar dhe pajisje tjera shkollore.

KRYESUESI: Pyetje shtesë, zoti deputet?

LAHI BRAHIMAJ: Për shkollën “Ali Hasi”, t’i vetë e ke premtuar edhe në fjalën publike, por edhe në bashkëbisedim me drejtorin, e ke pasur kërkesën, nuk është realizuar.

Ndërsa për shkollën “Gjergj Fishta” në Jagodë, ata kanë bërë kërkesë në Drejtorinë Komunale, por nuk i janë përgjigjur, njëjtë edhe me Drejtorinë Komunale në Gjakovë, shkolla e “Dëshmorët Lleshi”, por ata nuk kanë marrë asnjë përgjigje dhe nuk është investuar.

Pyetja ime ishte: A je në dijeni për këto që janë kah ndodhin?

KRYESUESI: Urdhëro, ministër!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Edhe një herë, i nderuar deputet, Jemi në njohuri jo vetëm për këto shkolla, por me dhjetëra e qindra shkolla parashetrojnë kërkesa për renovime, për mirëmbajtje, por nuk do t'ua jap asnjë pritje shkollave, këto probleme duhet të zgjidhen në pushtetet komunale.

Pushtetet komunale gjenerojnë të hyra nga taksat e qytetarëve dhe unë uroj që ato të hyra të orientohen drejt sektorit të arsimit.

Kurse edhe një po ju them, për shkollën "Ali Hasi" nuk kemi pasur një kërkesë specifike. Ne jemi të gatshëm në çdo kohë dhe e ftoj edhe nga këtu Drejtorinë e shkollës që të vijë edhe ne do t'ua japim inventarin dhe pajisjet tjera pa asnjë hezitim.

KRYESUESI: Faleminderit! Edhe për një pyetje kemi kohë. Deputetja Teuta Haxhiu, pyetje ministrin Arsim Bajrami.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Është mirë që ministrat apo Qeveria, kur deputetët u parashetrojnë pyetje, të marrin ndonjë hap, pas parashtrimit të pyetjeve, edhe pse rendi po na vjen shumë vonë për t'i bërë këto pyetje.

Pyetja ime për ju, ministër, pra pas përfundimit, pas skadimit të Kontratës Kolektive ishte se si e arsyetoni moszbatimin e Kontratës Kolektive, përderisa i ka skaduar afati më 11 prill 2017? E di që dje e keni nënshkruar, po tani na tregoni a e keni bërë nënshkrimin e kësaj kontrate sikurse kontrata e fundit, e cila u nënshkrua, por nuk u zbatua dhe a do ta zbatonin në tërësi? Apo, thjesht, vetëm po nënshkruajmë kontrata me sindikatat dhe asnjëherë nuk po respektohen në tërësi.

KRYESUESI: Ministri Bajrami e ka fjalën.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: E nderuar deputete Haxhiu!

Më lejoni t' ju informoj, besoj që edhe e keni përcjellë dje nëpërmjet mediave, brenda afatit ligjor është nënshkruar Kontrata e re Kolektive trevjeçare për të gjithë mësimdhënësit e nivelit parafillor, parauniversitar, por edhe të arsimit të lartë, një kontratë që është një lajm i mirë për të gjithë mësimdhënësit që përmban tri shtylla kryesore: e para, kontrata ofron një mbështetje të madhe për zhvillimin profesional të të gjithë mësimdhënësve, për ngritjen e karrierës dhe për vlerësimin e performansës, duke përfshirë edhe shpërblimin sipas performansës.

Pra, kjo kontratë i ofron mundësinë secilit mësimdhënës që të avancojë në karrierë dhe ky avancim të reflektojë jo vetëm në pozitën e tij brenda shkollës, por edhe në aspektin material.

Kemi ofruar katër nivele të gradimit të mësimit dhe nesër do të jetë ceremonia solemne e inaugurimit të kësaj pakete. Pra, të gjithë mësimit parauniversitarë do të gradohen në katër nivele për t'i ofruar mundësinë secilit të mbërrijë në nivelin më të lartë dhe ky përparim do të mbështetet edhe në pagën e tyre. Ne do të angazhohemi që të Ligji për pagat të sigurojmë pagesat shtesë për këta mësimit.

Segmenti i dytë i Kontratës Kolektive është jashtëzakonisht i rëndësishëm. Sindikatat duhet të jenë partnerë jo vetëm kur është në pyetje pozita materiale, por edhe në përpjekjen e përgjithshme në ngritjen e cilësisë, sepse jemi pajtuar që sindikata të mbështesë përpjekjet e Qeverisë së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit për rritjen emergjente të cilësisë në të gjitha nivelet e arsimit.

Dhe, segmenti i tretë, ai tipik sindikal, e kemi akorduar pakon e mbështetjes sindikale për punëtorët e arsimit në disa segmente dhe, në këtë drejtim, Qeveria e Kosovës dhe Ministria e Arsimit do të mbështetë buxhetet komunale, sepse punëdhënësit e mësimit parauniversitarë janë komunat. Tregova edhe në pyetjen paraprake që e kemi rritur grantin specifik, e kemi rritur ndjeshëm grantin specifik të komunave dhe do të angazhohem që komunat me mirëbesim të ofrojnë mbështetje për mësimit sa i përket transportit, sa i përket segmenteve të tjera, sa i përket pensioneve, ndoshta ceremoniale, me rastin e pensionimit dhe me këtë ne e kemi kryer një obligim ligjor dhe jemi zotuar të punojmë me sindikatën jo vetëm në aspekte sindikale, por në aspekte emergjente, për të cilat po angazhohemi të gjithë, ngritja emergjente e cilësisë në sistemin arsimor në mënyrë që vërtet ky proces të fillojë dhe pastaj të rezultojë me një standard çfarë ne mund të arrijmë.

KRYESUESI: Faleminderit! Të nderuar deputetë, pyetje shtesë?

TEUTA HAXHIU: Faleminderit!

Të obliguar keni qenë edhe me mbledhjen e mbajtur në Kuvend më 11 dhe 18 prill të vitit 2013, kur Kuvendi ka rekomanduar që Qeveria të nxjerrë ligj të veçantë për statusin e punëtorëve të arsimit shqip në Republikën e Kosovës nga viti shkollor 1990 -1991, deri në vitin shkollor '98 - '99, në të cilin statusi i tyre barazohet me statusin e personave të merituar në formimin dhe ndërtimin e shtetit të Republikës së Kosovës.

I nderuar ministër, Qeveria e Republikës së Kosovës ka qenë e obliguar të hartojë këtë ligj në afatin kohor prej tre muajsh. Sot kanë kaluar tre vjet dhe ende nuk e keni nxjerrë një ligj të tillë. Çka tash, edhe sa vjet të tjera duhet të presim? Apo ndoshta shumica e tyre edhe nuk janë sot në jetë.

KRYESUESI: Urdhëro, ministër!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, e nderuar deputete!

Edhe si mësime të reja e dini që ky është një ligj që 15 vjet i vonuar, pra padrejtësisht i vonuar dhe më lejoni t'ju informoj që tanimë ligji ka përfunduar, është harmonizuar plotësisht me kërkesat sindikale, me Zyrën e Kryeministrit, e cila e ka mbështetur këtë proces dhe ligji aktualisht është në vlerësimin final financiar. Kemi zbritur në maksimum koston financiare dhe ne urojmë që sa më shpejt të vijë në këtë legjislaturë, në mënyrë që ky ligj të miratohet dhe mësime të marrin kontributet e merituar në vitet më të rëndësishme të mbijetesës së arsimit shqip, pra vitet '90-'99 dhe uroj që kjo legjislaturë të jetë me fat që ta sjellë këtë ligj, të cilën tani katër legjislaturat e mëparshme nuk kanë mundur ta trajtojnë për shkak të një kostoje të papërbalueshme. Kemi pasur edhe mirëkuptimin e sindikatave, e kemi zbritur në minimum koston financiare, kostoja financiare është periodike, nuk është një ngarkesë e menjëhershme dhe urojmë së bashku që ky ligj në këtë legjislaturë të miratohet.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, është harxhuar koha për pyetje parlamentare. Pyetjet e deputetëve që nuk marrin përgjigje në dy seanca plenare, do të publikohen në revistën e Kuvendit dhe në faqen zyrtare elektronike të Kuvendit.

3. Interpelanca e kryeministrit të Kosovës, z. Isa Mustafa, sipas kërkesës së deputetes Donika Kadaj-Bujupi, e mbështetur edhe nga 15 deputetë nënshkrues, për çështjen e shfrytëzimit të thëngjillit dhe minierën e Sibocit

Deputetja Donika Kadaj-Bujupi, e mbështetur edhe nga 15 deputetë nënshkrues në bazë të nenit 44 të Rregullores së Kuvendit ka parashtruar kërkesë për të ftuar në interpelancë kryeministrin e Kosovës, Isa Mustafa, për çështjen e shfrytëzimit të thëngjillit dhe minierën e Sibocit.

Ju njoftoj se në bazë të Rregullores së Kuvendit interpelanca mund të zgjasë deri në tri orë. Përfaqësuesi i interpelancës mban të drejtën e fillimit të debatit në kohëzgjatje deri në 10 minuta dhe në përfundim të debatit në kohëzgjatje pesë minuta, sipas nenit 44.7 të Rregullores së Kuvendit. Kryeministri Isa Mustafa e paraqet dhe e arsyeton qëndrimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për çështjen e shtruar në interpelancë në kohëzgjatje prej 15 minutave, sipas nenit 44.8 të Rregullores së Kuvendit. Koha e ndarë për diskutim sipas grupeve parlamentare dhe deputetëve pa grup parlamentar është në vijim, kur të fillojë puna do ta lexoj dhe këtë pjesë.

Atëherë, interpelanca zyrtarisht është paraqitur nga Donika Kadaj-Bujupi, mbështetur nga 15 firma deputetësh, mua po më duken që janë kryesisht të Lëvizjes “Vetëvendosje”, po s’është me rëndësi kjo, mund të jenë edhe të tjerë. Atëherë, nuk po e shoh Donika-Kadaj, a ka zëvendës prej këtyre që janë nënshkrues që e merr detyrën e Kadaj-Bujupit, shefi i Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”, Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: I nderuar nënkryetar,

Unë kërkoj që kjo interpelancë të shtyhet, për shkak që parashtruesja e kërkesës është në një udhëtim zyrtar, bashkë me anëtarët e komisionit, kanë vizitë zyrtare në Budapest. Kjo vizitë zyrtare është ditur shumë më herët që do të ndodhë, herën e parë interpelanca është shtyrë për shkak të një udhëtimit zyrtar të kryeministrit, kësaj radhe ka udhëtim zyrtar parashtruesja e kësaj interpelance. Kështu që me mirëkuptim edhe nga deputetët e koalicionit qeverisës kërkoj që kjo interpelancë të shtyhet për një moment kur të vendosë Kryesia në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Pra, nënshkruesit e kërkesës së kësaj interpelance, në emër të Donika Kadaj-Bujupi, deputetët e “Vetëvendosjes” kërkojnë që meqë Kadaj- Bujupi s’është këtu dhe qenka në udhëtim zyrtar, të mos mbahet interpelanca. Unë pos këtij deklaramit tjetër nuk kam për këtu, po të shtoja diçka, do të shtoja që kemi pasur mbledhje dje të Kryesisë dhe shumë mirë është ditur që do të jetë në rend dite kjo pikë. Kjo më shumë për deputetët që s’janë anëtarë Kryesie dhe s’janë kryetarë të grupeve parlamentare.

Kaq, po jap vetëm fakte, s’bëj interpretime. Po të shkojë logjika kush, kur udhëton dhe sa janë zyrtare, unë po shpreh njëfarë skepticizmi kur mbahet kjo interpelancë, por është problem i perceptimit tim, nuk është juaji. Atëherë, mua më mbetet t’ju them që e kemi këtë njohuri, po s’kemi çka të votojmë këtu, sepse interpelanca s’mund të bëhet.

4. Interpelanca e ministrit Blerand Stavileci, sipas kërkesës së deputetit Visar Ymeri, i mbështetur edhe nga 15 deputetë nënshkrues, në lidhje me Kontratën e privatizimit të Kompanisë së Distribuimit të Energjisë Elektrike

Deputeti Visar Ymeri, i mbështetur nga 15 deputetë nënshkrues, në bazë të nenit 44 të Rregullores së Kuvendit ka parashtruar kërkesë për ta ftuar në interpelancë ministrin e Zhvillimit Ekonomik, z. Blerand Stavileci, në lidhje me Kontratën e privatizimit të Kompanisë së Distribuimit të Energjisë Elektrike. Ju ftoj se në bazë të Rregullores së Kuvendit interpelanca mund të zgjasë 3 orë. Përfaqësuesi i interpelancës mban të drejtën e fillimit të debatit në kohëzgjatje prej dhjetë minutave dhe në mbyllje të debatit në kohëzgjatje prej pesë minutash.

Ministri Stavileci e paraqet dhe e arsyeton qëndrimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për çështjen e shtruar në interpelancë në kohëzgjatje 15 minutave. Koha e ndarë prapë është, si duket s’kemi pse e ndajmë. Pra, tash e kemi situatën inverse.

Kjo ka ndodhur, në seancën tjetër është shtyrë, sepse keni thënë ju, zotërinj të “Vetëvendosjes”, pa Ymerin s’bëhet kjo interpelancë”. Ymeri është këtu, s’është Blerand Stavileci. Pra, nëse keni diçka të deklaroni, deklaroni prapë, ju jap fjalën, por unë sa po e shoh, kjo interpelancë nuk ndodh sot. Urdhëro, Ymer, e ke fjalën.

VISAR YMERI: Natyrisht që pa ministrin, i cili është i thirrur në interpelancë, interpelanca s'mund të mbahet, këtu jam dakord. Por, një pyetje e kam për Sekretarinë e Kuvendit: a ka ndonjë shkresë zyrtare nga ministri që s'mund të vijë sot ose mund të vijë pas një ore a dy, ku ta di unë? Ka mundësi që e ka llogaritur që do të kemi edhe një interpelancë tjetër, ose nëse ia ka deleguar këtë përgjegjësi ndonjë prej ministrave të tjerë ose kryeministrit.

KRYESUESI: Interpelanca s'delegohet, Ymer, ti e di shumë mirë atë punë. Ju s'po e delegoni si kërkesë prej njëri-tjetrit, e po pritni interpelanca s'delegohet, interpelanca është me emër, sa i përket Rregullores. Puna tjetër unë nuk di, letër unë për vete s'kam.

Edhe kjo nuk ka çka të interpretohet tutje, interpelanca nuk mund të mbahet sot, sepse mungon ministri Stavileci.

5. Debat parlamentar sipas kërkesës së deputetes Teuta Haxhiu, e mbështetur edhe nga 9 deputetë të tjerë nënshkrues, në lidhje me moszbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga Qeveria e Republikës së Kosovës

Të nderuar deputetë, deputetja Teuta Haxhiu, e mbështetur nga 9 deputetë të tjerë ka propozuar debat parlamentar në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Atëherë, e ftoj deputeten Teuta Haxhiu që në cilësinë e propozuesit të çështjes ta marrë fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Për hir të opinionit publik, debati i thirrur nga ana ime dhe e kolegëve nënshkrues ka rreth pesë muaj që po presim për këtë debat. Debat për moszbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit për vitin 2015, përderisa neve na ka ardhur edhe raporti për vitin 2016. Prandaj, kërkoj falje në qoftë se vërtet ka edhe diçka nga rekomandimet dhe është mirë në qoftë se ka filluar zbatimi i tyre, por ne nuk kemi informata.

Në bazë të nenit 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 15, pika 8 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës kërkon nga Kryesia e Kuvendit që të thërrasë seancë për debat parlamentar me çështjen në vijim: Moszbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Në Ditën ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut nga përkrahimi i gjendjes jo të mirë në Kosovë, duke pasur parasysh mosimplementimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhe organizatave të tjera që merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe institucionet e tjera, pra është e nevojshme që Kuvendi të debatojë për këtë çështje.

Bazuar në rekomandimet e Avokatit për vitin 2015, nga ana e tij, pra të këtij institucioni, nga rreth 60 rekomandime të paimplementuara janë 36 rekomandime, 7 prej tyre janë në pritje të implementimit për afro 2 vjet. Qeveria e Kosovës është institucioni kryesor, i cili bën shkeljen e të drejtave të njeriut duke mos zbatuar rekomandimet e Avokatit të Popullit. Pas kësaj për moszbatim të rekomandimeve radhitet Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, pastaj kemi edhe sistemin e drejtësisë që përfshin gjykatat, shërbimin korrektues, e të tjera. Bazuar në të gjitha këto të dhëna, pra është e nevojshme që sot të bëjmë debat, të mbajmë një debat dhe në fund do të dakordohemi sa i përket rekomandimeve, të cilat unë i synoj t'i paraqes në fund.

Rëndësia e zbatimit të raporteve me rekomandime të Avokatit të Popullit: Tipar kryesor i raporteve të Avokatit të Popullit është se ato nuk e kanë për qëllim vetëm të përshkruajnë punën e institucionit të Avokatit të Popullit, siç praktikohet zakonisht nga shumica e organeve që i raportojnë Kuvendit, por qëllim kryesor dhe shumë i rëndësishëm i raporteve është që të japin informacione mbi gjendjen e të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës, si dhe paraqesin rekomandime konkrete drejtuar institucioneve publike përgjegjëse për përmirësimin e kësaj gjendjeje. Ky rol i Avokatit të Popullit në paraqitjen e rekomandimeve konfirmohet edhe me Kushtetutë, si dhe me Ligjin nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit.

Neni 135 i Kushtetutës, raportimi i Avokatit të Popullit përcakton shprehimisht: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa nëse vëren shkelje të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore”. Po ashtu, Ligji për Avokatin e Popullit kapitulli 3, kompetencat dhe përgjegjësitë e Avokatit të Popullit përmend rolin e Avokatit të Popullit në paraqitjen e rekomandimeve për autoritetet shtetërore të Republikës së Kosovës. Fakti që dhënia e rekomandimeve përbën pjesën kryesore të punës së Avokatit të Popullit, i jep një natyrë tjetër raporteve të tij në krahasim me raportin e shumicës të organeve të tjera të pavarura.

Kjo nuk do të thotë se këto organe të pavarura e kanë të pamundur ose të papërshtatshme që të paraqesin rekomandime, por megjithatë kompetencat dhe përgjegjësia për të dhënë rekomandime të tilla luajnë një rol shumë më të madh në punën e Avokatit të Popullit, gjë që pasqyrohet qartë në raportet e tij. Pse është i rëndësishëm zbatimi i tyre?

Ne kemi parë në raportin e Avokatit të Popullit për vitin 2015, në të cilat janë adresuar 57 rekomandime dhe po ashtu ka pasur një rritje të përqindjes së zbatimit të tyre që flet një trend pozitiv, megjithatë duhet synuar që kjo përqindje e zbatimit të rritet. Po ashtu, indikativ është raporti preliminar i paraqitur nga Avokati në fund të vitit 2016, i cili neve na ka ardhur tanimë, mirëpo nuk e kemi shqyrtuar si komision ende. Shihet një trend i rritjes së raportimeve, pra me rekomandime, sidomos për çështje sistematike të drejtave të njeriut, në të cilat përfshihet një numër shumë i madh i qytetarëve, të drejtat e të cilëve janë shkelur. Ndër to mund të përmendim rastin e mosekzekutimit të vendimeve të plotfuqishme të gjykatave, çështjen e dinjitetit të njeriut

në rastin e detyrimit të pensionistëve që të dëshmojnë se janë gjallë, rastin e mirënjohur “Grudiq”, është e rëndësishme që të ndalemi pak te opinioni i Avokatit të Popullit sa i përket këtij rasti. Ky opinion paraqet rastin e parë ku një institucion kombëtar i të drejtave të njeriut i drejtohet Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës bazuar në Rregulloren 9, të Rregullores që ka të bëjë me mbikëqyrjen e ekzekutivit të aktgjykimeve për zbatimin e një vendimi të GJDNJ-së kundrejt një vendimi të tretë.

Siç e dimë, aktgjykimi në rastin “Grudiq” kundër Serbisë është aktgjykim parimor, me të cilin Serbia është e obliguar të kompensojë në mënyrë të njëjtë, sipas këtij aktgjykimi, pensionet kontributdhënëse, pensionet invalidore të punës dhe pensionet e familjarëve për qytetarët e Republikës së Kosovës, të cilat i kanë gëzuar këto pensione deri në vitin 1999, kur edhe janë ndërprerë nga Serbia në mënyrë arbitrare. Serbia në vazhdimësi ka dhënë arsyetime për t’i ikur zbatimit të këtij aktgjykimi, përkundër detyrimit dhe respektimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e së këndejmi obligimit për zbatimin e këtij vendimi. Në anën tjetër, duke marrë parasysh se deri më tani institucionet e Republikës së Kosovës nuk e kanë ngritur këtë çështje në instanca, nëpërmjet të cilave do të kërkohej zbatimi i këtij aktgjykimi dhe së këndejmi për të gjithë rastet e tjera të kësaj natyre Avokati i Popullit ka parë të arsyeshme të japë opinionin e tij, duke u bazuar në Rregulloren e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës që ka të bëjë me mbikëqyrjen e ekzekutimit të aktgjykimeve.

Opinionin i Avokatit të Popullit në mënyrë të detajuar sqaron sfondin ligjor dhe kronologjik lidhur me çështjen në fjalë dhe del me rekomandime konkrete: sipas Kushtetutës dhe standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në këtë drejtim, Kuvendi e ka për detyrë të mbështesë punën e Avokatit. Në kontestin e një Republike parlamentare, Kuvendi është institucioni, pushteti i të cilit buron drejtpërdrejt nga populli i Kosovës. Ky fakt e vesh Kuvendin jo vetëm me të drejtën, por edhe me detyrën për ta kontrolluar Qeverinë prej institucioneve të tjera shtetërore, sidomos, pra në moszbatimin e këtyre rekomandimeve.

Detyrën e parlamenteve për të mbrojtur autoritetet shtetërore lidhur me të drejtat e njeriut e konfirmon edhe Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, e cila në vitin 2011 nxori Rezolutën nr. 1823 “Parlamentet Kombëtare, garantuese të të drejtave të njeriut në Evropë”. Në këtë rezolutë Asambleja ka pohuar se Parlamentet Kombëtare janë çelësi i implementimit efektiv të normave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në nivelin kombëtar. Duke iu referuar gjithashtu detyrës së tyre për të mbrojtur të drejtat e njeriut, duke kërkuar llogari prej ekzekutivit në veçanti, Asambleja Parlamentare është shprehur se Parlamentet Kombëtare janë në pozitë të veçantë për të kërkuar llogari prej Qeverisë për zbatimin e shpejtë dhe efektiv të këtyre aktgjykimeve.

Për shkak se paraqitja e rekomandimeve dhe zbatimi i tyre në praktikë luajnë një rol të rëndësishëm në raportin e Avokatit, votimi për miratimin e raportit të Avokatit të Popullit duket

sikur nuk ka kuptim, ky është mendimi im, dhe më shumë duket si një votim formal, sepse ne, në të kundërtën, po mendojmë që Avokati nuk po paraqet një të vërtetë. Votimi për miratim është i përshtatshëm kur Kuvendi dëshiron të shprehë mendimin e tij për punën që ka të bëjë me institucionet si në të kaluarën, por është i përshtatshëm për një institucion që po raporton për hapat që duhen ndërmarrë nga autoritetet shtetërore në të ardhmen.

Nisur nga kjo, do të ishte e përshtatshme që ndryshimi i Rregullores së Kuvendit me procedurë të shpejtë për mbikëqyrjen e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga ana e autoriteteve shtetërore, në këtë mënyrë Kuvendi do të kishte mundësi të luajë një rol në rritjen e nivelit të zbatimit të këtyre rekomandimeve. Duke marrë parasysh faktin që Avokatit të Popullit i mungojnë kompetencat ekzekutive për të siguruar zbatimin e rekomandimeve të tij, është e domosdoshme që për statusin e misionit të këtij institucioni Kuvendi ta mbështesë sa më fuqishëm këtë mision. Ne deputetët për të pasur një pasqyrë më reale të zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit është e rëndësishme të kemi raportim të rregullt periodik të kryesuesit të Grupit ndërminstoror për të drejtat e njeriut, që në këtë rast është kryeministri i vendit, sipas vendimit të Qeverisë të datës 13 maj 2016, e që kryeministri pas thirrjes nga ana ime të këtij debati ka mbajtur një mbledhje formale, vetëm një herë ka mbajtur një mbledhje formale dhe asnjëherë nuk i ka raportuar Kuvendit që e ka obligim.

Po ashtu, është shumë e rëndësishme që të rritet roli i Kuvendit në rast të moszbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit brenda afatit të përcaktuar që zakonisht është 30 ditë. Të thirren në përgjegjësi institucionet e vendit për të kuptuar arsyet e moszbatimit të rekomandimeve.

Të nderuar kolegë deputetë, rekomandimet unë i kam këtu, por pres që pas kontributit tuaj në këtë drejtim t'i harmonizojmë dhe të dalim... Atëherë, me insistimin tuaj, unë po i lexoj rekomandimet:

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Vazhdojani, se po i lexon rekomandimet.

TEUTA HAXHIU: Pra,

1. Të implementohen rekomandimet e Avokatit të Popullit,
2. Të krijohen kushtet e nevojshme në kuptimin financiar që rekomandimet e Avokatit të Popullit të zbatohen,
3. Kuvendi të kërkojë përgjegjësinë nga Qeveria e Republikës së Kosovës për moszbatimin e vendimit të Qeverisë të datës 12 maj 2016, raportim të rregullt periodik të kryesuesit të Grupit ndërminstoror për të drejtat e njeriut, të cilin e udhëheq kryeministri,

4. Në rast të moszbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, që është pra 30 ditë, të thirren në përgjegjësi udhëheqësit e institucioneve në komisionet përkatëse në Kuvend për të kuptuar arsyet e moszbatimit të këtyre rekomandime, dhe
5. Kuvendi i Kosovës gjatë plotësimit-ndryshimit të Rregullores së Kuvendit ta rregullojë çështjen e votimit të raporteve të Avokatit të Popullit, për arsye se Avokati i Popullit raporton për gjendjen reale për të drejtat e njeriut.

Pra, edhe njëherë rekomandimi i fundit sidomos është që shpeshherë na ka ndodhur që raportet, të cilat vijnë në Kuvend, marrin ose nuk marrin votimin tonë dhe thjesht nuk ka përgjegjësi asnjëherë. Prandaj, unë pres që ky rekomandim sa i përket raportit të Avokatit të Popullit, pra të mos votohet në Kuvend, sepse në të kundërtën ne, në qoftë se ndodh që të mos i votojmë raportet e Avokatit të Popullit, ne po ndërhyjmë dhe thjesht po tregojmë që Avokati i Popullit nuk po tregon një të drejtë që ai e ka të garantuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ju njoftoj se janë paraqitur dy vetë deri tash. Lirije Kajtazi apo Qeveria e ka të drejtën e fjalës kurdo, por kryetarët e grupeve është mirë ose në emër të grupeve nëse donë të deklaroheni. Në emër të grupeve, a ka deklarime në emër të grupeve? I kam tre emra. Kajtazi, a flet? Mexhide, në emër të grupit? Flet Mexhide Mjaku-Topalli për Grupin e PDK-së.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni të them se vendi ynë po përballlet me një nga proceset më të mëdha politike dhe historike që lidhen me procesin e integritit të Kosovës në BE. Ky është një proces sfidues dhe shumë i rëndësishëm për qytetarët e Kosovës, i cili ofron perspektivën për zhvillim dhe mirëqenie, po ashtu kërkon institucione të përgjegjshme, funksionale, llogaridhënëse, transparente dhe me kapacitete të mjaftueshme njerëzore, të cilat duhet ta bartin peshën e angazhimit dhe përgjegjësisë për ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të nevojshme që do ta udhëheqin dhe realizojnë procesin e integritit të Kosovës në BE.

Është e padiskutueshme se efekti i ligjeve, politikave dhe performansave të institucioneve që merren me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut varet nga kontesti i përgjithshëm politik, ekonomik, social dhe kulturor, duke përfshirë edhe qeverisjen e mirë, nivelin e demokracisë. Secili shtet e ka mekanizimin e vet kombëtar për t'i mbrojtur të drejtat e njeriut dhe një sistem i tillë efektiv shihet si shenjë e qeverisjes së mirë dhe si një kontinuitet ndaj sundimit të ligjit dhe demokracisë në vend.

Edhe institucioni i Avokatit të Popullit e luan një rol të rëndësishëm në kuadrin e sistemit kombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si një mekanizëm i pavarur. Thelbi i filozofisë së funksionimit të këtij institucioni është që Avokati i Popullit, pavarësisht se cilat forca politike udhëheqin shtetin, ai do të jetë gjithherë një oponent për mirëqenie. Në raportin e Avokatit të Popullit është kërkuar që të debatohet në Kuvend, siç është edhe ky i sotmi. Krejt kjo në të mirë të përmirësimit të gjendjes së të drejtave të njeriut në Kosovë. Ndërsa, sa i përket zbatimit të rekomandimeve të dala nga Avokati i Popullit, në raportin e Avokatit të Popullit të vitit 2015 vlerësohet se ka pasur një ngritje, ku 50% e rekomandimeve janë realizuar, ndërsa pjesa tjetër është duke u trajtuar prej institucioneve, që do të thotë se ende janë në proces.

Në bazë të raportit të Avokatit të Popullit, shkeljet e të drejtave të njeriut apo ankimit janë të natyrave të ndryshme, duke filluar nga fëmijët, të cilët detyrohen të punojnë, e deri tek pensionistët, të cilët nuk mund të realizojnë një jetë të dinjitetshme. Autoritetet në nivel qendror dhe lokal të qeverisjes sonë duhet të sigurojnë përgjigje të shpejta për të gjitha kërkesat dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit. Sidomos Zyra e Kryeministrit duhet të koordinojë dhe të monitorojë procesin e zbatimit të rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit, adresuar ministrive dhe komunave.

Realizimi i rekomandimeve të dala nga institucioni i Avokatit të Popullit zhvillon një administratë profesionale, efikase dhe efektive, transparencë, llogaridhënie dhe përgjegjësi të Administratës Publike karshi qytetarëve dhe forcën e zhvillimit të sundimit të ligjit. Dhe, nga kjo rezulton rritje e besimit të qytetarëve në Administratën Publike, sistemin gjyqësor dhe në të gjitha institucionet e tjera të vendit. Ndërsa, sa u përket rekomandimeve të dala nga deputetët nënshkrues që e kanë thirrur këtë debat është mirë që grupet parlamentare të takohen dhe t'i harmonizojnë rekomandimet e dala nga ky debat. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Lirije Kajtazi për Grupin Parlamentar të LDK-së e ka fjalën.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Kjo që ne sot po e bisedojmë rreth zbatimit të rekomandimit të një institucioni të pavarur kushtetues, rekomandimeve të Avokatit të Popullit, natyrisht që jemi të prirë ta shohim si një mundësi për mbjellje të një disipline pozitive, e cila ndihmon edhe në dialogimin e mekanizmave shtetërorë, të atij të Parlamentit, të Qeverisë dhe të gjithë atyre që u adresohen rekomandimet.

Si një institucion i tillë i pavarur, Avokati i Popullit tani me ndryshimin e ligjeve bazike për të drejtat e njeriut ka më shumë kompetenca dhe në këto kompetenca është shtuar Mekanizmi

kombëtar për parandalimin e torturës, që është shumë i nevojshëm të arrijë në ato vende, ku është interesimi edhe i vetë neve deputetëve, por ndoshta në pamundësi që të jemi në institucionet ku njerëzit janë të privuar nga liria, që ka qenë shqetësim në disa raste, është Mekanizimi kombëtar për parandalim të torturës ai i cili na e ofron këtë pasqyrë. Pastaj i është shtuar kompetenca në mbikëqyrjen e sektorit privat dhe, ajo që është esenciale, inicimi i procedurave gjyqësore nga Avokati i Popullit.

Krejt këto kanë ndikuar që normal me rritje të kompetencës ka reflektuar edhe me rritje të rekomandimeve nga ky institucion dhe rritja e rekomandimeve, për fat të mirë, ka ndikuar në zbatimin e rekomandimeve. Siç e keni parë nga Avokati, është shtuar në 50% zbatimin e rekomandimeve dhe, për fat të mirë, kjo është në harmoni me vetë fjalën e kryeministrit kur e ka marrë detyrën se do të jetë ai i cili do të kujdeset ndjeshëm në zbatimin e rekomandimeve të këtij institucioni.

Natyrisht që mbetet shumëçka për t'u bërë, ngase krejt kjo nuk e ka vetëm atë ndikimin juridik, e ka edhe politik, edhe të mos them buxhetor, kështu që shumë çështje dhe në bisedat e drejtpërdrejta me Avokatin, ngase si Komision i të Drejtave të Njeriut kemi një bashkëpunim të theksuar, është thënë që ka shumë çështje që mbesin në procedurë nga kostoja financiare që ato e kanë mbi vete. Është me rëndësi ta themi edhe si komision kemi organizuar një tryezë, ku kemi ftuar të gjitha institucionet, të cilave u adresohen rekomandimet dhe përveç Zyrës Administrative të Mitrovicës Veriore dhe Komunës së Parteshit, të gjitha institucionet e tjera kanë qenë të pranishme. Po ashtu, është për t'u përhëndetur edhe Grupi ndërministror, siç edhe ka prezantuar edhe Avokati gjatë punës së tij në komision. Grupi ndërministror që e ka ngritur kryeministri dhe si sekretariat ka Zyrën për Qeverisje të Mirë dhe aty, natyrisht që janë kërkuar që të dinamizohet zbatimin e rekomandimeve.

Duhet ta pranojmë që shpesh edhe ne, ndoshta jomjaftueshëm, apo institucionet tona i marrin rekomandimet edhe të institucioneve të tjera të pavarura, siç ndodh edhe atij të shërbimit të pavarur mbikëqyrës dhe, edhe pse e dimë se janë të natyrës përmbarimore, shpesh institucionet tona e neglizhojnë dhe gjëra të tilla na barten edhe në gjykatë. Megjithatë, ne e shohim si mjaft të rëndësishme që t'i jepet hapësirë debatit për rekomandime, ngase kjo sjell kualitet në qeverisje, kjo sjell edhe kualitetin e institucioneve tona në përgjithësi, me mundësinë që edhe ligjet tona të përmirësohen sa më mirë dhe krejt kjo edhe në funksion të një demokracie të brendshme, e cila e ofron zërin e qytetarëve aty ku ne kemi nevojë dhe është mbrojtësi i rasteve kur edhe në pamundësi që ata të jenë të ulur drejtpërdrejt në tryezat e vendimmarrjes, ne jemi të obliguar që t'i zbatojmë rekomandimet, që njëherësh janë edhe zbatim apo respektim i të drejtave të njeriut.

Sa për rekomandimet besoj se në fund është mirë t'i shikojmë së bashku dhe ta shohim se çfarë mund të bëjmë që të përmirësohet kjo fushë. Faleminderit!

KRYESUESI: Mytaher Haskuka, në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”, e ka fjalën.

MYTAHER HASKUKA: Së pari, po më vjen mirë që në fund erdh radha për të diskutuar edhe këtë çështje, ose të vijë te debati lidhur me mosimplementimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

Në aspektin e përgjithshëm janë dy çështje, por do të flas edhe për një rast konkret lidhur me mosimplementimin e kërkesave të Avokatit të Popullit, siç është shkon në aspektin e institucioneve të gjyqësorit. Në raportin e fundit të Avokatit të Popullit, të cilin e kemi marrë vitin e kaluar, në tabelën nr.14 implementimi i rekomandimeve të nxjerra nga raportet për rastet e hetuara, domethënë theksohet se janë 57 rekomandime, nga këto vetëm 14 janë implementuar, ndërsa nuk janë implementuar 36 dhe 7 janë në pritje të implementimit. Domethënë, me njëfarë aspekti vetëm diku 25% të rekomandimeve të Avokatit të Popullit implementohen nga ana e institucioneve shtetërore dhe me këto, si për shembull, mund ta vërejmë në këtë tabelë që Qeveria e Kosovës i ka vetëm dy rekomandime të implementuara, 11 rekomandime të paimplementuara dhe 2 në pritje. Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale nuk ka asnjë rekomandim të implementuar, 7 janë të paimplementuara dhe 0 në pritje.

Është problematike, si për shembull, gjykatat e Kosovës, ku faktikisht ka shumë raste, të cilat nuk janë implementuar, po në përgjithësi, nga çështjet të cilat paraqiten nga institucioni i Avokatit të Popullit janë edhe zvarritje e proceseve gjyqësore, e cila është njëra nga problemet kyçe të qytetarëve të Kosovës, edhe nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës tanimë në raportin e tyre ceket se janë diku 417 mijë e 733 raste të pazgjidhura nëpër gjykatat e Kosovës, të cilët paraqesin një problem serioz dhe shkelje flagrante të të drejtave të njeriut në aspektin e drejtësisë.

Në këtë aspekt unë dua të marr një rast konkret se si të drejtat bazike të qytetarëve të Kosovës shkelen nga gjykatat e Kosovës dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit nuk merren parasysh. Edhe pse, për shembull, në rastin konkret janë dy rekomandime nga Avokati i Popullit, një në vitin 2012 dhe një në vitin 2014, me rastin e njëjtë dhe në të dy rastet asgjë nuk është bërë nga gjykatat për ta adresuar çështjen ose nga Ministria e Drejtësisë apo nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës apo kushdo qoftë që merret me drejtësi në Kosovë.

Për rastin konkret, unë e mora lejen edhe të personit që të flas me emër konkret dhe me mbiemër, është rasti i zotit Rrahim Bajrami, i cili në vitin 2003, për shkaqe pronësore, domethënë shkon në gjykatë dhe rasti vazhdon me vite të tëra. Para se të finalizohet rasti në vitin 2009, domethënë para se të vendosë gjykata se e kujt është prona, një gjykatë tjetër e Kosovës, Gjykata Komunale e Prishtinës, e shpall personin të vdekur, pa anëtarë të familjes prezentë, pa dëshmitarë, faktikisht janë dy dëshmitarë, të cilët nuk e njohin personin personalisht dhe pa raport mjekësor. Faktikisht, kjo është një keqpërdorim i gjykatave, në mënyrë që të fillohen ndërtimet në pronën e kontestuar.

Domethënë, këta persona, nuk do t'i jap emrat, me këtë vendim të gjykatës që është bërë në vitin 2009, kur personi Rrahim Bajrami është shpallur i vdekur, me këtë vendim pastaj këta vazhdojnë të bëjnë ndërtime në pronën e kontestuar të Rrahim Bajramit. Rrahim Bajrami pas këtij rasti, po në të njëjtin vit, më 2009, hap një padi ndaj gjyqtarit, i cili e ka shpallur të vdekur dhe dy personave, të cilët kanë kërkuar që të shpallet i vdekur.

Që nga viti 2009 asnjëherë nuk është mbajtur seanca lidhur me gjykatësin, i cili e ka shpallur të vdekur Rrahim Bajramin. Prej vitit 2015, diku rreth 15-16 raste, kërkesa për gjykatë është dërguar një herë në Gjykatën e Prizrenit, pastaj në Gjykatën e Gjilanit, pastaj prapë në Gjykatën e Prishtinës, por edhe pse 15 herë është thirrur, gjykata nuk ka mbajtur asnjëherë seancë lidhur me rastin konkret. Pastaj, pas të gjitha këtyre gjërave, domethënë Rrahim Bajrami këto i ka paraqitur te Avokati i Popullit dhe Avokati i Popullit, pas një shqyrtimi të mirëfilltë të raportit, në vitin 2013 nxjerr vendimet në 7-8 faqe dhe në faqen përfundimtare rekomandon:

1. Gjykatës Themelore të Prishtinës 4 rekomandime, që të merren masat e menjëhershme për shqyrtimin dhe vendosjen e lëndës gjyqësore të anketuesit Rrahim Bajrami pa vonesë të mëtutjeshme, lidhur me rastin e vitit 2003, rastin pronësor.
2. Të anulohet vendimi i Gjykatës Komunale të Prishtinës për shpalljen “të vdekur” të ankuesit Rrahim Bajrami.
3. Të merren masa ndaj veprimeve, keqpërdorimeve eventuale të gjyqtarëve përkatës për shpalljen “të vdekur” të ankuesit Rrahim Bajrami, si dhe zvarritjen e paanshme të procedurave gjyqësore në rastin Rrahim Bajrami dhe
4. Të garantojë shqyrtimin e rasteve dhe dorëzimin e aktgjykimeve për të gjitha palët, vënien e afatit të arsyeshëm në pajtim me nenet 6 dhe 13 të KDNJ-së.

Tash, ky vendim është marrë në vitin 2013 nga ana e Avokatit të Popullit, tani jemi në vitin 2017, jemi në prill të vitit 2017, domethënë kanë kaluar prapë 4 vjet nga vendimi i Avokatit të Popullit, asgjë nuk është rekomanduar, asgjë nga rekomandimet e Avokatit të Popullit nuk janë marrë parasysh nga Gjykata Themelore e Prishtinës dhe personi Rrahim Bajrami ende oficialisht, domethënë është “i vdekur” në raportet zyrtare të shtetit të Kosovës.

Pra, një person 8 vjet është në mesin tonë, kërkon të drejtën të shpallet që është i gjallë dhe ai nuk mund të arrijë këtë të drejtë. Dy vendime të Avokatit të Popullit nuk merren parasysh dhe më se 15 seanca nuk mbahen, ngase gjyqtarët nuk janë të interesuar që të gjykojnë kolegun e tyre, i cili në mënyrë të kundërligjshme e ka shpallur të vdekur personin Rrahim Bajramin. Tash, s'po di a ka ndonjë rast më flagrant të shkeljes së të drejtave të njeriut dhe të mosimplementimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit sa ky rast? Domethënë, ne si grup parlamentar e mbështesim kërkesën e deputetes zonja Teuta Haxhiut dhe rekomandimet, të cilat janë parapare për implementimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Edhe njëherë kërkojmë që rekomandimet, të cilat i nxjerr Avokati i Popullit të merren parasysh nga institucionet e Kosovës,

ngase është e papranueshme që më se 70-80% të rekomandimeve të mosimplementohen nga institucionet përkatëse, e këtu duke filluar prej Qeverisë së Kosovës dhe ministritë e tjera përkatëse dhe gjykatat e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Ali Berisha flet në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

ALI BERISHA: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit të Kosovës!

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot po debatojmë për një temë që është themel i shteti të së drejtës, mbrojtja dhe promovimi i lirive dhe të drejtave të njeriut. Por, në vend që të flisnim këtu me vlerësime pozitive sa i përket respektimit të të drejtave, në fakt, sot duhet të ankojemi dhe të kërkojmë llogari institucionale për moszbatimin dhe implementimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

Trendi i keq për të drejtat e njeriut pasqyrohet ende në statistikat e Kosovës. Një vlerësim është se institucioni i gjyqësorit dhe Administratës Publike, ku bëjnë pjesë ministritë dhe Administrata Lokale, prijnë në ankimimet e qytetarëve dhe problemet ankimore për shkeljen e të drejtave të njeriut. Sa i përket shkeljeve të të drejtave të njeriut nga sistemi gjyqësor, pjesa më e madhe e shkeljeve ka të bëjë me zvarritjen e procedurave gjyqësore dhe një grup i rasteve ka të bëjë me mosekzekutimin e vendimeve të plotfuqishme gjyqësore. Ndërsa, te Administrata ka probleme shumë të mëdha, për çka edhe ka pasur raport, të cilin e ka Qeveria dhe ne si Kuvend i Kosovës. Në atë raport mund të shihet një kulturë e papërgjegjësive të Administratës Publike dhe nuk ekziston asnjë kontroll efektiv gjyqësor mbi vendimet që nxjerr Administrata. Pra, i vetmi organ gjyqësor përgjegjës për kontrollin e Administratës është Departamenti për Konflike Administrative që funksionon në kuadër të Gjykatës Themelore dhe në Gjykatën e Apelit, gjithashtu.

Se ka mjaft shkelje të të drejtave të njeriut dhe sa i përket vetë të punësuarve në Administratën apo kandidatëve që pretendojnë të punësohen aty, mund ta vlerësoni edhe në raportet e Agjencisë së Pavarur Mbikëqyrëse të Shërbimit Civil të Kosovës, ku raportohet për ankimimet, për konkurse, largim nga puna pa bazë, zëvendësim apo degradim brenda institucioneve, e tjerë dhe askush nuk po ndëshkohet për këto shkelje. Edhe në rekomandimet që i ka publikuar institucioni i Avokatit të Popullit kërkohet që të ndërrohet kjo qasje dhe që duhet të ketë efekt më të madh në sistemin gjyqësor, në kontrollin e vendimeve që nxjerr Administrata e dy niveleve: atij lokal dhe atij qendror.

Avokati i Popullit në çdo raport të tij për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut ka dhënë shumë rekomandime, të cilat asnjëherë nuk janë marrë parasysh. Por, sipas Avokatit të Popullit, kjo do të duhej të na bëjë të mos ndiheshim mirë. Shteti është për t'u dalë në mbrojtje qytetarëve, e jo të jetë shkelës i të drejtave të njeriut. Për fund, shpresoj që ato që janë rekomandime të kësaj

seance të harmonizohen mes grupeve të deputetëve, të aprovohen, por edhe të implementohen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Berisha! Shukrije Bytyqi flet për Grupin “Nisma”.

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit, kryesues!

Fatkeqësisht sot po diskutojmë për shkelje të të drejtave të njeriut, ndoshta kishte qenë më mirë që ne sot të diskutojmë për avancim dhe ngritje të nivelit të vetëdijes dhe për mosshkelje të të drejtave të njeriut, por po shohim që ndër shkelësit kryesorë të të drejtave të njeriut prin Qeveria e Kosovës, mandej ministrinë, drejtorinë komunale, gjykatat, qendrat korrektuese, por edhe shkollat.

Për neve është shumë shqetësuese çështja e moszbatimit ose mosimplementimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, siç u cek edhe nga parafolësit e tjerë. Domethënë as 25% të rekomandimeve të Avokatit të Popullit nuk gjejnë zbatim nga institucionet përkatëse, të cilat kanë bërë shkelje të lirive dhe të të drejtave të njeriut. Ne konsiderojmë se institucioni i Avokatit të Popullit është një institucion i pavarur dhe ashtu edhe duhet të jetë. Prandaj, institucionet e tjera, ato që bëjnë shkelje të lirive dhe të drejtave të njeriut, duhet t’i marrin më me përgjegjësi çështjet dhe shkeljen e të drejtave të njeriut dhe t’i trajtojnë me shumë përpikëri rekomandimet e Avokatit të Popullit dhe t’i zbatojnë ato në përpikëri. Nuk janë pa shkelje të të drejtave të njeriut edhe universitetet e Republikës së Kosovës, ku prin Universiteti “Hasan Prishtina”, Universiteti i Prishtinës, po edhe universitetet e tjera.

Fatkeqësisht, domethënë që nuk kemi institucion në Republikën e Kosovës që nuk bën shkelje të lirive dhe të drejtave të njeriut. Ne e përkrahim iniciativën e koleges Teuta Haxhiu për këtë debat parlamentar dhe shpresojmë që rekomandimet të harmonizohen mes grupeve parlamentare, të votohen, por edhe të gjejnë zbatueshmëri. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Dëgjuam deklaratat në emër të grupeve parlamentare, fjalën e ka kërkuar kryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Isa Mustafa.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Unë nuk dëshiroj të diskutoj gjatë për këtë çështje, vlerësoj se ne duhet ta respektojmë institucionin e Avokatit të Popullit dhe po ashtu të bëjmë përpjekje maksimale për implementimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit, por në asnjë rast nuk duhet ta shfrytëzojmë këtë institucion për nevoja politike. Prandaj, unë ju ftoj që të jemi të kujdesshëm në vlerësimet që i japim. A janë vlerësime tona, apo vlerësime të Avokatit të Popullit, në qoftë se ne vlerësojmë se Qeveria e Republikës së Kosovës është shkelësi kryesor i të të drejtave dhe lirive të njeriut, unë ju kisha lutur ta argumentoni atë.

Në qoftë se këtë e ka thënë Avokati i Popullit, atëherë Avokati i Popullit duhet ta arsyetojë dhe ta argumentojë. Në qoftë se dikush thotë nga këtu, atëherë ju kisha lutur të argumentohet, sepse kjo nuk është vetëm çështje e relacioneve tona pozitive-opozitive, ose të relacioneve tona politike. Janë çështje edhe të relacioneve tona me komunitetin ndërkombëtar dhe në qoftë se ne për shkak të mospajtimeve të brendshme i dërgojmë sinjale komunitetit ndërkombëtar, se Qeveria e Kosovës është shkelësi kryesor i të të drejtave dhe lirive të njeriut, atë duhet ta argumentojmë, për arsye se është në pyetje shteti dhe Qeveria e shtetit.

Unë nuk di këso vlerësimesh. Unë e kam mbajtur grupin ndërministror për të drejtat e njeriut, ka qenë edhe Avokati i Popullit, kemi diskutuar për këto çështje, por në asnjë rast nuk e kam pasur një vlerësim se Qeveria është shkelësi dhe nuk e pranoj një vlerësim të tillë pa e argumentuar ju, ose pa e argumentuar Avokati i Popullit.

Ndërkaq sa i përket implementimit, përkatësisht realizimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, ne do ta bëjmë atë, do të insistoj që edhe grupi ndërministror të punojë edhe më tutje në këtë fushë, por kurrsesi që Institucionin e Avokatit të Popullit ta shfrytëzojmë për qëllime politike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër.

Atëherë vijojmë me diskutuesit tjerë të paraqitur sipas radhës. Bali Muharremaj, nga AAK-ja, e ka fjalën.

BALI MUHARREMAJ: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Nuk mund të ketë besim të qytetarëve në Institucionin e Avokatit të Popullit pa filluar të respektohen rekomandimet e tij nga institucionet e vendit.

Të drejtat e njeriut rregullohen me konventa të shumta në kuptimin ndërkombëtar, të dakorduara thuajse të gjitha shtetet, sidomos ato të fuqishme, nëpërmjet rezolutave të miratuara në organizatat e Kombeve të Bashkuara. Kosova, para se të ndodhë lufta, kuptohet ka qenë nën okupim dhe si e tillë është e kuptueshme që ai regjim ka bërë gjithnjë shkelje flagrante, diskriminim të të drejtave të njeriut mbi bazën e racës dhe etnisë.

Që nga viti 1999 e këndeje është e kuptueshme që liritë dhe të drejtat e njeriut brenda territorit të Kosovës kanë qenë më të mbrojtura. Janë më mirë pra vetëm nëse e krahasojmë me paraluftën, por nuk janë shumë më pak mirë nëse e krahasojmë ndër vitet e respektimit të të drejtave të njeriut, apo implementimin e rekomandimeve të Institucionit që merren me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, siç është Avokati i Popullit pas luftës.

Sa herë ka pasur raportim të Avokatit të Popullit për liritë dhe të drejtat e njeriut dhe ka dhënë rekomandimet e veta, prapë herën tjetër është dashur të flasim po për të njëjtat rekomandime, që nuk janë implementuar, kryesisht nga organet e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Shkelje të të drejtave të njeriut kemi kudo nga Qeveria e Kosovës në raportet me qytetarët, të cilat vazhdojnë të jenë kampion në këtë drejtim. Sikur të ishin në gjerësi të mira këto, atëherë do t'ia kalonim edhe Zvicrës. Shkelje ka edhe në qendrat e korrektimit të Kosovës, në spitale, në shtëpi të shëndetit, në shkolla, në institucione dhe në çdo vend tjetër ku kanë sado pak mundësi që ta bëjnë një gjë të tillë, sepse në vend të fuqizimit të Institucionit të Avokatit të Popullit nga ky Kuvend, por edhe nga Qeveria. Ne duke mos insistuar në zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit, ia humbim peshën dhe rëndësinë, duke mos u marrë shumë me të.

Pra, këtu shihet qartë kush është si dhe, të themi, sponsorizuesi kryesor i humbjes së peshës për Institucionin e Avokatit të Popullit, që ai është i vetmi organ civil e shoqëror, që ndoshta mund ta thotë opinionin e vet të pandikuar e të paanshëm politikisht.

Qeveria e Kosovës, duke mos e respektuar zërin dhe opinionin e Avokatit të Popullit sa u takon lirive dhe të të drejtave të njeriut, dhe përderisa vazhdon të jetë shkelësi më i madh i këtyre lirive dhe të të drejtave bashkë me institucionet e saj, normalisht se do të ketë raporte të dobëta e aspak shpresëdhënëse në kuptimin e përafrimit me Bashkimin Evropian dhe integritet në të.

Për fund e kam një pyetje për Qeverinë e Republikës së Kosovës, meqë në mes rregullimit të fondit ligjor sa i përket Avokatit të Popullit, moszbatueshmëria e rekomandimeve të tij konsiderohet vepër penale. A jeni në dijeni sa zyrtarë qeveritarë apo sa persona edhe nga sektori privat janë thirrur në përgjegjësi për moszbatueshmërinë e rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Faleminderit!

KRYESUESI: Vjosa Osmani e ka fjalën.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, kryesues!

E mirëpres debatin për këtë temë. Besoj se është një temë jashtëzakonisht e rëndësishme për shkak se një shoqëri funksionale e demokratike patjetër që matet edhe me nivelin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe jo rastësisht shtetet më të zhvilluara në Evropë, por edhe më gjerë, janë pikërisht shtetet që kanë nivel shumë më të lartë të të drejtave themelore e kushtetuese të qytetarëve të saj.

Unë e mora fjalën për ta dhënë një kontribut sado të vogël lidhur me rekomandimet që u prezantuan nga kolegja deputete.

E para, sa i përket rastit “Grudiq” kundër Serbisë, ky Kuvend në mandatin e kaluar e ka miratuar një rezolutë, e cila e ka obliguar Qeverinë e Kosovës që ta krijojë një komision ndërministror, i cili, përveçse do ta përfshijë edhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, po ashtu do të përfshijë edhe ekspertë të fushës së të drejtës evropiane dhe në veçanti ekspertë që kanë përvojë në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të cilët do t’u ndihmojnë pensionistëve që t’i përgatitin lëndët e tyre para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut kundër Serbisë.

Prandaj, në rekomandimet e Kuvendit ne duhet të kërkojmë edhe zbatim të plotë të asaj rezolute të Kuvendit dhe ndoshta ministri i Punës mund të na sqarojë deri ku kanë arritur në këtë proces dhe në qoftë se ka ndonjë rast konkret ku edhe janë ndihmuar pensionistët nga ky komision që t’i përgatitin lëndët e tyre për Gjykatën Evropiane.

E dyta, duhet ta inkurajojmë Qeverinë që t’i rrisë përgatitjet për anëtarësim në Këshillin e Evropës, sepse, tek e fundit, për të gjitha këto shkelje që po pretendohet se janë bërë nga institucionet publike të Kosovës, qytetarët e Kosovës sot nuk mund të vijojnë apo të shkojnë me paditë e tyre deri në Gjykatën e Strasburgut, por gjithçka përfundon në sistemin e drejtësisë së Kosovës, për të cilin edhe ka më së shumti vërejtje këtu në raportin e vitit 2016.

Në momentin kur Kosova është anëtare e Këshillit të Evropës, automatikisht është edhe palë në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe qytetarët e Kosovës do ta kenë edhe një instancë më shumë, një instancë të pavarur evropiane që do të vendosë për të drejtat e tyre.

E treta, rekomandoj që meqenëse shumë nga rekomandimet e Avokatit të Popullit ndërlidhen me ndryshime që duhet të bëhen në legjislacion dhe me punën e cila mund të bëhet në Kuvendin e Kosovës, pra që nuk kemi nevojë ta presim Qeverinë apo institucionet tjera ekzekutive, që ta bëjmë një lidhje të drejtpërdrejtë në mes të rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhe punës së komisioneve parlamentare në Kuvend. Pra, automatikisht rekomandimet që dalin nga ky Kuvend, për shembull, që lidhen me një ministri të caktuar, ose me Këshillin Gjyqësor, ose të tjera, të bëhen automatikisht pjesë e planit të punës së komisioneve të Kuvendit. Ka këtu pra çështje që lidhen me rekomandime për të drejtën e qytetarëve në ambient, kjo do të shkonte drejtpërdrejt në komisionin që merret me këtë çështje, ose Komisioni për Integritet Evropian për shumë nga çështjet që janë përmendur në raportin e vitit 2016. Natyrisht, Komisioni për të Drejtat e Njeriut do të duhej ta luante një rol koordinimi me komisionet e tjera në këtë aspekt.

Pra, ta japim edhe ne si Kuvend një kontribut të drejtpërdrejtë, që shkon shumë përtej këtij debati, duke thirrur vazhdimisht në raportime e dëgjime ministrat dhe duke i marrë ata në përgjegjësi për zbatimet e rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Pra, të shkohet shumë përtej një debati që bëhet një herë gjatë një mandati për këto rekomandime. Për shembull, te çështja e dhunës në familje, dhunës në baza gjinore, për të cilën raporti flet shumë pak në krahasim me shkeljet tjera, ndër të tjera rekomandohet që të bëhet profilizimi profesional i gjyqtarëve të

Gjykatës Themelore për çështjen e dhunës në familje. Me këtë çështje unë besoj që gjatë raportimit të Këshillit Gjyqësor në Komisionin për Legjislacion, patjetër do të duhej të ngrihej si çështje, por edhe kur të përgatitet buxheti vjetor i Republikës së Kosovës në buxhetet që ndahen për gjykata, patjetër duhet të kërkojmë që të bëhet buxhetimi edhe në këtë aspekt. Ose, për shembull, thuhet që duhet të harmonizohet Ligji për mbrojtjen nga dhuna në familje me ligjet tjera, për shkak të mospërputhjeve me disa nga dispozitat.

Kjo është iniciativë që mund ta marrim vetë ne si deputetë, pa pritur nga Qeveria dhe institucionet tjera që merren me këto çështje, siç janë Policia, Prokuroria apo gjykatat.

Dhe, përfundimisht, besoj që ka mundësi t'i shikojmë disa prej shembujve më të mirë në Evropë, siç është Suedia, dhe vendi ku ka lindur institucioni i Ombudspersonit që të shihet se si kanë arritur ato shtete që nivelin e zbatimit të rekomandimeve të Ombudspersonit ta kenë kaq të lartë dhe të shohim çfarë masash konkrete, të prekshme, që mund t'i ndërmarrim edhe ne, mund t'i kopjojmë, të them kështu kushtimisht, në mënyrë që edhe përqindja e zbatimit të rekomandimeve të Ombudspersonit nga institucionet e Kosovës të rritet.

Pra, propozoj që rekomandimet të jenë shumë më konkrete dhe të matshme, përafërsisht të jepet edhe afati kohor për secilin prej tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Së pari, më duhet të them që për të dëshmuar se këtij Kuvendi i ka humbur legjitimiteti e dëshmon fakti se as argumentet, as rezolutat, por edhe raportet me rekomandime që i votojmë nuk po e kanë asnjë kuptim për faktin se nuk po zbatohen nga institucionet tjera, qoftë nga Qeveria, apo edhe nga institucionet tjera të drejtësisë.

Deputeti ynë, Mytaher Haskuka, në emër të grupit parlamentar foli në përgjithësi për raportin e zonjës Teuta Haxhiu, që është deputete e Grupit Parlamentar të AAK-së, por u ndal veç e veç në shumicën prej këtyre rekomandimeve, mirëpo unë do të ndalem vetëm në dy çështje.

Sa i përket Institucionit të Avokatit të Popullit, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 132, paragrafi 3, thuhet: “Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’ia paraqesë atij apo asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligjin”. Pra, i bie që secili institucion, apo secili organ që e konsideron veten se është pushtet legjitim, duhet t’u përgjigjet rekomandimeve apo kërkesave të Avokatit të Popullit.

Meqë Qeveria është shkelësja më e madhe e të drejtave të njeriut, u tha këtu edhe në foltoren e Kuvendit, i bie që Qeveria nuk po e konsideron veten pushtet legjitim. Dhe, në qoftë se është kështu, unë pajtohem, sepse konsideroj që kjo Qeveri e ka humbur legjitimitetin.

Së dyti, në pikën 6 të rekomandimeve thuhet se Kuvendi i Kosovës gjatë plotësim-ndryshimit të Rregullores së Kuvendit ta rregullojë votimin apo mosvotimin e raporteve të Avokatit të Popullit. Ne e kemi pasur si Komision për Legjislacion një kërkesë të tillë nga Avokati i Popullit, në fakt ka qenë kërkesa e prerë që raportet e Avokatit të Popullit të mos i nënshtrohen votimit në seancën parlamentare, pra të diskutohen, mirëpo jo të votohen.

Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, institucionet e pavarura i raportojnë Kuvendit dhe shqetësimi im në këtë drejtim është se mos edhe institucionet tjera që janë të pavarura po e përdorin si precedent në mënyrë që të mos i raportojnë Kuvendit, apo që raportet e tyre të mos votohen. Në qoftë se do ta vendosnim drejt këtë çështje, është që me Rregulloren e Kuvendit, çfarëdo raporti i institucionet të pavarur, që nuk votohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, të shkarkohet ose drejtuesi i atij institucioni, ose Bordi, varësisht se si është i rregulluar institucioni. Mirëpo, kjo nuk po ndodh për faktin se edhe në qoftë se në të kaluarën nuk kanë kaluar në Kuvend të Republikës raportet e institucioneve të pavarura, askush nuk ka marrë përgjegjësi për këtë.

Pra, mendoj që këtë çështje duhet analizuar, në qoftë se jemi për votim ose jo të raporteve të Avokatit të Popullit. Ne si komision kemi pasur po ashtu takim me Komisionin për të Drejtat e Njeriut dhe po ashtu më duhet ta theksoj faktin që jemi në draftim të Rregullores së punës prej vitit 2010 dhe kjo është si vërejtje për Kryesinë e Kuvendit dhe pengesat që po i bëjnë në këtë drejtim. Prej vitit 2010, Kuvendi nuk ka një rregullore të re veten, edhe pse me Rregulloren aktuale thuhet se secila legjislaturë e ka rregulloren e vet. Ky Kuvend ka dështuar disa herë që ta votojë Rregulloren e punës për shkak të interesave të njerëzve përbrenda Kryesisë së Kuvendit.

Pra, po them se kjo çështje, domethënë kërkesa e Avokatit të Popullit, që rekomandimet apo raporti i tij të mos votohet në Kuvend, do të shqyrtohet edhe në grupin apo Nënkomisionin për Mandate dhe Imunitete, i cili aktualisht është duke u marrë me Rregulloren e punës. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka Selviqe Halimi.

SELVIQE HALIMI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Meqenëse pika e diskutimit ka të bëjë me një raport të Komisionit përkatës për të Drejtat e Njeriut dhe me disa rekomandime, unë dua të përqendrohem në diskutimin tim edhe rreth nivelit të ne deputetëve në raport me të drejtat e njeriut.

Fillimisht dua të them që pajtohem me të gjitha ato që tha kolegja ime, Vjosa, e që ma shkurtoi diskutimin. Cili është niveli i ne deputetëve? Cila është përgjegjshmëria dhe përgjegjësia e ne deputetëve në raport me të drejtat e njeriut?

Ne deputetët shpeshherë e kemi humbur arsyen, duke mos qenë mjaftueshëm të vëmendshëm, të përgjegjshëm dhe të kujdesshëm gjatë hartimit të legjislacionit, gjatë shqyrtimit të tij, qoftë në Kuvend, qoftë nëpër komisione përkatëse. Dhe, shkelja e të drejtave të njeriut, shkelja e lirive të njeriut, sesa është dhe në çfarë niveli është, varet fillimisht nga legjislacioni. Kushtetutën e kemi të rregulluar shumë mirë, i kemi edhe konventat për të drejtat dhe liritë e njeriut, të cilat jemi të obliguar t'i zbatojmë, por me legjislacionin e dytë, me ligje, me udhëzime administrative nuk qëndrojmë mjaftueshëm mirë dhe për këtë nuk mund ta fajësojmë asnjë institucion tjetër, që buron nga Kuvendi, përveçse ne vetveten.

Të nderuar kolegë,

Para se të flasim për zbatimin e lirive dhe të të drejtave të njeriut në praktikë, para se ta adresojmë përgjegjshmërinë te institucionet përkatëse, që domosdo pajtohem se nuk jemi në nivelin e kënaqshëm, unë bëj pyetje për secilin nga ne se sa po abuzojmë ne si deputetë me të drejtat e fëmijëve kur përdorim gjuhë të vrazhdë, gjuhë jashtë çdo etike parlamentare, duke iu adresuar njëri-tjetrit. Unë mendoj se më e rëndësishme është kjo, sesa kur flasim për adresime për të drejtat e njeriut nga institucionet, sepse ato mund të korrigjohen shumë shpejt, mjafton gatishmëria jonë në mënyrë të organizuar nga të gjithë mekanizmat shtetërorë.

Abuzimi me fëmijët, me gjuhën tonë joparlamentare, lë domosdoshmërisht pasoja në shëndetin e tyre mendor dhe për këtë asnjëherë nuk na shkon mendja para se të deklarohejmë. Asnjë fëmijë nuk është fajtor për asnjë veprim të prindit të tij, por ne duhet të jemi të kujdesshëm gjatë deklarimeve, kur flasim për njëri-tjetrin, për institucionet dhe përgjegjësit me emër dhe mbiemër. Kjo do t'i ruante fëmijët tanë që ata të mos kenë probleme me vetveten dhe probleme psikike dhe ata të mos jenë të padurueshëm dhe agresivë në rrethe shoqërore, siç po ndodh sot në Kosovë.

Çështja tjetër që do të kërkoja, në rekomandim duhet të hyjë domosdoshmërisht edhe rishikimi i legjislacionit dhe udhëzimeve administrative, sepse në veçanti me udhëzime administrative po lihet mundësia e shumë interpretimeve dhe për dikë udhëzimi del mirë dhe nuk ia cenon asnjë të drejtë, por për dikë cenon të drejta. Krejt kjo po ndodh për shkak se interpretimi i tyre pastaj po bëhet sipas tekeve dhe bindjeve politike. Kjo nuk ndodh vetëm në nivelin qeveritar, por kjo ndodh edhe në institucionet e pavarura publike, kjo ndodh edhe në nivelin lokal.

Andaj, bëj thirrje që të gjithë mekanizmat, të gjitha institucionet e vendit të jenë të përgjegjshme në respektimin e lirive dhe të të drejtave të njeriut konform Kushtetutës. Jemi mirë, por e mira asnjëherë nuk përfundon. Rrethanat nëpër të cilat jemi duke kaluar, bllokadat të cilat jemi duke ia bërë vetvetes dikush i koncepton si shkelje të të drejtave të njeriut, dikush i koncepton që nuk

janë të tilla. Andaj, ne duhet të ofrojmë strategji konkrete, të kemi definicione konkrete se çka duam të themi kur themi se kemi shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut, e jo t'i japim kahe politike, sepse shkelja apo liritë dhe të drejtat e njeriut kanë një koncept shumë të gjerë dhe buron nga institucionet dhe familja. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ismajl Kurteshi e ka fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Përshëndetje për të gjithë!

Dihet se Avokati i Popullit trajton vetëm ankesa të qytetarëve karshi institucioneve publike. Fakti që nuk janë të rralla rastet kur rekomandimet e Avokatit të Popullit nuk respektohen, dëshmon se shkeljet ndodhin nga institucionet publike.

Mosrespektimi i këtyre institucioneve ndodh më shumë në institucionet qendrore të vendit, edhe pse bazuar në statistikën në përgjithësi janë rreth 70 ose 80% të rekomandimeve, që nuk respektohen dhe kjo është edhe shkalla në të cilën shkelen edhe të drejtat e qytetarëve të Kosovës, pikërisht nga institucionet publike të vendit.

Duke pasur parasysh këtë injorim të Institucionit të Avokatit të Popullit po mungon edhe raporti i këtij institucioni për çështje dhe për institucione shumë të rëndësishme, po ashtu publike, siç është për shembull gjendja në burgjet e Kosovës. Këta muajt fundit të gjithë jemi dëshmitarë se në burgjet e Kosovës kanë ndodhur edhe vdekje të dyshimta të të burgosurve, e në mesin e tyre edhe e aktivistit politik Astrit Dehari, por për habi nuk kemi pasur asnjë raport të Avokatit të Popullit për gjendjen në burgjet e Kosovës, e që do të ishte me interes për të gjithë qytetarët e Kosovës, që ta kenë një raport të tillë nga një institucion aq i rëndësishëm.

Nëse nuk respektohen rekomandimet e Avokatit të Popullit, atëherë cila është arsyeja e ekzistimit të këtij institucioni dhe nëse këto rekomandime injorohen nga institucionet publike, e kryesisht ato qendrore, atëherë del se këto institucione praktikisht po i shkelin të drejtat e njeriut. Kështu që rekomandimet e sotme do të duhej të ndikojnë, të kontribuojnë, që kjo praktikë e mosrespektimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit të ndërpritet dhe kështu t'i kushtohet më shumë rëndësi respektimit të të drejtave të qytetarëve të vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, zoti Hamiti!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër,

Meqë u shterua debati, një pjesë e kolegëve i thanë disa prej diskutimeve që unë do t'i përmend tërthorazi.

Mendoj se është tepër me rëndësi që ne po e diskutojmë zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit. E përgëzoj kolegën Haxhiu që e ka marrë një nismë për faktin se si institucione mendoj se e kemi obligim të punojmë në mënyrë që këto rekomandime të zbatohen nga institucionet përkatëse.

Së fundi e kemi pasur edhe një kërkesë, siç u tha edhe më herët, nga Institucioni i Avokatit të Popullit, që të ndryshojë Rregullorja e Kuvendit dhe që raporti vjetor i Avokatit të Popullit të diskutohet në seancë plenare, meqë me këtë rregullore aktuale kemi problem dhe mund të flasim me orë të tëra, mirëpo nuk do të ketë asnjëherë zbatim të rekomandimeve të avokatit, nëse ne si deputetë të zgjedhur nuk do të kërkojmë përgjegjësi direkte nga Qeveria për zbatimin e këtyre rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

Do ta përmend këtu edhe shkeljen e të drejtave të njeriut, si raste të fundit. Mendoj se të gjithë jemi të vetëdijshëm për atë që javën e kaluar ka ndodhur në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, kur Vahide Tasholli nga Ferizaj e lindi foshnjën e saj në pllakat e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, në Klinikën Obstetrike Gjinekologjike. Po ashtu, rasti i kësaj ka qenë nëpër një pjesë të madhe të medievet të Kosovës dhe mendoj se është një shkelje flagrante e të drejtave të njeriut dhe institucionet përgjegjëse i kanë nisur hetimet lidhur me këtë rast.

Mua më vjen mirë, prandaj dua të përgëzoj Avokatin e Popullit, i cili duke u thirrur në kompetencat dhe përgjegjësitë që i ka, ka nisur hetimet 'ex officio' për rastin e lindjes në pllakat e QKUK-së dhe dëmtimeve që foshnja në këtë rast ka marrë. Po ashtu, edhe për rastin e fundit të kërcënimeve ndaj gazetares, zonjës Arbana Xharra. Do të thotë, Avokati i Popullit, duke u thirrur në këto kompetenca, ka marrë për sipër që 'ex officio' t'i hetojë këto raste dhe të dalë me rekomandime konkrete lidhur me shkeljen e të drejtave të njeriut dhe zbatimin e legjislacionit përkatës nga institucionet përgjegjëse.

Unë besoj shumë që institucionet duhet të jenë të vetëdijshme dhe t'i marrin me shumë seriozitet rekomandimet që do të dalin nga fillimi i hetimeve nga Avokati i Popullit dhe do t'i trajtojnë me shumë seriozitet dhe që raste të tilla të mos ndodhin më.

U përmend se kemi edhe shkelje të të drejtave të njeriut nëpër spitale, prandaj mendoj që rasti i fundit i zonjës Tasholli, lindja e saj në pllakat e QKUK-së, është një alarm për institucionet që ne t'i marrim në konsideratë dhe t'i trajtojmë me kujdes pacientët dhe të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Haskuka, a do edhe një herë të flasësh? Mytaher Haskuka e ka fjalën.

MYTAHER HASKUKA: Po, më herët ka qenë në emër të grupit. Nuk do ta zgjas, po vetëm pasi kryeministri na akuzoi pak për politizim dhe për pozitë-opozitë..., unë vetëm dua t'ia përkujtoj disa gjëra kryeministrit, edhe pse ai shkoi menjëherë.

Në aspektin e raportit të Avokatit të Popullit është tabela, e cila tregon për implementimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Brenda atyre institucioneve, të cilat faktikisht nuk i kanë implementuar rekomandimet e Avokatit të Popullit, në listë prin Qeveria e Kosovës. Unë i dhashë edhe statistikat në fjalimin paraparak.

Po ashtu, edhe ministrinë, të cilat janë pjesë e Qeverisë, shumica e tyre nuk i kanë implementuar rekomandimet e Avokatit të Popullit. Tash, çështja është se kjo nuk është as me opozitë, as me pozitë, por është për të drejtat e njeriut dhe lidhur me vendimet e Avokatit të Popullit për përmirësimin e gjendjes së të drejtave të njeriut në Kosovë. Në atë aspekt, ai si kryeministër duhet t'i marrë ato seriozisht dhe të mundohet që me Kabinetin qeveritar t'i implementojë rekomandimet e Avokatit të Popullit. Kjo është kërkesa që ne e kemi si deputetë.

Në aspektin e pikave, që nuk janë lidhur me shkeljen e të të drejtave të njeriut, apo me debatin se kush është fajtor, çështja është se ekzistojnë shkelje flagrante të të drejtave të njeriut në Kosovë. Unë paraprkisht e mora një shembull konkret, me emër e mbiemër, se si personit i privohet e drejta për të qenë i gjallë. Në anën tjetër, janë edhe çështjet tjera, të cilat i konstaton raporti. Mbrojtja e të drejtave të qytetarëve është çështje qeveritare, është çështje e kryeministrit, ai duhet të merret me to. Zvarritja e procedurave gjyqësore është çështje e cila domosdo lidhet me Qeverinë. Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore është çështje e cila lidhet me Qeverinë. Çështjet pronësore, të cilat paraqiten në raport si çështjet kryesore të shkeljes së të drejtave të njeriut, po ashtu janë çështje që lidhen me Qeverinë. E drejta e qasjes në dokumente publike, e cila garantohet edhe me Kushtetutë, e që nuk respektohet në shumicën e rasteve, në shumicën e institucioneve shtetërore, është çështje e cila lidhet me Qeverinë dhe me kryeministrin.

Të drejtat shëndetësore, mosrealizimi i së të drejtave shëndetësore, e cila paraqitet në raport, lidhet me Ministrinë e Shëndetësisë, lidhet me Qeverinë dhe me kryeministrin, barazia gjinore, e kështu me radhë. Domethënë, shumë çështje të cilat janë paraqitur në raport e të cilat janë çështje ku shkelen të drejtat e qytetarëve të Kosovës lidhen me Qeverinë. Unë këtu s'po shoh kurrfarë problemi në aspektin e kësaj.

Prandaj, meqë kryeministri nuk është këtu, por është ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, janë edhe rekomandimet lidhur me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, besoj se raporti duhet të merret seriozisht, po që se dëshirojmë që Kosova të përparojë në këtë çështje dhe ta kemi një shoqëri të mirëfilltë. Në atë aspekt, të merren seriozisht rekomandimet dhe të mundohemi t'i implementojmë ato.

Përndryshe, në raportin e vitit 2016 është edhe një pjesë që ka të bëjë me konditat në Burgun e Prizrenit dhe ndoshta qeveritarët po t'i kishin marrë seriozisht çështjet që janë paraqitur aty, ndoshta edhe rasti i Astrit Deharit s' do të ndodhte. Domethënë, Avokati i Popullit ka dalë me një deklaratë, në të cilën ka kërkuar që të ketë një hetim serioz dhe të paanshëm, e cila sërish nuk është respektuar nga organet kompetente.

Unë, në këtë aspekt, kërkoj që debatin ta kthejmë në atë aspekt se si ta përmirësojmë gjendjen e të drejtave të njeriut, e cila është shumë problematike dhe vazhdon të jetë problematike, po që se nuk merren parasysh rekomandimet e Avokatit të Popullit. Faleminderit!

KRYESUESI: Daut Haradinaj e ka fjalën.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesues!

Shkurt: Meqë, kryeministri shkoi, tashmë kjo që desha ta them veç e humbi peshën, por kryeministri nuk mund t'i shmanget përgjegjësisë, sepse është punëdhënësi më i madh në Kosovë. Këtu shumica e rekomandimeve të Avokatit të Popullit ndërlidhen me Ekzekutivin. Kjo është e para.

E dyta, ky debat është thirrur vitin e kaluar dhe tash prapëseprapë e ka humbur peshën, por liritë dhe të drejtat e njeriut shkelen pothuajse çdo ditë dhe në shumë sfera. Është krejtësisht e papërgjegjshme, kur kryeministri thotë “mos të bëjmë pozitë dhe opozitë”, ndërsa në anën tjetër sot e dëgjova një pyetje parlamentare, që një ministër i merr katër lëndë në Universitetin Publik. Kjo është absurd. A nuk kemi ne kuadro që do të mund të ishin pjesë e atij institucioni?

Nëse flasim për institucionet e brendshme, për avancimin e njerëzve, po ju siguroj që me FSK, me Polici, me inteligjencë, me Shërbimin Korrektues, me Universitet, me spitale, të gjitha këto shkojnë me të njohshëm dhe që ndërlidhen direkt me shefin e shtetit dhe ministrat e dikastereve të caktuara. Kurrkund nuk ka transparencë, kurrkund nuk ka barazi, gjithkund shkojnë me të njohshëm dhe avancohen, qoftë polici, qoftë ushtari, qoftë inteligjenca, qoftë shefi i inteligjencës, shefi i policisë, shefi i spitalit... Ne në Kosovë jetojmë, nuk mund të themi që s'është e vërtetë. Shumë e vërtetë është!

Për shembull, e kemi këtu ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale këtu, është një rekomandim, për shembull po e marr shumë thjesht: “Universiteti i Prishtinës duhet ta implementojë Ligjin rreth pranimi të fëmijëve të dëshmorëve”. Dhe, tash e sa kohë asnjë veprim nuk është bërë. I keni me data të shpjeguara.

Tash e dëgjova edhe një kolege të pozitës, e cila tha se nuk është mirë të diskutohet për të drejtat e njeriut. Në të njëjtën kohë e kemi edhe një debat pas kësaj pike, që ndërlidhet me të njëjtën

temë, i ftuar nga deputetët e pushtetit dhe që ndërlidhet me të drejtat e punëtorëve. Edhe ai është njeri, pavarësisht se e ka një detyrë.

Kështu që këta tash çka po bëjnë? Politikë po bëjnë. Me një fjalë, më mirë është të merren seriozisht rekomandimet, të implementohen, dhe e kanë obligim edhe ligjor, edhe kushtetues, se sa të thonë “pse opozita po e thirrka një debat”, i stërvonuar, i thirrur vitin e kaluar. Faleminderit!

KRYESUESI: Zafir Berisha e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Natyrisht, po flasim për një çështje të rëndësishme, e cilat në fakt paraqet gjendjen në të cilën gjendet shteti ynë, shtet i ri. Në fakt, moszbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit paraqet gjendjen e mjerueshme të institucioneve të vendit, veçanërisht të Ekzekutivit.

Është një fenomen që kemi rritje të numrit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga viti në vit dhe kjo është shqetësuese, për faktin se Ekzekutivi dhe organet përgjegjëse, jo që s’e marrin parasysh Avokatin e Popullit, por thjesht i shtojnë, ose i rritin shkeljet e të të drejtave të njeriut në vendin tonë.

Shkeljet e të të drejtave të njeriut janë evidente në Kosovë në të gjitha fushat, në shëndetësi, në punësim, ku gjendja është alarmante për shkak edhe të bindjeve politike, njerëzit ndëshkohen, ose edhe pse nuk janë anëtarë të skemave kriminele të parapolitikës së partive në pushtet. Natyrisht, shkeljet shkojnë edhe deri atje sa edhe subvencionet në bujqësi bëhen mbi baza partiake politike, gjë që nuk është pasqyrë e mirë, as për vendin, por edhe karshi miqve tanë ndërkombëtarë, si një vend me ambicie për integrim në familjen evropiane.

Shkeljet shkojnë deri atje sa edhe në skemat e përfituesve të ndihmave sociale të ketë ndërhyrje, por ajo që është më eklatante, që do ta ndërlidh edhe me qytetin prej nga vij unë, shkeljet e të të drejtave të qytetarëve në fushën e drejtësisë, veçanërisht në Prizren, ku ditëve të fundit është një rast tepër eklatant, ku për të njëjtën vepër një qytetar dënohet, ndërsa tjetri nuk dënohet. I pari nuk është pjesë e bandave të klanit “Pronto”, ndërsa i dyti është pjesë e bandave të klanit “Pronto” dhe nuk dënohet. Është shumë interesant se në medie kemi parë se është e njëjta materie dhe e njëjta lëndë. Kjo lë të kuptohet se, megjithatë, parapolitika e partive në pushtet është duke i shërbyer të keqes së vendit dhe është duke e paraqitur një pasqyrë jo të mirë në fushën e të drejtave të njeriut dhe në këtë rast unë mund të them se Kuvendi ka përgjegjësi që të kërkojë nga Ekzekutivi i vendit që në mënyrë rigorozë t’i marrë në konsideratë rekomandimet e Avokatit të Popullit. Faleminderit!

KRYESUESI: Famir Shurdhaj e ka fjalën.

FATMIR SHURDHAI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Meqë jemi sot duke debatuar për raportin e Avokatit të Popullit, i cili i saktëson të gjitha shkeljet e të të drejtave të njeriut, shkeljet e të drejtave të punëtorëve, shkeljet e të drejtave të fëmijëve, shkeljet e të drejtave të pensionistëve, unë po ndalem këtu në veçanti, pasi kryeministri tha “mos bëni politikë dhe adresohuni drejtpërdrejt institucioneve ku janë shkelur këto të drejta”.

Për shembull, në mandatin e kaluar, pasi këtu është edhe ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale e ka krijuar grupin, i cili ka bërë vlerësimin e për çështjen e pensioneve në lidhje me Serbinë, që është vjedhur fondi pensional dhe grupi i ekspertëve ka bërë gjithë ekspertizën dhe i ka rekomanduar Qeverisë dhe Qeveria e ka nxjerrë një udhëzim administrativ, ku në bisedimet me Serbinë do të futet kjo temë, e cila është shumë e nevojshme për qytetarët e Republikës së Kosovës, meqë është vjedhur fondi pensional nga Serbia.

Asnjëherë Qeveria e Kosovës apo ministrja për Dialog nuk e ka hedhur si temë të bisedimeve, as propozim, në dialogun në Bruksel çështjen e pensioneve të qytetarëve të Republikës së Kosovës, apo të fondit pensional, që është vjedhur nga Serbia. Madje, e kemi edhe rastin eksperimental, çifti Grujiq, që e ka fituar kontestin gjyqësor në Gjykatën e Strasburgut për të Drejtat e Njeriut. Personalisht jam takuar me çiftin Grujiq në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Ai mbeti një zë i shuar. Qeveria asnjëherë nuk mori asnjë rekomandim, që të paktën në bisedimet në Bruksel ta ketë temë kryesore këtë.

Janë edhe shumë çështje të tjera, mirëpo po ndalem te të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, te shkollimi i tyre, te përkrahja institucionale. Me të vërtetë, po abuzohet me ligj me këtë kategori sociale, sepse këta fëmijë po izoloohen. Familjet me asistencë sociale nuk po kanë mundësi ta mbajnë veten me atë asistencë sociale që marrin nga skemat sociale e lëre më nëse ata kanë fëmijë me nevoja speciale apo të veçanta, si do të gjenden në këtë rast? Po e marr një shembull, si prind i një fëmije me nevoja speciale, qysh do t'i trajtojë Kosova fëmijët në spektrin e autizmit? A do t'i lërë persona me retardime mentale që tërë jetën të vazhdojnë, e t'ua japim një pension, apo do t'i integrojë këta njerëz në shoqëri, sikur në vendet tjera?

Kjo po ndodh në Kosovë për faktin se institucionet e Kosovës nuk kanë kurrfarë përkrahjeje institucionale për këta fëmijë, përveç një pensioni të aftësisë së kufizuar. Kjo kategori e këtyre fëmijëve në vendet tjera integrohen në shoqëri me programe nga Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe me përkujdesje sociale, të cilët pas moshës 10 apo 12-vjeçare e kalojnë këtë problem.

Në Kosovë i kemi mbi 400 fëmijë, prindërit e shumicës së tyre kanë dalë jashtë shtetit, kanë shkuar azil, shumica e të tjerëve i trajtojnë në Kosovë nëpërmjet disa organizatave joqeveritare,

të cilat po mundohen të paktën t'i dalin në ndihmë kësaj kategorie. Madje, edhe me ligjin që tash po bëhet për aftësinë e kufizuar, pretendohet që të hiqet asistenca, nëse dikush i familjes është i punësuar, për këtë kategori, e kam fjalën për fëmijët me nevoja të veçanta, me sindromën dawn, me autizëm dhe me nevoja të tjera sociale.

Mendoj që Avokati i Popullit mirë i ka saktësuar të gjitha këto probleme. Edhe këto rekomandime janë për Qeverinë. Kryeministri nuk mund t'u ikën, as dikasteret e Qeverisë, obligimeve kushtetuese dhe ligjore, të cilat i miraton ky Kuvend. Mendoj që ne si Kuvend, ose duhet t'u përmbahemi rekomandimeve të Avokatit të Popullit, i cili është i pavarur, është i zgjedhur nga Kuvendi, ose nuk kemi nevojë ne të bëjmë politikë këtu, opozitë dhe pozitë, për ta thyer njëri-tjetrin. Kryeministri del edhe thotë: "mos bëni politikë... mos e shfrytëzoni rastin...".

Mendoj se këto rekomandime, Qeveria së pari duhet t'i marrë për bazë seriozisht dhe t'i shikojë mirë edhe rekomandimet e deputetëve këtu në Kuvend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faton Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Kryeministri deklaroi pak më herët dhe kërkoi që të argumentohet pse Qeveria e Kosovës është shkelësja kryesore e të drejtave të njeriut. E keqja në këtë çështje është që ai, posa e shtroi këtë pyetje iku nga seanca dhe, në fakt, përgjigjia për pyetjen që shtroi as që e interesoi.

Unë dua t'ia përkujtoj kryeministrit që Qeveria e Kosovës, jo vetëm nga opinionimi i brendshëm, jo vetëm nga opozita, por edhe nga organizata me renome ndërkombëtare, siç është ajo Amnesty International, është kritikuar për vdekjen e Astrit Deharit në rrethana të paqarta dhe shumë të dyshimta në burgjet e Kosovës.

Aktivistë të Lëvizjes "Vetëvendosje", si Adea Batusha, Frashër Krasniqi, Atdhe Arifi e Egzon Haliti po mbahen për arsye politike në arrest, edhe pse nuk ka asnjë fakt për akuzat të cilat u ngarkohen atyre. Ky është një proces krejtësisht politik dhe krejtësisht i diktuar nga politika dhe është një shkelje drastike e të drejtave të njeriut.

Sot kemi qindra fëmijë anekënd Kosovës prej moshës 10, 11 e deri në moshën 14-vjeçare, që punojnë rrugëve të Kosovës, shesin cigare, për t'i mbështetur ekonomikisht familjet e tyre. A nuk është kjo shkelje e të drejtave të njeriut?

Konsiderohet që informaliteti në ekonomi e kalon shifrën prej 30%. Këta janë punëtorë që punojnë në kushte të rënda, me rroga minimale, pa asnjë siguri sociale, pa kontribute për pensionet dhe pa asnjë të drejtë në punë. Sot kemi 420 000 dosje të pazgjidhura në gjykatat e

Kosovës, qytetarë të cilëve u është shkelur e drejta themelore e njeriut, e drejta që shteti në këtë rast ta ndajë drejtësinë për ta.

Gjykata Kushtetuese ka vendosur që punëtorëve të Fabrikës së Gypave në Ferizaj t'u paguhet dëmshpërblimi në raport me procesin e privatizimit, një vendim të cilin Qeveria e Kosovës në kundërshtim me ligjin nuk e ka zbatuar asnjëherë. Qeveria e Kosovës e mban përgjegjësinë kryesore dhe është shkelësja kryesore e këtyre të drejtave, për shkak se nuk ka krijuar kushte që ato të mbrohen.

Është detyrë e Qeverisë që t'i krijojë mekanizmat dhe të kujdeset që ata të funksionojnë. Kur Qeveria nuk i krijon mekanizmat mbrojtës, kur ajo nuk kujdeset që mekanizmat ekzistues të funksionojnë, atëherë ajo mban përgjegjësinë dhe është stimuluese, herë e drejtpërdrejtë, herë indirekte e shkeljes së të drejtave themelore të njeriut.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e merr Teuta Haxhiu. Teutë, i ke 5 minuta, të lutem!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!
Po u them faleminderit kolegëve, që e ndihmuan debatin.

Para së gjithash, është detyrë e secilit prej deputetëve, mirëpo sinqerisht humbja e interesimit dhe vonesat e thirrjes së debateve normalisht se po e tregon ndoshta një rezultat sa vërtet ka nevojë të diskutohet.

Është vërtetë e papranueshme se si Qeveria e Republikës së Kosovës nuk i merr, ama absolutisht, mos të them me 1% seriozitet rekomandimet, rezolutat që nxirren në Kuvend. Këtë e kam thënë shumë herë, me fakte.

Ashtu siç e përmendi edhe kolegja ime, Vjosa, janë shumë rezoluta, të cilat kanë mbetur nën hije dhe asnjëherë nuk janë marrë parasysh nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Të nxjerrë vendime Qeveria e Republikës së Kosovës dhe të mos i zbatojë vendimet e veta, kjo nuk do koment!

Prandaj, për kryeministrin, i cili tentoi të thoshte diçka në Kuvend, në fakt po i sugjeroj që ta lexojë me vëmendje raportin e vitit 2015 të Avokatit të Popullit. Po flasim, folëm, për raportin me rekomandime dhe nuk guxon të bëjë politikë me deputetët, në këtë rast tendenca, sepse nuk mund të bëjë, gjoja se nuk është shkelësi më i madh. Shkelësi më i madh dhe nuk mund të themi që kryeministri e ka hapësirë vetëm zyrën e vet. Kryeministri i ka vartësit e vet, pra ministrat, prandaj e kemi thënë sa herë, në papërgjegjësi për të qenë i përgjegjshëm në detyrën e vet, ai do të duhej shumë më herët të largohej nga Qeveria.

Prandaj, edhe një herë, faleminderit deputetë! Rekomandimet unë i kam lexuar më herët. Vërtet, i vlerësoj të gjitha sugjerimet tuaja dhe pres që t'i harmonizojmë ndërmjet grupeve parlamentare. Unë i kam shënuar disa nga rekomandimet e kolegëve deputetë dhe si të doni, vendos edhe nënkryetari... A të punojmë në rekomandime tani për pak kohë, apo ta lëmë pas drekës. Unë, megjithatë, s'po thërras drekë!

Pra, edhe një herë, faleminderit! Është shumë serioze që të flasim për rekomandimet e një institucioni, siç është Avokati i Popullit, prandaj nuk besoj se këtu ka politikë, por rekomandime me fakte, kush është shkelësi më i madh, se ato të tjerat që nuk janë në raport, normalisht se dalin shumëfish shkelës më i madh Qeveria e Republikës së Kosovës, pa dyshim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E dëgjuam debatin me përfundimin e kërkuarës së debatit. Të gjitha ato që janë rekomandime të kërkuara apo të sistemuara me deputetë të tjerë kur të bëhen gati vijnë në Kuvend.

Unë ju jap pushim për drekë deri në orën 15:00. Do të vazhdojmë atëherë. Faleminderit!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Po fillojmë, të nderuar deputetë:

6. Debat parlamentar sipas kërkesës së deputetëve Bekim Haxhiu dhe Xhevahire Izmaçu, të mbështetur edhe nga 8 deputetë të tjerë nënshkrues, në lidhje me shkeljen e të drejtave të punëtorëve në Kosovë

Deputetët Bekim Haxhiu dhe Xhevahire Izmaçu, të mbështetur nga 8 deputetë të tjerë, kanë propozuar debat parlamentar në lidhje me shkeljen e të drejtave të punëtorëve në Kosovë.

Xhevahirja nuk është, atëherë i japim të drejtën zotit Haxhiu që ta marrë fjalën për të bërë ekspozën e tij lidhur me çështjen e ngritur.

BEKIM HAXHIU: I nderuar nënkryetar,

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në bazë të nenit 68 të Kushtetutës dhe në bazë të nenit 15, pika 8 të Rregullores së Kuvendit, së bashku me deputeten Xhevahire Izmaçu dhe me mbështetjen e deputetëve të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike e kemi thirrur këtë debat parlamentar për të diskutuar në lidhje me shkeljen e të drejtave të punëtorëve në Kosovë.

Është evidente se në Kosovë shkelen të drejtat e punëtorëve. Kushtet e punës, siguria dhe shëndeti në punë janë ndër brengat kryesore të çdo punëtori.

Sipas raportimeve, vetëm gjatë 5 vjetëve të fundit në sektorin e ndërtimitarisë 61 qytetarë kanë humbur jetën në vendet e tyre të punës, ndërkaq 220 të tjerë janë lënduar. Ky numër mund të jetë shumë më i madh, sepse shumë raste të lëndimeve dhe vdekjeve në punë nuk raportohen fare.

Shkelja e të drejtave të punëtorëve fillon në shumë raste, duke mos u ofruar fare kontrata të punës, pastaj puna me orar të stërzgjatur, deri në 12 orë në ditë, punëtorët nuk kompensohen për punën që kryejnë jashtë orarit të rregullt të punës, u mohohet e drejta e shfrytëzimit të pushimit javor dhe vjetor, e që është shkelje e së drejtës për pushim. Mosrespektim i pushimit të lehonisë, ndërprerja e marrëdhënies së punës nga punëdhënësi pa paralajmërim, zgjatja e kontratave mbi vepër më shumë se sa lejohet me ligj, e të tjera, e në shumë raste edhe ato kur kuptohet se femrat janë shtatzënë nuk u ofrohet në sektorit privat punë fare.

Largimet kolektive nga puna janë të papranueshme dhe të dënueshme me ligjet në fuqi në

Republikën e Kosovës. Në fund të vitit 2016, siç e dini, kemi pasur largim kolektiv nga puna të 95 punëtorëve të KEDS-it.

Inspektorati i Punës në shkallën e parë dhe të dytë kishte vendosur në favor të punëtorëve, por KEDS nuk e kishte respektuar vendimin e Inspektoratit të Punës dhe Inspektorati i Punës ishte i pafuqishëm, duke mos i shqiptuar KEDS-it as gjobën me të vogël për mosrespektim të vendimit.

Prandaj punëtorët e larguar nga puna rrugën e tyre e kanë kërkuar nëpërmjet Gjykatës.

Kjo kërkesë është jo vetëm për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve që janë larguar në mënyrë kolektive nga KEDS-i, por edhe të atyre punëtorëve që aktualisht janë duke punuar në KEDS dhe u shkelen të drejta e tyre të punës dhe u nënshtrohen presioneve dhe shantazheve të ndryshme nga punëdhënësi.

Prandaj, kjo kërkesë është edhe në mbrojtje të punëtorëve të angazhuar në sektorin e ndërtimitarisë, aty ku kemi pasur shumë raste të vdekjeve për shkak të mungesës së kushteve të punës si në sektorin privat, por edhe në atë publik, në mbarë territorin e Republikës së Kosovës.

Ky debat organizohet për të gjithë ata punëtorë që kryejnë punën me përgjegjësi dhe përkushtim të plotë, ndërsa u mohohen të drejtat e tyre themelore të garantuara me ligj dhe Kushtetutë. Të drejtat e punëtorëve vazhdojnë të shkelen, edhe pse në aspektin ligjor të drejtat e tyre mbrohen me ligj.

Kuvendi i Kosovës për t'i mbrojtur të drejtat e tyre i ka miratuar këto ligje:

- Ligji i punës, i miratuar më 1 nëntor 2010,
- Ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë,
- Ligji për Inspektoratin e Punës,
- Ligji për Këshillin Ekonomiko-Social,
- Ligji për organizimin sindikal në Kosovë,
- Ligji për aftësim, riaftësim dhe punësimin e personave më aftësi të kufizuara,
- Ligji për grevat,
- Ligji për dhënien e lejes për punë dhe punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës, e akte të tjera nënligjore.

Përkundër miratimit të legjislacionit për këtë fushë, Inspektorati i Punës nuk ka arritur të jetë në shërbim të mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve për të mbikëqyrur zbatimin e ligjeve në fuqi.

Inspektorati i Punës ka vetëm 50 (pesëdhjetë) inspektorë, të cilët mbikëqyrin 37 komunat e Kosovës dhe kanë për obligim që së paku çdo punëmarrës ta inspektojnë një herë brenda një viti, apo edhe më shpesh, me kërkesë të palës së kërkuar.

Po, Inspektorati i Punës duket se ka devijuar nga detyra dhe përgjegjësia që e ka me ligj dhe, pse po e them këtë?

Sepse në shumë raste inspektorët e punës dhe Inspektorati i Punës, me kapacitetet që kanë, kanë interferuar në proceset e konkurrimeve në përzgjedhjet e drejtorëve, siç është rasti në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, por nuk janë marrë me problemet dhe me ankesat e punëtorëve dhe qytetarëve, të cilëve u shkelet e drejta e tyre e punës.

Puna e mirë e Inspektorati të Punës do të ndikonte në zbatimin e Ligjit të Punës dhe ligjeve të tjera të cekura më lart dhe kjo jo vetëm që do të ishte në shërbim të mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve, por do të ndikonte edhe në luftimin e informalitetit dhe zvogëlimin e papunësisë.

Nuk ka zhvillim ekonomik pa respektim të të drejtave të punëtorëve në sektorin privat. Ky sektor do të ishte atraktiv për punëkërkuuesin vetëm atëherë kur të respektohen ligjet në fuqi dhe respektohen të drejtat e punëtorëve.

Prandaj, duke parë këto shkelje të të drejtave të punëtorëve, së bashku me kolegen në bashkëpunim edhe me deputetë të tjerë kemi nxjerrë disa rekomandime, të cilat pres që të plotësohen nga ju, të nderuar kolegë deputetë. Prandaj më lejoni të lexoj që në fillim rekomandimet që mendoj se duhet të votohen në fund të këtij debati:

- Obligohet Inspektorati i Punës që të kryejë inspektime efektive në të gjithë sektorët,
- Të bëjë monitorimin e respektimit të të drejtave të punëtorëve në të gjitha ndërmarrjet publike dhe private dhe të gjitha raportet e inspektimeve dhe masat e shqiptuara t'i publikojë në ueb-faqen e Inspektoratit të Punës.
- Deputetët e Kuvendi të Kosovës janë kundër çdo largimi kolektiv nga puna. Prandaj, kërkohet nga KEDS që t'i kthejë në vendet e tyre të punës 95 punëtorët e larguar në mënyrë kolektive në vitin 2016.
- Të respektohet Kontrata Kolektive në të gjithë sektorët dhe në të gjitha ndërmarrjet.
- Të respektohet Ligji i punës dhe Ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe ligjet e tjera që rregullojnë të drejtat e punëtorëve, marrëdhëniet ndërmjet punëtorëve dhe punëdhënësve.
- Të funksionalizohet Këshilli Ekonomik Social i Kosovës dhe Këshilli Kombëtar për Sigurinë

dhe Shëndetin në Punë, duke u plotësuar me ekspertë të fushës përkatëse sipas ligjeve në fuqi, sepse këto këshilla nuk janë të plotësuara me kuadrat profesionale sipas ligjit.

- Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale të aprovojë Strategjinë për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve dhe për sigurinë dhe shëndetin në punë.

- Gjithashtu obligohet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale që të rrisë kapacitetet e Inspektoratit të Punës, transparencën dhe llogaridhënien.

- Inspektorati i Punës obligohet që çdo tre muaj të raportojë në Komisionin Parlamentar për gjetjet nga inspektimet, për nivelin e shkeljeve të të drejtave të punëtorëve në Kosovë dhe të gjitha këto t'i raportojë para Komisionit Parlamentar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani është radha e përfaqësuesve të grupeve politike. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, cili e keni fjalën? Abdyli nuk është, Mexhidja, nuk është këtu. Agim, ti nuk je në emër të grupit. Atëherë flisni me radhë, merrni dikush fjalën si deputet. Zoti Abdyl Ymeri e ka fjalën.

ABDYL YMERI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Sfida e cila po na përcjell nga viti në vit, edhe pse ka ndryshime, është niveli i lartë i papunësisë.

Përqindja e të papunëve pa dyshim është më e larta në rajon dhe në Evropë.

Kur flitet për ata që kanë pasur fatin të kenë një vend pune, pozita e tyre ende nuk është e kënaqshme, edhe pse kemi ligje të avancuara që rregullojnë këtë fushë dhe që janë sipas standardeve evropiane, por implementimi i këtyre ligjeve nuk është në nivelin e dëshirueshëm.

Standardet në sektorin publik dhe privat nuk janë në përputhshmëri me standardet dhe konventat ndërkombëtare.

Situata e të punësuarve në sektorin privat, krahasuar me atë të sektorit publik, është shumë më e rëndë, se shumica e të punësuarve në sektorin privat janë pjesë e ekonomisë joformale, e ekonomisë së zezës që është një fenomen tepër shqetësues dhe këta punëtorë janë të dëmtuar nga shmangiet e shpeshta fiskale.

Ende ka të punësuar në sektorin privat që punojnë pa kontratë pune, me orar të zgjatur të punës, pa të drejta për pushim ditor, pushimi javor ose vjetor, pa kompensim për punë jashtë orarit, pa sigurim në punë, pa pajisje mbrojtëse dhe pa të drejta fundamentale, të cilat rrjedhin nga instrumentet legale ndërkombëtare.

Një punonjës informal apo punëtor që punon në të zezën, është një punonjës i panjohur, pa asnjë të drejtë legjitime dhe, për rrjedhojë, nuk mund të monitorohet në kushte të tij, profilit të punës që do të thotë, nuk mund të flasim kurrësi për një vend të denjë apo për kushtet të sigurisë dhe shëndetit në punë.

Po ashtu kemi pasur raste dhe aksidente të rënda në punë dhe në forma të ndryshme është tentuar që të fshihen rastet e tilla, por kanë qenë mediat ato që i kanë dhënë fund heshtjes dhe fshehjes së aksidenteve të rënda, e në disa raste tragjike, edhe me humbje jete, duke i shfaqur pamjet në media të shkruara dhe elektronike.

Shtrohet pyetja: çfarë ndihme marrin këta punëtorë dhe familja e tyre pas këtyre aksidenteve, nëse nuk janë të siguruara, nuk kanë kontratë pune?

Pronari ka pushtet thuajse absolut mbi punëtorët dhe në rrethana të mosinspektimit nga ana e inspektorëve të punës, ai bëhet zotërues konkret i fatit të punëtorëve brenda orarit të punës.

Ky pushton buron edhe nga niveli i lartë i papunësisë që është në vendin tonë. Çka ndikon që organizimi dhe rezistenca aktive punëtoare të jetë inekzistente, ose në rastet më të mira rudimentare.

Si të tejshfrytëzuar dhe të nënshtruar në marrëdhëniet e punës, punëtorët fitojnë nga puna e tyre të ardhura të pamjaftueshme për të bërë një jetë shoqërisht të dinjitetshme.

Shumë shpesh më ka rënë të dëgjoj se nuk ka punëtorë të mirë dhe që nuk donë të punojnë.

Unë them se ka punëtorë të denjë dhe profesionistë të shumtë, vetëm se donë të trajtohen si duhet dhe paga dinjitoze, për të mbajtur familjet e tyre, po pse i njëjti punëtor që nuk ka punuar këtu, e që del në vendet perëndimore, është punëtori më i zellshëm? Sepse trajtohet si duhet dhe ka të ardhura të mjaftueshme për t'i përmbushur obligimet familjare.

Konsideroj se ata që merren me këtë fushë duhet të kenë një studim, një analizë dhe ekspertizë për tri gjëra esenciale të punëtorëve.

E para, mbi kushtet e jetës së punëtorëve, për të parë përballueshmërinë e jetës nga paga që e fiton dhe sa i përmbushet kërkesa familjare në përgjithësi.

E dyta, kushtet të punës: në çfarë kushtesh dhe në ç'ambient e kryen punën, shkalla e rrezikut shëndetësor në punë, raportet pushtetore me pronarin dhe mbikëqyrësit, marrëdhëniet mes punëtorëve dhe vështirësitë e organizimit sindikal, njohjen dhe zbatimin e të drejtave që burojnë

nga kuadri ligjor. Sepse në të dy sektorët, edhe atë publik dhe privat, kemi raste ku punëtorët i nënshtrohen një presioni për arsye të ndryshme.

Dhe e treta, kemi aspektin botëkuptimor, i cili është kufizuar në njohjen e ndërgjegjes punëtore mbi konceptet si shfrytëzim në punë, barazia dhe mundësia e vetë administrimit të ndërmarrjeve.

Institucionet tona që merren me këtë fushë duhet të bëjnë inspektime të shumta në mënyrë që të kemi sa më pak punëtorë që punojnë në të zezën dhe pa kontrata pune.

Gjatë inspektimit të fokusohen më shumë te të drejtat e punëtorëve që garantojnë me legjislacionin e punës, zbatim korrekt të kontratës së punës, e cila rregullon marrëdhënie në mes të punëdhënësit dhe punëmarrësit, kontrollin në drejtim të respektimit të orarit zyrtar, pagesës për orët jashtë orarit, pagesën e një page më të denjë dhe moslejimin e pagës nën atë minimale, po ashtu të kërkohet të rritet standardi i sigurisë dhe i shëndetit në punë, për të krijuar kushte më të sigurta pune sikurse dhe një ndërgjegjësim më të madh të vetë punonjësve për të kërkuar masa të duhura teknike që të ruajnë jetën e tyre.

Sipërmarrësit duhet të investojnë më shumë për sigurinë në punë, për vetë faktin se kostoja e parandalimit të një aksidenti është gjithnjë më lirë se sa kur aksidenti ndodh. Duke pasur gjithnjë në konsideratë edhe aspektin human të dëmtimit të njeriut, apo për më keq, akoma për humbjen e një jete njerëzore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Kolegë deputetë,
Zoti ministër,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar edhe pjesën e kërkesës së debatit nga dy deputetët, por edhe ka trajtuar me vëmendje të veçantë edhe rekomandimet që edhe u lexuan. Shumica nga to janë pjesë edhe e diskutimeve të përditshme, por edhe kërkesave dhe nevojave që kanë çështjet që kanë edhe me respektimin e të drejtave të punëtorëve në sektorin privat, por edhe në sektorët e tjerë në Republikën e Kosovës, duhet të kenë trajtim adekuat ligjor.

Tanimë është evidente që këto të drejta të punëtorëve në disa sektorë të caktuar, sidomos në sektorin privat, nuk respektohet, nga e cila përpos humbjeve financiare, kemi edhe raste të rënda të shfrytëzimit të paligjshëm të tyre, jo rrallë herë shumë nga këto kategori kanë pësuar edhe në shëndet dhe jetë.

Nevoja për punë ka bërë që shumë nga këta të mos bëhen pjesë e raportimit të shkeljeve të këtyre të drejtave dhe kjo na jep një arsye shtesë që organet kompetente, përpos obligimit ligjor që kanë në kryerjen e detyrave, të shtojnë aktivitetin e tyre në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve.

Pjesë të tjera, apo sektorë të veçantë që përmendëm, sidomos pjesa e sektorëve që kanë kaluar nga sektori shoqëror në atë privat, është tregues i qartë se institucionet e Kosovës nuk kanë qenë të vëmendshëm apo nuk kanë mundur t'u përshtaten kërkesave dhe mbrojtjes së të drejtave të këtyre punëtorëve, qoftë në mosrespektimin e Kontratës Kolektive, por qoftë edhe në mosrespektimin e Ligjit të punës dhe Ligjit për siguri dhe shëndet në punë, edhe ligjet e tjera që i rregullojnë këto të drejta.

Andaj, krahas rekomandimeve që janë dhënë, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës kërkon që Inspektorati i Punës jo vetëm të rrisë transparencën dhe llogaridhënien, por duke rritur numrin e punëtorëve dhe duke iu përshtatur një herë kërkesave të tyre edhe në raportim, por mbi të gjitha, edhe vënies para drejtësisë të gjithë ata që i shkelin këto të drejta në mënyrë permanente, qoftë në përjashtim jo të drejtë ligjor nga puna, qoftë në shkeljen e orarit të punës dhe, mbi të gjitha, mosrespektimin e shëndetit dhe jetës së tyre në punë.

Andaj, nëse është e nevojshme do të kemi qasje konstruktive në harmonizimin e këtyre rekomandimeve, edhe pse është tregues i qartë që këto rekomandime e plotësojnë edhe kornizën e kërkesave të vazhdueshme që kanë pasur deputetët apo që kanë ngritur deputetët karshi këtyre çështjeve jo rrallë herë edhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Ajo çka është thënë dhe neve si na është dhënë si informacion edhe nga vetë Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, është një tregues i rritjes së këtij kujdesi, ta quaj kështu, është një tregues i rritjes edhe i kërkesave që kanë dalë, rritjes së kapaciteteve të Inspektoratit të Punës, por njëherësh rritjes së llogaridhënies dhe përgjegjësisë që njerëzit që ankohen të marrinë përgjigje në afate sa më të shkurta kohore. Besoj që këto do të jenë pjesë e shpjegimit edhe nga vetë ministri.

Kështu që Grupi Parlamentar i LDK-së i përkrah këto rekomandime, besoj që edhe deputetët e tjerë, qoftë në aspektin ligjor, qoftë edhe në aspektin kohor të kërkesave për implementimin e këtyre rekomandimeve do të jenë koshientë ndaj këtyre kërkesave, të cilat janë shumë të drejta që njerëzit që mos pësojnë për shkak të mosrespektimit të ligjit, apo mbi të gjitha, për shkak të nevojës që kanë për punë dhe për jetë më të mirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Nëse në Kosovë ka një grup qytetarësh, i cili është krejtësisht i pambrojtur, i diskriminuar në formën më të vrazhdë të tij, i trajtuar pa dinjitet, i përçmuar, i zhveshur nga të drejtat elementare të njeriut, i shfrytëzuar në maksimum dhe i paguar në minimum, ky grup janë punëtorët e Kosovës. Kush janë këta qytetarë? Janë kryesisht punëtorë ndërtimi, shitës dhe shitëse në dyqane, në pompa të benzinës, pastrues dhe pastruese, janë punëtorë që merren me ndërtimin e rrugëve, kanalizimeve, janë punonjës furrash, fabrikash, punëtorë të KEK-u, “Bechtel&Enka”, të aeroportit, janë kamerierë e kameriere, janë kuzhinierë, taksistë, elektrikistë, shoferë, molerë, kopshtarë, teknikë medicinalë, janë rojë në ndërmarrje private të sigurimeve, berberë, kujdestarë fëmijësh, pra janë të gjithë ata që punojnë punë të rënda fizike dhe ofrojnë shërbime, pa të cilat nuk do të funksiononte jeta publike, madje pjesërisht as private në Kosovë. Cilat janë problemet e tyre?

Për ta kuptuar skllavërimin e punëmarrësve të Kosovës nuk ka nevojë për të cituar statistikat, për të prezantuar hulumtime të ndryshme. Mjafton të ndaleni në një punishte ndërtimtare, të bisedoni me një shitës në shitore apo në një pompë benzine, të diskutoni me një kopshtar dhe do të kuptoni shumë shpejt se të gjithë ata njerëz kanë të njëjtat probleme, e këto janë: orari i gjatë i punës, puna pa pushim vjetor, moskompensimi i orëve shtesë, moskompensimi i punës gjatë natës, ditëve të vikendeve, festave, pushimit të lehonisë, pagesës sipas kualifikimit, rroga të ndryshme mes grave dhe burrave për shërbime të njëjta, pagat minimale, moskompensimi i pushimit vjetor mjekësor, fatkeqësisë në punë, kushtet e rënda të punës në kundërshtim me Ligjin e punës dhe një varg problemesh të tjera, të cilat punonjësve të Kosovës u janë të njohura.

Mjafton t’u hedhim një sy kushteve të punës në ndërmarrjen “Bechtel&Enka” si një prej punëdhënësve të mëdhenj, për ta kuptuar se sa i diskriminuar dhe sa i skllavëruar është punëtori në Kosovë. 12 orë punë në ditë, një racion ushqimor, një ditë pushim në muaj, kush lëndohet largohet nga puna, kush mbetet invalid nga lëndimi, nuk merr dëmshpërblim.

Vetëm gjatë tre muajve të fundit kemi pasur gjashtë të vdekur nga fatkeqësitë në punë. Nëse vazhdon ky trend, deri në fund të vitit, së paku kështu thonë ekspertët, do të kemi edhe 20 të vdekur në fatkeqësitë e punës.

Rasti i fundit është ai i punëtorit të ndërtimtarisë në Prishtinë, Asllan Asllani, nga Drenasi, 41-vjeçar, baba i dy fëmijëve, veteran i UÇK-së, i cili në pamundësi për të jetuar me ndihmën, me lëmoshën prej 170 eurosh dhe ja çfarë keni bërë me veteranët e luftës, është detyruar të punojë në ekonominë informale për të siguruar ushqimin, për t’i siguruar mbijetesën familjes dhe fëmijëve të tij. Por, kush është fajtor për këtë situatë dhe marrëdhënies skllavopronare në punë? Kush është fajtor për orarin e gjatë 10, 12, 14 orë në ditë, për moskompensimin e orëve shtesë, për punën pa pushim vjetor, për një ditë pushimi në javë, e të shumë të tjerëve, një herë në muaj? Kush është fajtor që s’kemi siguri në punë? Kush është fajtor për rrogat minimale? Kush është fajtor që nuk kompensohet pushimi mjekësor, që nuk merret dëmshpërblim për lëndimet dhe

kush është fajtor që nuk zbatohet Ligji i punës? Kush tjetër: fajtor është Qeveria e Kosovës. Pse është fajtorë Qeveria e Kosovës? Është fajtorë për shkak që për 38 komunat e Kosovës ka punësuar vetëm 52 inspektorë, që i bie për çdo komunë të ketë mesatarisht nga 1.3 inspektorë të punës, të cilët e kanë për detyrë të kujdesen që të zbatohet Ligji i punës. Me 52 inspektorë në Kosovë nuk mund të sigurohet kurrë zbatimi i Ligjit të punës.

Edhe pse Ligji i punës ka shumë mangësi, ai paraqet një bazë solide për të drejtat e punëtorëve. Por Qeveria e Kosovës nuk është e interesuar që as kjo bazë solide e ligjit të zbatohet.

Duke mos u angazhuar për zbatimin e Ligjit të punës, ajo është kontribuuesi kryesor për rritjen e informalitetit në ekonomi dhe, në të njëjtë kohë, sponsoruesi kryesor i shkeljes së të drejtave të punëtorëve.

Informaliteti në ekonomi, nga njëra anë, krijon bazë për shkeljen e të drejtave të punësuarve dhe, nga ana tjetër, dëmton buxhetin e Kosovës dhe kjo nënkupton më pak buxhet për zhvillim ekonomik, më pak buxhet për arsim, më pak buxhet për pensione, më shumë raste sociale dhe më pak ndihma sociale, më pak inspektorë dhe, në fund, përsëri me pak të drejta për punëtorët dhe më pak punëtorë në tregun e punës.

Kur mungon kontrata në ekonominë informale apo kur ajo përpilohet jashtë Ligjit të punës, subjekti më pak i fuqishëm dhe më shumë i varur, në këtë rast, punëtori, është pala e dëmtuar, sepse raporti mes punëtorit dhe ndërmarrësit nuk është me raport vullnetar mes dy subjekteve të barabarta që kanë obligime karshi ligjit dhe obligime karshi njëri-tjetrit.

Ky raport, duke e pasur parasysh krizën e varfërisë, kthehet një raport skllavërues, ku punëmarrësi dhe vullneti i tij është të njëjtën kohë ligj, kushtetutë, shtet.

Punëtori e ka mbrapa familjen, duhet ta sigurojë ekzistencën e saj, ai është i gatshëm të pranojë gjithçka për të mundur ta sigurojë mbijetesën, edhe pse është i vetëdijshëm që trajtimi i tij është në kundërshtim me ligjin.

Tani, nëse ne vërtet dëshirojmë të mbrojmë të drejtat e punëtorëve, duhet ta bëjmë këtë me katër hapa që janë vendimtarë:

1. Të ndryshohet Ligji i punës për t'i shtuar të drejtat e punëtorëve aty ku me ligj janë të cinguara,
2. Të zbatohet Ligji i punës,
3. Të garantohet zbatimi i tij nëpërmjet rritjes së numrit të inspektorëve të punës dhe,

4. Të krijohet një gjykatë e punës, e cila merret vetëm me rastet e shkeljeve të të drejtave të punës, pa pasur nevojë për të pritur vite të tëra për t'i realizuar punëtorët e dëmtuar të drejtat që u takojnë me ligj.

Çfarëdo përpjekje tjetër, çfarëdo rekomandimi pa plotësuar këto katër pika, do të ishte qarje me lot krokodili dhe një debat pas gati tre vjetësh bashkëqeverisjeje, një debat tri orësh dhe 30 ditë para zgjedhjeve që mund t'i kontribuojë ndoshta rritjes së votave, por jo të drejtave të punëtorëve.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Pal Lekaj e ka fjalën.

PAL LEKAJ: Faleminderit, kryesues!

Qytetarë të Kosovës,

Kolegë deputetë,

Derisa Kosova ka kaluar nëpër zhvillime të ndërlikuara politike, të drejtat socio-ekonomike, përfshirë të drejtat e punëtorëve, nuk janë adresuar në mënyrë të përshtatshme, as në kohën e para pavarësisë, e as pas pavarësimit të vendit.

Kosova ka popullsinë më të re në rajon dhe një popullsi që ka rritje më të shpejtë se çdo vend në Evropë.

Të rinjtë meshkuj e femra nën moshën 25-vjeçare përbëjnë rreth 50% të popullsisë, nga të cilët rreth 20 janë të moshës 15 deri 24 vjet.

Përveç që është niveli i lartë i papunësisë këtu, në mesin e të punësuarve, sidomos në sektorin privat, por nuk përjashtohet edhe ai publik, kemi raste të shumta ku nuk respektohen të drejtat e këtyre punëtorëve, si në aspektin e lidhjes së kontratave, të cilat fare nuk respektohen, po ashtu në drejtën për pagesë shtesë pas orarit të rregullt të punës, po ashtu edhe sigurimet shëndetësore shumë punëdhënës nuk ua paguajnë.

Nuk duhet harruar edhe në rast të fatkeqësive gjatë punës askush nuk ua mbulon shpenzimet për shërim apo, larg qoftë, kur kemi raste me fatalitet gjatë punës. Askush nuk kujdeset më tutje për familjen e të punësuarit që pëson.

Pra, Qeveria si organ përgjegjës për të implementuar ligjet që përkojnë me këtë sektor, mund të arsyetohet se i ka ligjet më të mira në rajon, në këtë drejtim, por këto ligje që i kemi nxjerrë në këtë Kuvend nuk po zbatohen në terren dhe si pasojë e moszbatimit të ligjeve ata që po e pësojnë më së shumti janë punëtorët që në kundërshtim me ligjin, e pa më të voglin shpërblim punojnë edhe më tepër se tetë orë në ditë dhe në kushte tejet të rënda, si në kuptimin e mjeteve të

punës, e po ashtu edhe kuptimin e klimës, ata punojnë edhe kur është shi dhe rreziku është më i madh, edhe kur është borë po ashtu, që mund të jetë rrezik për të rrëshqitur.

Pra, kur flitet për të drejtat e punëtorëve, standardet në sektorin publik dhe privat nuk janë në përputhshmëri me standardet dhe konventat ndërkombëtare.

Situata e punëtorëve në sektorin privat, krahasuar me atë të sektorit publik, është shumë më e rëndë, ngase shumica e të punësuarve në sektorin privat janë pjesë e ekonomisë joformale, e ekonomisë së zezë dhe janë të dëmtuar nga shmangiet e shpeshta fiskale.

Nga rreth 400 mijë punëtorë në Kosovë, rreth 30% nga ta janë pjesë e ekonomisë joformale.

Sipas Trustit Pensional të Kosovës, janë rreth 280 mijë punëtorë që paguajnë kontributet e tyre aktivisht, kjo nga të dy sektorët, publik dhe ai privat.

Edhe pse, e thashë më lart, ligjet në Kosovë janë më të mira e Kushtetuta e Kosovës inkorporon në mënyrë indirekte konventa të shumta për të drejtat e njeriut, e rrjedhimisht për të drejtat e punëtorëve, ato prapë nuk respektohen ose nëse ndodh ajo, është me masë shumë të vogël.

Elementi tjetër i dobët në fushën e punësimit dhe të mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve është trupi ekzekutiv i Inspektoratit të Punës, i themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut mbi Ligjin thelbësor të punës, me një ligj të veçantë mbi Inspektoratin e Punës të miratuar në vitin 2002, ndryshuar në vitin 2008.

Që nga fillimi Inspektorati është ballafaquar me vështirësi në realizimin e kompetencave të caktuara dhe funksionalizimin si organizim struktural dhe mungesës së përkrahjes.

Pra, këto arsye nuk kanë arritur të përmbushin funksionet dhe obligimet e saj të parapara me legjislacionin vendor dhe standardet me përgjegjësi, ILO-konventës nr. 81 dhe protokollit të saj nga viti 1995. Neni 3, pika 1 a e konventës përcakton se funksionet e sistemit të inspektimit të punës duhet të sigurojnë zbatimin e dispozitave ligjore lidhur me kushtet e punës dhe mbrojtjes së punëtorëve në vendin e punës. Dispozitat e tilla që lidhen me orë, pagesë, sigurimi, shëndet dhe mirëqenie, punësimin e fëmijëve dhe personave të rinj dhe çështjeve të tjera, deri në atë masë që dispozitat e tilla të zbatohen nga inspektoratet e punës.

Kjo kërkon përkrahje të plotë nga institucionet qendrore, pra para së gjithash, duke krijuar kushte adekuate të punës dhe përkrahje optimale logjistike.

Duke marrë parasysh mungesën e kapaciteteve dhe ushtrimin të fuqive të sindikatave si dhe inspektorateve të dobëta, të cilat duhet t'i mbikëqyrin punëdhënësit, është e qartë se ka hapësirë të mjaftueshme për abuzim dhe shkelje të të drejtave.

Dikush mund të thotë se ka pasur përparime në fushën e të drejtave të punëtorëve në Kosovës, ndoshta me paraluftën dhe mund të ketë krahasime të tilla dhe mund të vërehet një përparim, por nëse e krahasojmë me pasluftën ose me paspararësinë, kemi ende sfida për t'u tejkaluar ky problem, e kjo ndodh për shkak të kompleksitetit të ligjeve dhe legjislacionit, në një anë, dhe implementimit të dobët, në anën tjetër.

Nga të gjitha raportet që janë bërë e që bëhen për këtë segment vërehet një konflikt i normave, e cila vazhdon të mbetet një pengesë serioze për implementimin e plotë të dispozitave ligjore dhe shpesh krijojnë situata të paqarta dhe pasiguri kur flasim për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve.

Është me rëndësi që të qartësohet Ligji i punës si dhe të sigurojë të drejtat e punëtorëve dhe të krijojë siguri të përgjithshme dhe mbrojtje më të mirë për punëtorët.

Është obligim i autoriteteve dhe i kompanive të hartojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të procedurave dhe instruksione të tjera ligjore, në mënyrë që të përmbushin dispozitat e Ligjit të punës, kjo duhet të ndodhë në vazhdimësi.

Institucionet publike duhet të jenë më aktive në promovimin dhe monitorimin e respektimin e të drejtave të punëtorëve, Inspektorati i Punës, Bordi Mbikëqyrës i Pavarur, gjykata, punëtorët socialë si dhe shoqëria civile duhet të kontribuojnë në mënyrë aktive në këtë drejtim.

Në të njëjtën kohë institucionet administrative, siç është Inspektorati i Punës, si dhe institucionet juridike, në përgjithësi gjykatat, u mungojnë kapacitetet që të mbikëqyrin implementimin e ligjeve dhe të ushtrijnë detyrat e tyre sipas kompetencave të tyre për shkak të problemit me staf, përkrahje financiare dhe pajisjeve adekuate, të cilat janë çështje thelbësore.

Duke marrë parasysh mungesën e kapacitetit të sindikatave për të ushtruar fuqi dhe dobësitë e përmendura me lart, është e qartë se mbikëqyrja dhe implementimi i Ligjit të punës mbetet një sfida e vërtetë për institucionet vendore.

Partnerët socialë si dhe shoqëria civile në përgjithësi, duke bërë këtë çështje temë diskutimi serioz për muajt dhe vitet në vijim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani po vazhdojmë me zonjën Mexhide Mjaku- Topalli.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kur jemi te debati rreth shkeljes së të drejtave të punëtorëve në Kosovë, opinioni publik për çdo ditë bombardohet me lajme për shkelje drastike të të drejtave të punëtorëve.

Themi se me dhjetëra punëtorë iu nënshtrohen kushteve të rënda të punës në sektorin privat, u mungon edhe mbrojtja adekuate të cilët i humbin jetët e tyre, lëndohen dhe nuk gëzojnë asnjë benificion as në shërim, e as që mund ta gëzojnë të drejtën e pensionimit edhe pse ndodh që të kenë lëndime të rënda.

Një numër i konsiderueshëm i punëtorëve në sektorin privat nuk kanë kontratë pune dhe nëse ndodh largimi i tyre nga puna, nuk kanë mundësi ankese. Por, edhe nuk u realizohet e drejta e kontributit pensional, po ashtu edhe orës shtesë nuk kompensohen.

Problemet nga marrëdhënia e punës, siç janë mungesa e kontratave të punës, mosrespektimi i të drejtave të pushimeve, pushimit të lehonisë, siguria në punë, diskriminimet e tjera, të gjitha këto janë si pasojë që punëdhënësi t'u ikë tatimeve.

Të nderuar deputetë,

Është fatkeqësi që të drejtat e punëtorëve cenohen edhe në rastet kur ligji ka krijuar mekanizma të qartë për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve dhe atë në sektorin publik.

Injorohen edhe vendimet e institucioneve kompetente, sikurse rasti i një të punësuarë femër, Shqipe Zeqiraj-Emini, drejtoreshë në shkollën “Muharrem Shemsedini”, në Bibaj, Ferizaj, e cila padrejtësisht për shkaqe politike, edhe pse i ka plotësuar të gjitha kriteret ligjore, nuk është pranuar në pozitën e drejtoreshës.

Në ankesën e asaj organet kompetente kanë vendosur drejtësinë, duke i dhënë të drejtën personit në fjalë dhe duke obliguar institucionin arsimor në Kuvendin Komunal në Ferizaj që ta emërojë të drejtën e fituar.

Në vendimin e parë aprovohet ankesa e Shqipe Zeqiraj-Emini, lidhur me vendimin vendit të punës drejtoreshë në shkollën “Muharrem Shemsedini”, më 16. 11. 2015 dhe vendimi i dytë më 16. 2. 2016.

Kjo femër akoma nuk është kthye në vendin e punës, këtë femër Komuna e Ferizajt e ka diskriminuar. Kjo femër troket dyerve të pushteteve politike duke kërkuar drejtësi.

E mora vetëm një shembull, por sigurisht se ka edhe shumë shembuj të tjerë nëpër sektorë të ndryshëm.

Vendimet e mara nga institucionet kompetente lidhur me evitimin e shkeljeve të të drejtave të punëtorëve nuk po respektohen në raste si në sektorin publik, ashtu edhe privat.

Kjo gjë na tregon se po na mungon mbrojtja e të drejtave të njeriut në fushën e punësimit.

Andaj rekomandoj:

Një: Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale nëpërmjet organeve të saja për zbatimin e ligjit të marrë masa kontrolluese si në sektorin publik, po ashtu edhe në atë privat, që të zbatohet ligji dhe të respektohen të drejtat e të punësuarve në tërësi.

Dy: Gjyqësori t'i trajtojë me prioritet të gjitha kontestet nga lëmi i punësimit si dhe të angazhohen në ndërgjegjësimin lidhur me të drejtat nga marrëdhënia e punës me qëllim parandalimin e diskriminimit, identifikimin e rasteve të cenimit të të drejtave nga marrëdhënia e punës, siç ishte edhe rasti i Shqipes, dhe vënia e drejtësisë në vend në rastet kur diskriminimi dhe shkeljet nga marrëdhënia e punës janë të pranishme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Besa Baftija e ka fjalën, le të përgatitet Agim Aliu.

BESA BAFTIJA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Aspirata për të mbrojtur dinjitetin e punëtorit në të gjithë sektorët paraqet thelbin e konceptit për të mbrojtur dhe të drejtat e njeriut.

Kjo aspiratë duhet të vëre qenien njerëzore në qendër të interesit. Ekziston e ashtuquajtura 'rregull e artë', sipas së cilës njeriu duhet t'i trajtojë të tjerët ashtu siç dëshiron ta trajtojnë atë vetë.

Por sa po trajtohen drejt punëtorët në sektorin privat nga ana e punëdhënësve kjo është larg kësaj thënie dhe asaj që obligojnë një sërë ligjesh që janë në fuqi e që rregullojnë këtë fushë.

Meqenëse shkelja e të drejtave dhe diskriminimi i punëtorëve në sektorin privat është shumë i madh, ashtu siç u tha nga shumë deputetë, unë diskutimin tim e kam fokusuar në shkeljen e të drejtave dhe diskriminimin që po u bëhet punëtorëve në kompanitë private në sektorin e pastrimit, mirëmbajtjes, sigurisë e kuzhinës në institucionet publike e shëndetësore.

Të gjithë e dimë se këta sektorë kanë qenë shërbime në kuadër të institucioneve shëndetësore publike, e ka disa vjet që këto shërbime që kanë qenë në kuadër të spitaleve janë privatizuar, e nga privatizimi kanë përfituar vetëm pronarët dhe individë që janë përfshirë në këtë proces. Ndërsa punëtorët janë ata që po u shkelen të drejtat që u garanton Ligji i punës dhe kontrata që ata nënshkruajnë në fillim të punësimit.

Çka është më e keqja, ndonëse të gjitha spitalet e përgjithshme janë nën ombrellën e Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, këto shërbime në disa spitale janë privatizuar, e në disa spitale janë në menaxhim të spitalit.

Po ashtu, në të njëjtin spital ka punëtorë që kryejnë të njëjtin shërbim, por që kuptohet ata që janë të afërt me menaxhmentin marrin pagë nga spitali, ndërsa të tjerët janë në kompani private.

Diskriminimi qëndron në atë se punëtorët, qofshin të sigurimit, të pastrimit, të mirëmbajtjes së kuzhinës nuk paguhen sikurse ata që marrin pagë prej spitalit derisa e bëjnë të njëjtën punë.

Këtyre punëtorëve nuk u paguhet trusti pensional, nuk u paguhen festat, puna e natës, stazhi i punës, puna jashtë orarit. Për shembull, një punëtor në sektorin e pastrimit që punon në spital, që është në kuadër të kompanisë private, deri para pak muajsh ka marrë pagë 170 euro, tani kanë pagën 205. Ndërsa punëtorët e pastrimit që janë në kuadër të spitalit marrin pagë 280 euro, plus u paguhet puna e natës, festat, trusti, dallime të tilla ka edhe në sektorë të tjerë.

Por, ajo çka është me rëndësi, nuk kemi dallime në shërbime, bile në disa spitale, ku këto shërbime janë me publikun, ka pastërti dhe rregull më të mirë, këtë e kemi parë dhe na e kanë thënë drejtorët e spitaleve të përgjithshme gjatë vizitave që i kemi bërë si Komision i Shëndetësisë gjatë monitorimit të Ligjit për shëndetësi.

Këta punëtorë, ndonëse trajtohen shumë herë edhe si skllave, nuk kanë guximin të kërkojnë të drejtat e tyre që u garanton Ligji i punës apo kontrata e punës, sepse po ankove, dihet se automatikisht e humb vendin e punës. Pastaj nuk kanë ku të ankohen, sepse kemi mosorganizim të sindikatave të punëtorëve privatë, kemi sistem gjyqësor të kapur.

Edhe atëherë kur u drejtohen menaxhmentit të spitaleve apo zyrtarëve ligjorë, përgjigja e tyre është se nuk kemi kompetenca dhe se gjithkund në kompanitë private punëtorët trajtohen në këtë mënyrë.

Pra, në vend që të inkurajojnë që këta punëtorë të kërkojnë të drejtat e tyre që u takojnë me ligj, ata në një farë mënyre i dekurajojnë dhe i frikësojnë punëtorët se mund ta humbin edhe vendin e punës.

Është shumë e qartë pse ndodh kjo, kur dihet se edhe në Ministrinë e Shëndetësisë, që është përgjegjëse për politika dhe organizimin e sistemit shëndetësor, nuk janë të interesuar për t'i zgjidhur këto padrejtësi, sepse është vetë Ministria e Shëndetësisë që ka bërë dhe bën padrejtësi të mëdha sa i përket punësimit, ndarjes së specializimeve, ku dihet se kriter për punësim dhe marrjen e specializimeve është të jesh militant i partisë politike që është në qeverisje.

Prandaj, ky debat sot që e kanë iniciuar deputetët që vinë nga subjekti, i cili është një ndër shkaktarët kryesor të kësaj gjendjeje të rëndë të punëtorëve në sektorin privat, sepse privatizimi i egër është përkrahur po nga këta. Atëherë kjo lë të kuptohet se kjo po bëhet për fushatë. Por punëtorët, jo vetëm ata, tani më e dinë dhe e kanë të qartë se nuk do të mashtrohen, ashtu siç u mashtruan tash e sa vjet, e t'i përkrahin ato subjekte që i kanë sjellë në këtë gjendje, sepse privatizimi në përgjithësi në Kosovë ka qenë proces i dështuar.

Nga ky proces kanë përfitur vetëm pronarët dhe individët që janë përfshirë në këto afera.

Prandaj, ne, Lëvizja “Vetëvendosje” nuk e kemi vetëm të bëjmë fjalë në Kuvend, por ne kemi në programin tonë, në alternativën qeverisëse, se do të angazhohemi të kemi një vlerësim gjithëpërfshirës të procesit të deritashëm të privatizimit.

Secili proces i privatizimit që rezulton në gjykatë si i parregullt, me shkelje ligjore, si rezultat i korrupsionit apo i mosrespektimit të kontratës dhe legjislacionit do të zhbëhet.

Meqenëse kam ende kohë, më lejoni, të nderuar deputetë, që para jush të paraqes edhe një shqetësim rreth shkeljes së të drejtave të punëtorëve që ka të bëjë me punëtorët tanë, qytetarët tanë, të cilët deri në pension kanë punuar në Zvicër, e tani jetojnë në Kosovë.

Mirëpo, siç e dini prej 1 prillit të vitit 2010 është bërë ndërprerja e njëanshme nga ana e Qeverisë së Zvicrës dhe këta punëtorë, këta qytetarë të Republikës së Kosovës nuk i marrin këto pensione, e kjo ka ndodhur nga neglizhenca që është shkaktuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, kur dihet se të gjitha ish- republikat nga ish-Jugosllavia që kanë dalë kanë një marrëveshje që e kanë vazhduar me Qeverinë e Zvicrës, ndërsa është e vetmja Qeveria e Republikës së Kosovës e cila nuk e ka vazhduar.

Në bazë të informacioneve që kemi, e të cilat informacione janë të sakta, tani Qeveria jonë është në negociata që të nënshkruajë një marrëveshje, marrëveshje e cila do të jetë e re dhe e cila shkon në dëm të këtyre qytetarëve, sepse këta qytetarë mund t'i marrin pensionet vetëm prej momentit kur kjo marrëveshje hyn në fuqi.

Prandaj, Qeveria jonë duhet të jetë syçelë kur është fjala për mundin, të cilin qytetarët tanë e kanë dhënë për vite të tëra në Zvicër dhe kjo i takon Qeverisë sonë që të negociojë në atë mënyrë që të mos bëjë shkelje të të drejtave të punëtorëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Aliu.

AGIM ALIU: Faleminderit!

I nderuar nënkryetar,

Ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe pse tashmë kanë kaluar shumë vjet pas luftës, respektivisht mbi 17 vjet, në Republikën e Kosovës, në sferën e të drejtave të të punësuarve ende janë evidente shkeljet e tyre në shumë sfera, sidomos kur kemi të bëjmë në sektorin privat, ku mund të themi se ende na duhet shumë punë për të bërë në këtë drejtim.

Edhe pse sa i përket legjislacionit të Republikës së Kosovës tashmë janë inkorporuar shumë direktiva të Bashkimit Evropian në ligjet bazike në fuqi, si në atë të Ligjit të punës, nr. 03/L-212 të vitit 2010, por edhe të Ligjit për siguri dhe shëndet në punë nr. 04/L-161, mirëpo deri te zbatimi i tyre mbetet ende shumë punë për t'u bërë.

Shkeljet me të mëdha të të drejtave të punëtorëve janë evidente, sidomos siç u cek edhe nga shumë parafolës, në sektorin privat, por mund të themi se edhe sektori publik po ashtu nuk dallon shumë sa i përket shkeljes së të drejtave të punëtorëve.

Te sektori privat ende ballafaqohemi me informalitet, ku ende në shumë subjekte afariste të punësuarit nuk janë të pajisur me kontrata të punës, pastaj kemi shkelje të të drejtave sa i përket orarit, respektivisht orar i stërzgjatur, mospagesa e orëve jashtë orarit të rregullt. Dihet se me ligj është paraparë orari i punës 40 orë në javë.

Shkelja e të drejtave sa i përket pushimeve javore, atyre vjetore, të cilat në shumicën e rasteve shfrytëzohen pjesërisht, e asnjëherë siç parashihet me ligj, katër javë në vit.

Pastaj është edhe mospagesa e ditëve të punës gjatë vikendeve apo ditëve të festave zyrtare e të tjera.

Shkelje të mëdha të të drejtave të punëtorëve ka te kompanitë që kryesisht merren me shërbime të ndryshme, të cilat përveç orëve të gjata të punës, edhe pagat i kanë nën mesataren më të ulët, e dihet fakti se paga minimale e lejuar në Kosovë është 170 euro.

Kur gjithë kësaj i shtohet edhe mungesa e kushteve të sigurisë në punë, e sidomos në lëmin e ndërtimtarisë, ku kemi rrezikshmëri të lartë gjatë ekzekutimit të punimeve, jemi dëshmitarë që çdo vit kemi edhe aksidente në vendin e punës, qofshin ato me lëndime të lehta apo të rënda trupore, por edhe me fatalitet.

Edhe kur kësaj i shtohet mungesa e sigurimeve shëndetësore, kjo e vështirëson ende më shumë gjendjen edhe ashtu të rënduar të të drejtave të të punësuarve. Tashmë, fatkeqësisht, qysh në fillim të vitit kemi edhe gjashtë raste me fatalitet.

Të punësuarit në këtë sektor edhe në sektorët e tjerë, ku rrezikshmëria është e lartë, nuk janë të pajisur siç duhet me pajisje personale, mbrojtëse, të punësuarit nuk janë të trajnuar për punët specifike që i bëjnë.

Prandaj, duke pasur parasysh këtë nivel të shkeljeve të të drejtave të punëtorëve konsideroj se Inspektorati i Punës, si organ i cili mbikëqyr zbatimin e Ligjit të punës, duhet t'i ngrejë kapacitetet, respektivisht të shtojë numrin e inspektorëve të punës, pastaj të ngrejë efikasitetin dhe cilësinë e inspektimeve që bëjnë.

Në Republikën e Kosovës me numrin 50 apo 52 inspektorëve sa janë aktualisht, është absolutisht e pamjaftueshme që kjo gjendje e të drejtave të punëtorëve të ndryshojë për të mirë.

Po ashtu është e nevojshme edhe bashkëpunimi edhe bashkërendimi i të gjithë aktorëve relevantë, duke përfshirë edhe organizimet sindikale, shoqërinë civile dhe të punësuarit që të gjitha shkeljet e të drejtave të të punësuarve t'i drejtojnë tek organet kompetente, sepse heshtja e këtyre problemeve vetëm sa do t'ua zgjasë jetën këtyre shkeljeve ligjore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Demaku e ka fjalën.

PUHIJE DEMAKU: Faleminderit, kryesues!

Është e qartë që në Kosovë është shumë e vështirë të gjesh punë, pikë së pari, e pastaj bëhet po aq e vështirë të jesh edhe punëtor, nga se në secilin fushë punëtorët pësojnë diskriminim të një lloji apo tjetër.

Po ashtu është fare e qartë se ndër kategoritë më të diskriminuara janë gratë e punësuarat, e në mesin e tyre pastaj diskriminim të theksuar pësojnë nënat e reja që ushqejnë fëmijët e tyre me gjii.

Nga takimet, bisedat dhe komunikimet e ndryshme me shumë nëna të reja kam kuptuar se një numër fare i vogël prej tyre janë në dijeni se ekziston Ligji për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri. Shumë nëna ose e kanë ndërprerë gjidhënien, ose kanë qenë të detyruara të lënë vendin e punës për të vazhduar të ushqejnë foshnjën me qumësht gjiri.

Nënat e reja që i ushqejnë fëmijët me qumësht gjiri dhe i kthehen punës pas pushimit të lehonisë ankohen për kushtet në vendet e punës, mungesë fleksibiliteti dhe mirëkuptimi nga ana e punëdhënësve për një detyrim të natyrshëm dhe thelbësor që vjen bashkë me të qenit nënë.

Edhe këtu nuk po flas për rastet kur fëmijët janë të sëmurë apo në një gjendje tjetër ku prania e nënës bëhet e domosdoshme për foshnjën, pra po flas për të drejtën elementare: të ushqyerit e foshnjës.

Ato po ashtu ankohen se detyrohen të punojnë në kushte të vështira duke iu ekspozuar produkteve të rrezikshme, orareve të stërzgjatura pa pagesë shtesë dhe ekspozimi ndaj stresit të lartë që po ashtu ndikon në shëndetin e tyre.

Këto nëna, përveç sfidave të shumta me të cilat përballen, detyrohen që për të ruajtur vendin e punës ta privojnë veten e tyre dhe foshnjën nga e drejta e garantuar me konventa ndërkombëtare, e tani edhe me ligj të Republikës së Kosovës.

Kjo tregon se Qeveria ka bërë fare pak apo, thënë më mirë, hiq për sensibilizimin e opinionit lidhur me ekzistimin e Ligjit për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri.

Në këtë rast nuk janë njoftuar as nënat, e me sa duket, as punëdhënësit.

Së dyti, kjo po ashtu tregon se edhe ata punëdhënës që janë në dijeni për dispozitat e këtij ligji, e heshtin atë nga se duan të përfitojnë në maksimum nga punëtorët gra, pa u dhënë pauzat e garantuara me pagesë.

Dua të marr shkas nga ky debat që t'ua citoj edhe një herë nenin 5 të këtij ligji që ta dinë edhe punëdhënësit, edhe nënat që i ushqejnë fëmijët me qumësht gjiri, se ka dispozita ligjore që i mbrojnë ato, në të cila dispozita edhe mund të thirren për të realizuar të drejtat e veta dhe të foshnjave të tyre.

Neni 5 i këtij ligji thotë si vijon: “Secilës grua të punësuar që ushqen foshnjën me qumësht gjiri i takojnë të gjitha të drejtat e garantuara me legjislacionin përkatës në fuqi në Kosovë. Çdo e punësuar që e ushqen foshnjën me qumësht gjiri, nëse nuk e shfrytëzon pushimin e lehonisë pas muajit të gjashtë të tij dhe sipas dispozitave përkatëse ligjore në fuqi, prej muajit të gjashtë deri në një vit ka të drejtën e pushimit me pagesë në kohëzgjatje prej dy orëve në ditë brenda orarit të punës, duke mos përfshirë pushimin e rregullt, pra pauzën, gjatë orarit të punës, për ta ushqyer foshnjën me qumësht gjiri, siç është përcaktuar me këtë ligj”.

Pika 3, e nenit të 5: “Çdo e punësuar që e ushqen foshnjën me qumësht gjiri pasi vitit të parë deri në dy vjet, ka të drejtën e një ore në ditë pushimin me pagesë brenda orarit të punës për ta

ushqyer foshnjën me qumësht gjiri, duke mos përfshirë pra prapë pauzën, pra pushimin e rregullt që është brenda orarit të punës.

Dhe pika 4, e nenit 5, thotë: “Çdo e punësuar që ushqen foshnjën me qumësht gjiri pushimi me pagesë në kohëzgjatje prej 1 apo 2 orëve në ditë brenda orarit të punës e shfrytëzon në fillim, në mes apo në përfundim të orarit të punës në marrëveshje me punëdhënësin dhe për këtë e njofton me shkrim punëdhënësin bashkë me vërtetimin e mjekut se e punësuar është në gjidhënie”.

Pra, le të marrim shkas nga ky debat që edhe një herë ta vëmë në dijeni edhe nënën, por edhe punëdhënësin kudo që janë, që ekzistojnë këto dispozita ligjore dhe le të jetë kjo një thirrje për nënat që ta shfrytëzojnë këtë ligj dhe një thirrje për punëdhënësit dhe për Qeverinë që të insistojnë në zbatimin e tij. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Shaip Muja e ka fjalën, përgatitet zoti Ismajl Kurteshi.

SHAIP MUJA: Zoti Haliti, faleminderit! Edhe pse po duket i varfër nga përbërja qeveritare kjo seancë, edhe nga përbërja e deputetëve, megjithatë është një temë shumë e rëndësishme të diskutohet dhe të adresohen problemet, të cilat nuk e besoj që kjo seancë do t'i përmbushë ato që duhet ne të përkujdesemi dhe shpresoj që edhe shefat e grupeve parlamentare do të kthehen këtu dhe t'i marrin obligimet, të cilat mund t'i adresojnë pranë deputetëve.

Nga kjo që po thonë kolegët tonë jepet përshtypje që ne kemi një adresim vetëm në tregun privat dhe po e harrojmë edhe tregun publik, edhe ky që është publik që punëson, është një lloj tregu. Por, po i harrojmë edhe të dhënat, të cilat Banka Botërore në vitin 2015-2016 e nxjerr Kosovën me 35 deri 38% në treg informal. Çka do të thotë? Nga 700 mijë vetë, minimum 30%, ose 38%, pra diku 260 mijë veta punojnë të paregjistruar dhe për t'u nënshtruar sigurimeve sociale, edhe mbrojtjes në punë. Por, cilët janë faktorët? Janë faktorët, të cilët me hile i bën Qeveria që nga viti 2013, deri më 2014 ka qenë në alert Qeveria që të rritet paga minimale e punonjëse.

Sot në sistemin e Kosovës ka pagë, e cila nuk është e tolerueshme, është më e ulëta në Ballkan, nga 135 deri në 170 euro paga minimale, që nuk lejohet, sepse aq e përkrah Ministria e Çështjeve Sociale. Nga aspekti i keqpërdorimeve në tregun privat, unë mendoj që mungojnë mekanizmat informues të punëdhënësit dhe punëmarrësit. Ne duhet të investojmë, t'i edukojmë edhe punëdhënësit, edhe punëmarrësit për benefitet që të jenë të punësuar në mënyrë legale, t'u nënshtrohen taksave dhe benefiteve konform ligjeve, të cilat i kanë parashtruar edhe kolegët tonë për debat.

Në sektorin publik Republika e Kosovës, konkretisht Qeveria e Republikës së Kosovës mashtron punonjësit dhe momentalisht ka 5 mijë deri në 6 mijë persona kjo Qeveri që i ka punësuar në kontratë mbi vepër. Çka do të thotë kjo? Kjo do të thotë një mashtrim i momentit, për militantët

politikë, për t'i arritur qëllimet votuese. Këto nuk janë politika për nevoja publike, por janë politika votuese që përkthyer në esencë, janë politika mashtruese. Prandaj, këto janë adresimet, të cilat ne duhet t'i adresojmë dhe t'i gjejmë si fakte, të cilat ne duhet t'i ngremë edhe në rekomandime për të ardhmen.

Problemet e mekanizmave kontrollues, nëse në shkallë vendi, në shkallë republike janë 50 inspektorë, për komunë i bie 1.3 inspektorë. Ata po të jenë 'spiderman' nuk mund të kontrollojnë sistemin e funksionimit, sepse nuk janë të përcaktuar inspektorët e punës vetëm për sistemin privat. Sistemi privat e mban Republikën e Kosovës, nuk e mban sistemi publik. Edhe në sistemin publik ka ngecje të kontrollit, të trajtimit, të hedhjes nga puna. Ne në pikën e kaluar e patëm për Avokatin e Popullit që i kanë ngritur shumë shqetësime për nxjerrjen nga puna të njerëzve në mënyrën si të ishte private institucioni publik, pavarësisht a është ministri, a është komunë, a çka është. Prandaj, ky trajtim ka krijuar një demotivim për të mos pasur interesim as në nivelin publik, as në nivelin privat. Në orientimet, të cilat thuhet se raportohen nga Inspektorati i Punës, Ministria e Çështjeve Sociale, e cila nuk i ka përmbushur obligimet, për mrekulli është duke përdorur politika spekulative për votuesit, e duhet ta dinë fort mirë votuesit e Republikës së Kosovës, duke filluar nga pensionistët, nga Agjencia e Punës, duke filluar nga organogrami që e ka brenda, se është duke i përdorur në mënyrë perfide politikat, të cilat janë më shumë interes të votuesve se sa në interes të shërbimit publik dhe privat.

Prandaj, në këtë pikë ka ngecje. Unë e kuptoj buxhetin e Republikës së Kosovës që është i ngecur, por nuk është e tolerueshme forma çfarë përdoret në këto politika. Prandaj, shpresoj që në rekomandimet e paraqitura, pavarësisht në disa institucione që u përmendur këtu, me theks të veçantë edhe në KEDS. KEDS-i është privatizuar, është e vërtetë, por është keqpërdorues i madh i nevojave tona për energji dhe i klasës punëtore brenda në KEDS. Ne nuk mund ta lejojmë KEDS-in të bëhet një sjellës i pakontrolluar mbi të drejtat e punëtorëve. Janë të drejtat e garantuara universale me ligjet e Republikës së Kosovës dhe, si të tilla duhet të jenë të adresuar si shqetësim serioz për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duhet të jenë të adresuara si shqetësim serioz për punonjësit, për deputetët e Republikës së Kosovës, edhe të këtij Parlamenti.

Prandaj, ne nuk duhet t'i lëmë vetëm tema në televizion, por duhet t'i trajtojmë si tema në komisione, t'i trajtojmë si tema jo vetëm sa për të kaluar një debat, por t'i shtjellojmë në mënyrë komplekse.

Në fund, unë besoj që meqenëse ministri ka mbetur i vetmuar këtu pa Qeverinë, të mos i marrë si adresime personale. Unë e di që janë përpjekje ekzistenciale të kësaj qeverie që të shtyjë një ditë më shumë qeverisjen, sepse kjo qeverisje nuk i ka përmbushur të arriturat dhe vlerësimet e njëjta i kanë edhe deputetët, kolegët e mi nga LDK-ja, të cilët me grimasat e tyre m'i miratojnë, po s'i sheh kamera dhe në këtë mënyrë, unë shpresoj që një formatizim sa më i shpejtë politik i

strukturës politike në Republikën e Kosovës do të sjellë një shpresë më të madhe për udhëheqjen e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sot është data 19, më 1 Maj është Dita e Punëtorëve, mund të dalësh në protesta. Zoti Ismajl Kurteshi e ka fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Në Kosovë nuk janë në hall vetëm të papunësuarit, ose edhe ata që i kanë humbur vendet e tyre të punës si rezultat i privatizimit të egër, edhe pse kishin kaluar shumë vjet në punë dhe kishin kontribuar shumë për zhvillimin ekonomik të këtij vendi.

Edhe pse kjo kategori, pra të papunësuarve, edhe të atyre që i kanë humbur vendet e punës është në pozitë më të rëndë. Edhe të punësuarit në sektorin privat përballen me shumë padrejtësi, si për shembull: orari i zgjatur i punës, punë pa asnjë ditë pushimi në javë, mohim i të drejtës për pushim vjetor, për pushim të shtatzënisë, mungesë e mbrojtjes në punë, kushtet e rënda të punës, të ardhurat nën çdo nivel, e shumë padrejtësi të tjera që ndodhin para syve të institucioneve të shtetit që paguhen për t'i mbrojtur të drejtat e punëtorëve dhe sindikatave që në këtë sektorë nuk u lejohet veprimtaria.

Shkelja më e rëndë e të drejtave të punëtorëve konsiderohet punësimi informal, pra mosevidentimi i punëtorëve dhe mospagesa e asnjë lloj kontributi për këtë kategori nga ana e punëdhënësve. Këta punëtorë nuk gëzojnë asnjë të drejtë, shpesh largohen nga puna pa i paguar për punën që e kanë kryer. Derisa të punësuarve legalë shpesh u lëshohen nga dy kontrata pune: njëra për ta prezantuar para inspektorëve të punës, nëse rastësisht ndodh që inspektorët ndonjëherë në vend të darkave dhe drekave, të merren me kontratat e tyre. Ajo është në përputhje me ligjin, pra kontrata e parë e punës, po që nuk zbatohet në praktikë dhe tjetra, pra kontrata interne që vihet në jetë dhe praktikë, e që është në kundërshtim me ligjin.

Punëtorët informale nuk kanë fare kontratë pune, askush nuk e di numrin e tyre të saktë, por dihet se janë shumë. Ata i hasim në shumicën e kompanive, ky fenomen është i njohur për të gjithë, përveç për inspektorët e korruptuar të punës, të cilët nuk janë të interesuar t'i zbulojnë punëtorët informale, siç nuk janë të interesuar të zbulojnë as shkelje të tjera që kanë të bëjnë me të drejtat e punëtorëve, si për shembull, mosimplementimin e vendimit të gjykatave për kthimin në punë të punëtorëve të larguar padrejtësisht nga puna ose të atyre që nuk i fitojnë vendet e punës për shkak të manipulimeve me konkurse nga punëdhënësit, në këtë rast publikë.

Një numër i madh i punëtorëve në sektorin privat aktualisht përjetojnë padrejtësi të mëdha, punëtorët informale dhe ata me dy kontrata pune punojnë në kushte skllavërie. Në kushte të ngjashme punojnë edhe punëtorët e kompanive private që burim të të ardhurave e kanë buxhetin e shtetit, pra kompanitë që i shesin shtetit shërbimet e tyre e i shkelin të drejtat e punëtorëve pa

asnjë pengesë nga Inspektorati dhe nga institucionet e tjera të shtetit që paguhen për t'u bërë shërbime punëtorëve. Edhe pse buxhetit të shtetit i kushton shumë më shtrenjtë blerja e shërbimeve nga kompanitë private për pastrim, sigurim fizik të objekteve, për kthim, e të tjera, se sa nga angazhimi i punëtorëve të punësuar drejtpërdrejt në institucionet, edhe pse punëtorët do ta kishin më mirë po të punësoheshin drejtpërdrejt në institucione, që po i blen shërbimet, megjithatë vazhdohet me blerjen e shërbimit.

Nga blerja e shërbimeve në vend të punësimit të drejtpërdrejtë përfitues janë vetëm kompanitë private dhe, sipas të gjitha gjasave, shpesh edhe zyrtarët që janë të implikuar në blerjen e shërbimeve nga privatët për institucionet. Shembuj të diskriminimit të kësaj kategorie hasim çdo kund, duke përfshirë këtu edhe Kuvendin e Kosovës. Me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve të garantuara me ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës, Inspektorati i Punës duhet të funksionojnë në përputhje me përshkrimin e detyrave të punës, me ligjet në fuqi dhe konventat ndërkombëtare që e rregullojnë këtë fushë.

Inspektorët e korruptuar, që shpesh shihen në dreka e darka me pronarët e kompanive dhe pasurohen shumë më shpejt se që ua mundësojnë të ardhurat e tyre, e që kurrë nuk marrin masa kundër shkeljeve të të drejtave të punëtorëve, duhet të largohen nga këto pozita shumë të ndjeshme. Sindikatat duhet të themelohen edhe në sektorin privat, nëse ka nevojë edhe me përkrahjen e drejtpërdrejtë të shtetit. Përgjegjësia për pozitën kaq të rëndë të të punësuarve në sektorin privat, por edhe në sektorin shoqëror, i takon institucioneve tona që nuk qajnë kokën për evitimin e këtyre dukurive. Kjo gjendje tepër e rëndë e të punësuarve, sidomos e atyre në sektorin privat, shpejt duhet të ndryshojë, por gjendja nuk ndryshon vetvetiu. Atë duhet ta ndryshojnë ata që paguhen për një gjë të tillë dhe e kanë marrë besimin e qytetarëve për këtë, por edhe vetë punëtorët e diskriminuar duhet të organizohen dhe ta ngritin zërin kundër këtij trajtimi çnjerëzor nga ana e punëdhënësve të tyre, e të cilët kanë mbetur edhe pa përkujdesjen e institucioneve të shtetit. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Luljeta Veselaj-Gutaj e ka fjalën.

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Derisa flasim për të drejtat e punëtorëve, pa dyshim se flasim për një të drejtë të garantuar dhe e cila po sfidohet dita-ditës në Kosovë.

Të drejtat e punëtorëve vazhdojnë të mos respektohen në masë të madhe, duke filluar nga kushtet e punës, kontratat, siguria, shëndeti, oraret e stërzgjatura në punë pa kompensime, pa pushim, etj. etj. Derisa flasim për të drejtat e punëtorëve, nuk mund të lëmë anash trajtimin e të drejtave që në vazhdimësi nëpërkëmbën nga punëdhënësit, e që janë të drejtat e femrës së punësuar qoftë në sektorin publik apo në atë privat. Trajtimi jo i drejtë dhe jo i barabartë i femrës së punësuar, ku

ne jemi dëshmitarë të jo pak rasteve që janë bërë shkelje të të drejtave të tyre në punë. Shumë prej këtyre rasteve janë bërë edhe publike, por edhe më keq, kur ato nuk po bëhen publike.

Duke filluar nga kompanitë me renome, e për të vazhduar deri te bizneset me numër simbolik të të punësuarve, madje pa i lënë anash edhe mediat, për të cilat veç jemi të njoftuar, ka pasur mjaft raste të trajtimit jokorrekt të femrave në punë. Shumë gra shtatzëna dhe shumë gra, të cilat sapo kanë lindur, janë përballur me largime nga puna para se ato të lindin apo edhe pas lindjes. Në disa raste, duke shpikur arsye nga punëdhënësit apo edhe pa arsye fare, ato janë larguar vetëm e vetëm që të mos mbeten barrë për pagesë në pushimin e lehonisë.

Edhe trajtimi në rastet kur akoma nuk janë larguar nga puna, trajtimi i grave shtatzëna apo lehonave është për të ardhur keq në shumë raste kur kanë pasur punë me oraret e zgjatura, punë që nuk është kompatible me gjendjen e nënave, të cilat kanë qenë në ardhje të fëmijës, punë me stres dhe pa konsideratë, si dhe shumë e shumëçka tjetër që e karakterizon një femër shtatzënë, apo një femër lehonë në Kosovë. Kjo sigurisht se do të ketë ndikimin edhe në uljen e natalitetit në Kosovë dhe është një demotivim për të gjitha femrat që pretendojnë të bëhen nëna dhe njëkohësisht të jenë të punësuar për të mbajtur familjet e tyre. Institucionet e Kosovës, sidomos Inspektorati Punës dhe institucionet e tjera përgjegjëse, duhet të bëjnë më shumë për të garantuar zbatueshmërinë e Ligjit të punës dhe respektimin e të drejtave të punëtorëve.

Ky debat në fund duhet të nxjerrë rekomandime të qarta, të cilat duhet të jenë obliguese për institucionet tona dhe ne duhet të jemi përgjegjës për monitorimin e zbatimit të këtyre rekomandimeve. Punëtorët në Kosovë duhet të trajtohen drejt dhe në përputhshmëri me ligjin, nuk duhet të lejojmë që në Kosovë dikush të trajtohet si skllav, vetëm e vetëm se shpreh gatishmërinë që të punojë dhe të kontribuojë për veten, në radhë të parë, për familjen dhe rrjedhimisht për gjithë vendin.

Unë i ftoj të gjithë kolegët që sot pas këtij debati t'i harmonizojmë qëndrimet tona rreth rekomandimeve dhe të njëjtat pas votimit t'i monitorojmë në zbatimin e tyre në vazhdimësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Kajtazi e ka fjalën.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër Abrashi,

Sot kur flasim për të drejtën në punë, natyrisht që ndoshta nuk mund ta kalojmë problemin e papunësisë, i cili dominon te ne dhe, mbi të gjitha, duhet të shikohen dhe politikat nacionale, të cilat do të ndikojnë në zhvillimin ekonomik, i cili në rend të parë nuk do t'i diskriminonte

njerëzit që t'i qasen tregut të punës dhe pastaj për të folur për kualitetin e punës apo për kualitetin e të drejtës së gëzimit të punësimit.

Komisioni i të Drejtave të Njeriut vazhdimisht pranon peticione dhe peticionet me të cilat përballet ai janë çështje, të cilat u ngritën edhe nga kolegët deputetë këtu, edhe nga humbja e të drejtës së punës nga procesi jo i mirë i privatizimit, edhe nga diskriminimi në punë a diskriminimi gjinor. Prandaj, ne nuk mund ta kalojmë këtë dhe, edhe pse u theksua ndjeshëm edhe nga deputetët e tjerë. Për barazinë gjinore është shumë me rëndësi pozita e gruas në tregun e punës dhe rol kyç në këtë luan kuadri ligjor që e garanton këtë të drejtë. Kemi mospërputhshmërinë e disa ligjeve, siç është ai Ligji për shërbimin civil me Ligjin e punës, ndërsa ligjet e të drejtave të njeriut që është ai i barazisë gjinore, mbrojtja nga diskriminimi dhe Ligji për Avokatit e Popullit tani flasin për më shumë mundësi në këtë drejtim.

Ne më parë, në pikën paraprake folëm edhe për rekomandimet e Avokatit të Popullit dhe mbetën pa u përmendur edhe kompetencat e Avokatit të Popullit tani me ligjin e ri, me plotësimndryshimet e reja në mbikëqyrjen e sektorit privat, në të drejtën e punësimit. Për fat jo të mirë, Avokati evidenton shkelje të vazhdueshme dhe në këtë aspekt përballet edhe me kërkesat, të cilat ne duhet t'i shohim qartë në atë që thashë si bërje e politikave nacionale, të cilat edhe garantojnë të drejtën e punës, por edhe ofrojnë parametra të tjera, të cilët ne duhet t'i shohim. Nuk është për t'u injoruar edhe kërkesa e bizneseve që të rishikohet më mirë Ligji i punës, i cili u bie barrë bizneseve për të paguar edhe pushimet e lehonisë, edhe pushimet e tjera.

Prandaj, duhet të jetë shteti ai i cili e bën këtë balancë mes zhvillimit ekonomik, zhvillimit të atyre bizneseve dhe të drejtës dhe qasjes në punë. Diskriminimi në punë fillon që nga koha ndoshta edhe e hapjes së konkursit, kur specifikohet përpos gjinisë, edhe mosha, kërkohet moshë e re, zakonisht tejkalim i fazës riprodutive për të mos u përballë me pagesa të pushimit të lehonisë dhe çështje tjera, të cilat me të vërtetë kërkojnë një vëmendje më të theksuar edhe më serioze në këtë aspekt. Forcimi i mekanizmave, siç është ai që u kërkua edhe këtu, më shumë inspektorë për ta mbuluar krejt sektorin, do të ofronte më shumë kualitet të të drejtave në punë dhe po ashtu, siç thashë, tani edhe kompetenca e re e institucionit të Avokatit të Popullit dhe ajo që rrallë shfrytëzohet, e kemi parë nga ajo e peticioneve, nga kërkesat e drejta ligjore e bazuar në konventa, duke e ditur se Kushtetuta e Republikës së Kosovës u jep supremacinë e sundimit apo të të drejtës konventave ndërkombëtare më shumë se ajo që është e drejtë edhe ligjore.

Edhe pse nganjëherë thashë se edhe ligjet flasin mjaft, ndërkohë që ne nuk i zbatojmë mjaftueshëm dhe ajo që është esenciale për t'iu qasur edhe tregut të punës është ofrimi i institucioneve, ngritja e institucioneve të kujdesit edhe për fëmijët, për të moshuarit, i cili do ta bënte konkurrent serioz edhe gruan dhe, për këtë, edhe pse është një kuotë e përfaqësimit, kuota është një përmirësim i kulturës, e cila do t'i japë hapësirë kultivimit të ambientit apo të konkurrencës reale, e cila besoj që nuk mungon përgjithësisht te gratë. Prandaj, unë mendoj se

është mjaft komplekse që të shihet qartë kjo çështja e politikave që mbron biznesin, mbron punësimin, mbron të drejtat edhe kualitetin në punë dhe të gjitha çështjet e tjera, të cilat prezantohen me këtë gjë. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka zoti Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit!

U thanë shumë gjëra këtu sa u përket të drejtave të punëtorëve, edhe mënyrës se si zbatohen ato, ose realizohen këtu në Republikën e Kosovës. Po mendoj që, së pari, duhet ta kemi parasysh që edhe Ligji i punës në formën e vet, në të cilën është, nuk është se i mbron kushedi sa të drejtat e punëtorëve, e natyrisht pastaj aq më pak ato mbrohen kur ky ligj nuk zbatohet fare dhe mendoj se këtu problemi duhet të shtrohet në të dyja rrafshet. Mirëpo, pa e shtruar problemin në rrafshin ligjor, legjislativ, që është dhe burimi i së keqes për sa i përket trajtimit të punëtorëve, mendoj që shtrimi i problemit vetëm në këtë rrafshin e dytë nuk është asgjë tjetër përveç një mbledhje e deputetëve me lot krokodili që shtiren kinse vërtet po brengosen për të drejtat e punëtorëve, siç e kuptoj unë edhe këtë debat, siç e kuptoj edhe thirrjen e këtij debati, edhe hipokrizinë që e mbështjell këtë debat, sepse është hipokrizi e atyre që e kanë thirrur debatin.

Këtu po e shoh që janë dy deputetë të Partisë Demokratike dhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës që e ka kërkuar këtë debat për të diskutuar për të drejtat e punëtorëve dhe kur lexohet arsyetimi, aty janë disa prej gjërave, të cilat natyrisht janë evidente dhe publike si probleme jashtëzakonisht të mëdha në këtë fushë, mirëpo askund nuk trajtohet, për shembull, edhe çështja e ligjit. Pra, që ta diskutojnë njëherë deri në ç' masë ligji është i përshtatshëm për t'i realizuar të drejtat e punëtorëve, deri në ç' masë ai ligj edhe po të zbatohet plotësisht do t'i mbronte këta punëtorë nga një lloj arbitrariteti i punëdhënësit, e me këtë rast punëdhënësi nënkupton edhe ai në sektorin privat, por qe besa edhe ai në sektorin publik, ku e kemi parë që në të dyja rastet ka shkelje të të drejtave të punëtorëve.

Po çka më çudit më së shumti që te arsyetimi kemi detaje të ndryshme për sa i përket, për shembull, KEDS-it, mënyra si i ka trajtuar KEDS-i punëtorët, por askund nuk përmendet "Bechtel&Enka". Është shumë interesante, domethënë një ndërmarrje, korporatë, e cila me paratë publike të buxhetit të Republikës së Kosovës i ka trajtuar punëtorët vërtet si skllav në pagesat që ua ka dhënë, në sigurinë që nuk ua ka ofruar edhe në punësimet e përjashtimet plotësisht arbitrare pa kurrfarë kontrolli, ajo nuk përmendet fare në arsyetim. Pra, kjo heshtet nga Grupi Parlamentar i PDK-së dhe, natyrisht mendoj me qëllim. Po ashtu, as Aeroporti nuk është askund. Edhe aeroporti pas koncesionimit e ka të njëjtin metodë që e ka përdorë edhe KEDS-i pas skadimit të kësaj periudhe trevjeçare të dakorduar me Qeverinë, ku përjashton një numër të konsiderueshëm të punëtorëve nga puna, përfshirë edhe punëtorët e kualifikuar dhe ata nuk përmenden askund në arsyetim.

Prandaj, po them ky debat, mënyra si është thirrur është edhe hipokrit, edhe me sherr. Po të shkojmë te KEDS-i, meqenëse është përmendur këtu, unë mendoj që natyrisht duhet të përmendet KEDS-i. Në rastin e KEDS-it i kemi gjithsej afro 490 punëtorë, të cilët janë përjashtuar nga vendi i punës përgjatë kohës sa kjo kompani është privatizuar dhe është menaxhuar nga kapitali privat. Pra, sipas raportit të Qeverisë gjithnjë, raportin që e kanë dërguar Ministria për Zhvillim Ekonomik, në të cilën ata vetëm i paraqesin numrat e punëtorëve se sa janë përjashtuar nga vendi i punës, pa pasur asnjë vlerësim pastaj, e as pa na treguar se çfarë ka ndërmarrë në këtë drejtim, edhe pse e kanë pasur në mbikëqyrje KEDS-in, thuhet kështu, te pika 4.10 që merret me të drejtat e punëtorëve të transferuar: “Më 8 maj të vitit 2013 në KEDS kanë qenë të punësuar 2 mijë e 623 punonjës. Ndërkohë që më 8 maj 2016, tre vjet pas, kanë qenë të punësuar 2 mijë e 433 punonjës” dhe tash vazhdon raporti i Qeverisë, pra po flas për raportin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, thonë: “Më 30 prill 2016, nga 190 punëtorë që nuk janë më në punë, 33 janë pensionuar, 157 e kanë lëshuar punën vullnetarisht”.

Pra, në kushtet e një papunësie flagrante në Kosovë, ku diku afër 45% të qytetarëve të Republikës së Kosovës, fuqisë punëtore sot, nuk mund të gjejnë vend pune, ne paskemi këtu njerëz që e lëshojnë vullnetarisht vendin e punës. Dhe, kjo shihet nga aeroplani që është gënjeshtër, por ministria këtë e merr si të mirëqenë, na e dorëzon neve deputetëve dhe thotë kështu është puna: 157 punëtorë nga KEDS-i e paskan lëshuar punën vullnetarisht. Pra, Blerand Stavileci, i cili sot nuk erdh në interpelancë dhe po ashtu, pastaj vazhdon i njëjti raport: “Ndryshimi i numrit të punonjësve prej majit 2016 deri në dhjetor 2016” pas skadimit të këtij afatit trevjeçar. Ju e dini që edhe kur është privatizuar KEDS-i, pra për tre vjet janë dakorduar me Qeverinë, si shitës i kësaj ndërmarrjeje, që t’i mbajnë shumicën e punëtorëve në punë, që po shihet që deri diku tre vjet i kanë realizuar, me përjashtim të këtyre 190 dhe pastaj pas skadimit të kësaj kanë dalë nga puna edhe 292 punëtorë të KEDS-it, prej të cilëve Qeveria na thotë “10 janë pensionuar, 134 tash e kanë lëshuar vendin e punës vullnetarisht, edhe 120 punëtorëve u është ndërprerë kontrata”. Pra, prapë e kemi numrin më të madh të njerëzve që kanë dalë nga KEDS-i ata që pretendohet nga Qeveria që e kanë lëshuar vendin e punës vullnetarisht.

Kjo është shumë e qartë, pra Qeveria këtu nuk e ka pasur asnjë interesim për t’i mbrojtur të drejtat e punëtorëve në rastin e KEDS-it. Po, a ka pasur interesim që t’i mbrojtë të drejtat e punëtorëve në rastin e aeroportit, kur është koncesionuar ai? Jo, pra ne e dimë që as aty nuk i ka mbrojtur të drejtat e punëtorëve, madje-madje shpeshherë edhe vetë siguria e aeroportit është rrezikuar për shkak se njerëzit e kualifikuar brenda aeroportit janë detyruar ta lëshojnë vendin e punës, vullnetarisht siç po pretendon Qeveria, në mënyrë që t’u krijohet aty hapësirë punëtorëve të rinj.

Dhe, për t’iu kthyer KEDS-it. Shihe çfarë ndodh tash në KEDS. Me gjasë, prejse është privatizuar KEDS-i e ka themeluar, të them ashtu, një shkollë që ata e quajnë “Akademia e KEDS-it”. Dhe, çka bën KEDS-i tash këtu? Punëtorët që kanë përvojë dhe të cilët e kanë një

nivel më të lartë të pagës, po, po ashtu kanë edhe kualifikime për punën që e kryejnë, i përjashton nga puna në forma të ndryshme, disa i detyron ta lëshojnë vendin e punës, disa nuk i sistemon fare dhe nuk ua vazhdon kontratat dhe të tjerëve thjesht ua ndërprejnë kontratën. Dhe vendet e punës pastaj i mbush me punëtorë të rinj, studentë të cilët e kryejnë “Akademinë e KEDS-it”, të cilët për shkak të papunësisë së madhe nuk kanë zgjidhje tjetër përveçse të shkojnë aty dhe të cilët i paguan shumë më pak dhe kështu e maksimalizon profitin, duke e dëmtuar fuqinë punëtore, klasën punëtore të Republikës së Kosovës. Ky është eksploatim i kulluar.

Dhe, ne këtu nuk po flasim për eksploatimin që u ndodh punëtorëve të KEDS-it, edhe pse e kemi përmendur KEDS-in këtu në arsyetim, por po flasim për punëtorët që i kanë përjashtuar, të cilët natyrisht KEDS-i as nuk duhet ta bënte, e as nuk duhet të lejohet t’i përjashtojë. Po, s’po flasim edhe për eksploatimin që u bëhet atyre punëtorëve, të cilët nuk janë përjashtuar ende nga vendi i punës, por që, qe besa, mund t’i presë një gjë e tillë shumë shpejt. Tash, flasim pak për rekomandimet që janë paraqitur këtu nga deputetët kërkues të këtij debati. Mendoj që një pjesë e rekomandimeve janë në rregull, janë të natyrshme. Pra, për shembull: nëse kërkohet ne që Inspektorati i Punës të kryejë inspektime efektive në gjithë sektorët dhe të bëjë monitorimin e respektimit të të drejtave të punëtorëve. Këtu jam plotësisht dakord, mirëpo për cilët inspektorë po flasim këtu? Sepse, sipas të dhënave dhe sipas një kritike që i është bërë vazhdimisht Qeverisë së Republikës së Kosovës, edhe nga Raporti i Progresit, numri i inspektorëve që i kemi aktualisht në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale është absolutisht i pamjaftueshëm për ta kryer këtë inspektim efektiv.

Pra, çfarë po bëjmë ne me këtë kërkesë, nëse nuk kërkohet njëkohësisht që të rritet numri i inspektorëve, atëherë nuk po bëjmë asgjë tjetër përveçse po e krijojmë një pikë, e cila mund të tingëllojë mirë, pra ka një dozë të popullizmi në të, apo më mirë thënë, demagogjie në të, po e cila nuk ka kurrfarë efekti në rrethana të cilat vepron sot Kosova dhe me administratën që e ka. Dhe, po ashtu këto kërkesa që të respektohet Ligji i punës, Ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë, e kështu me radhë, mendoj që janë të tepërta, sepse nëse ka ardhur puna që Kuvendi t’i kërkojë Qeverisë t’i respektojë ligjet, atëherë vërtet i kemi punët shumë keq dhe mendoj që duhet të trajtohet ky problem si fenomen, i cili nuk është vetëm në këtë rast po që po na përsëritet vazhdimisht nëpër forma dhe nëpër çështje të tjera që i diskutojmë këtu në Kuvend, sepse Kuvendi vazhdimisht po obligohet njëfarë mënyre që të kërkojë nga Qeveria t’i zbatojë ligjet.

Pra, të mos bëjë asgjë tjetër përveçse t’i zbatojë ligjet. Dhe, mendoj që disa prej këtyre rekomandimeve janë të panevojshme, por në anën tjetër, duhet të shtohen rekomandime të tjera. Unë mendoj që në mënyrë eksplicite duhet përmendet këtu “Bechtel&Enka”, duhet t’i bëhet një inspektim i tërësishëm se si i ka trajtuar punëtorët deri tash. Edhe ata që kanë punuar në autostradën që e lidh Prishtinën me Tiranën dhe ata që po punojnë në autostradën që e lidh Prishtinën me Shkupin. Po domosdoshmërisht këta punëtorë dhe të drejtat e tyre duhet të trajtohen, mes të tjerëve, të cilëve u shkelen të drejtat këtu në Kosovë.

Dhe, domosdoshmërisht Ligji i punës duhet të diskutohet në këtë Kuvend dhe të amendamentohet. Pra, neve na duhet një ligj, i cili vërtet i mbron të drejtat e punëtorëve, një ligj i cili u garanton siguri punëtorëve dhe një ligj, i cili e zhdok mundësinë e arbitraritetit të punëdhënësit, duke e kamufluar atë me një lloj fleksibiliteti në punësim dhe përjashtim nga puna që i bëhet punëtorit. Pra, kontratat, të cilat tash po bëhen për çdoherë e më të shkurtra, prej kontratave të përhershme në njëvjeçare, e tash edhe më të shkurtra, gjë që e lejon Ligji i punës, janë mekanizmi më i mirë se si punëdhënësit e rrisin eksploatimin ndaj punëtorëve, sepse kështu u krijojnë një mungesë absolute të hapësirës që ata të kërkojnë të organizohen dhe të luftojnë për të drejtat e veta, sepse përjashtimi i tyre sot është bërë shumë i lehtë dhe ligji po e mundëson këtë përjashtim.

Të njëjtin fenomen e kemi edhe në KEDS, të njëjtin fenomen e kemi pasur edhe dje në “Bechtel&Enka”, të njëjtin në aeroport, të njëjtin...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka ministri Arban Abrashi.

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Mora disa shënime për vërejtjet nga diskutimet që u bënë, por parimisht mendoj që është një debat i qëlluar, për kundër që mund të shihet si popullist. Besoj që tema për mirëqenien e qytetarëve duhet diskutuar sa më shumë në Kuvend, sepse e ndihmojnë njëri-tjetrin të gjejnë politika, të hartojmë politika sa më të mira karshi problemeve, të cilat patjetër se janë barrë e institucioneve, por në këtë rast janë barrë e të gjithë shoqërisë, posaçërisht të drejtat e punëtorëve, sepse ka të bëjë edhe me kulturën e vetë ndërmarrjeve, kulturën tonë të përgjithshme si të sillen ndaj punëtorëve.

Me marrjen e mandatit, duke u bazuar në mundësitë edhe ligjore, financiare, të cilat i kam si ministër, kam investuar në ato që janë me prioritet dhe që janë të mundshme. Kemi investuar një mund të madh në dialogun social, dialogu social diçka që ndoshta nuk ka ekzistuar më herët, por ka marrë një vëmendje shumë më të madhe gjatë këtyre dy vjetëve, duke inkurajuar bisedat mes sindikatave, mes punëmarrësve, punëdhënësve dhe palëve të tjera të interesit dhe gjatë dy vjetëve të fundit është diskutuar shumë edhe për Ligjin e punës, për mangësitë e ligjit, për numrin e inspektorëve, për Kontratat Kolektive, çka është bërë gabim më herët, çka mundet të ndryshohet?

Edhe gjendja në terren dallon prej shumë sektorëve, kemi sektorë ose fusha që janë shumë të ndjeshme, për shembull, punësimi i grave, edhe duhet të diskutohet veçantë për atë fushë. Kemi rastin e sektorit të ndërtimitarisë që është më i rrezikuari dhe e kemi trajtuar edhe këtë punë. Prandaj, kemi një pasqyrë shumë të mirë të gjendjes në terren dhe po punojmë aq sa mundemi në

kuadër të mundësive. Problemi më i madh, ajo që u përmend nga shumë dhe këtu realisht përpos kërkesave të mia të vazhdueshme, besoj që duhet edhe përkrahje e Kuvendit, duhet të bëjmë rritjen e numrit të inspektorëve. Domethënë, është e papranueshme dhe e paimagjinueshme që 50 inspektorë plus - minus, të bëjnë inspektimin e diku rreth 70-75 mijë bizneseve aktive, të cilat funksionojnë në Kosovë dhe paguajnë taksa.

Domethënë, përkundër një presioni, le të themi, pozitiv që kemi pasur karshi Inspektoratit që t'i rritë performansat, për çka edhe Inspektorati e ka rritur performansën. E shohim që në vitin 2015 Inspektorati ka pasur punë më të mirë se sa vitin paraprak, më 2016 punë më të mirë, ne mendojmë që edhe më 2017 do të ketë punë më të mirë në inspektimin e bizneseve. Nëse nuk gabojmë, në vitin 2016 janë inspektuar biznese që kanë diku rreth 60 mijë të punësuar, por kjo ka qenë maksimumi çka mund të japin këta inspektorë.

Prandaj, rritja e numrit të inspektorëve është diçka e domosdoshme, në mënyrë që të kemi një përfshirje më të mirë rreth kësaj pune. Kemi diskutuar Këshillin Ekonomik Social, është një këshill, i cili bën bashkë anëtarët e Qeverisë, punëmarrësit, punëdhënësit, të gjitha sindikatat, të cilat kanë numër më të madh të anëtarësisë dhe diskutojmë për problemet më të ndryshme dhe si t'i trajtojmë këto probleme që nga shkeljet e punëtorëve, që nga Ligji i lehonisë e kështu. Ne kemi pasur vërejtje nga Bashkimi Evropian se ky përfaqësimi në këtë Këshill duhet të ndryshojë dhe besoj që deri në qershor e sjellim ligjin e ri, plotësim-ndryshimin e Ligjit për Këshillin Ekonomik Social, i cili merr parasysh vërejtjet e Komisionit Evropian dhe ato janë pjesë e ligjit. Prandaj, besoj që edhe Këshillin Ekonomik Social e ngremë në nivel më të lartë.

Këshilli Kombëtar për Siguri dhe Shëndet në Punë gjithashtu është themeluar nga Qeveria këta muajt e fundit dhe tani është duke funksionuar dhe sjell politika të ndryshme në zyrat tona, se si duhet të ndryshojnë politikat qeveritare karshi kësaj. Jemi duke punuar në plotësimin e kornizës ligjore sipas kërkesave të Bashkimit Evropian dhe kjo po bëhet në një projekt të BE-së, i cili zgjat deri në vitin 2020. Diçka që nuk u përmend këtu, edhe besoj që është shumë e mirë sa i përket sigurisë në punë dhe e shton sigurinë në punë të punëtorëve në sektorin privat, është pensioni invalidor i punës.

Kjo nuk ka ekzistuar më herët, po flas për Kosovën e pasluftës, tani si pension i tillë është dhe ka filluar që të implementohet gjatë muajit prill. Është një shans i mirë për të gjithë ata, të cilët mund të lëndohen, urojmë që të mos lëndohen në vend të punës, por për shkak të atij lëndimi nuk mund të punojnë, tani shteti i merr përsipër një pension për ta dhe është garanci e mirëqenies së tyre. Prandaj, është punuar në këtë fushë sipas mundësive, në mënyrë që të tejkalojmë numrin e inspektorëve derisa të rritet numri i inspektorëve shkaku i marrëveshjes me FMN-së, e cila e ka bllokuar rritjen e punëtorëve në sektorin publik, ne synojmë të arrijmë marrëveshje, mirëkuptime me institucionet e tjera, të cilat kanë në fushëveprimin e tyre inspektimet në terren dhe mund të bartin disa prej roleve edhe të vetë Inspektoratit të Punës. Synojmë që të kemi një marrëveshje

me Administratën Tatimore të Kosovës, cila merr përsipër disa punë, por të ketë marrëveshje mirëkuptimi me Inspektoratin e Punës.

Jemi duke punuar në pagën minimale, diçka që mendojmë që është diskriminuese dhe e kemi trashëguar. Besoj që gjatë muajve në vijim ne do të kemi dy vendime sa i përket pagës minimale: një që të jetë e njëtrajtshme, të mos ketë dy paga minimale, një për ata që janë nën 35-vjeçar dhe mbi 35-vjeçar, dhe pastaj varësisht nga rritja ekonomike dhe parametrat e tjerë makroekonomikë, të bëjmë edhe ngritjen e pagës minimale në përgjithësi. Por, edhe kjo do të bëhet në konsultim me partnerët socialë në kuadër të Këshillit Ekonomik Social, sepse çfarëdo ngritje e pagës minimale do të ketë presion buxhetor edhe te skemat pensionale, se shumë janë të lidhura me pagë minimale, por gjithashtu edhe te sektori privat, i cili do të financojë pjesën më të madhe, sepse po flasim për 2/3 e fuqisë punëtore, e cila angazhohet në sektorin privat.

Kontrata Kolektive është implementuar aq sa ka qenë e mundur të implementohet, sepse si e tillë ka pësuar ndryshime menjëherë pas nënshkrimit të palëve, ku njëri prej partnerëve është tërhequr nga Kontrata Kolektive dhe ka krijuar një paqartësi ligjore, por ne si institucion i kemi kryer obligimet tona.

Dhe, për fund, që të mos e zgjas shumë, unë mendoj që mund të bëjmë edhe do të ftojme bashkë, përkundër që është organ ekzekutiv Inspektorati që së bashku me Inspektoratin të bëjmë vizita te sektori privat, te kompanitë të cilët mendojmë që po bëjmë shkelje të drejtave të punëtorëve. Unë e kam bërë atë vetë edhe e praktikoj kohë pas kohe bashkë me sindikatat t'i bëj këto vizita. Besoj që kjo mund të bëhet bashkë edhe me një grup të deputetëve. Edhe, e fundit, kërkoj nga ju mundësisht që të llojmë bashkë, që të rrisim edhe numrin e inspektorëve, të cilët funksionojnë në kuadër të Inspektoratit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Zonja Blerta Deliu-Kodra e ka fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Mendoj që është mirë që ka ardhur në rend dite, pavarësisht vërejtjeve që ne i dëgjuam paraprakisht. Mendoj që është e rëndësishme që po diskutojmë për të drejtat e punëtorëve në punë, e që ka qenë fokus i shqetësimeve të një pjese të deputetëve gjatë kësaj legjislature të Kuvendit.

Edhe unë jam e shqetësuar për të drejtat e punëtorëve në punë, e veçanërisht të këtyre njerëzve, të cilët për çdo ditë e më shumë po bëjnë përpjekje maksimale të mbijetojnë nga djersa e vet, duke mos zgjedhur asnjë punë, por duke duruar edhe nga 12 orë punë dhe pa pushim vjetor, por me një pagë që është minimale, e që siguron asgjë më shumë përveç mbijetesës dhe një mirëqenie për familjet e tyre. Mendoj që si Kuvend viteve të fundit jemi përpjekur të bëjmë ligje të mira, të cilat duhet të mbështesin sektorin privat dhe duhet po ashtu t'u japin mundësi

kompanive tona që të zhvillojnë bizneset e tyre. Megjithatë, mendoj që sfidë në zbatimin e legjislacionit mbasin veçanërisht të punësuarit në sektorin privat në Kosovë, të cilët, siç u tha edhe në këtë seancë, ballafaqohen me shkelje të rënda të të drejtave në punë, gjatë orarit të stërzgatur, po ashtu kanë punë pa kontrata, i kanë pagat jo të rregullta. Në shumicën e rasteve trajtimi i punëtorëve nga punëdhënësi është tepër i rëndë, pastaj është problem që këto shkelje, të cilat bëhet në disa raste nga punëdhënësi, nuk është se raportohen, në disa raste për shkak të frikës që ata mund të humbin edhe vendin e tyre të punës. Ligji mendoj që ka gjetur një pjesë të zbatimit, ashtu siç u tha nga ministri, në sektorin publik, por që ne duhet të jemi shumë të vëmendshëm karshi zbatimit të këtij legjislacioni në sektorin privat.

Nuk e di a mjaftojnë gjithë këto ligje dhe mekanizma, mendoj që jo, ende ka punë për të bërë Qeveria dhe shteti me të gjitha instrumentet e veta. Pra, duhet të kenë shkas këto kompani që sot një punëtor ta trajtojnë si një fuqi fizike apo edhe si një vegël pune, siç ka ndodhur. Kjo duhet mendoj që të ndalohet dhe ne si Kuvend dhe kemi obligim që të punojmë në këtë drejtim.

Punëtorët në sektorin e ndërtimeve gjatë ditëve të verës në temperatura mbi 30 gradë celsius, pastaj gjatë stinës së dimrit, në temperatura minimale, pa sigurinë në punë, me rroga minimale, me një ditë pushimi në javë dhe me paga që u jepen në dorë, nuk duhet të mendoj që ky fenomen të vazhdojë dhe këtu mbështes edhe atë që e tha ministri, pensionimi invalidor i punës, sepse kemi pasur shumë incidente gjatë viteve ku punëtorët kanë humbur edhe jetën në vendin e tyre të punës, por edhe kanë pësuar dëmtime, prandaj shteti mendoj që ka për obligim të sigurojë mbështetje për këtë kategori.

Janë shumë gra e vajza tona, me qindra të punësuar në marketet gjigante, të cilat nuk po trajtohen si duhet. Puna që zgjat 12 orë, që shfrytëzohet edhe për pastrim edhe për palosje, jo vetëm për punën që e kanë për detyrë, me një ditë pushimi në javë, me vetëm 10 ditë pushim vjetor dhe pa asnjë ditë kompensimi jashtë orarit të punës, duke mos lënë kështu as një karrige derisa ato i llogarisin faturat e gjata të blerësve. Kjo mendoj që më nuk duhet të ndodhë.

Një tjetër fenomen janë edhe shoferët e taksive të dhjetëra kompanive, të cilat operojnë në Republikën e Kosovës dhe kemi pasur shumë reagimet të tyre. Shumica punojnë pa kontrata të punës, paguhen po ashtu me para kesh dhe pa asnjë të drejtë si punëtorë, pa kontrata dhe pa siguri në punë. Janë qindra vajza e gra në bankat tona në vend, të cilat punojnë me shumë presion dhe largohen puna pa ndonjë shkas, por edhe u kërkohet po ashtu edhe dorëheqje si një marrëveshje që pronarët të ikin nga përgjegjësitë që mund t'u dalin prej proceseve gjyqësore.

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë do të përmend këtu vetëm një të njërën prej tyre, është zonja Albana Morina, njëra prej të punësuarve në një të njërën prej bankave të Kosovës, e cila ka fituar rastin në instancën e parë. Ne bashkë me koleget deputete e kemi pasur në Grupin e Grave Deputete, ku ajo para nesh ka

rrëfyer përvojën e saj të tmerrshme se me çfarë është ballafaquar nga punëdhënësi i saj vetëm e vetëm për të lëshuar vendin e punës. Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore, do të thotë kompania detyrohet që Albana Morinës t’ia kthejë dhjetë paga dhe t’ia kompensojë po ashtu pagat nga momenti i largimit nga puna, t’ia paguajë po ashtu tatimin në ATK dhe kontributet në Trustin Pensional.

Ajo ka rrëfyer para nesh gjithë presionin e tmerrshëm që i është bërë vetëm e vetëm për të pezulluar atë nga vendi i saj i punës. Janë edhe shumë punëtorë të tjerë në sektorin privat dhe nuk është vetëm Albana, por ka edhe shumë vajza të tjera, të cilat diskriminohen në mënyrën më të tmerrshme, të cilat pyeten nga punëdhënësi nëse ato janë me barrë, duke u diskriminuar që në start dhe një pjesë e tyre po ashtu pezullohen nga puna për faktin se kanë vendosur të krijojnë, të rrisin familjen e tyre. Po ashtu, u përmendën këtu edhe rastet e fundit, të cilat kanë ndodhur me punëtorët e KEDS-it dhe për të cilat ne, unë si deputete kam adresuar shqetësimet për largimin nga puna të përreth 500 punëtorëve nga kjo kompani. Disa prej këtyre punëtorëve, me një përvojë të jashtëzakonshme dhe me kontrata të përhershme të punës, edhe ata kanë rrëfyer për diskriminimin dhe për mënyrën se si kjo kompani ka operuar dhe i ka larguar këta punëtorë nga vendet e tyre të punës, pa u ofruar ndonjë arsye të veçantë, mirëpo duke u thirrur gjithmonë në sistematizimin e vendeve të tyre të punës.

Të gjithë këta punëtorë në sektorin privat që sot punojnë në Kosovë, në fabrika dhe kudo janë të angazhuar për të siguruar një mirëqenie për familjet e tyre dhe kanë nevojë për kujdesin tonë si deputetë, kanë nevojë po ashtu për mbrojtje dhe sigurime nga shteti. Unë nuk dua që t’i përgjithësoj të gjitha kompanitë, të cilat operojnë në vendin tonë. Vlerësoj dhe dua po ashtu të ndaj nga ky gjykim ato kompani dhe pronarë që kujdesen ligjërisht dhe moralisht për punonjësit e tyre dhe që i trajtojnë ashtu si duhet të trajtohet një punëtor në një shtet demokratik, por që fatkeqësisht janë më të pakët se sa këta që punëtorin e konsiderojnë si vegël pune në institucionin e tyre.

Jam e shqetësuar edhe për një kategori tjetër të punonjësve, qindra gazetarë në mediat tona të shkruara dhe në mediat elektronike, televizive, të cilat mbajnë familjet e tyre dhe na informojnë me zhvillimet politike dhe publike në vend. Ata punojnë me orar të stërzgatur dhe ballafaqohen me presione pa kontrata të rregullta nga kompanitë, tek të cilat janë të punësuar.

Të nderuar kolegë, ka nga ata të cilët madje nuk marrin paga deri në katër dhe pesë muaj rresht. Sot nuk do të përmend emrat e këtyre mediemeve, por nëse pas kësaj seance nuk do të shohim ndryshimet në praktikë, mendoj që është mirë që në këtë Parlament të thuhet me emra ata të cilët po keqpërdorin mundin e punëtorit në Republikën e Kosovës. Mendoj që nuk është mirë të na mbajnë moral ata të që nuk dinë çka është as humane, as e drejta e respektimit ligjor i të drejtave të punëtorit në Kosovë, sepse vetë e bëjnë jetën e luksit, e neve na moralizojnë ditë të tëra për punën dhe pagat e tyre.

Në fund, të nderuar kolegë deputetë, unë i ftoj të gjitha institucionet në vend, agjencitë tona rregullative të marrin përgjegjësitë për sektorin që rregullojnë këto fusha përkatëse. Dua të kërkoj edhe mbështetjen e ministrit dhe të kolegëve deputetë. Po ashtu, ftoj Bankën Qendrore të përcjellë funksionimin e bankave private në vend dhe mënyrën se si ato i implementojnë ligjet tona, veçanërisht në raport me të drejtat e punëtorëve dhe këtu dua të vë theksin e zonjës Albana Morina, e cila ka pasur kërkesë të drejtpërdrejtë në Bankën Qendrore të Kosovës lidhur me mosrespektimin dhe shkeljen e të drejtës së saj për punë.

Kërkoj përgjegjësi edhe punë më efikase nga Inspektorati i Punës, ka shumë kërkesa të cilat drejtohen në drejtim të këtij Inspektorati dhe kërkoj nga Inspektorati që t'i trajtojë me përpikëri dhe t'i respektojë punëtorët e Republikës së Kosovës, në mënyrë që të mbikëqyrë realizimin e të drejtave në punë të punëtorëve në sektorin privat. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Pantina e ka fjalën.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Shumë prej çështjeve që unë doja t'i përmendja tashmë u përmendën nga kolegët, kështu që nuk dua t'i përsëris. Dua të marr shkas nga deklarimi i ministrit, i cili bëri thirrje këtu për të shkuar dhe vizituar disa nga kompanitë dhe unë mendoj se disa prej kompanive ku ka nevojë për vizita tashmë u përmendën, siç ishin "Bechtel&Enka", KEDS-i e disa të tjera. Por, është një kompani, e cila ende nuk u përmend dhe unë i sugjeroj ministrit që vizitat për të parë se si nuk respektohen të drejtat e punëtorëve të fillohen mu nga kjo kompani, sepse e ka edhe më të lehtë, e njeh më nga afër pronarin e kësaj kompanie, e ai është zëvendëskryeministri Ramiz Kelmendi, pronari i kompanisë "Elkos", gjegjësisht i rrjetit të marketeve ETC.

Ai kur erdhi në Qeveri, erdhi sikur ta kishte formulën magjike për të krijuar vende pune, për ta zbutur apo për ta eliminuar bile fare papunësinë në Kosovë, por ajo çka ka ndodhur është se vetëm muajin e fundit nga kompania e tij janë larguar rreth 200 punëtorë nga puna pa paralajmërim dhe pa ndonjë arsyetim. Çështje tjetër është se ka, në fakt, në mesin e tyre të larguar edhe të atillë që e kanë lënë vendin e punës dhe unë kam takuar disa prej tyre dhe padashur të përmend me emra e mbiemra, unë dua ta përmend historinë e njërës nga këto punëtore, studente, e cila për t'i mbuluar shpenzimet e studimeve, natyrisht se kishte synuar të punojë për të siguruar një pagë që pastaj t'i mbulojë shpenzimet. Por, ajo jo vetëm që nuk arriti t'i mbarojë studimet, sepse kishte vetëm një ditë pushimi në javë, punonte 12 orë, punonte në një sektor brenda njërës nga dyqanet ETC, e ku kërkonte nga ajo që të kishte edhe forcë fizike, sepse duhet të barte, duhet të zhvendoste nga një vend në tjetrin mallin, objektet që ishin në shitje dhe, në fund, para se të lëshonte vendin e punës pesha e saj zbriti në 45 kg. dhe filloi të kishte edhe probleme me kurrizin.

Kështu që në fund ajo përfundoi edhe me probleme shëndetësore, e le që nuk mundi t'i mbarojë studimet. Po ashtu, çdonjëri nga tregimet e saj ishte se i kishte ndodhur dy herë gjatë vitit, sa kishte punuar, që të vonohej dy minuta në punë. Për këta dy minuta vonesë ajo prapë është detyruar të punojë 12 orë brenda ditës, por që i ishte hequr komplet paga për atë ditë pune. Pra, edhe ka punuar edhe i është hequr mëditja si ndëshkim, për faktin se ajo është vonuar 2 minuta në punë.

Tash, është e vërtetë se ndoshta është i pamjaftueshëm numri i inspektorëve të punës për të shkuar dhe për t'i vizituar, sidomos të punësuarit në sektorin publik. Por, është po ashtu e vërtetë se ndëshkimet që japin këta inspektorë për rastet kur ata i vërtetojnë shkeljet e të të drejtave të punëtorëve, përkatësisht Ligjit të punës nga punëdhënësit, janë po ashtu qesharake. Shumicën e kohës janë thjesht vërejtje me shkrim dhe nuk ka ndëshkim. Natyrisht se kur nuk ka ndëshkim, ka inkurajim që të vazhdohet me këto shkelje.

Prandaj, edhe pse numër i vogël i inspektorëve, po ta kryenin punën e tyre siç duhet dhe me efikasitet, unë mendoj se gjendja do të ishte pak më e mirë sesa është tani.

Po ashtu, ne kemi lexuar në medie për rastet kur këta inspektorë në vend se t'i mbrojnë punëtorët, ka ndodhur e kundërta. Ata kanë marrë rryshfet, janë korruptuar, me një fjalë, nga punëdhënësit, qoftë për t'i mbyllur sytë apo për të heshtur edhe për rastet kur ata kanë konstatuar shkelje të të drejtave të punëtorëve.

U përmend po ashtu fakti se shumica e të të punësuarve, sidomos në sektorin e ndërtimitarisë, nuk e kanë të siguruar jetën dhe tashmë jemi dëshmitarë të dhjetëra rasteve të humbjes së jetës së këtyre punëtorëve, kur punëdhënësit nuk kanë marrë asnjë përgjegjësi.

Po ashtu, është problem, por u përmend tashmë çështja e pagës minimale. Përderisa, vitin e kaluar kryeministri i atëhershëm, e i cili vinte nga partia që sot e ka thirrur këtë debat, ngriti pa asnjë analizë të mirëfilltë se si do të ndikonte në buxhetin e shtetit, por edhe në përgjithësi në zhvillimin ekonomik të vendit pagat e të të punësuarve në sektorin publik, kjo nuk u bë asnjëherë në rritjen e pagës minimale, e që do të afektonte, do të kishte ndikim pra edhe në sektorin privat dhe të punësuarit në sektorin privat e vuajtën këtë, sepse u rritën çmimet, për të cilat tashmë ata do të duhej të paguanin pa pasur rritje të pagës.

U përmendën shkelje të rënda, të dyfishta, të trefishta, të të drejtave që u bëhen të punësuarave gra, prandaj unë nuk dua të ndalem këtu. Dua të ndalem po ashtu te një rast konkret i një kompanie, punëtorët e së cilës kanë pësuar shumë keq, jo vetëm aq sa kanë pësuar të tjerët në rastin e privatizimit, por këta e kanë humbur edhe të drejtën për të përfitur nga 20%, i cili u është dhënë punëtorëve pas shitjes së kompanisë, e këta janë punëtorët e ndërmarrjes "Ramiz Sadiku".

Arsyeja pse këta punëtorë nuk e kanë gëzuar të drejtën është sepse nuk janë informuar me kohë për këtë të drejtë dhe kjo është bërë qëllimshëm nga menaxhmenti i asaj kohe, për faktin se ata kishin punësuar një numër, qoftë militantësh partiakë, qoftë familjarë, në dy-trevjetëshin e fundit, para se kompania të shitej dhe për ta zvogëluar numrin e atyre punëtorëve që do të përfitonin nga 20%-shi ata i kishin lënë anash punëtorët që kishin përvojë ndërmjet 15 e 20 vjetësh punë në këtë ndërmarrje.

Tani këta punëtorë enden nga një gjykatë në tjetrën, nga një avokat në tjetrin, duke tentuar për ta siguruar një të drejtë që ishte e garantuar me ligj, ndonëse edhe humbja tashmë ishte shkaktuar nga vetë shitja e ndërmarrjes, por vetëm se menaxhmenti dëshironte që shuma e ndarë për punëtorët të mbetej më e madhe për ata që vetë i kishin punësuar, përfshirë menaxherët, nuk i kishin njoftuar këta punëtorë, të cilët shumica ishin punëtorë fizikë dhe nuk kishin qasje të duhur të mjaftueshme në informata, të cilat edhe ashtu ishin dhënë të kufizuara, vetëm në botim të gazetës ditore, e të cilat jo çdoherë lexohen nga të gjithë.

Çështje tjetër, po ashtu që u përmend, është shkelja e të drejtave të punëtorëve nga kompanitë publike. Posta dhe Telekom i Kosovës është njëra nga kompanitë, e cila i ka shkelur të drejtat e këtyre punëtorëve, e para duke punësuar pa kushte dhe kritere, shpeshherë pa pasur nevojë për punëtorë, një numër të caktuar të njerëzve, e të cilët, në fakt, as nuk punojnë atje, por shkojnë dhe nënshkruajnë, siç është rasti ta zëmë edhe te kompania apo ndërmarrja e institucionit tjetër publik, siç është Radiotelevizioni i Kosovës, ku një numër i punëtorëve vetëm nënshkruhen atje, nuk punojnë, nuk rrinë fare dhe në fund të muajit e marrin pagën e njëjtë, sikur punëtorët që ndoshta punojnë më shumë se 8 orë. Por, në këto dy kompani ne kemi pasur ndëshkime të punëtorëve, vetëm pse ata kanë ta mbrojnë interesin e institucionit. Në njërën anë kanë qenë sindikalistët e RTK-së, ndaj të cilëve menaxhmenti ka bërë ndëshkime për shkak se ata i kanë vënë në pah shkeljet që në vazhdimësi janë bërë nga menaxhmenti, jo vetëm e të drejtave të punëtorëve, por në përgjegjësi interesit të ndërmarrjes, dhe i njëjti rast ka ndodhur në Postën dhe Telekom i Kosovës, kur punëtorët janë ndëshkuar pse e kanë ngrehur zërin për parregullsitë që kanë ndodhur në këtë ndërmarrje.

Tash në të dyja rastet, me intervenimin e institucioneve tjera, përkatësisht gjykatës, në rastin e PTK-së, kjo punëtoje e ka realizuar të drejtën e vet, por ajo çfarë ka ndodhur është se menaxheri nuk është ndëshkuar fare dhe humbësi në këtë rast prapë ka qenë institucioni, prapë në këtë rast është shkelur e drejta publike, në fund të fundit dhe ata të cilët vërtet e shkelin ligjin, vërtet e cenojnë qoftë interesin e punëtorin, qoftë interesin e ndërmarrjes. Lëre që s'ndëshkohen, por përkundrazi avancohen në pozita të ndryshme, sepse ata qëllojnë të jenë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ibishi e ka fjalën.

NUREDIN IBISHI: I nderuar zoti kryesues,
Ministër Abrashi,
Deputetë,
Qytetarë,

Së pari dua t'i falënderoj nismëtarët, zotin Haxhiu dhe zonjën Izmaku me tetë deputetët tjerë, për nismën e këtij debati. Gjithashtu, kisha për të cekur, nëse flasim për shkeljen e të drejtave të punëtorëve, në veçanti atë që edhe zonja Kajtazi më herët e përmendi lidhur me mospërfshirjen në mënyrë meritore të kategorisë së grave, edhe pse kur është mbikëqyrur Ligji për barazi gjinore, në legjislacionin e kaluar është konstatuar se përfshirja apo mospërfshirja e femrave në nivelin lokal është shumë diskriminues, në nivel shumë të vogël, ndërsa në nivelin qendror qëndrojmë pak më mirë, edhe detyrimin ligjor në bazë të Ligjit të punës për çdo 50 punëtorë të punësohet një person me aftësi të kufizuara.

Po flas për çështje që kanë të bëjnë me mospërfshirje, qoftë rreth grave në tregun e punës, por njëkohësisht edhe për personat me aftësi të kufizuara.

Një çështje e veçantë është se përveç çështjeve formale-juridike, të cilat parashihen me ligjin dhe nuk realizohen me Ligjin për punën, prej kontratës së punës, nivelit të pagës, të pushimeve, është shqetësuese. Ministri e tha në një formë që edhe pse është miratuar nga Qeveria e kaluar Kontrata Kolektive me Bashkimin e Sindikatave të Pavarura, ajo pjesërisht është në zbatim. Mirëpo, në veçanti duhet të mbikëqyret me masa të shtuara, si në procedura, por edhe në masa tjera për siguri në punë që realisht mungojnë, si në sektorin privat, po ashtu edhe në atë publik dhe janë të përshkruara në Ligjin për sigurinë dhe shëndetin në punë, ku vetëm në vitin e fundit kemi raste me fatalitet, të vdekjes apo të aksidentimit në vend të punës me 61 të vdekur dhe 223 të lënduar, që kanë shkallë të ndryshme të invaliditetit.

Gjithashtu, në këtë duhet të përfshihen edhe çështjet rreth mbrojtjes nga fatkeqësitë elementare, për ç'gjë realisht shumë pak bëhet në drejtim. Ndoshta më pak u cek dhe duhet të përfshihet në rekomandime edhe Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe Qeveria, se duhet të jenë shumë më efikase dhe të sakta në kontrollin dhe implementimin e dispozitave që dalin nga kontratat e privatizimit të ndërmarrjeve publike. Ajo që u tha edhe më herët, edhe aspekti i diskriminimit të punëtorëve, sidomos të KEDS-it, "Limak-Çalik", e të tjera. Duhet në këtë aspekt të jemi të kujdesshëm.

Në çështjen e fundit, kur flasim për aspektin mbikëqyrës, që është njëri prej rekomandimeve të iniciatorëve të këtij debati, përveç Inspektoratit të Punës duhet të obligohet edhe Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, por siç e tha edhe zonja Kajtazi, që me ligjin e ri janë të shtuara edhe atje dispozitat rreth mbikëqyrjes së Institucionit të Avokatit të Popullit, që në një formë të obligohen ata që çdo tre muaj ditë, me këtë edhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, të raportojnë para komisioneve parlamentare, jo vetëm një komisioni që ka të bëjë me punën, por edhe

Komisioni për të Drejta të Njeriut si dhe ai për Siguri, lidhur me nivelin e shkeljeve të të drejtave të punëtorëve në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haskuka e ka fjalën.

MYTAHER HASKUKA: Lidhur me të drejtat e punëtorëve në Kosovë është diskutuar shumë pak dhe mirë u bë që tani në Kuvendin e Kosovës po i diskutojmë këto çështje.

Janë problematikë e gjerë e mosrespektimit të të drejtave të punëtorëve dhe në atë aspekt çështja kyçe është moszhvillimi i bizneseve dhe mungesa e vendeve të punës, që ndoshta është thënë edhe nga kolegët më përpara, por sipas statistikave zyrtare kur në një vend papunësia kalon 33%-shin, me një popullatë kaq joaktive, ku vetëm 18% e grave janë aktive dhe kërkojnë punë, e prej tyre 37% janë të papunë, normalisht se e kemi një gjendje shumë të pafavorshme të punëtorëve që i kanë vendet e tyre të punës, ngase ata gjithmonë rrezikohen që të përjashtohen nga punëdhënësi dhe të zëvendësohen me punëtorë të tjerë, të cilëve nuk u intereson aq shumë për të drejtat e tyre dhe në njëfarë mënyre do t'u nënshtrohen ashtu siç kërkojnë punëdhënësit.

Në aspektin e të drejtave të punëtorëve, problematika kyçe është mosimplementimi i ligjeve dhe pamundësia e monitorimit të të drejtave të punëtorëve, sidomos nga Inspektorati i Punës, për shkak të numrit të vogël të punëtorëve. Siç u tha më herët, kemi më pak apo 1 inspektor për komunë, gjë që është e pamjaftueshme për ta monitoruar gjendjen e të drejtave të punëtorëve nëpër komunitet e Kosovës.

Por, në të njëjtën kohë, nëse shikojmë nga perspektiva e punëtorëve, sindikatat janë ato që në shumë vende të botës mundohen, ose luftojnë për të drejtat e punëtorëve. Në Kosovë kjo nuk ekziston, ngase nuk ekzistojnë sindikata të punëtorëve të sektorit privat, në shumë ndërmarrje nuk ka sindikata, por edhe në sindikatat e sektorit publik ato janë të nënshttruara dhe nuk i përfaqësojnë interesat e punëtorëve, për çka janë krijuar, ose për të drejtat e të cilëve duhet të luftojnë.

Në pak raste kur sindikatat mundohen t'i mbrojnë interesat e punëtorëve, siç ka qenë rasti i punëtorëve të RTK-së para dy vjetësh, kryetari i RTK-së që suspenduar nga menaxhmenti i RTK-së për shkak të aktivitetit të tij sindikal dhe kjo ka qenë një shkelje flagrante e Ligjit të punës dhe e të drejtave të punëtorëve dhe të së drejtës sindikale. Kjo ka ndodhur në një institucion që monitorohet nga Kuvendi i Kosovës. Nëse në një institucion që monitorohet dhe buxhetohet nga Kuvendi i Kosovës, siç është RTK-ja, sindikatat e punëtorëve nuk e gëzojnë të drejtën e tyre, ose nuk mund ta mbrojnë të drejtën e punëtorëve pa persekusion, ose pa qenë të suspenduar, atëherë mund të paramendojmë se çfarë është gjendja me sindikatat në sektorët tjerë, ku nuk ka kurrfarë monitorimi nga ndonjë instancë më e lartë, siç është rasti i RTK-së dhe i Kuvendit të Kosovës.

Në anën tjetër, këtu pothuajse u harruan edhe shkeljet e të të drejtave të punëtorëve të ndërmarrjeve të privatizuara. Në aspektin e ndërmarrjeve të privatizuara shumë punëtorë që kanë punuar me vite të tëra, që kanë kontribuar me vite të tëra në krijimin e këtyre ndërmarrjeve publike, nuk kanë mundur t'i realizojnë të drejtat e tyre dhe nuk kanë mundur t'i marrin jo vetëm pagat e tyre që kompanitë publike u kanë mbetur borxh, po as 20%-shin që u takon nga Fondi i Privatizimit.

Ka shumë raste të tilla, por ndër rastet më flagrante, si për shembull mund ta them rastin e punëtorëve të ndërmarrjes “Sharr-Cem” në Han të Elezit, ku faktikisht këta jo vetëm që nuk u është paguar 20%-shi, por për shkak të natyrës së punës me azbest, shumë nga këta punëtorë kanë paguar gjatë punës së tyre një fond të veçantë për kompensim shëndetësor, ngase kanë qenë të rrezikuar nga azbesti dhe pluhuri në Fabrikën e Çimentos, këta nuk i kanë marrë këto kompensime dhe nga më shumë se 100 punëtorë, shumë prej tyre kanë ndërruar jetë pa i marrë kompensimet e duhura, as shëndetësore, por edhe kompensimet e 20%-shit që u takojnë sipas Ligjit për privatizimin.

Ç'është më e keqja, në një takim me këta punëtorë ata treguan që shumë prej tyre vuajnë nga kanceri dhe nga sëmundje të ndryshme të mushkërive dhe nuk kanë mundësi të mjekohen, ngase nuk kanë mjete financiare dhe janë në moshë. Në shumë raste janë të varur nga ndihmat e të të afërmeve, ose nga ndihmat e familjarëve, në mënyrë që t'i përballojnë shpenzimet e mjekimit.

Po ashtu, gjendja e njëjtë është me punëtorët e ndërmarrjes “Liria” në Prizren. Edhe pse ndërmarrja publike “Liria” i ka pasur obligime pagat e punëtorëve për një kohë shumë të gjatë dhe 20%-shin, pasi është privatizuar, këta nuk janë kompensuar as 20%-shi, por as obligimet ose pagat që kompania “Liria” u ka mbetur borxh punëtorëve të saj.

E njëjta gjendje është edhe në Fabrikën e Amortizatorëve në Prishtinë. Fabrika është privatizuar, por punëtorëve nuk u janë dhënë kompensimet, as 20%-shi, por as edhe fitimet tjera që i ka pasur Fabrika e Amortizatorëve, si për shembull qiraja që e ka pasur prej UNMIK-ut. Fabrika e Amortizatorëve i ka pasur diku rreth 5 milionë euro të ardhura nga qiraja, por në vend se të ndahen me të gjithë punëtorët, nuk dihet se ku kanë shkuar ato. Sindikatat e kërkojnë pjesën e tyre, punëtorët kanë mbetur pa kompensim, por edhe nuk janë kompensuar me 20%.

Këtu në aspektin e të të drejtave të punëtorëve, jo vetëm që duhet të kërkojmë funksionalizimin e Inspektoratit të Punës, monitorimin shumë më të mirë të të drejtave të punëtorëve në kompanitë që momentalisht janë duke punuar, por në të njëjtën kohë duhet të kërkojmë ose të krijohet një komision që t'i shqyrtojë rastet e privatizimeve, ku punëtorëve të kompanive të privatizuara nuk u janë realizuar të drejtat e tyre nga procesi i privatizimit, meqë atyre ose nuk u janë paguar pagat që ju kanë mbetur borxh, ose nuk u janë paguar benefitet, si punëtorëve të “Sharr-Cemit”,

ose edhe 20%-shi në shumë raste nuk u është paguar punëtorëve. Duhet të shqyrtohen dhe duhet të kërkohen të drejtat e tyre nga Agjencia e Privatizimit e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hajdar Beqa e ka fjalën.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni t'i përgëzoj iniciuesit e këtij debati me një temë të rëndësishme për punëtorët në vendin tonë, që ka të bëjë me shkeljen e të drejtave të punëtorëve në Kosovë.

Gjendja e punëtorëve në Kosovë nuk është si do ta dëshironim të gjithë ne sot. Sot, si pasojë e mosbesimit në sektorin privat, nëse një punëtori i ofrohet një punë për një pagë 500 euro në sektorin privat dhe e njëjta punë për 300 euro në sektorin publik, ai do ta zgjedhë sektorin publik me më pak para për arsye se nuk beson shumë në sektorin privat.

Kjo çështje duhet të trajtohet me kujdes duke zbatuar ligjet në fuqi nëpërmjet mekanizmave mbikëqyrës, siç është Inspektorati i Punës. Nëse dëshirohet të luftohet informaliteti duhet të forcohet Inspektorati i Punës, sepse në këtë mënyrë përfitojnë edhe të punësuarit, pajisen me kontrata pune, e cila është bazë për t'i rregulluar raportet e tyre me punëdhënësit, përfiton biznesi, sepse kështu krijohen kushtet e barabarta në treg. Nëse i ka punëtorët pa kontratë, nuk paguan kontribut, nuk paguan trustin, tatimin në pagë, e tjera dhe krijohet përparësi në çmim, qoftë në shërbime, prodhim apo të tjera. Përfiton shteti, sepse me pagesën e kontributeve mbushet arka e shtetit, gjithashtu mund të vijë edhe deri te rritja e numrit të të punësuarve në vendin tonë. Gjithashtu, i mundëson shtetit që ta rrisë edhe pagën minimale, e cila, përveçse është më e ulëta në rajon, është edhe më diskriminuesja. Jemi i vetmi vend që kemi dy nivele të pagës më të ulët, 140 euro dhe 170 euro.

Kur punëtorët të kenë kontratë pune, atëherë punëdhënësi duhet t'i paguajë edhe orët shtesë 30% mbi pagën bazë dhe benificionet tjera, si për shembull pushimin vjetor, pushimin mjekësor, pushimin e lehonisë dhe pushimet tjera. Se ka nevojë për shtimin e inspektorëve të punës e thonë edhe mekanizmat ndërkombëtarë, së fundmi edhe MSA-ja, ku kërkohet që në këtë vit të rritet numri i inspektorëve në 65.

Se ka shkelje të të drejtave të punëtorëve edhe në sektorin privat dhe në sektorin publik, kjo nuk diskutohet, edhe pse ka avancim të dukshëm që nga viti 2009 e këndeje, por për ta përmirësuar edhe më tutje sipas standardeve të kërkuara ndërkombëtare këtë gjendje, duhet të mbështetemi te mekanizmat mbikëqyrës.

E rëndësisë së veçantë është edhe siguria në punë, që gjithashtu duhet të përmirësohet. Vetëm në këtë vit, në vitin 2017, i kemi 6 njerëz të vdekur në vendin e punës.

Andaj, krejt në fund, për të mos e zgjatur, që u tha edhe nga debatuesit tjerë dhe konsideroj se edhe në fund të këtij debati do të dalim me konkluzione konkrete, kur e kemi parasysh se Inspektorati i Punës mbikëqyr kompanitë private që llogariten në vendin tonë të jenë rreth 70 biznese aktive, shëndetësinë, arsimin, kompanitë publike të nivelit qendror, kompanitë publike të nivelit lokal, mbikëqyr Ligjin e punës, Ligjin për siguri në punë dhe një mori ligjesh tjera, atëherë konkludoj se me këtë numër të inspektorëve, që në vendin tonë është rreth 50, nuk mund ta kryejë punën e vet në mënyrën efektive, pavarësisht vullnetit dhe angazhimit të tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit,
Qytetarë të Republikës,

Kriza financiare, e cila nis në shtator të vitit 2008 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, i pati rrëzuar përtokë lidhjet dogmatike ndërmjet lirisë së kapitalit, rritjes ekonomike dhe mirëqenies së shtuar. Mirëpo, kjo fare nuk u shfrytëzua për debat në Kosovë, qoftë ai institucional e publik, po ashtu as qeveritar apo partiak.

Përderisa nuk besohet që pasuria vjen nga puna, nuk mund të kemi respekt për punën. Në Kosovë konsiderohet se pasuria vjen nga trashëgimia dhe nga pushteti. Të ardhurat jo aq nga paga, por nga kapitali që i bie qiraja, dividendat, interesi, profiti, e të tjera... Pra, ai koeficienti "beta", raporti i kapitalit me punën apo i pronës me të ardhurat, është shumë i lartë në Kosovë. Në vendet e zhvilluara është 5 deri në 6, mirëpo në Kosovë është shumë më tepër se kaq dhe nuk ka të dhëna për një gjë të tillë.

Raporti i kapitalit me punën është proporcional me raportin e shkallës së kthimit në kapital me rritjen ekonomike dhe sa më i madh që është raporti i shkallës së kthimit në kapital në rritjen ekonomike, aq më e madhe është edhe pabarazia. Në këtë mund ta shohim edhe në rastin e bankave në Kosovë, ku kamatat janë shumë më të larta sesa rritja ekonomike. Dhe, sa më e madhe pabarazia, edhe kërkesa agregate në shoqëri është më e vogël, mirëpo në të njëjtën kohë edhe shoqëria është më e ndarë e më e përçarë.

Ju e dini shumë mirë se ne sjellim shumë shpesh ligje këtu në Kuvendin e Kosovës, projektligjet që na vijnë nga Qeveria i miratojmë, mirëpo kur ke pabarazi kaq të mëdha, ato ligje vërtet mbeten të pazbatueshme. Kur njerëzit në shoqëri kanë dallime tepër të mëdha njëri prej tjetrit, nuk mund të ketë një ligj që vlen për të gjithë njësoj. Ligji është universal dhe do të duhej që të gjithë t'i nënshtroheshin njësoj, mirëpo kur ka dallime kaq të mëdha ndërmjet njerëzve, natyrisht se nuk mund të presësh që ai ligj edhe do të zbatohet. Natyrisht kjo nuk vlen për Ligjin e punës, meqenëse Ligji i punës nuk zbatohet për arsye krejtësisht tjera, e arsyeja kryesore është sepse në

disbalancë midis kapitalit dhe punës, Qeveria nuk është në anën e punës. Qeveria është në anën e kapitalit. Ky është problemi kryesor.

Pra, në shtetet e ndryshme që e praktikojnë edhe drejtësinë sociale, përveç idesë së zhvillimit ekonomik, në shtetet që e kanë idealin e shtetit të mirëqenies, natyrisht se Qeveria është në anën e punës dhe të punëtorëve, nuk është në anën e kapitalit.

Kjo do të thotë që nuk ka progres shoqëror nga zhvillimi ekonomik pa drejtësi sociale, e drejtësia sociale nuk ekziston në Kosovë. Drejtësia sociale është dy gjëra, para së gjithash, sigurimet shoqërore, në njërën anë, dhe, në anën tjetër, është tatimi progresiv. Ne nuk kemi sigurime shëndetësore, nuk kemi sigurime shoqërore. Nëse një automjet bën aksident, atëherë automjeti është i siguruar, por jo edhe njerëzit brenda automjetit. Në anën tjetër, çereku i Buxhetit shkon për investime kapitale, gjysma e tij është “paga dhe mëditje” e “mallra dhe shërbime” dhe kjo që shkon për investime kapitale, 90% është për asfalt, që do të thotë se prapë bëhet fjalë për rrugën. Prandaj, populli ynë është një popullsi në rrugë. Automjeti ka sigurim, e jo njerëzit në të, dhe investimet kapitale nuk janë as për ujësjellës, kanalizim, arsim e shëndetësi, por janë veçse për asfalt.

I gjithë ky model i gabuar ekonomik, natyrisht se nuk ka si të mos bjerë edhe në kurrizin e këtyre punëtorëve të paktë, që janë të punësuar. Le të mos harrojmë që ne klasën punëtore e kemi jashtë. Para disa vjetësh një gazetar më pati pyetur mua, tha pse nuk protestojnë njerëzit në Prishtinë më 1 maj, por shkojnë në piknik? Thash, jo protestojnë, qytetarët e Kosovës që janë punëtorë protestojnë, por protestojnë në Berlin, në Cyrih, në Paris, se klasën punëtore e kemi atje. Klasa punëtore atje punon pa pushim, ndërkaq pauzën e kafesë ua mbajmë ne këtu në Kosovë.

Klasa punëtore e shqiptarëve të Kosovës realisht është shumë më tepër jashtë vendit sesa brenda vendit dhe për shkak të papunësisë së madhe në vend dhe klasës së vogël punëtore në Kosovë, kemi shkelje të mëdha të të drejtave të punëtorëve, me ç’rast sindikatat janë shumë të dobëta. Punëdhënësi shumë kollaj mund t’i dëbojë nga puna punëtorët, kur e ke një papunësi kaq të madhe. Mirëpo, përderisa sindikata ua mbron të drejtat punëtorëve kolektivisht, është Ligji i punës ai i cili i mbron ata individualisht.

Dhe, siç u tha edhe më herët, Ligji i punës nuk funksionon, nuk zbatohet për shkak të Inspektoratit të Punës, i cili qëllimisht është lënë vetëm me 50 inspektorë. Me nga një inspektor e gjysmë për komunë nuk mund të presësh që të zbatohet kurrfarë mbrojtje e të drejtave të punëtorëve. Një inspektor e gjysmë nuk i mjafton as fshatit, e lëre më komunës në Kosovë.

Ministri më herët tha se kriteret e Fondit Monetar Ndërkombëtar na kanë detyruar që ne ta mbajmë të ulët numrin e inspektorëve të punës. Kjo është absurde! Ku gjetën që t’i reduktojnë

punëtorët pikërisht te Inspektorati i Punës, le t'i reduktojnë në ndonjë fushë tjetër. Nëse ka diçka që është jetike, është pikërisht Inspektorati i Punës. Do të duhej të bënin reduktime diku tjetër, ndërkohë që rekrutime të reja duhet të bëhen te Inspektorati i Punës.

Tjetër gjë që tha ministri është tërësisht gabim. Tha që paga minimale duhet të rritet varësisht nga rritja apo zhvillimi ekonomik. Jo, jo, paga mesatare le të rritet nga zhvillimi ekonomik apo rritja ekonomike. Paga minimale është minimumi jetik. Ajo është një bindje e jotja për drejtësinë për jetën ekzistenciale të njeriut. Ajo është shporta elementare e punëtorit. Nuk mund të thuash ti tash, varësisht prej zhvillimit ekonomik rritet paga minimale. Jo, jo, paga minimale është në çka beson ti. Është çështje e bindjes politike, është çështje ideologjike, në fund të fundit. Paga mesatare le të jetë ajo që rritet varësisht se si është zhvillimi ekonomik dhe rritja ekonomike. Pra, ministri e ka tërësisht gabimisht këtu.

Arsyeja pse kjo pabarazi është e madhe në Kosovë, pra raporti i kapitalit me punën, apo i pronës me të ardhurat, është për shkak se kapitali dihet në përgjithësi se në kapitalizëm është shumë më koncentruar se puna. Punëtorët janë të shkapërderdhur, por kapitali është shumë më i koncentruar. Dhe, pikërisht ky koncentrim i kapitalit bën që të ardhurat prej kapitalit të jenë të tejprëfaqësuar në 10%-shin e epërm.

Ne këtu i patëm propozuesit, domethënë deputetët Izmaku dhe Haxhiu, mirëpo mua më duhet të them që nuk mund të bëhet mbrojtja e të drejtave të punëtorëve, kur jeni në një subjekt politik që parullën kryesore e ka “familja, prona, shteti”. Pra, “familja, prona, shteti”, ky është slogani juaj. Në atë Revolucionin Borgjez Francez ka qenë “liri, barazi, vëllazëri”, Lëvizja “Vetëvendosje” thotë “barazi, zhvillim, drejtësi”, ju thoni “familja, prona, shteti”. Tash kur të thuash “familja, prona, shteti”, s’ka të drejta të punëtorëve aty. Është më mirë në Këshillin Drejtues ta merrni një iniciativë për ta ndryshuar këtë parullë, dhe kjo le të jetë, për shembull “punë, siguri, shëndet” ose diçka e ngjashme, mirëpo nëse e ke parullën “familja, prona, shteti”, nuk ke se si flet më për të drejta të punëtorëve. Pra, i ke dhënë pronës prioritet dhe le të mos harrojmë që në këtë Kuvendin e Kosovës ku jemi këtu ka shumë pak punëtorë, ama ka pronarë shumë. Ky është vend i pronarëve. Këtu pronarët janë duke diskutuar për punëtorët dhe të drejtat e tyre. Kjo është paradoksale. S’ka kurrfarë kuptimi kjo.

Pra, do të duhej që ata deputetë që janë punëtorë të diskutojnë për të drejtat e punëtorëve. Kur deputetët që janë pronarë diskutojnë për të drejtat e punëtorëve, kjo është, siç tha Visari më herët, të derdhësh lot krokodili. Dhe, unë po e përmend vetëm shembullin e SPD-së gjermane, e cila ta zëmë në programin e saj të Hamburgut të vitit 2007 thotë që ajo e përkrah rritjen e pagave që bazohet në rritjen e produktivitetit dhe në inflacion, por gjithashtu dëshiron që të shohë më shumë pronësi në duart e punëtorëve. Në këtë aspekt, participimi, pjesëmarrja e punëtorëve në kapitalin e ndërmarrjes është një burim shtesë i të ardhurave që e siguron shpërndarjen më korrekte dhe në të njëjtën kohë edhe suksesin e firmës.

Po ashtu, një shpërndarje e tillë, një pjesëmarrje e tillë paraprakisht është ajo e cila e rritë inovacionin dhe produktivitetin.

Më tutje thuhet që duhet të bazohemi në parimin e demokracisë së brendshme në kompani, që duhet të implementohet nëpërmjet vendimmarrjes së përbashkët në këshillat e punëtorëve dhe pjesëmarrjes në bordet mbikëqyrëse që duhet të forcohen. Kjo është socialdemokracia gjermane, se dihet që ekonomia nuk është shkencë natyrore, varet prej cilit kënd e shikon. A e shikon prej këndit të prodhuesit vendës, konsumatorit vendës, apo prodhuesit të huaj. Pra, varet shumë prej cilës pikëpamje e sheh.

E këto të drejtat e punëtorëve nga pikëpamja e pronarëve që kryesisht fitimin e kanë nga të ardhurat që u vijnë prej kapitalit e jo prej punës, unë besoj që kjo është më shumë një teatër qesharak, se sa ndonjë farë brengje serioze për temën në fjalë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Labinotë Demi e ka fjalën.

LABINOTË DEMI: Faleminderit për fjalën, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

U tha shumë për shkeljen e të drejtave të punëtorëve dhe meqë jemi kah fundi i debatit, nuk di nëse do të ketë efekt ajo çfarë unë kam menduar ta them. Gjithsesi, do ta them një pjesë të saj.

Shkelja e të drejtave të punëtorëve në Kosovë, sidomos të atyre në sektorin privat, është një çështje e ngritur në forma të problematikave të ndryshme, që fatkeqësisht gjithnjë po shkon duke u rritur. Kjo si problem i përgjithshëm, ndërsa në mënyrë të veçantë i shprehur te gjinia femërore.

Problematika kryesore, mendoj unë, është mungesa e kontratave për punëtorët e angazhuar, sidomos në sektorin privat, por edhe mosrespektimi i kontratave të nënshkruara. Shumë shpesh kemi kontrata me të cilat punëtorët janë të obliguar të punojnë 8 orë në ditë për pagën e përcaktuar në kontratë, ndërsa punojnë 12 orë në ditë. Kanë së paku një ditë të lirë gjatë javës sipas kontratës, ndërkaq punojnë 18 orë një të diel për ta pasur të lirë të dielën e javës pasuese, ose një javë rresht punojnë nga 18 orë gjatë ditës për ta shfrytëzuar një javë pushim, kryesisht gjatë pushimeve verore. Kjo dukuri është e shprehur sidomos te punëtorët e taksive private, pa përjashtuar edhe punëtorët e sektorëve tjerë.

Sa u përket problemeve më të theksuara te gjinia femërore, përveç mosrespektimit të orarit të punës dhe detyrave të përcaktuara me kontratë, është edhe pushimi i lehonisë ai që nuk respektohet në shumicën e rasteve nga punëdhënësi. Për këtë shkak, shumë shpesh kemi edhe ankesa të formave të ndryshme dhe një numër shumë të madh.

Një tjetër problematikë shqetësuese, që për aq sa e përcolla debatin nuk e dëgjova deri më tash, është edhe rritja e dukurisë së ngacmimeve seksuale në vendin e punës. Përderisa shumë nga problematikat që u cekën, që i ceka unë dhe parafolësit tjerë, i përfshijnë punëtorët e sektorit privat, kjo dukuri edhe jomorale përfshin të dy sektorët.

Krejt kjo dukuri negative dhe të tjerat që u përmendën ndikojnë në imazhin e keq dhe në joefikasitetin e punës së obliguar me kontratë, çka pastaj reflekton edhe joseriozitetin e përgjithshëm dhe dëmet e mëdha që u bëhen individëve të atakuar, familjeve dhe familjarëve të varur financiarisht nga të punësuarit dhe shoqërisë, në përgjithësi.

Konsideroj se niveli lokal dhe i udhëheqjes, por edhe ai qendror, duhet të jenë më efektivë në mbikëqyrjen e të gjitha rrethanave që rëndojnë gjithnjë e më shumë ditën dhe jetën e qytetarit nëpërmjet formave të inspektimit përkatës të paraparë, sikur që duhet ta pranojmë faktin se asnjë qeveri e deritanishme nuk ka bërë aq sa duhet për të krijuar politika të mirëfillta sociale. Ndërkaq, përveç mbikëqyrjes ose inspektimit, duhet të merren edhe masa disiplinore për të gjithë punëtorët që i shkelin rregullat dhe abuzojnë me pozitën dhe vendin e tyre të punës, e që as rastet e tilla nuk mungojnë në vendin tonë dhe shpesh janë storie mjaft atraktive, në kuptimin më të keq të fjalës, në përditshmërinë dhe mediumet tona. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Halimi, e keni fjalën, pastaj Bekimi.

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, kryetar!

Meqenëse isha nënshkruese e kërkesës për këtë debat, ndiej obligim që t'i ngre disa çështje.

Duke pasur parasysh faktin që zhvillimi i sektorit privat i ka paraprirë edhe krijimit të legjislacionit, ka krijuar praktika jo të mira në raport me të drejtat e punëtorëve dhe situatat e palakmueshme, që çdo ditë e më shumë po rriten në këtë sektor, mirëpo e kam ngrehur edhe këtu në Kuvend në kuadër të pikës - ngritja e çështjeve.

Tashmë institucionet e Kosovës duhet të përfundojnë së kërkuari vetëm taksat dhe tatimet nga sektori privat, por duhet të kërkojnë domosdoshmërisht edhe respektimin e ligjit në raport me punëtorët, për faktin se sa të duash të mbledhësh taksa dhe tatime, po që se klasa punëtore shkatërrohet, atëherë për çka i duhen shtetit mjetet?

Aq sa unë arrita të kujtohem, në institucionet e Kosovës janë më shumë se shtatë lloje të inspektorateve dhe secili e bën inspektimin sa i përket fushës së vet. Inspektimi sipas fushave në secilën veç e veç ka të bëjë vetëm me inspektimin se a po respektohen ligjet e Kosovës, në veçanti në raport me punëtorët, a po mbrohen të drejtat e punëtorëve në punë?

Të nderuar kolegë deputetë,

Është koha që Qeveria të mendojë për një riorganizim ndryshe të Inspektoratit dhe këto inspektorate të organizuara në institucione të veçanta, me detyra të veçanta, që e kanë një qëllim të vetëm, të organizohen asisoj që secili zyrtar që e ka titullin e punës inspektor të veprojë kudo që i jepet mundësia që shihet se ka ndeshje me ligjin, ngase po që se bëjnë një ndarje të kërkesave ligjore në raport me të drejtat e punëtorëve, në raport edhe me mbrojtjen e mjedisit, në raport edhe me stafin në institucione publike, siç është arsimi, shëndetësia, e të ngjashme, dhe i kanalizojmë në shtylla shkeljet e ligjit apo kërkesat se si të respektohet ligji me të vetmin qëllim që të ruhet vendi ynë dhe të ruhen punëtorët, të mos dëmtohen nga menaxherët e tyre, qoftë në sektorin publik apo privat, këto përcaktohen në dhjetë grupe. Dhe, secili grup i ka vetëm nga dy nëngrupe, pa shkuar në ndarje të mëtejshme. Secili person që tashmë edhe e ka një përvojë të gjatë pune, mund t'i mësojë këto detyra shumë mirë dhe të veprojë kudo që shihet se ka ndeshje me ligjin apo ka dilema sa i përket respektimit të ligjit.

Vetëm në këtë formë do të mund t'u ikim gjithë arsytimit se nuk kemi mjaftueshëm inspektorë për këtë fushë apo atë fushë. Inspektori është inspektor dhe mund t'i mbajë në mend apo t'i shënojë në një fletore të vogël 20 kërkesa ligjore dhe cilindo institucion, pa dallim publik apo privat. Kjo duhet të bëhet kështu, mendoj unë, me të vetmin qëllim, që të gjithë të punësuarit në sektorin privat të mos e shohin veten si punëtorë apo të punësuar të papunësuar, sepse na rastis shpesh, të gjithë neve besoj, që secili thotë 'më ndihmo ta punësoj djalin, dajën, tezen, hallën'. Kudo, në komunë, në bashkësi lokale, në institucione qendrore, në institucione publike... "Pse? A s'janë duke punuar kurrkund? - Jam në minimarket, jam në këtë kompani, jam në atë kompani, por ajo s'është punë".

Dhe, kjo ndodh vetëm për faktin se asnjë i punësuar në sektorin privat nuk ndien një lloj sigurie dhe duhet të përfundojë më bindja se në sektorin publik ke siguri në vendin e punës, kurse në sektorin privat nuk ke siguri në vendin e punës.

Trajtimi duhet të bëhet i barabartë. Më mirë është që vetë shteti t'i bonificojë institucionet, përkatësisht kompanitë private, të cilat e respektojnë ligjin në dobi të interesave të punëtorëve, sesa të kërkojë për çdo tre muaj, madje tash së fundi po dëgjoj në medie që edhe tri herë në ditë inspektorët shkojnë në kompani të caktuara për të verifikuar kuponë, kontrole të ndryshme... Janë ato që duhet të plotësohen, nuk jam kundër, por tri herë në ditë shkon për një kupon, atëherë tri herë në ditë e shih gjendjen e punëtorit në çfarë gjendjeje është dhe si e trajton menaxheri.

Do të thotë, këto dy çështje duhet të shkojnë njësoj, sepse, mendoj unë, se për nga vlera dhe rëndësia prapë më përparësi i jap personit, punëtorit, sesa një kupon fiskal, sepse me atë ti mund ta kthesh në formë të tatimit, të dënimeve dhe mund t'i marrësh mjetet si shtet, por shkatërrimin e një punëtori që punon 10 orë, 12 orë dhe 15 orë pa pushim 7 ditë në javë, atë nuk mund ta rehabilitosh pa shpenzime të mëdha.

Prandaj, edhe një herë bëj thirrje që institucionet duhet të mendojnë për një formë tjetër të organizimit të inspektorateve dhe secili duhet të veprojë kudo që është, në mënyrë që ta krijojmë mundësinë që të themi se të drejtat e punëtorëve po respektohen edhe në sektorin publik, edhe në atë privat.

Nuk mund ta lë pa e përmendur edhe një rast në Gjilan. Kisha dashur që të mos jetë e vërtetë, mirëpo dje e mora si informacion. Një zyrtare e Administratës së Gjilanit fiton në zgjedhje lokale dhe e kryen mandatin e asamblistes, në të njëjtën kohë e pezullon vendin e punës si zyrtare, sepse ia ka lejuar ligji në atë kohë. Më pas, pas përfundimit të mandatit si asambleiste do të kthehet në vendin e punës dhe Komuna e Gjilanit nuk e lejon. I drejtohet gjykatës dhe, uroj që të mos jetë kështu, se është gabim shumë i rëndë, mirëpo gjithnjë sipas interpretimit të saj, gjykata ia njeh të drejtën e kompensimit të pagave deri në kohën kur ajo bën ankesë në gjykatë, por nuk ia njeh të drejtën që të kthehet në vendin e punës. Kjo është një shkelje e etikës profesionale, nuk e di me apo pa qëllim, por duhet ta kemi parasysh këtë.

Kemi dhe raste të tjera, kur nga institucionet publike përjashtohen njerëz me procedura disiplinore, punësohen në institucionin tjetër dhe me vendim të gjykatës kompensohen për vitet, të cilat nuk kanë mundur ta ushtrojnë profesionin në institucionin e parë, e të njëjtën kohë paguhet nga Buxheti në institucionin e dytë. Do të thotë, këto janë anomali dhe për ta akuzuar gjithëherë vetëm sektorin privat duhet t'i heqim të gjitha këto dilema dhe këto veprime të dëmshme dhe të paligjshme edhe në sektorin publik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në fund, zoti Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar Haliti!

Fillimisht, një pjesë të këtij fjalimi dua t'ju jap, që është përgatitur nga deputetja Xhevahire Izmaku, ia jap Administratës së Kuvendit që ta procedojë si pjesë e fjalimit. Ky në fakt është fjalimi i deputetes Xhevahire Izmaku, me të cilin bashkërisht e kemi organizuar këtë debat.

E kemi organizuar këtë debat, sepse për mua, për deputeten Xhevahire Izmaku dhe Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike, shkelja e të drejtave të punëtorëve është brengë e madhe dhe nga diskutimet e të gjithë diskutuesve sot vërtet vërehet që të gjitha grupet parlamentare dhe të gjithë deputetët e kanë këtë brengë dhe gjithsecili me diskutimet e tyre dha dromcat nga ajo pjesë e shkeljes së të drejtave të punëtorëve në të gjithë sektorët.

E kam theksuar në arsyetimin e këtij debati KEDS-in. Pse KEDS-in e jo kompanitë tjera, ashtu siç e theksuan disa nga kolegët. KEDS-in sepse bën shkelje e të drejtave kushtetuese, largim kolektiv. Ne të gjithë kemi vuajtur nga largimet kolektive. Ne deputetët e Kuvendit të Kosovës nuk duhet t'i pranojmë largimet kolektive dhe vërtet duhet t'i dënojmë ato. S'e kam përmendur "Bechtel"-in, por i kam përmendur kompanitë ndërtuese ndërtimore, tregtare, private, nuk bëj selektive.

Kam theksuar sepse shkeljet e të drejtave të punëtorëve për ne në gjithë sektorin privat dhe publik janë brengë. Nuk janë demagogji, nuk janë hipokrizi. Këtu deputetët janë në këtë sallë dhe jetojnë me pagën e tyre, jetojnë nga paga e tyre. Nëse ndonjëri nga këta deputetë është pronar i ndonjë kompanie, përgjegjësia i takon atij, por nëse ndonjëri nga deputetët bën reklamim të ndonjë kompanie, siç janë për shembull Devollët dhe të njëjtit deputetë këtu na akuzojnë ne për hipokrizi dhe njëkohësisht u bëjnë devollëve reklamë, deputetët e kësaj partie u bëjnë reklamë devollëve. Kjo është hipokrizi dhe demagogji.

Hipokrizi është nëse ti e lexon vetëm pikën 1, e nuk e lexon pikën 7 të rekomandimeve. Kjo është demagogji e skajshme, sepse kur kemi kërkuar inspektime efektive në pikën e parë, në pikën e shtatë kemi kërkuar rritjen e kompetencave dhe të numrit të inspektorëve, transparencë dhe llogaridhënie. Kjo është demagogji.

Demagogji është të vihet në Kuvend, hipokrizi gjithashtu, të akuzohen devollët e të shkohet për të pirë “coca-cola” zero në jaht. Kjo është hipokrizi.

Demagogji dhe hipokrizi është t’u thuhet deputetëve ‘jeni pronarë’. Ju jeni përfaqësues, ne jemi përfaqësues. Ne këtu në Kuvend jemi rrezikuar nga deputeti Kurti dhe nga disa kolegë të tij në vendin e punës. Këtu jemi rrezikuar. Përveç nesh, janë rrezikuar edhe punëtorët e Administratës, që s’ia kanë pasur borxh Albin Kurtit për kauzën e tij politike që t’i rrezikojë ata. Pra, kemi shkelje të të drejtave të punëtorëve edhe këtu, edhe në Kuvend, nga ata që për dogma politike përdorin çdo gjë.

Qëllimi i këtij debati vërtet është për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve, sepse me mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve ne do arrijmë edhe zhvillim ekonomik. Pra, do t’i arrijmë dy efekte. Njëri që është në aspektin njerëzor dhe tjetri në aspektin zhvillimor. Këtë mendojmë ta arrijmë nëpërmjet një debati dhe mendoj që ky debat e ka arritur qëllimin, sepse ka arritur ta sensibilizojë këtë çështje, e cila shihet edhe nga diskutimet se ka qenë çështje e njohur për të gjithë, por e padebatuar dhe e padiskutuar. Nuk jam ndalur për të diskutuar për kompanitë veç e veç, por jam ndalur për t’i theksuar të gjitha vërejtjet që u përkasin shkeljes së të drejtave të punëtorëve.

Dhe, krejt në fund, të nderuar kolegë deputetë, pasi sot nuk ka kuorum të mjaftueshëm për t’i votuar këto rekomandime, në diskutim edhe me kryetaren e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, mendoj që këto rekomandime bashkë me konkluzionet që janë nxjerrë nga monitorimi i Ligjit të punë të na vijnë për votim dhe t’i harmonizojmë bashkë, fillimisht në Komisionin Parlamentar, e pastaj t’i votojmë këtu në Kuvend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Faleminderit!

Ne e dimë që kemi aq shumë dallime, mospajtime e kështu me radhë, nuk mund t'i trajtojmë tash të gjitha ato. Mund të organizojmë debate të veçanta, por për bindjen time, lidhur me këtë debat që është thirrur ka një kundërthënie fundamentale ndërmjet kërkesës për të drejtat e punëtorëve, për sigurinë në punë, për shëndetin e punëtorëve dhe parullës kryesore partiake “familja, prona, shteti”. “Familja, prona shteti”, domethënë këtu është çështja. Si sqarohet kjo kontradiktë fundamentale. Ne kemi pa fund dallime. Kemi bërë edhe akuza. Por, dallimet që i kemi janë dallime ideologjike, veçse me propozimin që keni bërë, unë pajtohem për shumë pika. Nuk mund të pajtohesh me këto propozime që i keni bërë dhe në të njëjtën kohë ta mbani lart flamurin partiak me parullën “familja, prona, shteti”.

Pra, së pari familja, pastaj prona, në fund shteti. Thuajse shteti duhet t'i ruajë pronat e familjes. Kjo parullë është shumë e çuditshme. Është parullë ekstreme e djathtë. Partitë e ekstremit të djathtë në Evropë kanë këso parullash. “Familja, prona, shteti” është parullë e ekstremit të djathtë. Ekstremi i djathtë nuk është në funksion të të drejtave të punëtorëve. Unë vetëm këtë po e them. Kurse dallimet që i kemi, këto i diskutojmë ndonjë herë tjetër, ne vijmë në Kuvend prapë. Ato janë pa fund dhe shumë mirë që janë ashtu.

KRYESUESI: Kundër-replikë, Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, zoti Kurti!

E vërtetë është që dallojmë në koncepte ideologjike, sepse orientimi i Partisë Demokratike dihet dhe ai i partisë suaj, domethënë nga Koreja e Veriut, edhe ai dihet. Por, po doni arsyetim. E drejta e punëtorit, e drejta e punëtorit po kërkon... Si i mendon punëtorët, Albin? Njerëz të ardhur nga hëna? Nuk i konsideron pjesë të familjes punëtorët? Të kujt janë këta këtu punëtorët në ndërmarrje publike? Çka janë ata? Punëtorët në sektorin privat nuk punojnë për familjen? Nuk e konsideron të drejtën e punëtorëve cenim edhe të familjes? Gabohesh atëherë. Gabohesh, gabohesh! Ai është koncepti juaj.

KRYESUESI: Faleminderit! Të nderuara zonja dhe zotërinj, me kaq ky debat dhe seanca kanë përfunduar.

Mirupafshim në seancën e ardhshme, kur ta caktojë Kryesia e Kuvendit. Faleminderit!

* * *

E enjte, 4 maj 2017

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 19 prill

Rendi i ditës

1. Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për minierat dhe mineralet,
2. Votimi i propozim-rezolutës në lidhje me arrestimet e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”,
3. Votimi i rekomandimeve në lidhje me moszbatimi e rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga Qeveria e Republikës së Kosovës,
4. Votimi i rekomandimeve në lidhje me shkeljen e të drejtave të punëtorëve në Kosovë,
5. Interpelanca e kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, sipas kërkesës së deputetes Donika Kadaj-Bujupi, e mbështetur edhe nga 15 deputetë nënshkrues, për çështjen e shfrytëzimit të thëngjillit dhe minierën e Sibocit,
6. Interpelanca e ministrit Blerand Stavileci, sipas kërkesës së deputetit Visar Ymeri, i mbështetur edhe nga 15 deputetë nënshkrues, në lidhje me kontratën e privatizimit të Kompanisë së Distribuimit të Energjisë Elektrike,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave nga pjesët veriore të Kosovës,
8. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/ L-145 për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë.

Dnevni red

1. Glasanje N/zakona o izmena i dopunama Zakona o rudnicima i mineralima,
2. Glasanje Predloga rezolucije u vezi hapšenja aktivista Pokreta “Vetëvendosje”,
3. Glasanje preporuka u vezi sprovođenja preporuka Narednog advokata od strane Vlade Republike Kosova,
4. Glasanje preporuka u vezi kršenja prava radnika na Kosovu
5. Interpelacija premijera Isa Mustafa, na zahtev poslaniče Donika Kadaj-Bujupi, podržana i od 15 poslanika potpisnika u vezi pitanja korišćenja uglja u rudniku u Sibovcu,
6. Interpelacija ministra Blerand Stavileci, na zahtev poslanika Visar Ymeri, podržan i od 15 poslanika potpisnika u vezi Ugovora o privatizaciji Kompanije za distribuciju električne energije,
7. Prvo razmatranje N/zakona o osposobljavanju, ponovnom osposobljavanju i zapošljavanju lica sa severnog dela Kosova,
8. Razmatranje izveštaja Komisije za obrazovanje, nauku, tehnologiju, kulturu, omladinu i sport u vezi nadgledanja sprovođenja Zakona br. 03/L-145 o osnaživanju i učešću omladine.

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Ndërkohë kisha kërkuar që deputetët, të cilët janë në ambientet e Kuvendit, le të vijnë për 10 minuta, në 10:25, për 15 minuta, në fakt, e fillojmë seancën, sepse jemi në votime, duhen 60 deputetë. I kisha lutur kolegët deputetë të vijnë, në 10:25 e fillojmë. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti)

KRYESUESI: Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Të nderuar ministra, kryeministër, zëvendëskryeministra që nuk jeni këtu,

I hap punimet për vazhdimin e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës me pikat e papërfunduara nga seanca plenare e 18 dhe 19 prillit 2017, sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 3 maj 2017.

1. Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për minierat dhe mineralet

Ju njoftojmë se votimi i kësaj pike është përsëritur dhe diskutimet janë kryer. Vetëm duhet ta votojmë projektligjin.

Në sallë janë 66 deputetë, ju lus që t'i zini vendet dhe të përgatiteni për votim.

Ju lutem, t'i zini vendet tuaja, sepse po fillon votimi. Zoti Paqaku, nuk ke të drejtë të flasësh me pjesën andej, në qoftë se flisni me deputetë, ju nxjerr jashtë, nuk jeni këtu të flisni në sallë, por ta përcillni seancën.

Ju lus që të përgatitemi për votim, votojmë tash.

Kuorum ka, nuk po doni të votoni, si duket, ose u vonuat të votoni.

Ju kisha lutur, në qoftë se grupet parlamentare nuk janë të interesuara të votojnë, ta deklarojnë votën kundër, të paktën që në parallogaritje ta dimë kush nuk do dhe arsyet ka të drejtë secili t'i shprehë pse nuk do të votojë.

Zoti Kuqi, zoti zëvendëskryeministër Kuqi! Vërtet është një situatë e padenjë për të qenë deputet kështu.

Atëherë, edhe një herë po e përsëris votimin për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për minierat dhe mineralet.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Faleminderit! Kanë votuar 68 deputetë, 31 deputetë me kartelë janë për, një pa kartelë është për, bëjnë 32 deputetë, 25 deputetë kundër dhe 12 abstenime.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për minierat dhe mineralet.

2. Votimi i rekomandimeve në lidhje me moszbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga Qeveria e Republikës së Kosovës

Nga seanca plenare e mbajtur më 19 prill 2017 është zhvilluar debat parlamentar në lidhje me moszbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Në mungesë të kuorumit për vendimmarrje, nuk janë votuar rekomandimet e propozuara dhe deputetja Teuta Haxhiu.

E ftoj deputeten Teuta Haxhiu që t'i paraqesë rekomandimet e harmonizuara me grupet parlamentare.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Pra, duke falënderuar të gjithë kolegët deputetë për angazhimet e tyre gjatë debatit për moszbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhe pas konsultimeve me të gjitha grupet parlamentare, LDK-në, PDK-në, "Vetëvendosjen", "Nismën", "6+", kemi ardhur në përfundim që rekomandimet janë këto, gjithsej shtatë:

1. Të implementohen rekomandimet e Avokatit të Popullit të vitit 2015,
2. Qeveria e Republikës së Kosovës të krijojë kushte të nevojshme në kuptimin financiar që rekomandimet e Avokatit të Popullit të implementohen,
3. Komisionet parlamentare obligohen të përfshijnë çështjet që dalin nga raportet vjetore të Avokatit të Popullit në planet e tyre të punës,
4. Kryeministri i Republikës së Kosovës, si kryesues i Grupit Ndërmnistror për të drejtat e njeriut, të raportojë në Kuvend të paktën një herë në vit,
5. Komisionet parlamentare t'i ftojnë në debat udhëheqësit e institucioneve në komisionet përkatëse në Kuvend, për t'i kuptuar arsyet e moszbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit,

6. Kuvendi i Kosovës gjatë plotësim-ndryshimit të Rregullores së Kuvendit, të parashohë vetëm diskutimin e raportit vjetor të Avokatit të Popullit, e të mos hidhet në votim,

7. Të zbatohet Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Kosovës lidhur me kontributet pensionale të qytetarëve të Kosovës, të mbajtura ilegalisht nga Serbia.

Prandaj, i ftoj edhe një herë të gjithë kolegët që t'i përkrahin rekomandimet e cekura. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

I votojmë rekomandimet e harmonizuara me grupet parlamentare.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash:

Faleminderit! Kanë votuar 72 deputetë, 64 deputetë janë për, 5 kundër dhe 3 kanë abstenuar. Kuvendi miratoi rekomandimet e propozuara nga deputetja Teuta Haxhiu dhe të harmonizuara me grupet parlamentare. Faleminderit!

3. Votimi i rekomandimeve në lidhje me shkeljen e të drejtave të punëtorëve në Kosovë

Në seancën plenare të Kuvendit të mbajtur më 19 prill 2017 është zhvilluar debat parlamentar në lidhje me shkeljen e të drejtave të punëtorëve.

Në mungesë të kuorumit për vendimmarrje, nuk janë votuar rekomandimet e propozuara nga deputetët Bekim Haxhiu dhe Xhevahire Izmaku.

Andaj sot vazhdojmë me votimin e propozim-rekomandimeve.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Në sallë janë 87 deputetë, aktivë në votim kanë qenë 53 deputetë.

Tani unë nuk e di a është më me rëndësi për deputetin të flasë në telefon a të votojë!

Po e përsëris edhe një herë votimin, pastaj keni të drejtë të votoni për ose kundër, e përsëris edhe një herë votimin.

Ju lus për qetësi! Zoti Gashi, të lutem rrini në vend, nuk mund të flasësh pesë rreshta matanë. Ta mbajmë njëfarë rendi, se gjithmonë hajgare po bën, le pashë Zotin, mos i shqetëso deputetët, të

lutem! Nuk është punë jotja, puna jote është, e di ti cila... Po, puna ime është të ta tërheq vërejtjen ty kur nuk je i disiplinuar.

Po vazhdojmë votimin e rekomandimeve në lidhje me shkeljen e të drejtave të punëtorëve.

Në seancën plenare të Kuvendit të mbajtur më 19 prill 2017 është zhvilluar debat parlamentar në lidhje me shkeljen e të drejtave të punëtorëve në Kosovë.

Në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje nuk janë votuar rekomandimet e propozuara nga deputetët Bekim Haxhiu dhe Xhevahire Izmaku.

Rekomandimet janë lexuar në seancën e kaluar, kush nuk ka qenë, nuk i kam faj, votojmë tash, punë juaja është a votoni a jo!

Faleminderit! Kanë votuar 65 deputetë, 63 deputetë kanë votuar për, 2 kanë abstenuar dhe asnjë kundër.

Kuvendi i miratoi rekomandimet e propozuara nga deputetët Bekim Haxhiu dhe Xhevahire Izmaku, të mbështetur nga tetë deputetë të tjerë.

4. Votimi i propozim-rezolutës në lidhje me arrestimin e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Ju njoftoj se votimi i kësaj pike është përsëritur në disa seanca, por nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

Andaj në seancën e sotme e riprocedojmë votimin e kësaj propozim-rezolute.

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin e propozim-rezolutës.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash:

Faleminderit! Kanë votuar 69 deputetë, për janë 22 deputetë, kundër 31, kanë abstenuar 16.

Kuvendi nuk e miratoi rezolutën lidhur me arrestimin e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

5. Interpelanca me kryeministrin e Kosovës zotit Isa Mustafa, sipas kërkesës së deputetes Donika Kadaj-Bujupi, e mbështetur edhe nga 15 deputetë nënshkrues, për çështjen e shfrytëzimit të thëngjillit dhe minierën e Sibocit

Unë i jap 10 minuta pauzë, shpresoj që zoti kryeministër të vijë gjatë kësaj kohe.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

Më lejoni t'ju informoj lidhur me votimin që kaloi me numra, sipas meje, herën e parë.

Votimi për Ligjin për minierat, sipas interpretimit të Sekretarisë dhe rregullave të Kuvendit, ligji nuk ka kaluar, për faktin se është dashur të jenë 32 vota dhe kanë qenë vetëm 31 vota.

Nga 68 deputetë, është dashur të votojnë 35 deputetë për të kaluar ligji. Prandaj, sipas rregullave që i kemi në Kuvend, ky ligj nuk ka kaluar, sa për njoftim tuajin.

5. Interpelanca e kryeministrit të Kosovës, zoti Isa Mustafa, sipas kërkesës së deputetes Donika Kadaj-Bujupi, e mbështetur edhe nga 15 deputetë nënshkrues, për çështjen e shfrytëzimit të thëngjillit në minierën e Sibocit

Ju njoftoj që kjo pikë ka qenë e radhitur në rend dite të seancës së kaluar, po në mungesë të propozuesit, zonjës Donika Kadaj-Bujupi, është shtyrë për seancën e sotme.

Zonja Donika Kadaj-Bujupi, e mbështetur edhe nga 15 deputetë nënshkrues, në bazë të nenit 44 të Rregullores së Kuvendit, ka parashtruar kërkesë për të ftuar në interpelancë kryeministrin e Kosovës, zotin Isa Mustafa, për çështjen e shfrytëzimit të thëngjillit dhe minierën e Sibocit.

Ju njoftoj se në bazë të Rregullores së Kuvendit, interpelanca mund të zgjasë deri në tri orë.

Përfaqësuesi i interpelancës mban të drejtën e fillimit të debatit në kohëzgjatje deri në 10 minuta dhe në përmbyllje të debatit 5 minuta, neni 44, pika 7 e Rregullores së Kuvendit.

Koha e ndarë për diskutim sipas grupeve parlamentare të deputetëve pa grup parlamentar është si në vijim: me dhe pa.

Grupi Parlamentar i PDK-së, ka 36 deputetë, 54 minuta, minus 6 minuta për kryeministrin të dhëna nga grupi parlamentar.

Grupi Parlamentar i LDK-së, 33 deputetë, 50 minuta, minus 6 minuta për kryeministrin, domethënë 44 minuta.

Grupi Parlamentar “Vetëvendosje” ka 16 deputetë, kanë 24 minuta,

Grupi Parlamentar Lista serbe, 11 deputetë, kanë 16 minuta, minus 2 minuta për kryeministrin, domethënë kanë 14 minuta.

Grupi Parlamentar i AAK-së, 8 deputetë, kanë 12 minuta.

Grupi Parlamentar “Nisma”, 6 deputetë, kanë 9 minuta.

Grupi Parlamentar “6+”, ka 6 deputetë dhe ka 9 minuta, minus një minutë për kryeministrin, bëjnë 8 minuta.

Pa grup parlamentar janë 4 deputetë, kanë gjithsej 6 minuta.

Unë e lexova minutazhin për t’ua tërhequr vërejtjen, sepse kur po harxhohen minutat deputetët po reagojnë pse e le këtë ose atë të flasë.

Ju brenda grupeve parlamentare mund t’i pjesëtoni minutat tuaja ose duhet t’ia leni regjisë, bashkë me kryesuesin e seancës që t’i pjesëtojnë minutat dhe aq minuta sa i bie secilit deputet mund të flasë.

Kësaj radhe nuk e kemi bërë këtë praktikë, por zakonisht në parlament deklarohen minutat e deputetit dhe jo të kryetarit të grupeve parlamentare, se kujt ia fal minutat.

Prandaj, po jua tërheq vërejtjen që nëse dikush dëshiron të diskutojë sa i përket çështjes së interpelancës, merruni vesh brenda grupeve tuaja parlamentare dhe mos më gjuani fjalë prej sallës, se unë nuk kam faj në këtë rast.

E ftoj zonjën Donika Kadaj-Bujupi, në cilësinë e propozuesit të interpelancës që ta marrë fjalën, 10 minuta i keni në dispozicion.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Në bazë të nenit 65, pikë 9 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 44, paragrafi 1 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e thërret në interpelancë kryeministrin Isa Mustafa për çështjen në vijim: rreth shfrytëzimit të thëngjillit dhe minierën e Sibocit.

Prej disa kohësh Kosova është duke u përballur me krizë të thellë energjetike.

Midis një sërish shkaqesh të tjera, një problem me pasoja tepër të rënda është situata në fushën e mihjes së re, pra në Siboc.

Në territorin e destinuar për mihje tash ka mbi 260 ndërtime pa leje.

Përpos importit direkt të energjisë elektrike, nevojat për thëngjill të korporatës energjetike të Kosovës tash e sa vjet po plotësohen nga importi i thëngjillit, a nuk është kjo absurd: një vend që fle në thëngjill, importon thëngjill.

Në fushatën e mihjes së re në Siboc tash e sa kohë është ndalur pjesërisht puna e heqjen e djerrinës dhe përgatitjes së mihjes së thëngjillit, kjo për shkak të ndërtimeve të jashtëligjshme në këtë zonë.

Aty janë duke u shfrytëzuar disa mbetje të pashfrytëzuara më herët në procesin e mihjes së thëngjillit dhe furnizimit të termocentraleve, e si pasojë po shkaktohen plasaritje që mund të rrezikojnë familjet, sidomos familjet e vjetra të cilat jetojnë aty prej kohësh dhe rrethinën.

Ky proces duhet të ishte shmangur, duke qenë se nga pikëpamja ligjore qysh prej vitit 2004 ka vendim qeveritar për ta trajtuar si zonë të interesit të veçantë ekonomik, e që si pasojë ndalon rreptësisht çfarëdo aktivitetit, qoftë ndërtimor, i cili ndalohet pra edhe me ligj, edhe me këtë rregullore të nxjerrë në vitin 2004 afër zonës së përparimit të kësaj mihje.

Në vitin 2009 Qeveria e asaj kohe ka marrë sërish vendim me qëllimin e njëjtë, pra duke përforcuar vendimin e mëhershëm. Duke e theksuar sërish si zonë ekonomike me interes të veçantë.

Deri në vitin 2009 në territorin e kësaj zone të veçantë nuk kanë qenë më shumë se 50 deri në 60 shtëpi të ndërtuara. Mirëpo, pas këtij viti, pra pasi doli vendimi i Qeverisë në vitin 2009, deri në ditët e sotme janë ndërtuar diku rreth 260 shtëpi në territorin e destinuar për mihje dhe të mbrojtur si zonë me interes ekonomik.

Kjo situatë e ka vendosur kompaninë publike KEK para faktit të kryer, e që tash i kërkohet të negociojë për kompensim me ata që, në fakt, janë udhëzuar të shkelin ligjin dhe të rrezikojnë qoftë jetët e familjarëve atje, qoftë punën e KEK-ut dhe prodhimin në këtë ndërmarrje.

Në fakt, janë duke rrezikuar edhe punën e rreth 5000 punëtorëve, të cilët punojnë në miniera, e cila po rrezikohet të mbyllet në fillim të qershorit për shkak të këtyre veprimeve neglizhente dhe mosveprimit nga ana e Qeverisë.

Përveç problemeve të zakonshme të termocentraleve, problemeve organizative të mirëmbajtjes, tash shtohet edhe problemi i atyre që duan të shfrytëzojnë mihjen e KEK-ut për përfitime personale.

Duke kërkuar kompozime, ndonëse për këto ndërtime qysh para 10 vjetësh kishte ndalesë me vendim, porse ky vendim nuk është respektuar asnjëherë, prej asnjë institucioni.

Çështja në fjalë është ekskluzivisht kompetencë e Qeverisë, rrjedhimisht e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, sa i takon garantimit të kushteve të plota për punë të korporatës energjetike si dhe marrjen e masave dhe planifikimin për çfarëdo problemi me zonat e banuara përreth.

Për këto arsye dhe arsye të cilat do t'i prezantojnë edhe kolegët e tjerë ndërkohë, Grupi Parlamentar i Lëvizjes "Vetëvendosje" i propozon Kuvendit të Kosovës për miratim këtë mocion përmbajtjesor:

Në mbështetje të nenit 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 6.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës në seancën plenare të mbajtur më 4 maj 2017, miraton këtë:

REZOLUTË

1. Qeveria e Kosovës të lirojë zonën e veçantë nga ndërtimet e jashtëligjshme brenda 3 muajve në vijim.
2. Realizimi i planit nga ana e agjencive qeveritare për largimin e gjithë sasisë së djerrinës nga fronti i shfrytëzimit të thëngjillit jo më vonë se 6 muaj.
3. Të themelohet korporata publike e thëngjillit, së cilës do t'i barteshin ekskluzivisht të gjitha licencat për hulumtim dhe shfrytëzim të thëngjillit në Kosovë.

4. Të hetohen dhe të ndërmerren masa ligjore ndaj të gjithë atyre të cilët janë përfshirë në këtë rast, që prej atyre që kanë penguar zgjerimin e minierës e deri te ata që e kanë ndryshuar kahun e zgjerimit të saj.

Më lejoni të theksoj se kërkesa për këtë interpelancë është shtruar më 7 mars të vitit 2017. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Ftoj kryeministrin e Kosovës, zotin Isa Mustafa, që të paraqesë qëndrimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me çështjen e shkruar për interpelancë, zoti Mustafa, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Sa i përket kësaj interpelance, konsideroj që ekzistojnë arsytet që në Kuvend të diskutohet lidhur me këto probleme, sepse janë probleme të cilat po na preokupojnë çdo ditë.

Mirëpo sa i përket rezolutës të paraqitur në këtë interpelancë, mendoj se pikat e paraqitura në përgjithësi nuk nevojiten të jenë pjesë e kësaj rezolute.

Për arsye se afatet dhe metodologjia, e cila do të shfrytëzohet te shpronësimet dhe te zhvendosja e qytetarëve ndërlidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë në procedurat ligjore, prandaj ligji i përcakton këto dhe nuk ka arsye që procedurat të cilat janë të përcaktuara me ligj, t'i zëvendësojnë me rezolutë.

E dyta, sa i përket themelimit të korporatës publike të thëngjillit, themelimi i kësaj korporate është në harmoni me vendimet e Qeverisë dhe të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

Kjo formë e organizimit është përgatitur në bashkëpunim edhe në konsulentë me USAID-in, kjo do të thotë se Divizioni i thëngjillit është paraparë të ndahet nga Divizioni i prodhimit të energjisë, kurse në të ardhmen kjo korporatë do të furnizojë me thëngjill termocentralet publike dhe ato që themelohen me kapital privat.

Sa i përket masave ligjore që propozohen me rezolutë, ne jemi të informuar se Korporata Energjetike e Kosovës tashmë ka kohë që ka bërë kallëzime penale pranë organeve përkatëse për mosveprim të ndërtimit ilegal në zonën e interesit nacional, por po ashtu pajtohemi se këto veprime duhet të ndërmerren edhe në të ardhmen ndaj të gjithë atyre që kanë mundësuar këtë dhe që nuk i pengojnë këto veprime.

Më lejoni po ashtu të nënvizoj se në vendin tonë procedurat e marrjes së pronave ose të shpronësimeve për interes publik kryhen nëpërmes dy dokumenteve ligjore, që janë Ligji nr.

03/L-139 për shpronësimet e pronës të paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205 dhe me dokumentin Korniza e politikave për zhvendosje për zonën fusha e mihjes së re të Republikës së Kosovës, e miratuar me vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 10/22 të datës 6 korrik 2014.

Në zonën e Fushës Mihja e Re, ku bënë pjesë edhe fshati Shipitullë, komuna e Obiliqit, procedurat për shpronësimin e tokave për nevojat e interesit publik janë zhvilluar në bazë të dokumentit “Kornizat e politikave për zhvendosje”.

Sipas kësaj kornize, procedurat e marrjes së tokave, vlerësimit, kompensimit, ankesave, pagesave, buxhetit, afateve kohore, duhet të përshkruhen dhe të paraqiten në një dokument që quhet “Plani i veprimit për zhvendosje”.

Përgjegjëse për realizimin e zhvendosjes në këtë kornizë është Korporata Energjetike e Kosovës.

Ndërsa Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është përgjegjëse për miratimin dhe monitorimin e implementimit të planit të veprimit për zhvendosje pasi ky plan të përgatitet nga KEK-u.

Kërkesa për iniciimin e procedurës për zhvendosje, shpronësim për pronarët e patundshmërisë të fshatit Shipitullë, zona kadastrale Hade dhe Shipitullë, përkatësisht lagjet Bërbatovci, Krasniqi dhe Mirena të fshatit Shipitullë të Obiliqit, është paraqitur nga Korporata Energjetike e Kosovës pranë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor më 1 korrik 2014.

Ministra më 27 gusht të vitit 2014 ka nxjerrë vendimin për miratimin e kësaj kërkesë dhe e ka obliguar Korporatën Energjetike të Kosovës të hartojë planin e veprimit për zhvendosje, konform dokumentit që e thashë më parë, “Kornizës së politikave për zhvendosje” për zonën Fusha e Mihjes së Re të Republikës së Kosovës, e miratuar me vendimin e Qeverisë.

Në vazhdim dua të sqaroj se kur përmendet zona me interes të veçantë, duhet ta kemi të qartë se kjo zonë tejkalon projektin e Sibocit jugperëndimor, për të cilën debatojmë sot në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Standardet e reflektuara në politikat e kornizës për zhvendosje janë përgatitur nga Banka Botërore dhe janë harmonizuar me të gjitha palët e interesit në sektorin e energjisë.

Me përshkrimin e konstatimeve nga paraqitësit e kërkesës për interpelancë ka disa pasaktësi në krahasim me të dhënat që më janë prezantuar nga Korporata Energjetike e Kosovës dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, dhe në këto të dhëna konstatohet se nga regjistrimi i

objekteve në atë zonë janë evidentuar 206 objekte, prej të cilave rreth 150 prej tyre ose 150 prej këtyre konsiderohen se janë ndërtuar për qëllime përfitime.

Se Korporata Energjetike e Kosovës nuk ka importuar asnjëherë thëngjill, përkundrazi KEK-u planifikon një sasi, afërsisht 200 mijë tonë thëngjill për treg të vendit, përfshirë këtu edhe thëngjillin që KEK-u u ofron shkollave të komunës së Obiliqit dhe disa rasteve sociale në këtë komunë.

Sa i përket rrezikimit të banorëve, eksploatimi i thëngjillit nga Korporata Energjetike bëhet në bazë të planit të veprimit dhe teknologjisë eksploatuese, kjo do të thotë se duhet të respektohet distanca e lejuar me ligj për zonat e banuara.

Korporata Energjetike ka lajmëruar se ka ndaluar të gjitha veprimet e pajisjeve për heqjen e djerrinës dhe se po respekton distancën e lejuar me ligj për zonat e banuara, po monitoron rregullisht zonën dhe ka vlerësuar se nuk ka asnjë rrezik për banorët përreth.

Në zonën e interesit përgjegjëse për monitorimin e ndërtimeve në hallkën e parë është pushteti lokal, në këtë rast Komuna e Obiliqit, pastaj Ministria e Mjedisit.

Në rast se Komuna nuk ka kapacitet për monitorimin dhe inspektimin e ndërtimeve, ajo kërkon ndihmë nga pushteti qendror, pra nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, sikurse ka qenë rasti të fshatrat Shipitullë dhe Hade, kur në momentin që Komuna e Obiliqit ka deklaruar se nuk ka kapacitete dhe ka kërkuar mbështetje nga pushteti qendror, Ministria e Mjedisit ka ofruar mbështetje dhe ka angazhuar Inspektoratin për marrjen e veprimeve për ndalimin e ndërtimeve pa leje në këtë zonë të interesit.

Sa i përket planit të djerrinës, ky plan në vitin 2016 ishte 12 milionë e 500 mijë metra kub djerrinë dhe është realizuar 55,4%.

Sa i përket ndërtimeve, Korporata Energjetike pohon se ka raportuar rregullisht për ndërtimet spekulative që po bëheshin në atë zonë. Ndërtimet spekulative janë ndaluar në fillim të këtij viti, konkretisht më 7 mars 2017, kur Inspektorati i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në koordinim me institucione të tjera ka rrënuar disa prej këtyre objekteve.

Të nderuar deputetë,

Si përfundim, më lejoni të nënvizoj se për herë të parë në vendin tonë, por edhe në rajon janë aplikuar standardet nëpërmjet politikave të kornizës për zhvendosje sa i përket zhvendosjes së banorëve, të cilët janë mbështetur nga palët e interesit të sektorit të energjisë, përkatësisht edhe nga Banka Botërore.

Procesi është përgatitur dhe monitoruar në vazhdimësi nga kompanitë ndërkombëtare.

Tani Korporata Energjetike është në fazën përmbyllëse sa i përket zhvendosjes dhe janë marrë masat si në vijim. Është përgatitur Matrica e të drejtave, që është përfunduar më 27 shkurt. Kjo Matricë e të drejtave është shpalosur para banorëve të katër lagjeve të Shipitullës nga data 9 mars, në grupe dhe në mënyrë individuale.

Më 25 mars janë dorëzuar ofertat për paketën e kompensimit për banorët e zonës me prioritet.

Plani i veprimit të zhvendosjes ka përfunduar më 30 mars dhe i është adresuar Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ministria ka për detyrë të vlerësojë se a do të vazhdohet sipas kornizës apo sipas Ligjit për shpronësim, duke pasur parasysh interesin publik dhe interesin e qytetarëve.

Nga ministri unë jam i informuar se ministria u ka dhënë një përgjigje dhe ka kërkuar të bëhet plotësimi i këtij dokumenti për të marrë vendimin meritore ministria.

Dhe, po ashtu dëshiroj të shtoj se efikasitetin në implementimin e politikave të shpronësimit dhe të zhvendosjes dhe planifikimi i ekzekutimit me kohë do të jenë edhe kritere për mbështetjen e projektit Kosova e Re nga partnerët tanë ndërkombëtarë, veçmas nga Banka Botërore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër! Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së fjalën e ka zoti Bislim Zogaj.

BISLIM ZOGAJ: Realisht, unë isha përgatitur për të folur për ato, e tani kemi disa sqarime nga kryeministri. Kisha kërkuar që të veprohet sa më shpejt rreth shpronësimit të atyre pronave, që të mos vijmë në një kolaps energjetik dhe kjo si pasojë e mosveprimit, kur dihet që KEK-un e kemi edhe pa bord. Prandaj, kërkojmë që të merren masa sa më urgjente në shpronësimin e atyre pronave dhe të ecet përpara me prodhimin e thëngjillit.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Murat Hoxha e ka fjalën.

MURAT HOXHA: I nderuar kryesues i Kuvendit,
I nderuar kryeministër,
Kabinet qeveritar,
Deputetë të nderuar,

Interpelanca e thirrur nga Lëvizja “Vetëvendosje” gjithsesi është e drejtë kushtetuese dhe e bazuar në Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në fakt, kjo interpelancë paraqet vetëm një segment të përkushtimit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Planifikim dhe Ambient, përkatësisht Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë.

Dua t’jua rikujtoj hartimin dhe miratimin e Ligjit për Obilqin nga ky Kuvend. Iniciativa e Komisionit për zgjedhjen e problemeve të zhvendosjes së Hades dhe formimi i grupit për hartimin e Ligjit për Haden. Gjithsesi, përpjekjet e Qeverisë janë të mëdha dhe më konkrete, meqë me vendimin nr. 02/57 shpallet zonë me interes të veçantë fusha e mihjes së re, me një sipërfaqe prej rreth 150 km², e si rezultat i këtij vendimi është hartuar plani hapësinor 2010-2020, zona me interes së veçantë - fusha e mihjes së re. Në kuadër të këtyre përpjekjeve është miratuar edhe Ligji për shpronësimin e pronës së paluajtshme, ku në mënyrë të detajuar janë paraparë procedurat e shpronësimit.

Megjithatë, ne ende nuk e kemi një legjislacion adekuat për trajtimin e zhvendosjes së popullsisë, kështu që Qeveria, respektivisht Ministria për Ambient dhe Planifikim, e ka hartuar kornizën e politikave për zhvendosje, që reflekton praktikën dhe standardet ndërkombëtare për mbrojtjen, kompensimin dhe kushtet e zhvendosjes së popullsisë.

Sigurisht që zhvendosja është paraqitur si sfidë kryesore edhe në planin hapësinor për zonën me interes të veçantë të rreth 4 mijë banorëve në rreth 900 njësi banimi të fshatrave Hade, Lajthishtë, Shipitullë dhe Siboc, duke i ruajtur specifikat e komunitetit në kuptimin fizik të ndërtimit të shtëpive, duke marrë parasysh elementin ekonomik e social, zhvillimin e bizneseve, kompaktësinë familjare, e të tjera.

Gjatë takimeve të grupit në kuadër të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Ambient dhe Planifikim kemi identifikuar që prioriteti duhet të jetë zhvendosja e banorëve të Hades, zonë e cila është rrezikuar, ndërsa prioriteti i shfrytëzimit të qymyrit do të jetë Siboci, pjesa jugperëndimore, dhe Siboci i Ri, në vazhdim të pjesës veriore të Bardhit dhe Mirashit.

Zhvendosja e përgjithshme e popullsisë bazohet në zhvillimin dhe avancimin e mihjes së re mbi projektin e aprovuar dhe sipas planit dinamik për zhvendosje, në afatin kohor dhe përgjegjësitë e caktuara, të hartuara nga investitorët në bashkëpunim me Qeverinë. Sipas planit dinamik të parashikuar në planin hapësinor të zonës parashihet që deri në vitin 2020 të zhvendoset tërësia e mbetur e fshatit Hade dhe pjesa e fshatit Shipitullë, kurse pas vitit 2020, në varësi të zhvillimit të projekteve, duhet të vazhdojë zhvendosja e vendbanimeve tjera në fushën e re të mihjes së fshatit Siboc dhe Lajthishtë, apo Leshkoshiq.

Problemet me ndërtimet pa leje përfshijnë krejt territorin e Kosovës dhe për këtë arsye është miratuar Ligji për legalizimin, i cili tani është në proces të ndryshimit, por gjithsesi do t'i trajtojë edhe këto ndërtime si të ligjshme, apo në kundërshtim me ligjin. Sigurisht se korniza e politikave për zhvendosje do ta ketë parasysh aspektin social të banorëve të këtyre shtëpive.

Rezoluta e propozuar nga Grupi Parlamentar “Vetëvendosje” nuk paraqet përmbajtje të harmonizuar me planin hapësinor dhe dinamika e paraparë në këtë plan për zonën e veçantë Mihja e Re nuk është në përputhje me planin e veprimit të kompanisë. Sigurisht që zgjidhja e çështjeve është më komplekse, ndërsa aktorët kryesorë janë KEK-u, komuna e Obiliqit dhe Qeveria. Vlerësojmë që nga Qeveria duhet të merret nisma për:

1. Hartimin e Ligjit për zonën me interes të veçantë Fusha e Mihjes së Re, i cili rekomandim është i përfshirë edhe me planin hapësinor të zonës.
2. Qeveria ta themelojë një komision ndërministror, i cili do të kujdeset për cilësinë e planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të zonës me interes të veçantë - Fusha e Mihjes së Re.
3. Qeveria të raportojë në baza vjetore në Kuvendin e Republikës së Kosovës lidhur me progresin e realizimit të planit të veprimit në kuadër të dinamikave të parapara të planit hapësinor të zonës me interes të veçantë Fusha e Mihjes së Re. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, fjalën e ka zoti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Mendoj që në këtë interpelancë po e diskutojmë një çështje, jo vetëm të rëndësishme për Republikën e Kosovës, si shtet dhe ekonomi, por po ashtu edhe shumë urgjente. Në këtë drejtim konsideroj që kjo qasje që e dëgjuam nga kryeministri Mustafa, me një shpërfillje goxha të madhe të kësaj urgjence, mendoj që është shumë problematike, sepse në njërin anë po e shpërfillë një çështje prej së cilës rrezikojmë shumë shpejt të mbetemi në një, ta quaj kështu “o kolaps energjetik, o rritje alarmante të çmimit të energjisë elektrike”, por në anën tjetër është edhe shpërfaqje e mënyrës se si ka vepruar kjo Qeveri karshi interesave të vendit, e natyrisht se sistemi energjetik paraqet një prej interesave madhore të këtij vendi, duke pasur parasysh edhe pozicionin ekonomik në të cilin jemi, por duke pasur parasysh edhe resurset të cilat i kemi.

Mendoj që në këtë pikë shihet qartë sesi Qeveria shpërfill interesin publik. Pra e shpërfill interesin publik në kuptimin që nuk ndërmerr masa emergjente karshi një situatë emergjente dhe kështu disi në njëfarë mënyre, kryeministri në fjalën e vet pak a shumë tentoi të shfajësohet se

një pjesë e përgjegjësive i takon Korporatës së Energjisë së Kosovës, një pjesë tjetër i takon Ministrisë së Planifikimit Hapësinor, që i bie praktikisht që asnjë pjesë e përgjegjësive nuk i takon kryeministrit. Pra, kjo është një logjikë, një mendësi jashtëzakonisht e dëmshme në politikë, ku për çdo herë e më shumë po shtohet ky lloji i politikanit, i cili do vetëm privilegje nga pushteti, por asnjëherë përgjegjësitë, që është problem madhor.

Dhe, në anën tjetër, është edhe dëmtim i potencialit zhvillimor të kompanisë publike. Pra, me këtë shpërfillje të interesit publik, e veçanërisht të interesit të kompanisë publike të Korporatës Energjetike të Kosovës, në njëfarë mënyrë shpërfaq edhe një dimension tjetër të qeverisjes ose mendësisë së qeverisjes, që e kemi të instaluar aktualisht, e që nuk është e vetmja dhe as e para në Republikën e Kosovës, pra është vazhdimësi e qeverive të kaluara, me të cilën qëllimisht shpeshherë dëmtohet interesi i kompanisë publike, në mënyrë që kjo pastaj të bëhet edhe lehtë e shijshme, edhe të paraqitet në sytë e qytetarëve më shumë si barrë, sesa si pasuri. Mendoj që edhe këtu në këtë rast, po jo vetëm në këtë rast, karshi Korporatës Energjetike të Kosovës po e shohim një qasje të tillë, një tendencë të tillë, sepse në momentin kur Korporata Energjetike e Kosovës nuk mund ta shfrytëzojë thëngjillin e Kosovës, atëherë ai obligohet ose detyrohet t'i bëjë dy gjëra, ose dy prej mundësive. Në njërin anë, o të importojë thëngjill, që pastaj bëhet njëfarë ndërmarrjeje jashtëzakonisht, edhe e pamundshme, por edhe e shtrenjtë e problematike për Republikën e Kosovës, o në anën tjetër ta mbyllë e të mos gjenerojë më fare energji elektrike, që i bie të importojmë energji elektrike nga jashtë, e ne e kemi parë në shtator të vitit 2014 se çka nënkupton për xhepin e qytetarit të Kosovës, çka nënkupton për ekonominë e Kosovës importi i energjisë elektrike nga jashtë.

E këto dy mundësi, asnjëra prej tyre, nuk janë as të dobishme për Kosovën, e as për Korporatën Energjetike të Republikës së Kosovës. Prandaj, mendoj se jo vetëm që është e drejtë kjo rezolutë që e kemi paraqitur, por edhe është e domosdoshme që në kushte kur Qeveria e shpërfill interesin publik, atëherë do të duhej që Kuvendi të ndërmarrë masa urgjente, në mënyrë që ta detyrojë Qeverinë që ta përfillë këtë interes publik, sepse, tek e fundit, ne këtu e përfaqësojmë këtë interes për të mirën e përgjithshme, ose thënë më mirë - do të duhej që ta përfaqësojmë këtë interes.

Konsideroj që kjo rezolutë e paraqitur, por edhe çështja, do të duhej të merrej me shumë më shumë seriozitet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, sepse kolapsi energjetik natyrisht që edhe po na kërcënon vazhdimisht, por edhe është një çështje për të cilën duhet t'i investojmë të gjitha mundësitë në mënyrë që të mos lejojmë të ndodhë. Në këtë drejtim, konsideroj që Qeveria e Republikës së Kosovës, prapë po e përsëris, jo vetëm kjo, por edhe qeveritë e kaluara, edhe pse vazhdimisht kanë folur sesi energjia është prioritet i zhvillimit ekonomik në Republikën e Kosovës, asnjëherë këtë nuk e kanë materializuar në vendime dhe në politika të qeverisjes, e po shihet që as kjo Qeveri nuk e ka këtë qëllim.

Prandaj, edhe një herë ju bëj ftesë të gjithëve që jo vetëm ta votojmë këtë rezolutë, por edhe ta plotësojmë nëse e shihni të udhës që ta plotësojmë, por në asnjë mënyrë të mos sillemi me kaq indiferencë karshi një problemi madhor që po na ndodh në Republikën e Kosovës, sepse ky problem do t'i prekë të gjithë qytetarët, përfshirë edhe ne si deputetë, përfshirë edhe ekonominë tonë në përgjithësi, por përfshirë edhe shtetin tonë si Republikë e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Rrustem Berisha, në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, e ka fjalën.

RRUSTEM BERISHA: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Ne si Aleancë e kemi vizituar KEK-un, fshatin Siboc, Shipitullë. Kemi biseduar me përfaqësuesit e Komunës së Obiliqit, Ministrinë e Planifikimit Hapësinor dhe bashkë me KEK-un kemi dalë në vend të ngjarjes, në fshatin Shipitullë, ku jemi njoftuar me problematikën. Mendojmë se është një problem mjaft serioz dhe në zonën e shfrytëzimit të KEK-ut ka ndërtime pa leje të shtëpive për përfitime personale edhe pasi ajo është shpallur si zonë e interesit të veçantë, ose zonë e shfrytëzimit të KEK-ut.

Gjatë vizitës në fshatin Shipitullë thjesht kemi vërejtur se ekzistojnë disa banorë që vërtet kanë banuar më herët aty, por nga përshtypja e parë dalloheshin edhe shtëpitë ku nuk banon askush, por që janë ndërtuar vetëm për përfitime personale.

Në bisedë e sipër me përfaqësues të KEK-ut, të Komunës, të Ministrisë së Planifikimit, shihet qartë se aty ekziston një moskoordinim ose mosmarrje e përgjegjësisë kush është përgjegjës për parandalimin e këtyre dukurive natyrore. Secili në formën e vet mundohet ta përcjellë fajin te pala tjetër. Ne konsiderojmë se situata aty është tepër alarmante, krimi po lulëzon me të madhe dhe Qeveria duhet patjetër t'i thërrasë edhe përfaqësuesit e KEK-ut, të ministrisë, pastaj të Komunës së Obiliqit dhe t'i marrë masat urgjente për parandalimin e kësaj dukurie, e cila vërtet është tepër shqetësuese. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar "Nisma", zoti Berisha e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Natyrisht se po flasim për një çështje të rëndësishme dhe është në pyetje pasuria nacionale, por unë do të ndalem vetëm te një segment, i cili mendoj se është pengesa kryesore, që i ka ngushtuar hapësirat e veprimit të KEK-ut në atë pjesë, pra në Minierën e Sibocit.

Çështja është se qysh para dhjetë vjetësh dihet plani strategjik i shtrirjes së kësaj miniere, por edhe të dhënat që jepen këtu për ndërtimin e shtëpive veçanërisht, e besoj se edhe parafolësi e ka

hallin aty, se këtu krimi i organizuar, njerëzit që janë të lidhur me hallkat e krimit të organizuar në pushtet, edhe në rastet tjera, por edhe në këtë rast, mendojnë ta shfrytëzojnë dhe të përfitojnë nga shpronësimet, sepse në rast se, ta zëmë, para dhjetë vjetësh në atë zonë ka pasur 60 shtëpi, e tash ka 260 shtëpi, kur pjesa dërmuese e atyre shtëpive janë të pabanuara, por janë ndërtuar për ta rritur koston e shpronësimit, kjo nënkupton se Qeveria me qëllim, edhe tash, edhe në të kaluarën, nuk ka ndërmarrë hapa.

Arsyetimi i Isa Mustafës si kryeministër në këtë rast, me gjakftohtësi ekstreme, duke u thirrur në ligje dhe në procedura, mendoj se krijon hapësirë edhe të mëtejme që njerëzit e papërgjegjshëm të shfrytëzojnë momentume të caktuara për përfitime personale në kurriz të pasurisë publike dhe të buxhetit të shtetit tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdojmë me të paraqiturit nga deputetët. Zoti Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryesues!

Së pari, unë jam i befasar me qëndrimin hipokrit ndaj problemeve që e ngarkojnë nevojën e komuniteteve dhe në përgjithësi të popullatës së Kosovës që i bën edhe Qeveria, por edhe një pjesë e deputetëve, duke e anuluar Ligjin për miniera dhe minerale, e kjo temë që sot po e bisedojmë i dedikohet këtij problemi, se nuk është i ndarë si problem, por është i ndërlidhur që të përfitojë komuniteti.

Zona e Obiliqit, të gjithë jemi të vetëdijshëm që industria energjetike e Kosovës është shumë me rëndësi, por ekspozimi ose gjendja e popullatës në atë regjion është e papranueshme. Do të thotë, si komunitet u ekspozohet problemeve, të cilat janë të papranueshme. Shkelen të drejtat e njeriut, është ambient i dëmtuar, është perspektiva e munguar, nuk kanë as shkolla, as shëndetësi, as rrugë, as ajër dhe ai komunitet duhet të jetë shqetësuar për të gjithë ne.

Në anën tjetër, nëse shihet zhvillimi energjetik i Kosovës, kjo Qeveri po e maskon situatën. Republika e Kosovës është në kolaps energjetik. Zoti kryeministër, popullit duhet t'i tregoni - nuk është KEK-u dhe Bordi i KEK-ut përgjegjës për problemet strategjike, por jeni ju, kryeshërbyesi i të të gjitha institucioneve publike që të tregoni se Kosova është sot në kolaps energjetik.

Po e them dhe publikisht po ju ftoj nëse mund të na demantoni do të ju kërkoj falje publike prapë në këtë foltore. Blloqet do të hyjnë në remont të detyrueshëm dhe Kosova do të mbetet me 300 megavatë rrymë elektrike në vitin 2018. Prandaj, ne do t'i ekspozohemi lojës që në atë formë që ka tentuar Serbia të ndikojë mbi Kosovën politikisht, ushtarakisht, të ndikojë të na sundojë nga aspekti ekonomik nëpërmjet luftës energjetike.

Në këtë formë, eksploatimi i qymyrit që bëhet, ne jetojmë mbi energjinë, ndërsa asnjëherë nuk është treguar në mënyrë strategjike, sepse ndërkombëtarët, menaxhimi i ndërkombëtarëve që e kanë bërë një strategji nga viti '99 ka qenë një bashkëdyzim, ose një bashkëveprim me persona të cilët KEK-un e kanë pasur si shfrytëzues për interesa personale, duke filluar edhe nga mungesa e strategjisë për ndërtimin e atij KEK-u. Me aq sa është investuar do të ishin bërë dy KEK të tjerë. Sa është rinovuar do të ishin bërë dy KEK të tjerë. Eksploatimi i qymyrit, nëse me ligjin që sot ju, zoti kryeministër, u keni thënë deputetëve të LDK-së të mos e votojnë, edhe një pjesë që quhen institucionalistë, që populli e di kush ka votuar kundër, pa e ditur pse s'po votojnë. Ajo popullatë duhet të përfitojë, sepse është e ekspozuar. Ligji i Obiliqit është i paimplementueshëm. Ne e kemi miratuar këtu, ai është kundërthënës i veprimeve që ne ndërmarrim. Prandaj ju duhet të dilni e të thoni "ne po bëjmë ligje mashtruese, fiktive, që nuk janë të implementueshme". Këtu nuk ka ndonjë inat, nuk ka ndonjë interes personal.

Prandaj, perspektiva jonë është e cunguar me qëndrimet që po i bëjmë ne vetë. Qëndrimet, duke filluar nga Qeveria, që s'e ka një strategji, gjendja ekonomike maskohet vazhdimisht me parametra fiktivë dhe ajo praktikë do të na tregojë, tregon edhe situata ekonomike në popullatë. Prandaj, ne nuk kemi nevojë të maskojmë asgjë. Ne nuk e kemi marrë në pronësi Kosovën që ta kemi e të mburremi në aspektin personal. Nëse nuk jemi të aftë, ne duhet të lëvizim nga postet, do të vijë sovrani që do t'i zgjedhë ata që janë të aftë për ta kuptuar, edhe se si shfrytëzohet qymyri, edhe se si garantohet energjia, edhe se si ruhet ambienti, edhe se si ruhet perspektiva. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Zoti kryeministër,
Zëvendëskryeministër,
Kolegë deputetë,

Unë po e them që në fillim se në mesin e atyre që i kanë takuar përfaqësuesit e punëtorëve jam edhe unë në emër të Grupit Parlamentar dhe pa dyshim se ne i mbështetim të gjitha shqetësimet e mundshme që mund t'i kenë punëtorët për faktin se mund t'u rrezikohet vendi i punës, sikundër që normalisht shfaqim shqetësimin tonë edhe për gjendjen, rrezikimin eventualisht të jetës së banorëve në atë pjesë.

Por, ajo që dua të them në fillim është që ne, të nderuar kolegë, këtij problemi duhet t'i qasemi nga ajo që ta analizojmë nëse e kemi apo s'e kemi infrastrukturën e nevojshme ligjore dhe nga ajo që u tha, nuk është se mungon kjo infrastrukturë ligjore. Çka mungon, nëse mungon, në këtë drejtim? Cilat janë veprimet mundësitë që, po ashtu, me ligjet ekzistuese, siç ishte plani hapësinor 2010-2020, pastaj me udhëzimin, përkatësisht vendimin për shpalljen e zonës me interes të veçantë, siç është Fusha e Mihjes së Re. Nëse i kemi këto dhe ligjet tjera, çfarë po

mungon që s'po punohet e s'po veprohet, a ka hapësirë për veprime në këtë drejtim dhe e vetmja mënyrë është që ne mund ta obligojmë Qeverinë e Republikës së Kosovës nëpërmjet ligjeve që ne i kemi nxjerrë, apo që duhet t'i nxjerrim, sepse Qeveria e Republikës së Kosovës në asnjë rrethanë tjetër nuk mund të obligohet për të bërë diçka që del jashtë suazave, jashtë mundësive dhe jashtë obligimeve ligjore që i ka.

Prandaj, ne jemi dakord që Qeveria t'i kryejë obligimet, duhet t'i kryejë obligimet, por ato që i ka të përcaktuara, ato që e obligon Kuvendi. Sigurisht që nuk them se rezoluta nuk obligon, por megjithatë asnjë rezolutë nuk duhet, as s'mund të jetë e nxjerrë në kundërshtim eventualisht me ligjet që janë në fuqi, e aq më tepër me planin hapësinor, që ne tashmë e kemi për atë pjesë, që është një sipërfaqe dhe një hapësirë më e madhe se zona, ose pjesa që ka të bëjë me Sibocin.

Prandaj, ne duhet të kemi kujdes. Unë i kuptoj edhe vlerësimet politike. Këtu nuk duhet bërë vlerësime politike sa duhet bërë propozime dhe vërejtje konkrete në zbatueshmërinë, ose moszbatueshmërinë e asaj që është shifër strukturë ekzistuese ligjore. Edhe një herë po e përsëris, çfarë ne duhet të bëjmë në aspektin e kompletimit të infrastrukturës, nëse s'e kemi bërë deri tani, por në asnjë rrethanë nuk mund të kërkojmë as obligime, ose përgjegjësi nga ata nëse këto obligime nuk janë të përcaktuara në mënyrë taksative me ligjet tona.

Gjithsesi, unë mendoj se pikërisht në vendime të tilla të rëndësishme, që kanë një kohë të gjatë të zbatimit ose të moszbatimit, por që kanë procedura, duhet të kemi edhe gjakftohtësi edhe racionalitet dhe veprim ligjor, sepse nën ndikimin, pavarësisht të problemeve dhe emocioneve që mund të jenë probleme të natyrës së tillë, ne nuk mund të veprojmë jashtë normave të përcaktuara ligjore.

Fatkeqësisht, është një procedurë e cila merr kohë shumë më tepër, e të gjithë ne, ose shumica prej nesh, e dimë se çështja e shpronësimeve është procedurë që kërkon veçmas edhe zbatim ligjesh, edhe kërkon kohë, edhe kërkon mjete materiale.

Prandaj, edhe si grup parlamentar, nga kolegu im i nderuar, zoti Hoxha, i dhamë ato që ne mendojmë që aktualisht do të duhej bërë, në mënyrë që ne ta bëjmë një hap më tej, në kuptimin e intensifikimit të veprimeve karshi nevojave për mbijetesën, nëse mund të themi, dhe vazhdimin e punës së punëtorëve në atë pjesë, gjithsesi duke pasur parasysh edhe interesin e punëtorëve që janë në atë pjesë, por që gjithsesi ligjet janë ligje që ne duhet t'u nënshtrohemi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Mytahir Haskuka e ka fjalën.

MYTAHER HASKUKA: Faleminderit!

Të nderuar qytetarë të Republikës,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Propozimet politike e këto rekomandime që janë paraqitur në këtë interpelanca, janë për mbrojtjen e interesit publik, ashtu që të mos vijë deri te ndërprerja e prodhimit të energjisë në termocentralet Kosova A dhe B dhe që të kemi një vazhdimësi të furnizimit me rrymë elektrike, edhe pse e parregullt, por të mos ndalet fare, prandaj këto nuk janë propozime politike, sa unë po shoh, por janë propozime konkrete se çka duhet të bëjë Qeveria për mbrojtjen e interesit publik.

Si në shumë raste, edhe në shembullin e minierës së Sibocit ilustron joseriozitetin e qeverisjes, mospuna dhe korrupsioni që shfaqen në mungesën e vetëdijes shtetformuese të partive qeveritare.

Kjo mungesë e vetëdijes shtetformuese transformohet si krim pushtetar ndaj pronës publike dhe përfitimeve personale, prandaj edhe kemi dy vendime, një në vitin 2004 që zona e minierës së Sibocit të jetë zonë e veçantë ekonomike, ku nuk bën të ketë çfarëdo aktiviteti ekonomik, pastaj e kemi edhe vendimin e vitit 2009, që të ndalohet çfarëdo aktiviteti ekonomik në këtë zonë. Por, prapëseprapë në këtë zonë kemi ndërtim të shtëpive, ku numri i shtëpive apo ndërtimeve të objekteve të ndryshme pa leje, nga 50-60 ndërtime në vitin 2004, ka kaluar në 260 në vitin 2016.

Kjo rritje e dukshme e numrit të shtëpive me rreth 500% në këtë zonë, apo pesëfishimi i shtëpive në këtë zonë, nuk mund të shpjegohet me bukuritë natyrore të kësaj zone, apo nga ajri i pastër, as nga uji i pijshëm, por kjo rritje e popullsisë paraqet një korrupsion, i cili kalon nga strukturat ose institucionet komunale dhe udhëheqësit e KEK-ut dhe të ministrisë, të cilët i këshillojnë fshatarët që të rrezikojnë jetën e tyre, që të rrezikojnë pasurinën e tyre për një përfitim hipotetik në rast të kompensimit kur këto objekte pa leje të merren nga ata.

Ky mentalitet shkatërrues rrezikon jo vetëm jetën e qytetarëve, pasurinën e tyre, dëmton financiarisht shtetin, por në të njëjtën kohë rrezikon edhe zhvillimin ekonomik, nga se së shpejti minierat ekzistente të linjitetit do të shteren, e në anën tjetër, miniera e Sibocit nuk është gati për eksploatim.

Kjo do të rrezikojë prodhimin e energjisë elektrike nga termocentralet Kosova A dhe B dhe, si na është thënë, në 17 vjetët e fundit që nuk mund të ketë investime dhe prodhimtari nëse nuk ka energji të rregullt elektrike, ose furnizim të rregullt me energji elektrike, në Kosovë jo vetëm që nuk do të kemi furnizim të rregullt me energji elektrike, por nuk do të kemi energji elektrike fare apo do të kemi energji elektrike shumë më të shtrenjtë se ajo që është, e që momentalisht është energjia më e shtrenjtë në rajon.

Sipas programit për zbatimin e strategjisë së minierave të Kosovës për periudhën 2015/2017 të Qeverisë për të pasur menaxhim efikas të infrastrukturës dhe personelit mbështetës duhet të ndërtohen objekte të KEK-ut për personelin në këtë zonë, në mënyrë që të bëhet transferi i personalitetit të prodhimit të mirëmbajtjes në drejtim të Sibocit.

Pra, derisa ky objekt nuk është përfunduar, aty kanë përfunduar me qindra objekte pa leje.

Në këtë aspekt, kjo mungesë e vetëdijes qeverisëse shihet gjithkrah, jo vetëm në aspektin, në këtë rast, por edhe në shumë ndërtime infrastrukturore që janë bërë më herët, si për shembull, autostrada “Ibrahim Rugova” kalon vetëm 3 kilometra nga qendra e Prizrenit, por për t’u kyçur në këtë autostradë qytetarëve u duhen 11 kilometra rrugë, duke kaluar nëpër zona të ndryshme vetëm se disa persona të lidhur me pushtetin është dashur të kompensohen për kalimin e autostradës ose që pronat e tyre të lidhen me rrugën më të shtrenjtë në Evropë.

Ky mentalitet grabitës ndaj pronës publike për shkak të interesit privat na ka bërë që të kemi jo vetëm autostradat më të shtrenjta në Evropë, por edhe rrymën më të shtrenjtë në rajon, arsimin më të dobët në Evropë, papunësinë dhe varfërinë më të lartë në Evropë, prandaj në mënyrë që këto të ndalen duhet që ky Kuvend të marrë vendime, të cilat janë në interes të mbrojtjes së qytetarëve ose interesit publik.

Dhe, këto rekomandime, siç thamë edhe më herët, janë për të mbrojtur interesin publik, pra që KEK-u të vazhdojë punën dhe të mos ndalet prodhimtaria e energjisë elektrike, të mos kemi import të energjisë elektrike dhe të mos kemi import të thëngjillit, ndoshta. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Tërmkollli e ka fjalën. S’është këtu. Atëherë zoti Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar zoti nënkryetar i Kuvendit,

Zoti kryeministër,

Zëvendëskryeministra,

Kolegë deputetë,

Mendoj se çështja e menaxhimit të pronave publike dhe krijimit të kushteve për shfrytëzimin e thëngjillit është një çështje mjaft e ndërlikuar, për shkak se me dekada është lënë pas dore dhe me dekada janë bërë probleme. Dhe, natyrisht, kur grumbullohen problemet, ato do t’i vështirësojnë zhvillimet rreth KEK-ut dhe zhvillimet rreth të drejtave të njeriut, problemet mjedisore e të gjitha këto janë probleme të një kohe të gjatë.

Dhe, për çudi, ne tash i aktualizojmë këto probleme, në vend që të ishim marrë dhjetë vjetët e fundit me to.

Nuk janë këto probleme të reja, këto janë diskutuar. Nuk po flas këtu për këta që e kanë iniciuar interpelancën, mirëpo për njerëz se harrojnë dhe mendojnë që vetëm këto dy vjet janë paraqitur problemet, pak a shumë për mua tingëllojnë çuditshëm.

Ekziston një histori e kësaj pune, ekzistojnë diskutimet që janë bërë për këtë punë dhe ekzistojnë qëndrimet e aktorëve të caktuar lidhur me këto çështje.

Prandaj, në qoftë se dikush do ta fshijë kujtesën historike, ato nuk mund të fshihen. Ato janë evidente, janë të shënuara dhe dihet gjithçka se si është zhvilluar situata.

Mirëpo, retorika dhe mospajtimet tona fatkeqësisht nuk i ndihmojnë zgjidhjes së problemeve.

Ne duhet të shohim, problemi është këtu, duhet të ecim përpara në bazë të ligjeve dhe duhet t'i zgjidhim problemet.

Unë plotësisht pajtohem me pikën 3 të kësaj që është thënë këtu.

Duhet të shihet kush ka bërë atje dallavere me prona, kush ka ndërtuar pa leje, cilat janë ato grupe të interesit që e mbajnë peng zhvillimin dhe këto duhet t'i bëjnë organet e caktuara.

Fatkeqësisht ne vetëm mund të apelojmë këtu, por organet e caktuara duhet të tregojnë një efikasitet më të madhe në trajtimin e këtyre problemeve.

Sa i përket çështjes se a është Kosova në kolaps energjetik, unë mendoj se, në qoftë se nuk realizohen planet që janë, mund të vijë në vështirësi energjetike. Por aktualisht dëshiroj ta informoj këtë Kuvend se Kosova vitin e kaluar ka prodhuar 6,7, gati 7 % më shumë energji se një vit më parë dhe prodhimi i energjisë vitin e kaluar është prodhimi më i mirë që e kemi pasur ndonjëherë këto vitet e fundit për energji.

Prandaj, problemet duhet t'i themi aty ku janë.

E dyta. Sa i përket përkujdesjes për komunitete nuk është mirë kurrkush të tregojë këtu protagonizëm, për arsye se problemi i komuniteteve dhe problemi i përdorimit të rentes minerare për nevoja të komuniteteve është trajtuar shumë mirë në ligjin që do të vijë tash, në Ligjin për miniera e minerare, me grupin punues që e ka udhëhequr deputetja Sala Berisha-Shala, ku ka edhe anëtarë të tjerë, është zgjedhur shumë mirë dhe në harmoni me ligjin dhe Ligjin mbi financat.

Prandaj, mendoj që çështjet në atë drejtim nuk do të kenë probleme dhe për herë të parë Kosova do të thotë se orienton një pjesë të rentes te komunitetet minerare në harmoni me ligjin dhe me Kushtetutën. Prandaj janë disa çështje që ne duhet t'i kanalizojmë, duhet të kërkojmë përgjegjësi, duhet të kërkojmë më shumë efikasitetet në kryerjen e këtyre punëve dhe ne shpresojmë se do të përfundojnë me sukses bisedimet rreth "Kosovës së Re", të cilat më duket se janë duke përfunduar, ku trajtohen në mënyrë shumë të përgjegjshme edhe problemet e zhvendosjes së

popullatës dhe të mjedisit në mënyrë moderne dhe në bashkëpunim me ligjin e ri për minierat dhe ligjet hapësinore. Mendoj se kjo çështje mund të menaxhohet, por praktikisht janë disa probleme që kërkojnë një përgjigje urgjente dhe unë besoj që edhe Ministria e Planifikimit Hapësinor, edhe Qeveria këto çështje po i trajtojnë dhe do t'i trajtojnë në kohën optimale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Tërmkolli, meqenëse nuk ishte më parë këtu, le ta marrë fjalën. Në rregull, le ta marrë fjalën Shaipe, për të bërë replikë, nëse ia ka përmendur emrin.

SHAIP MUJA: I nderuar nënkryetar,

Unë thashë këtu, edhe parafolësi zoti Muhamet Mustafa, se unë nuk po gaboja që po them Qeveria e "Riinvestit", ka edhe arsyetim që ne jemi duke e bërë ligjin, e s'po ta pranojmë ligjin e 6 deputetëve, që 6 muaj qarkullon këtu, nuk ka arsyeshmëri, ti bën ligje dhe plotëson vazhdimisht, por para komunitetit ti nuk ke asnjë arsyeshmëri për punën e rentes minerale.

Problemi i kolapsit energjetik, kur po them se kjo seancë nuk është e mjaftueshme për t'i dhënë notën, kur thashë që në remont të detyrueshëm do të futet, ndërsa ne jemi të obligueshëm, e ai remont do ta qesë në kolaps energjetik Kosovën. Ne dhe qytetarët që po na dëgjojnë do ta kuptojnë qartë se kush kanë qenë ata që kanë ndërtuar perspektivën energjetike. Edhe okupimin dikush prej Serbisë e ka menduar ndryshe, por tash po bëjnë mekanizma, sepse kur të kapet në energji dikush, ti s'ke as pavarësi, as zhvillim, as ekonomi, asgjë tjetër. Prandaj, më vjen keq që po mundoheni të jepni arsyeshmëri.

Renta minerale u ka takuar si është miratuar Ligji i Obilijit.

Pse s'po del të tregosh se Ligji i Obilijit është i paimplementueshëm, në disa nene, Ligji i Trepçës është i paimplementueshëm, por bëheni këtu filozofë, të cilët mundoheni të na bëni neve arsyeshmëri, të cilat i komentoni si politike, interesa personale ose kauza të paqena.

Prandaj sot Kosova më shumë se realizëm, se pragmatizëm, nuk kërkon.

Realizëm e pragmatizëm, por jo filozofi, prej dominimit të emërimeve fiktive edukative. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Mustafa, kundërreplikë, një minutë e ke.

MUHAMET MUSTAFA: Paj, thënë të drejtën, u mendova a të përgjigjem apo jo, sepse kjo kakofoni dhe përzierje e koncepteve dhe një mbështjellje e shumë problemeve që një njeri i ka në kokë, nuk meritojnë as përgjigjeje, por ekziston opinionimi dhe duhet nganjëherë të përgjigjesh.

Renta minerare dhe përdorimi modern i rentes minerare për interes të komunitetit është iniciuar në komisionin përkatës dhe është duke u trajtuar në mënyrë shumë të rregullt, në mënyrë sistematike dhe në interes më të mirë publik dhe interes më të mirë të komuniteteve.

Të gjitha të tjerat janë spekulime dhe protagonizëm, për arsye që mua s' më interesojnë, por gjithkush mund t'i mbajë për veti.

E dyta. Ato fobi që dikush i ka prej një institucioni shumë të suksesshëm, kompetent, që asnjëherë nuk ka shkuar në dëm të interesit publik, ato le t'i mbajë për vete dhe mund të rrijë me to, mund të frikësohen gjithë natën prej "Riinvestit", por ajo veç do t'ua rrisë frikën dhe

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Tërmkolli e keni fjalën.

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit! Shaip, ruaju se ke, ruaju edhe pak se ke ende kundër-replika, mos ke dert!

Të nderuar deputetë,

Unë do të hap këtu një çështje, një temë, për të cilën nuk kam konfirmime të plota, por kam shumë informacione nga zyrtarë më të lartë të KEK-ut që Banka Botërore, me disa institucione po planifikon që kompensimin e pronave të qytetarëve të Sibocit ta bëjë me tokën në Bardh të Madh.

Unë mendoj që kjo, në fakt, jo vetëm që unë mendoj, por është edhe një realitet dhe diçka tërësisht e papranueshme, sepse në qoftë se ato toka të Bardhit të Madh, të cilat janë eksproprijuar, nëse rifunksionalizohen, atëherë duhet t'u kthehen pronarëve të tyre, në radhë të parë, siç është një rend e rregull, pra pronarëve të mëhershëm të Bardhit të Madh, e jo dikujt tjetër.

Kam frikë se nga përpjekja për të zgjidhur ndonjë problem të natyrës së caktuar, siç është rasti me zhvendosjen e qytetarëve, të një pjese të caktuar atje në Obiliq, në fakt po krijojmë probleme të reja me mundësi edhe të shfaqjes së konfliktit, gjë që jam shumë e bindur se diçka e tillë nuk guxon të lejohet të ndodhë.

Sigurisht se prona, shpronësimi dhe zhvendosja e qytetarëve do të bëhet në bazë të standardeve, rregullave ligjore dhe ligjeve që janë të përcaktuara dhe të miratuara.

Unë kërkoj edhe nga Banka Botërore, edhe nga Qeveria që të kenë shumë kujdes në çështjen, të cilën e shtrova më herët, që kompensimi i pronave nuk mund të bëhet me tokën në Bardh të Madh, kjo nuk do të lejohet.

Dhe, këtu po fliten edhe disa gjëra të tjera, kolegët tanë deputetë po paralajmërojnë për një kolaps energjetik, e të tjera e të tjera. Unë nuk e di krejt qysh do të shkojë puna dhe pa dashur të abstraktoj përgjegjësinë e kësaj Qeverie, unë mund të them siç e dinë të gjithë qytetarët, siç e dinë të gjithë zyrtarët që KEK-un e ka shkatërruar shumë Qeveria më herët.

KEK-u është shkatërruar shumë nga qeveritë më herët, e që po vazhdon të shkatërrohet po ashtu edhe më tutje nga zyrtarët e Qeverisë së mëhershme.

Nëse keni harruar, janë ende në kontest gjyqësor kontrata shumëmilionëshe që kanë lidhur zyrtarët e PDK-së me KEK-në, e të cilat nuk dihet si do të përfundojnë dhe për çfarë janë dërguar në gjykatë. Edhe kjo nuk është as e fshehtë, nuk është as që dikush po do të nxjerrë në pah diçka që nuk ekziston, por janë faktet, janë argumentet, për të cilat nuk është mirë të fajësohet dikush tjetër, por është mirë secili ta shohë veten çka po bën.

Angazhimi kryesor i zyrtarëve të PDK-së në KEK, po e bëtë një kontroll edhe më të voglin, është punësimi enorm i militantëve partiakë të PDK-së dhe duke shmangur, ashtu siç e kemi paraparë me ligj, duke shmangur punësimet me prioritet të të gjithë atyre qytetarëve që u janë bërë dëme të mëdha nga shfrytëzimi i pronave, tokave të tyre dhe të gjitha pasurive që kanë pasur.

Qytetarët duhet ta ditë shumë mirë edhe besoj e dinë kush po e zhvat edhe më tutje KEK-un. KEK-u po zhvatet edhe më tutje, KEK-un po e grabitin edhe më tutje zyrtarë të caktuar të PDK-së, përfshirë edhe ndonjë deputet që po vajton këtu për KEK-un. Emrat i dini ju më mirë se unë, po nëse doni, po jua them edhe një herë edhe emrat krejt me rend të gjithëve, edhe kush keni firmë aty, edhe kush po zhvat, edhe kush po bën kontrata katastrofale milionëshe, edhe që jeni nëpër gjyqe.

Prandaj, mos hidhni gur aty ku nuk mund të gjuani dhe të nxirrni, shikoni pak veten, shikoni secili punët që po i bëjnë, sepse është e vërtetë. Kosovës i duhet fuqi më e madhe energjetike, po i duhet mbi baza ligjore, mbi baza njerëzore dhe mbi baza të interesave publike, interesave të qytetarëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Sa për kujtim, më duhet të them që çdonjëri që e fsheh veprën penale dhe nuk e paraqet, dënohet me ligj. Prandaj, zonja Tërmkollli, t'u kisha lutur që të kërkosh të bëhet Komision Parlamentar, se t'i nuk je prokurore, edhe nëse ke fakte, të lutem shko në prokurori, edhe këtu kërko komision, unë nuk kam asgjë kundër, s'jam kurrëgjë kundër. Unë nuk i di ato

personalisht, po është shumë e përgjithësuar, të kisha lutur nëse ke diçka, lirisht thuaje dhe ne si parlament mund të bëjmë një komision hetimor për të gjitha çështjet, se vërtet jemi lodhur prej përrallave dhe të disa prej medieve, edhe të akuzave kuturu në parlament. Nuk kam asgjë kundër në këtë.

Po zonja Tërkkolli, nëse doni.

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Nuk e di a u dëgjua mirë a jo. Unë nuk e akuzova askënd, nuk thashë asgjë, veç ajo çka thashë është ajo çka është publike. Domethënë, çka dihet, le të dinë të gjithë qytetarët e Kosovës për ato konteste, të cilat janë duke u zhvilluar në gjyq, asgjë tjetër. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Muja e ka kërkuar fjalën për replikë.

SHAIP MUJA: Po, po, replikë!

Zoti nënkryetar, faleminderit!

Parafolësja hodhi disa pupla, të cilat po mendon që publiku i ha, edhe ju falënderoj shumë për orientimin e saj, sepse këta kanë strategji të gjuajnë topin diku tjetër për t'u ikur qëllimeve ku janë duke e bërë 'llugë'.

Nuk ka nevojë të thuhet PDK-ja, ka emra, mbiemra, ka identitet. Kur po them që në këtë parlament ka deputetë pa përgjegjësi publike dhe flasin veç në hava, sa për ta dëgjuar elektoratin, një elektorat që s'e merr vesh, ndoshta vetëm sa për ta votuar.

Është e turpshme të dëgjohen në forma të tilla, këtu nuk jemi duke folur për probleme politike personale, po flasim për perspektivën e përgjithshme, edhe ku jemi duke shkuar. Kush ka fakte, le të urdhërojë, e ka derën e njohur. Prandaj, forma kur thashë edhe për rentën minerare, ju po të kishit dashur të votoni, po ta donit atë komunitet, do të përfitonte komuniteti 20% nga shfrytëzimi i qymyrit, përfiton edhe për shëndetësi, edhe për rrugë, edhe për ambient, edhe për ndriçim, edhe për çerdhe, edhe për fëmijët.

Prandaj, cili qenka shfrytëzimi modern këtu që zbulohen disa, se ky që e paskemi propozuar ne qenka shfrytëzimi primitiv, ndërsa këta qenkan duke përgatitur me shfrytëzimin e rentës në mënyrë moderne. Është lojë e fjalëve dhe kakofoni e tyre është, se nuk është imja, është kakofoni e tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Tërkkolli e ka fjalën, për kundër-replikë.

MELIHATE TËRMKOLLI: Nuk po dua të bëhem shumë e tepërt, po të jemi të qartë. Unë di të them PDK-ja, po nuk thashë PDK-ja, thashë zyrtarë, disa zyrtarë, nuk është prandaj PDK-ja, janë

disa zyrtarë, emrat po i dini more krejt. Shkoni, këqyrni nëpër krejt mediat, nëpër krejt janë dhënë emrat, dihen kontratat, e të tjera.

Shkoni, ju lutem, ta bëni veç një hulumtim të vogël dhe këqyrni kush po punësohet në KEK, qysh është mbipopulluar punësimi në KEK dhe kush kë po e punëson? Veç shkoni e këqyrni, këqyrni a ka njerëz aty të Obiliqit, këqyrni a ka njerëz të Bardhit të Madh, të Fushë-Kosovës, këqyrni a ka njerëz të cilëve u janë marrë krejt pasuritë e mundshme dhe shkoni këqyrni kush kë po e punëson? Kaq, janë gjëra të ditura, fakte notore.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Salih Salihu.

SALIH SALIHU: Faleminderit, kryesues!

Në fakt, këtu kemi të bëjmë me dy çështje të rëndësishme.

E para është që pas shpalljes së kësaj zone me interes të veçantë ekonomik në vitin 2004 dhe pastaj, edhe në vitin 2009, ka filluar zhvendosja e fshatit Hade, por kjo zhvendosje u ndërpre, duke mbetur gati gjysma e banorëve të jetojë aty, në kushte ekstreme, të vështira, si pasojë e veprimeve të KEK-ut, duke e mihur sipërfaqen e tokës së tyre për eksploatimin e thëngjillit.

Komisioni për Bujqësi dhe Mjedis e ka vizituar Haden dhe mihjen dhe kemi parë që pluhuri, zhurma e makinave të rëndëve, mungesa e rrugëve, e kanalizimit, por edhe rreziku për të rrëshqitur i tërë fshati në gropën e mihjes, e bëjnë të pamundur jetën e banorëve të mbetur në atë fshat, të cilëve në fillim sipas planit strategjik të zhvillimit të punëve dhe shpalljes si zonë me interes të veçantë ekonomik, ky fshat është dashur komplet të zhvendoset në lagjen e re në Shkabaj, por kjo gjë nuk po ndodh për shkak të devijimit të planit të mihjes nga KEK-u, gjegjësisht nga Qeveria.

Dhe, çështja e dytë është devijimi i planit të mihjes. Pse është devijuar plani, askush nuk e di, përveç dihet se tashmë po ndërtohet pa leje në fshatin Shipitullë, natyrisht duke e ditur se shumë shpejt këto ndërtime do të shpronësohen.

Ky problem i ka irrituar edhe banorët e fshatit Shipitullë dhe kanë kërkuar hetime për zhvendosjen e Shipitullës.

Para pakë ditësh në fshatin Hade Inspektorati i Ndërtimit urdhëroi të shkatërrohen shtatë themele të shtëpive, ndërsa Inspektorati i sheh ndërtimet që po ndodhin në Shipitullë.

Banorët thonë se kompania e përzgjedhur nga KEK-u ka favorizuar ndërtimet ilegale që janë bërë nga banorët jorezidentë të këtij fshati. Madje, sipas tyre, më shumë po vlerësohen shtëpitë ilegale, se sa ato që janë të ndërtuara më herët.

Banorët kanë reaguar nëpërmjet letrave, takimeve, por edhe protestave për të treguar se ata ballafaqohen me shkeljen të të drejtave të tyre, kushtet e rënda mjedisore, ekonomike që po e rrezikojnë edhe jetën e familjet e tyre.

Por Qeveria e Kosovës nuk është në gjendje ta zgjidhë problemin, pra as t'i ndalë ndërtime pa leje në Shipitullë, e as të bëjë zhvendosjen e fshatit Hade në Shkabaj apo në Haden e Re.

Qeverisë po i intereson thëngjilli, e qytetarëve po ua kthehen me energjinë me çmim më të shtrenjtë në rajon.

Pra, siç duket, është në interes të dikujt që ky problem të mos zgjidhet dhe këtë ndoshta më së miri e di Qeveria, e nëse jo, atëherë do të duhet të bëhej një hulumtim më i thellë se kush po ndërton atje dhe në tokën e kujt po ndërton dhe çfarë lidhje ka me zyrtarë të lartë të KEK-ut. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Daut Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesues!

Thënë sinqerisht, nuk e pata ndërmend të flas, por meqenëse u anulua ose u shpall i pavotuar Ligji për miniera e minerare më herët, atëherë u pa hapur që qëllimi i vetëm është të dëmtohen qytetarët e Obiliqit, edhe pikërisht për shkak se atje qeveris një kryetar i AAK-së, Xhafer Gashi, e që për mendim timin, është kryetari më i suksesshëm në Kosovë.

Po shihet që ia ka nisur fushata, shumë mirë, bile, i kisha përgëzuar dhe kisha shpresuar që shumë shpejt të shkohet në zgjedhje, e shpresoj që ai ligj vjen shpejt edhe një herë e votojmë përsëri. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Adem Salihaj e ka fjalën.

ADEM SALIHAI: Zoti kryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë mendoj që problemet që janë shtruar këtu në interpelancë kanë dimension shumë më të madh se sa janë paraqitur. Problemi është shumë më kompleks dhe në gjithë këtë kompleksitet janë shumë faktorë që ne duhet t'i shqyrtojmë këtu.

Së pari është një problem që rrjedh prej vitit 2004, pra nuk është një problem i ri dhe është një problem që është shkaktuar nga disa qeveri prej vitit 2004 deri më tash dhe nuk është aspak një problem që është shkaktuar gjatë mandatit të kësaj Qeverie.

Pra, kjo Qeveri nuk ka asnjë lloj interferimi në çështjet për të cilat është vendosur prej vitit 2004 e deri më tash.

Problemi është kompleks për faktin se qysh në vitin 2004 Qeveria e kryesuar nga Bajram Rexhepi ka marrë një vendim fillestar që të ndalohen të gjitha ndërtimet dhe është shpallur si zonë me interes të veçantë ekonomik. Pra, prej atëherë është marrë qëndrim që kjo të jetë zonë me interes të veçantë ekonomik dhe janë ndaluar të gjitha ndërtimet në atë zonë.

Pas këtij vendimi janë edhe shtatë vendime të tjera të Qeverisë lidhur me këtë çështje. Pra, nuk është e saktë se është një vendim i vitit 2004 dhe një i vitit 2009.

Janë edhe shtatë vendime të Qeverisë dhe një vendim i Kuvendit Komunal të Obiliqit, i cili po ashtu ka natyrë të njëjtë dhe nuk është zbatuar asnjëherë nga Komuna e Obiliqit. Pra, edhe vendimi i Komunës së Obiliqit i ndalon ndërtimet, por komuna vetë nuk e ka zbatuar asnjëherë këtë vendim dhe tash problemi i ndërtimeve të reja e të tjera.

Komisioni për Bujqësi, Mjedis e Planifikim Hapësinor ka një vit që po merret me problemin e Hadës së mbetur. Pra, problemi më i madh në atë rajon i komunitetit është Hadja e mbetur, jo këto fshatrat e tjera që po përmenden këtu.

Dhe Hadja e mbetur është shpronësuar përgjysmë, u janë marrë tokat, u janë lënë vetëm 52 hektarë tokë dhe gjysma e fshatit, i cili është i rrethuar nga tri anët nga makineria e rëndë, nga shiritat transportues dhe nga mihja e KEK-ut.

Pra, është një problem tepër serioz dhe unë mendoj që Qeveria duhet ta ketë parasysh edhe ta trajtojë seriozisht këtë problem, sepse ata banorë aty kanë mbetur në një lloj geto, të izoluar e pa të drejtë që të shkojnë diku tjetër, nuk janë shpronësuar dhe nuk është lejuar asnjë lloj ndërtimi apo mbindërtimi.

Pra, prej vitit 2004 deri më sot kanë kaluar rreth 13 vjet dhe ata banorë nuk kanë pasur të drejtë të ndërtojnë një dhomë të re, të krijojnë familje, e të tjera dhe Avokati i Popullit me të drejtë e ka paraqitur këtë problem si shkelje të të drejtave të njeriut. Pra, është një problem serioz, me të cilin duhet të merret Qeveria aty.

Komisioni e ka thirrur disa herë ministrin për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, por që deri më tash nuk është gjetur zgjidhje për këtë.

Sa i përket vendbanimeve të tjera në atë rajon, problemi i ndërtimeve të reja është një problem që drejtpërdrejt shihet prej aeroplanit. Shipitulla nuk është një vendbanim tërheqës për banim, pra realisht banorët e Shipitullës do të duhej të migronin në drejtim të Prishtinës ose Fushë-Kosovës

ose Obiliqit, por për çudi, atje ka ndërtime të reja dhe shkojnë banorë prej të tjera anëve për të ndërtuar aty.

Pra, qëllimi i vetëm është përfitimi, përfitimi nga shpronësimi, i cili pritet të ndodhë aty dhe ka aq shumë ndërtime sa që as Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, as Komuna e Obiliqit deri para pak kohësh nuk kanë marrë asnjë veprim që t'i ndalojnë ato ndërtime. Pra, është një problem shumë kompleks dhe unë mendoj që Qeveria duhet ta rishikojë politikën e KEK-ut për ndërtimet e mihjeve si dhe për shpronësimet që ka planifikuar t'i bëjë.

Pra, është një problem serioz pse KEK-u e ka rrethuar nga tri anët gjysmën e Hadës së mbetur? Pse nuk e ka shpronësuar këtë pjesë, po ka dalë përtej atje në Sibovc e në Shipitullë e në ato pjesë të tjera?

Pra, është një çështje që duhet të shqyrtohet seriozisht dhe duhet të vlerësohet pse kanë ndodhur të gjitha këto?

Ne e kemi vizituar Hadën dhe, për çudi, Hade që është shumë afër termocentraleve, Hade që është e rrethuar nga mihjet sipërfaqësore prej tri anëve, në shkollën e saj nuk ka pasur energji elektrike, me muaj të tërë.

Pra, këto janë antagonizma serioze që duhet shqyrtuar nga Qeveria, sepse KEK-u nuk po bën një politikë të mirë dhe të drejtë, por në politikën e KEK-ut për shpronësime dhe për orientimin e drejtimeve të mihjes kanë ndikim ndoshta edhe profitorë të ndryshëm që nuk është vështirë t'i identifikojmë, sepse atje në Shipitullë veçanërisht ka ndërtime të shumta që krejt janë të palogjikshme, përveç faktit se ata gjatë shpronësimit do të kenë përfitime të mëdha.

Komisioni për Bujqësi, Mjedis e Planifikim Hapësinor është duke e shqyrtuar seriozisht këtë situatë dhe unë besoj që komisioni do të kërkojë zgjidhje për të gjitha këto probleme.

Pra, edhe politika e zhvendosjes ose korniza e zhvendosjes duhet t'i ketë parasysh problemet reale në terren dhe të veprojë.

Unë mendoj se Qeveria ka hapësirë për të vepruar, ka mundësi të korrigojnë këto probleme ose të zgjidhen këto probleme që janë krijuar në mandatet e mëparshme, jo gjatë kësaj qeverisje dhe të gjejnë zgjidhje të drejta edhe për banorë të atjeshëm, të cilët kanë pasoja të shumta edhe nga ndotja e shumëfishtë që bëhet, por edhe nga një politikë tendencioze ose qëllimisht e gabueshme e zhvendosjes së banorëve të atyre pjesëve. Faleminderit!

KRYESUESI: I fundit është zoti Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Për të mos u përsëritur disa elemente, të cilat u theksuan edhe nga kolegë deputetë, pa dallim pozitë dhe opozitë, është interes i veçantë që të merren masa adekuate, po mbi të gjitha me një analizë të qartë, duke eliminuar të gjitha ato defekte që kanë ndodhur rreth kësaj problematike, e cila është më shumë komplekse se sa që është paraqitur edhe në vetë kërkesën për interpelancë, por edhe nga diskutimet që ne sot këtu po mundohemi t'i theksojmë.

Lëvizjet që janë bërë sidomos në këtë pjesën që po e përmendën të tri fshatrave, edhe në lagje të caktuara, ne kohë pas kohe kemi marrë letra dhe kemi marrë edhe shqetësime nga banorët e asaj pjese, qoftë të fshatit Shipitullë, që u apostrofua këtu, lagjet Krasniqi, Bërbatovci, Mirena, që është thënë para shumë vjetësh, ndoshta edhe kohët e fundit se mënyra e shtimit të shtëpive ka ndodhur në vazhdimësi. Domethënë, nga 40 shtëpi të gjendjes ekzistuese, sot theksohet se janë më shumë se 260 shtëpi, pavarësisht vendimeve të cilat kanë qenë në të kaluarën. Dhe, kjo ndoshta e ka rritur edhe tensionin mes banorëve, por mbi të gjitha, edhe për të aplikuar norma edhe projektin, të cilin e realizon kompania si kontraktor i KEK-ut.

Andaj, besoj që kjo duhet të jetë edhe pjesë e këtij riformulimi, duhet saktësohet, mbi të gjitha të mbrohet interesi i qytetarëve, jo interesi qoftë edhe i kompanive, qoftë edhe i nënkontraktorëve apo edhe i njerëzve, individëve që mund të kenë preferenca të tilla.

Kështu që po mendoj që brenda rezolutës duhet të saktësohen qartë, sepse është e qartë dhe është i ditur problemi, është e njohur zona, por duhet veprimi.

Siç shihet, Ministria e Zhvillimit Ekonomik nuk ka mundur t'i qaset në mënyrë adekuate dhe të ndërpresë të gjitha këto aktivitete, andaj nuk është e thënë që vetëm grupi ndërministror, por vetë njerëzit që janë kompetentë me marrjen e masave, jo vetëm të planifikimeve të vazhdueshme, të zgjidhin sidomos problemin edhe me zonat e banuara përreth, por konkret edhe për pjesën të cilën ne sot po diskutojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Konstatoj që ka përfunduar lista e të paraqiturve për diskutim.

Tani është radha e fjalës përfundimtare të kryeministrit, zotit Isa Mustafa, nëse dëshiron ta marrë fjalën.

Zoti kryeministër Mustafa e ka fjalën.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Unë nuk kam ndonjë çështje të veçantë, nuk dëshiroj të ndalem në natyrën ose adresimin e disa diskutimeve.

Unë konsideroj se problemi është problem, për të cilin duhet të diskutohet, se ekziston një përkushtim edhe i ministrive përkatëse, edhe i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Korporatës Energjetike të Kosovës, Komunës së Obiliqit. Këto janë katër subjekte, me të cilat mund t'ju them se unë nja 5-6 herë jam takuar në zyrë, i kam thirrur në zyrën time për t'u afruar zgjidhje dhe për të marrë masa, në mënyrë që të kapërcehet kjo situatë, të cilën e kemi atje.

Në fillim ka pasur mjaft shumë mosshpërputhje të veprimeve ndërmjet ministrive përkatëse, edhe tentativë që përgjegjësitë të kapërcehen te tjetri, mirëpo më vonë është arritur që çdo ministri ta marrë përgjegjësinë e vet në këtë fushë, edhe KEK-u në fushën e vet. Ka pasur dobësi mjaft të mëdha që janë përcjellë të kontrollit të ndërtimeve pa leje në atë pjesë, që janë ndërtime kryesisht spekulative dhe të cilat mund t'i kushtojnë buxhetit të Kosovës rreth 4 milionë e gjysmë. Është paraparë paraprakisht të mbërrijnë tash në rreth 14 apo 15 milionë. Mirëpo, prapë edhe në këtë aspekt jo buxhetit, por KEK-ut, sepse KEK-u duhet t'i bëjë shpronësimet për interes të kompanisë publike.

Mirëpo, unë plotësisht pajtohem në pjesën që duhet të ndërmerren masa ligjore, në mënyrë që të ndalen këto procese dhe se ministrinë përkatëse, edhe KEK-u duhet të veprojnë sa më shpejt, në mënyrë që të zgjidhen problemet me banorët, veçmas i kemi gjashtë raste, të cilat janë në frontin ku duhet të zhvillohen punimet, te të cilat duhet të gjendet zgjidhja e parë, pastaj zgjidhjet të tjera me radhë.

A do të aplikohet këtu korniza apo do të aplikohet Ligji për shpronësim, prapë mbetet çështje ligjore, sepse dikush më kritikoi që kryeministri po thirret në ligj. Kryeministri nuk mund të thirret në veprime e të tjera, jashtë ligjit asnjë veprim s' mund ta bëjmë.

Kryeministri nuk ka grupe paralele që e zbatojnë ligjin. Unë kërkoj që institucionet ta zbatojnë ligjin, kërkoj që organet përgjegjëse, që janë organe ligjore... Kush është vonuar te energjia, kush është dashur në ç' kohe t'i bëjë veprimet, ato sende janë shumë të qarta dhe nuk kemi nevojë të hyjmë sot këtu tash të shpërndajmë përgjegjësi edhe fajë. Çdo njëri e merr pjesën e përgjegjësive së vet. Edhe unë e marr pjesën e përgjegjësive për këtë mandat, çka kemi bërë dhe çka s' kemi bërë. Jam munduar ta bëjmë dhe po mundohemi ta gjejmë, kemi bërë edhe strategjinë e energjisë, kemi bërë edhe përgatitjet për fillimin e ndërtimit të termocentralit të ri Kosova e Re dhe do të mundohemi që edhe këto procese t'i çojmë përpara.

Prandaj, unë mendoj se më tepër duhet të kemi një qasje pozitive, qasje konstruktive, sepse është problem të cilin ne nuk mund ta tejkalojmë me retorikë boshe, as me fajësime të panevojshme, por të gjejmë rrugë. Rruga është që të gjitha institucionet ta bëjnë punën e vet, në këtë aspekt unë pajtohem, afate nuk mund të caktojmë këtu, sepse afatet i cakton ligji. Transformimin e kemi filluar, është filluar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe do të bëhet, në mënyrë që ta kemi

një korporatë që do të merret vetëm me thëngjillin dhe çështje të tjera mbesin çështje ligjore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Propozuesi i interpelancës, zonja Kadaj-Bujupi, e ka fjalën, pesë minuta i keni.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit!
Unë fillimisht i kam dy pyetje për kryeministrin Mustafa.

E para, a po e pranoni se është situatë emergjente, edhe pas të dhënave që ne prezantuam.

E dyta, cili është plani për veprim, sepse gjithçka që dëgjuam këtu është: ne u përpoqëm, ne e analizuam, po në fakt, as tani, kur situata është emergjente, ju nuk treguat se a keni plan veprimi dhe cili është ai? Cilët janë hapat që do t'i ndërmerri, jeni tre vjet në Qeveri.

Tjetra, në vitin 2005 shpronësimi ka kushtuar 3 milionë, sot kushton rreth 18 milionë dhe kjo është përgjegjësi e atyre të cilët nuk e zbatuan ligjin.

Dhe, po ju kujtoj, edhe atëherë, edhe në vitin 2009, madje në vitin 2009 keni qenë në koalicion me partnerin e njëjtë, pra me PDK-në, me të cilin tani po ia hidhni fajin njëri-tjetrit për dështime.

Edhe tani e tre vjetët e fundit përsëri në koalicion me PDK-në, cilat kanë qenë veprimet tuaja për të zgjidhur problemin? Cilat veprime konkrete?

Ne dëgjuam këtu akuza e kundërakuza, e dimë që janë ndërtuar objekte fiktive nga ata të cilët kanë lidhje me Qeverinë dhe me politikën, po pse s'i keni ndalur? Pse s'i keni ndalur?

Dhe, te çështja të cilën e diskutuat, çështja e thëngjillit, ju thatë që nuk është importua thëngjill. Unë këtu kam të dhëna nga Dogana, kryeministër, për juve janë, sepse po e demantoj atë çka e thanë më parë në fjalën tuaj.

Janë 450 mijë tonë bazuar në Doganat e Republikës së Kosovës, thëngjill i importuar. Kush i ka importuar dhe për çka? Përderisa i kemi gjithë këto resurse, pse ka qenë e nevojshme të importohet dhe pse e thatë që nuk është importuar? Kush kë po e mbron dhe çka po mundoheni të fshihni?

Sa u përket banorëve, është e vërtetë që ata janë viktimat e këtij pushteti dhe regjimi tuaj dhe mospërfilljes, sepse kështu jeni sjellë me të gjitha çështjet madhore. Kështu keni qenë shpërfillës edhe për demarkacionin, edhe për 'Zajednicën', po ja ku kemi mbërritur.

Po dua të dëshmoj edhe një herë që shpërfillja juaj, në fakt, përcillet me përpjekje të partnerit tuaj, na ana e PDK-së, për t'i rimashtruar këta banorë, sepse në mes të datës 20 dhe 30 mars të vitit 2016, dy ministrat e Qeverisë tuaj kanë shkuar në fshat dhe kanë premtuar punësime për banorët, kanë diskutuar dhe kanë premtuar se do t'i punësojnë, ndërkohë që me veprimet tuaja dhe mosveprimin tuaj, në fakt, deri më 1 qershor ju rrezikon humbjen e vendeve të punës të 5000 minatorëve, të cilët punojnë atje. Ata nuk kanë punë tjetër, familjet e tyre, pra të 5000 minatorëve në mije varen prej planit për të cilin ju po thoni që: “Po, duhet të bëhet dhe do të bëhet”, por në fakt, nuk keni asnjë veprim konkret për të dalë nga situata emergjente dhe nga kriza, në të cilën e keni sjellë vendin nga neglizhenca juaj.

Duke e përmbyllur me kërkesën që ta votojmë këtë rezolutë, unë dëshiroj të theksoj se në Kosovë janë dy kompani të fundit publike që prodhojnë. Pra janë “Trepça” dhe KEK-u. Ju bashkë me PDK-në jeni përgjegjës për shkatërrimin e të dyjave. Ashtu siç keni bërë gjatë procesit të privatizimit, bashkë me të gjitha kompanitë tjera publike, të cilat fillimisht i keni shkatërruar qëllimisht, për t'i shitur dhe për të qenë aksionarë dhe për të marrë përqindje nga ato shitje të dyshimta, sot po përpiqeni dhe po veproni në drejtim të shkatërrimit të dy ndërmarrjeve të fundit prodhuese, pra të “Trepçës” dhe të KEK-ut.

KRYESUESI: Unë mendoj që ky diskutim u desh më herët për t'ia dhënë mundësinë edhe kryeministrit që të përgjigjet, por sidoqoftë e the atë që deshe.

I ftoj deputetët në sallë për të votuar. Sa veta janë në sallë?

(Ndërprerje e incizimit)

Ju lus që t'i zini vendet dhe ju ftoj që të deklaroheni nëpërmjet votimit për Propozim-rezolutën sa i përket çështjes së interpelancës. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

I kemi 60 vota me elektronikë të votuara, një pa elektronikë që abstenon.

61 deputetë kanë votuar. 19 janë për 34 kundër dhe 8 abstenime.

Atëherë, konstatoj që Kuvendi nuk miratoi rezolutën e propozuar nga deputetja Donika Kadaj-Bujupi, mbështetur nga 15 deputetë nënshkrues për çështjen e shfrytëzimit të thëngjillit dhe Minierën e Sibocit.

6. Interpelanca e ministrit Blerand Stavileci, sipas kërkesës së deputetit Visar Ymeri, e mbështetur nga 15 deputetë nënshkrues, në lidhje me kontratën e privatizimit të Kompanisë së Distribuimit të Energjisë Elektrike

Nuk qenka ministri këtu. Unë s'kam informacion, as me shkrim, as me gojë, nuk di nëse vjen a nuk vjen. Qenka jashtë vendit, unë deri tash s'kam... E shtyjme për një herë tjetër.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave nga pjesët veriore të Kosovës

Ju njoftoj se kjo pikë ka qenë e radhitur në rend dite të seancës së kaluar, por në mungesë së propozuesit të këtij projektligji është shtyrë shqyrtimi i tij.

Komisioni Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, e ka shqyrtuar projektligjin e propozuar nga Safete Hadërgjonaj, e mbështetur nga 25 deputetë, dhe Kuvendit i ka rekomanduar mosmiratimin e tij.

E ftoj zonjën deputete Hadërgjonaj, që në emër të propozuesit, ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Problemet politike që në vazhdimësi kanë qenë aktuale në Mitrovicë kanë bërë që në këtë rajon të ketë ngecje më të theksuara në zhvillimin ekonomik. Krahas problemeve politike, shkalla e ulët e zhvillimit ekonomik i ka bërë mitrovicasit të ballafaqohen me papunësi dhe probleme sociale.

Mitrovica, dikur vendi më i industrializuar në Kosovë, sot përballet me papunësi të lartë, varfëri, mungesë të perspektivës ekonomike, por edhe shërbime të varfra publike për shkak të rrethanave të krijuara në këtë pjesë. Institucionet e Kosovës, në përgjithësi, por edhe ne si deputetë, në veçanti, duhet të angazhohemi që popullsisë së asaj ane t'i hapim perspektiva për zhvillim ekonomik, se vetëm ulja e papunësisë dhe zhvillimi ekonomik përafron interesat e të gjitha komuniteteve dhe i bën ata të mendojnë për të ardhmen dhe të mos jetojnë nën hijen e së kaluarës.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka marrë iniciativën e këtij projektligji dhe i falënderoj deputetët nënshkrues të grupeve tjera parlamentare që i janë bashkëngjitur kësaj iniciative dhe sot kërkojmë nga deputetët që ta përkrahin iniciativën dhe ta votojnë Ligjin për aftësim, riaftësim profesional dhe punësim të personave nga pjesët veriore të Kosovës.

Qëllimi i këtij ligji është që të nxitet punësimi në Mitrovicë, duke lehtësuar punësimin e përkohshëm apo afatgjatë që ndikon në kërkesën për punë, duke reflektuar drejtpërsëdrejti në uljen e papunësisë.

Synimi ynë ka qenë që nëpërmjet këtij ligji të nxitet dhe mbështetet krijimi i vendeve të reja të punës, duke bashkëpunuar me punëdhënës dhe nëpërmjet subvencionimit të tyre nga shteti. Nxitja e punësimit nëpërmjet aftësimin dhe riaftësimin në punë, që do të thotë nxitja e punësimit nëpërmjet kushteve për t'u trajnuar dhe për t'u kualifikuar - forcën e punës në funksion të ofertës për punë.

Nëpërmjet këtij ligji synojmë mbështetjen e të papunëve të pjesës veriore për integrimin e tyre në tregun vendor të punës dhe integrimin social të tyre, që konsiderojmë se është një çështje mjaft e rëndësishme që ne duhet t'i qasemi me shumë seriozitet. Banorët e Mitrovicës nuk mund ta nxjerrin vetë qytetin nga izolimi ekonomik. Zhvillimi i këtij rajoni varet nga integrimi i plotë në tregun kombëtar dhe në tregjet rajonale.

Projektligji i ka 9 nene. Struktura e tij është e harmonizuar me Udhëzimin Administrativ nr. 2008/14 për hartimin e ligjeve dhe akteve nënligjore dhe shtojcat e tij.

Neni 1 i ligjit përcakton përkrahjen ligjore dhe institucionale për aftësimin dhe riaftësimin, nxitjen dhe përgatitjen profesionale për punësim për personat e pjesës veriore të Republikës së Kosovës dhe përcaktimin e kritereve të përzgjedhjes, subvencionimi dhe kohëzgjatja e ndihmës për vendin e punës.

Neni 2 i definon shprehjet e përdorura në ligj.

Neni 3 rregullon shumën e subvencionimit.

Neni 4 rregullon kohëzgjatjen e subvencionimit për vendin e punës.

Neni 5 i përcakton kushtet që duhet plotësuar i punësuar për të përfituar subvencionimin.

Neni 6 përcakton kushtet që duhet plotësuar subjekti ekonomik për të përfituar subvencionin.

Neni 7 rregullon të drejtat e personave nga veriu i Kosovës për aftësim dhe riaftësim profesional.

Neni 8 rregullon procedurat për themelimin e marrëdhënies së punës.

Ne e kemi obligim si institucione ta gjejmë mënyrën e zvogëlimit të papunësisë dhe të hapim perspektiva për qytetarët e Mitrovicës. Përpyekjet për t'i zgjidhur disa nga problemet, sipas

vlerësimit të disa organizatave vendore e ndërkombëtare, janë masat afatshkurta që mund të ndikojnë në ringjalljen ekonomike, në uljen e papunësisë dhe integrimin e kësaj pjese në tregun vendor të punës.

Ky projektligj i ofruar i jep efektet në këtë drejtim, prandaj rekomandoj në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës dhe të deputetëve nënshkrues të kësaj iniciative që të votohet ky projektligj, në mënyrë që të krijohet mundësia që të shkojë në komisionet parlamentare dhe gjatë shqyrtimit të dytë të bëhen plotësimet dhe ndryshimet sipas kërkesave të deputetëve, në mënyrë që ligji të jetë i zbatueshëm dhe të jep efektet e veta. Faleminderit!

KRYESUESI: Nuk kemi përfaqësues të Qeverisë. E ftoj përfaqësuesin e Komisionit Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale që ta arsyetojë raportin me rekomandime. Zonja Besa Baftija e ka fjalën.

BESA BAFTIJA: Kryesues,

Unë në emër të grupit, jo në emër të komisionit. Është kryetari, ose nënkryetari.

KRYESUESI: Fjalën e ka zoti Baxhaku.

HATIM BAXHAKU: Faleminderit, zoti kryesues!

E nderuar deputete,

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale më 6 shkurt 2017 e ka shqyrtuar projektligjin për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave nga pjesët veriore të Kosovës dhe gjatë një debati ka ardhur në përfundim pas një votimi me 3 vota për, 3 vota kundër dhe një abstenimi që të mos e përkrah këtë projektligj në formën si është hartuar, prandaj kërkon një analizë dhe diskutim gjithëpërfshirës.

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare.

Nga Grupi Parlamentar i PDK-së nuk është paraqitur askush. Nga LDK-ja, zoti Baxhaku e ka fjalën sërish.

HATIM BAXHAKU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës në mbledhjet e veta e ka shqyrtuar Projektligjin për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave nga pjesët veriore të Kosovës.

Gjatë debatit në grupin parlamentar është konstatuar se gjendja ekonomike dhe e mirëqenies së qytetarëve në këto pjesë nuk është e kënaqshme dhe e meriton një vëmendje dhe angazhim të

posaçëm të Qeverisë dhe të shtetit që kjo të përmirësohet, por duke bërë programe për rritjen e zhvillimit ekonomik dhe të punësimit.

Por, Grupi Parlamentar i LDK-së mendon se rritja e punësimit dhe mirëqenies sociale në këtë pjesë për qytetarët e kësaj pjese nuk mund të arrihet me ligje të tilla dhe ne mendojmë se një ligj i tillë fillimisht është edhe në kundërshtim me kornizën ligjore të Republikës së Kosovës që e rregullon këtë fushë dhe nuk është në harmoni me ligjet pozitive të Kosovës.

Së pari, me këtë ligj ne po e legalizojmë dhe po e ligjërojmë se një pjesë e Kosovës qenka një pjesë tjetër nga Kosova dhe gjithmonë duhet të shqyrtohet me ligje të posaçme, gjë që Grupi Parlamentar i LDK-së mendon se nuk është e drejtë dhe e mirë.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës mendon se rritja e punësimit dhe zhvillimit ekonomik të asaj pjese duhet të bëhet duke ndërmarrë masa të cilat i mbështetin ndërmarrjet private, por edhe ato publike dhe të subvencionimeve të organizatave dhe operatorëve që veprojnë në atë pjesë, sepse në këtë mënyrë do të mundësojmë që ata njerëz të jetojnë dhe të qëndrojnë atje. Në të kundërtën, me këtë ligj mendojmë se ne po e nxitim shpërnguljen e qytetarëve nga ato pjesë.

Duke pasur parasysh edhe faktin e qëndrimit dhe vendimit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, Grupi Parlamentar i LDK-së nuk e përkrah këtë projektligj dhe angazhohet që mirëqenia, punësimi dhe zhvillimi ekonomik i asaj pjese të bëhet me forma të tjera, të cilat shteti dhe Qeveria duhet t'i gjejë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Besa Baftija, në emër të grupit parlamentar.

BESA BAFTIU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

I ashtuquajhuri Projektligj për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave nga pjesët veriore, i sjellë nga një grup i deputetëve, në të cilin shumica janë deputetë të PDK-së, nuk ka kaluar në Komisionin Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale. Kështu që është mirë që komisioni ku bëj unë pjesë nuk e ka mbështetur këtë nismë legjislative.

Një nismë e tillë në mënyrën, qëllimin dhe arsyen se përse është hartuar është as më shumë e as më pak se një turp, madje edhe që ka ardhur deri këtu në këtë seancë. Ky tekst që po e quajmë projektligj synon që edhe de jure ta legjitimojë shpërnguljen e qytetarëve të pjesës veriore të vendit tonë. Që prej emërimit e deri te nenet brenda këtij teksti paraqitet qartë qëllimi i mbrapshtë, që synohet që personave që vijnë nga pjesa veriore, e që tashmë janë shpërngulur

përgjithësisht dhunshëm, ose për shkak të dhunës, t'u gjendet gjoja një punë nëpërmjet aftësisimit profesional në komunën ku tashmë janë zhvendosur.

Kjo do të thotë se në emër të punësimit, meqë në vend mbizotëron një gjendje e tmerrshme ekonomike, të vulozet plotësisht se ata nuk do të kenë, as nuk kanë mundësi, të kthehen ndonjëherë andej prej nga kanë ardhur. Njëkohësisht u jepet porosia shqiptarëve që kanë mbetur në pjesën veriore të vendit që në çdo kohë mund të shpërngulen prej andej e kështu, vetëm kështu, sipas këtij teksti që na ka ardhur sot në Kuvend, do t'i gjendet gjoja punë. Po ashtu, ky projektligj gjoja ua mundëson subvencionimin vetëm bizneseve që janë jashtë territorit të pjesëve veriore, e jo atyre bizneseve që veprojnë në pjesën veriore të Kosovës.

Këtë e specifikon neni 3, e në anën tjetër në nenin 5, që ka të bëjë me kushtet që duhet t'i plotësojë i punësuari për të përfituar subvencion nga Buxheti i Republikës së Kosovës, thotë se ky person duhet të jetë i lindur dhe me vendbanim në komunat veriore të Kosovës.

Paramendoni si mund të vijë një qytetar nga Mitrovica, për shembull, të punojë në Viti me një pagë prej 300 euro, të udhëtojë apo të paguajë qira, që do të thotë se esenca është që në start të ketë keqpërdorime të këtij fondi, që domethënë të mbështeten bizneset që janë të afërta me pushtetin, e në këtë rast me kryetarin e Kuvendit, sepse ky projektligj synon sigurimin e votave për PDK-në në komunën e Mitrovicës, aty ku Kadri Veseli e ka jetike të fitojë, duke marrë parasysh se vjen nga aty, e sipas këtij projektligji shumica e të subvencionuarve do të jenë nga kjo komunë.

Ky projektligj lë përshtypjen se do ta hapë një vrimë tjetër në buxhet, që PDK jo vetëm të furnizojë me para në dorë, siç ka vepruar, qytetarë të varfër të asaj pjese, të cilët i katandisën në këtë gjendje po vetë këta. Nga deklarata financiare duket se e dinë sa është numri i këtyre personave, sepse sipas deklaratës financiare do të ketë implikime shtesë buxhetore, si vijon: viti i parë 622 500 euro; viti i dytë 1 260 000 euro; viti i tretë ë 2 145 000 euro, që për këtë buxhet Ministria e Financave nuk ka dakordim.

Një përkrahje e këtillë me ligj për punëkërkuesit nga pjesa veriore është diskriminues në raport me punëkërkuesit e pjesëve tjera të Kosovës. Problemi i papunësisë është i përhapur në gjithë vendin. Të papunësuarit me vetë faktin që nuk e kanë një vend pune, ata janë të diskriminuar. Prandaj, ndarja e tyre në kategori bazuar në gjeografinë e vendit e dyfishon diskriminimin.

Qeveria duhet të angazhohet për zvogëlimin e papunësisë duke stimuluar prodhuesit vendorë në forma dhe mënyra të ndryshme, duke u ofruar mundësi të barabarta të gjithë qytetarëve të Kosovës, pavarësisht se në cilën pjesë të vendit jetojnë. Ndërsa, për shqiptarët në pjesën veriore të vendit ka plot punë e iniciativa për t'u ndërmarrë, që këto dy Qeveri nuk kanë dashur.

Së pari, hapi kryesor është revitalizimi i “Trepçës”, funksionalizimi i saj, që do të rezultonte me punësimin e tetë mijë qytetarëve. Ky fakt do të shtonte rrugën e një jetese normale në Mitrovicë me rrethinë. Bursat e studimit për shqiptarë dhe serbë nga veriu, për shqiptarë në shkolla të mesme dhe Universitetin e Prishtinës, investimet për Spitalin e Mitrovicës për ta rimëkëmbur e për t’u kthyer sërish punonjësit atje.

Secilit shqiptar të dëbuar t’i mundësohet kthimi në pronën e vet në veri. Të gjithë shqiptarët që janë detyruar t’i shesin pronat e tyre, Qeveria e Kosovës duhet t’i blejë ato. Këto sigurisht se janë punë konkrete, me plan dhe mbi të gjitha me vullnet politik kah drejtimi për të mirën e vendit.

Teksti që e kemi përpara është e kundërta totale e këtyre punëve, prandaj i ftoj deputetët që të mos e përkrahin këtë nismë, ashtu siç nuk e ka përkrahur edhe Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: Aleanca s’e do fjalën. Nisma për Kosovën, Shukrije Bytyqi e ka fjalën.

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Se gjendja në Republikën e Kosovës është e mirë edhe në atë kuptimin e riaftësimit dhe aftësimit profesional për të rinjtë e Kosovës tregon qartë edhe ardhja e një projektligji të tillë vetëm për një komunë të Republikës së Kosovës.

Ky projektligj nuk ka asnjë qëllim të mirë për qytetarët e Republikës së Kosovës, e as për qytetarët e veriut të Mitrovicës. Është për të të ardhur keq se qysh kjo Qeveri sjell projektligje të këtilla kur është në qeverisje partia që është në pushtet, që e ka udhëhequr me Mitrovicën për vite të tëra dhe nuk e ka ndërmarrë asnjë hap, as për mirëqenie të qytetarëve të Mitrovicës, as për siguri, as për shkollim dhe as për aftësim profesional dhe tani ta sjellë një projektligj që ndahet vetëm për një kategori, kjo është shumë shqetësues për ne, por edhe për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Ky projektligj nuk ka asnjë element të mirë në vete. Prandaj, ky projektligj nuk ka kaluar në Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale. Një shtet normal fillimisht u siguron siguri qytetarëve të saj, pastaj u siguron mirëqenie, shkollim dhe siguri që të qëndrojnë në shtëpitë e tyre.

Qeveria e Kosovës nuk e ka bërë asnjë hap për qytetarët e Mitrovicës, e veçanërisht për qytetarët e veriut të Mitrovicës. Por, ne të gjithë e dimë dhe është shqetësim yni sesi ata qytetarë i kanë

shitur shtëpitë e tyre, disa janë atje dhe nuk i kanë shitur, por qëndrojnë me një pasiguri shumë të madhe, disa të tjerë jetojnë me qira nëpër pjesë të ndryshme të Republikës së Kosovës dhe tani vjen një projektligj që ta punësojë një qytetar nga veriu i Mitrovicës në njërën prej komunave të Kosovës, që domethënë ajo pagë nuk do të ishte e mjaftueshme as për rrugë, e lëre më për mirëqenie të tij.

Prandaj, Grupi Parlamentar Nisma për Kosovën e ka shqyrtuar këtë në përpikëri dhe nuk e përkrah këtë projektligj.

KRYESUESI: Faleminderit! Për grupin Lista serbe, Slavko Simiq e ka fjalën.

SLAVKO SIMIĆ: Hvala, predsedavajući!

I Poslanička grupa Srpske liste razmatrala je nacrt zakona o osposobljavanju i zapošljavanju lica sa severa Kosova, i s obzirom da ovaj zakon ima za cilj pružanje zakonske i institucionalne podrške za osposobljavanje, prekvalifikaciju, podsticanje i stručnu pripremu za odgovarajuće zapošljavanje lica na severu Kosova, Poslanička grupa Srpske liste daje podršku ovom zakonu. I mi ćemo dati svoj doprinos da između prvog i drugog čitanja zadržimo ovaj zakon u ovakvom obliku, kako bi smanjili nivo nezaposlenosti građana na severu Kosova, daćemo podršku. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Parlamentar “6+”, fjalën e ka Fikrim Damka.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar Projektligjin për aftësim, riaftësim profesional dhe punësim të personave nga pjesa e veriut të Kosovës dhe në parim e përkrah këtë iniciativë dhe këtë projektligj. Por, disa shqetësime i kemi pasur edhe në komision dhe prej këtu do t’i paraqesim disa shqetësime. Unë besoj se duhet të ketë disa ndryshime substanciale në këtë projektligj dhe besoj se komisioni do t’i ndryshojë disa çështje, sidomos për implementimin e këtij projektligji, sepse do t’i ketë disa probleme vetë implementimi dhe kostoja e ligjit. Unë besoj se nuk është llogaritur si duhet kostoja e projektligjit, por në parim ne e përkrahim, duke bërë plotësimet dhe ndryshimet në komision. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Ismajl Kurteshi e ka fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Kolegë të nderuar,

Privilegjet si kategori shoqërore, pavarësisht ku ndodhin dhe kur ndodhin, prodhojnë diskriminim. Vetëm sjellja e një projektligji të tillë diskriminues në Kuvendin e Kosovës është shqetësues, e lëre më aprovimi i një projektligji të tillë, që e legjitimon diskriminimin e pjesës më të madhe të Republikës së Kosovës.

Kur e dëgjon arsyetimin për votimin e një projektligji të tillë të krijohet përshtypja se në pjesët tjera të Kosovës po lulëzon një mirëqenie, se s'ka të papunë, çdo gjë është në rregull dhe tash duhet të koncentrohemi vetëm në një pjesë, ku jeton një pjesë e qytetarëve të Kosovës. Pavarësisht ndryshimeve dhe qëndrimeve për këtë Republikë, mendoj se Kuvendi i Kosovës duhet ta gjejë forcën që të mos lejojë as të vijë në Kuvend për shqyrtim projektligje diskriminuese që kaheerë nuk shkojnë as në Kuvendin e Afrikës së Jugut. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e merr deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Vërtet më befason qasja e disa subjekteve politike, në veçanti edhe e Komisionit Parlamentar përkatës për këtë projektligj.

Kush e konsideron privilegj të jesh qiraxhi në qytetin tënd? Çfarë privilegji është të jesh, i nderuar Ismajl, qiraxhi në qytetin tënd? Të vetmit qytetarë në Kosovë që janë qiraxhinj në qytetin e tyre janë mitrovicasit. Dhe, ju jeni në bashkëqeverisje në Mitrovicë dhe nuk dua ta politizoj këtë çështje, sepse për mua është më shumë dhe më madhore sesa politike çështja dhe ndihmesa e qytetarëve të veriut, e banorëve të asaj pjese.

Ata lëre që s'kanë mundësi punësimi, por edhe këtë mundësi të riaftësimit, edhe subvencionimet për ta po doni ta ndalni. Ua keni ndaluar qiratë, që qeverisja e kaluar ua ka siguruar atyre, e keni ndaluar ndërtimin në pjesën veriore. Të mos harrojmë, po jua rikujtoj edhe një herë, në këtë foltore jua kam përsëritur dhe po jua përsëris, për herë të parë ka ndryshuar zhvendosja në Mitrovicë prej viti 2008. Deri në vitin 2008, të gjitha zhvendosjet e qytetarëve dhe banorëve në pjesën veriore kanë qenë prej veriut në jug. Vetëm prej vitit 2008, kur Partia Demokratike e Kosovës ka udhëhequr me pushtetin lokal dhe qendror, zhvendosja e qytetarëve në Mitrovicë ka filluar prej jugut në veri dhe kjo është e argumentuar me shifra me mijëra qytetarë dhe me qindra shtëpi të ndërtuara. Mbi 215 shtëpi i ka ndërtuar Partia Demokratike në Mitrovicë në pjesën veriore, e ju asnjë. Jo po doni t'ua pengoni tani, për interesa politike, edhe mundësinë e riaftësimit dhe të subvencionimeve.

Pa më tregoni, nëse ne s'i subvencionojmë ata banorë dhe fshatarë që jetojnë në Leposaviq, në komunat e Albanikut, si mund t'i mbajmë atje në ato fshatra të thella nëse nuk i subvencionojmë, si keni për t'i mbajtur. S'do të vijë të punojnë në Viti, mos u frikësoni, as në Kamenicë, e as në Gjilan. Qëllimi është që të riaftësohen dhe të punësohen në qytetin e tyre dhe të subvencionohen aty. Doni ta pengoni është çështje tjetër. Ky ligj i precizon qartë qëllimet, tendencat dhe objektivat e këtij projektligji.

Është mundësi e mirë e mbështetjes profesionale dhe financiare dhe e subvencionimit që ata të kenë kushte më të mira për jetë atje në qytetin e tyre dhe të punohet më shumë edhe për kthimin e atyre që ende nuk janë kthyer, por i vetmi kthim nga jugu në veri ka ndodhur me qeverisjen e Partisë Demokratike.

Mbështeteni këtë ligj, sepse është në interesin e pjesës veriore, është në interesin e qytetarëve të pjesës veriore, të atyre shqiptarëve që sot janë heronj të gjallë të Kosovës, sepse po qëndrojnë në vendet e tyre me shumë mund, me shumë sakrificë dhe ju s'jeni duke i mbështetur. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, Ismajl Kurteshi.

ISMAJL KURTESHI: Me këtë projektligj mund të fitojë çdokush, por jo qiraxhinjtë. Dhe, nuk është zgjidhje për qiraxhinjtë që të bëhen projektligje të tilla. Ata njerëz duhet të kthehen nëpër shtëpitë e tyre me angazhimin e Qeverisë së Kosovës, e cila bart përgjegjësi të madhe, që ata njerëz sot janë qiraxhinj dhe jetojnë në kushte tepër të rënda.

Me ligje të tilla diskriminuese ata vazhdojnë të diskriminohen edhe më shumë, kurse ata të cilët edhe ashtu e kanë gjendjen e mirë dhe kanë mundësi edhe të bëjnë firma e kompani do të përfitojnë nga këto ligje, të cilat nuk kanë për qëllim humanizmin dhe zgjidhjen e problemit, por rritjen e keqpërdorimeve të Buxhetit të Kosovës nga kjo Qeveri e papërgjegjshme dhe nga politikanë të cilët në mjerimin e atyre qiraxhinjve mundohen t'ia sigurojnë vetes pushtet edhe në të ardhmen. Faleminderit!

KRYESUESI: Një minutë, kundër-replikë për Haxhiun.

BEKIM HAXHIU: Vërtet po befasohem me qëndrimin e Ismajlit. Po çka jep ligji, në kuptimin nëse ne e miratojmë ligjin. Paragjykime? Pse ky i jep të drejt vetes për paragjykime të tilla, se dikush do të abuzojë për interesin e atyre qytetarëve?

Unë po i them Ismajlit, po si do ta mbështetës një banor, një shqiptar në komunat e Albanikut dhe të Mitrovicës atje, nëse nuk e mbështet edhe për një serrë, nëse nuk ia jep një subvencion, po qe se ai e ka të vështirë atë ta realizojë në komunë. Po nëse ne nuk e bëjmë me anë të këtij projektligji, si do t'i mbrosh banorët e Cerajës atje, po e marr një shembull vetëm për një fshat atje. Si, Ismajl?

Lëre more, mos bën këtu... Nuk mund t'i thuash këtij "i ashtuquajturi projektligj". Ky është projektligj për interesin e atyre qytetarëve të asaj pjese. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Besa Baftija e ka fjalën.

BESA BAFTIJA: Faleminderit, nënkryetar!

Nga kjo që u tha nga deputeti Bekim Haxhiu shihet qartë se nuk e ka lexuar këtë projektligj, për arsye se është e kundërta nga çfarë thotë ai. Nuk do të subvencionohen bizneset që janë në pjesën veriore të Kosovës, nuk do të subvencionohen as qytetarët që janë nga ajo pjesë, siç tha, nga Zubin-Potoku, Albaniku, Mitrovica Veriore apo e Jugut, të cilët i takojnë pjesës veriore të Kosovës, siç e thotë qartë neni 3 i këtij projektligji. Po e lexoj:

“Subvencionet për vendet e punës të komunave veriore.

Secili biznes i regjistruar në cilëndo komunë të Republikës së Kosovës, përveç atyre të regjistruara në komunën veriore sipas nenit 2”.

E neni 2 e përcakton cilat qytete janë pjesë e Kosovës Veriore. Paragrafit të këtij ligji, i cili ka të punësuar, apo ka për qëllim të punësojë ndonjë qytetar të komunave veriore, mund të aplikojë për të pranuar subvencionimin e këtij vendi të punës, që do të thotë se nuk do të subvencionohen bizneset që janë në atë pjesë, mirëpo do të subvencionohen bizneset që janë jashtë atij territori dhe qytetarët që vijnë prej asaj pjese.

E në anën e kundërt kërkohet që qytetarët të kenë vendbanim dhe leje të njoftimit për të dëshmuar se janë prej asaj ane. Prandaj, është e kundërta e asaj që thotë deputeti në fjalë. Faleminderit!

KRYESUESI: Bekim, emrin s’ta ka përmendur. Një minutë, Bekim Haxhiu!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit!

Vërtet po më vjen befasi, ose nuk po do ta kuptosh qëllimisht, e nderuar kolege.

Neni 2, te përkufizimet thotë kështu: “Pjesa veriore e Republikës së Kosovës është përkufizim i këtyre komunave të Republikës: Mitrovica Jugore dhe Veriore, Albaniku, Zubin-Potoku, Zveçani”.

Ndërsa te subvencionimet që ju thoni, e nderuar kolege, thotë kështu: “secili biznes i regjistruar në cilëndo komunë të Kosovës, përveç atyre të regjistruara në komunën veriore sipas nenit 2...” domethënë po flasim për subvencionimet. Këtu ky ligj e ka përkufizimin për këto katër komuna, të cilat... prandaj thotë “nuk do mbështeten komunat tjera jashtë këtyre”. Prandaj, problemin e keni vetëm te të kuptuarit e ligjit, asgjë më shumë.

KRYESUESI: Faleminderit! Mirjeta Kalludra e ka fjalën.

MIRJETA KALLUDRA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Rëndësia e politikave të reja që nxitin zhvillimin ekonomik në fusha të caktuara, duke ndikuar në përmirësimin dhe mirëqenien e qytetarëve, janë të mirëseardhura për ne si deputetë që të hartohen në Kuvend në dobi të qytetarëve.

E përkrah çdo iniciativë për punësim dhe rritjen e mirëqenies së qytetarëve të pjesës veriore të Kosovës, mirëpo ky projektligj nuk duhet të votohet, pra Projektligji për aftësim, riaftësim profesional dhe punësimin e personave nga pjesët veriore të Kosovës, përkatësisht në komunat Mitrovicën Jugore dhe Veriore, Albanik, Zubin-Potok dhe Zveçan, për arsye sepse nxit shpërnguljen e qytetarëve të asaj pjese dhe mendoj se qytetarëve të asaj pjese mund t'u ndihmojmë duke nxitur politika zhvillimore ekonomike nga Qeveria për atë pjesë, pa dallime për të gjithë qytetarët, duke krijuar vende të reja të punës, jo vetëm për qytetarët e asaj pjese veriore, por për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Ky projektligj ka implikime buxhetore të mëdha, ka diskriminim për qytetarët tjerë dhe subvencionimet nuk bëhen për pjesën e bizneseve në pjesën veriore. Kjo është e cekur tek neni 3, siç e tha edhe kolegja Besa, ku thuhet se secili biznes i regjistruar në cilëndo komunë të Republikës së Kosovës, përveç atyre të regjistruara në komunën veriore.

Ky projektligj e ka efektin e kundërt. Edhe dje në një emision televiziv, kryetari i Partisë Demokratike të pjesës veriore theksoi se ky projektligj është një iniciativë e kryetarit Kadri Veseli, gjë që krijon edhe konfuzion e shqetësim se në Kuvend ka ardhur si propozim i disa deputetëve, e nuk është bërë me qëllim të jetës së qytetarëve të asaj pjese, por si reklamim i fushatës së partisë për interesat e saj.

Ne si deputetë jemi të obliguar të hartojmë ligje, duke mos shkelur të drejtat kushtetuese, por duke ndihmuar në punësimin e tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Kolegë deputetë,

Meqenëse në seancën e kaluar ky projektligj u refuzua në njëfarë mënyre dhe nuk kishte vullnet që të mbështetej, që të votohej, u kërkua edhe brenda këtij Kuvendi dhe mazhorancës që të ketë një shtyrje, në mënyrë që të shikohet mundësia e të çohet më tej.

Sot nuk po shoh një vullnet të mirë për ta votuar dhe për t'i dhënë dritë jeshile këtij projektligji, për t'u punuar edhe më shumë edhe në fazën tjetër në komision e në grupe punuese. Dëshiroj të ju sqaroj se nuk dua të ndalem në kualitetin e këtij projektligji, sepse ideja është që ky Kuvend t'i japë një formë, një format të duhur këtij projektligji në të mirë të misionit për çfarë po bëhet.

Dhe, ajo për çfarë po bëhet ose është propozuar, ky projektligj është për t'u dhënë, nuk do ta quaja diskriminim, siç e quajti kolegja, por për t'i dhënë disa mundësi shtesë një kategorie të qytetarëve tanë, të cilët padrejtësisht kanë mbetur në një pozitë më të vështirë për zhvillim. Dhe, kjo është ideja që disa deputetë, që është edhe më mirë nëse e kanë koordinuar me kryetarin Veseli, ose cilindo personalitet, ose person, ose individ, që i njeh ata njerëz e ato rrethana, ose dëshiron të japë kontribut për ta.

Kështu që unë pa paragjykitime i ftoj të gjithë deputetët që ta votojmë dhe t'u japim mundësi të gjitha grupeve politike, që ta japin kontributin e tyre, ta bëjmë një ligj bashkërisht, në mënyrë që t'u ndihmojmë qytetarëve të asaj pjese me mundësitë, me kapacitetet që ka buxheti ynë, institucionet tona, Qeveria jonë dhe të gjithë bashkë.

Pra, edhe një herë ju kërkoj të gjithëve që ta votoni. Kjo nuk ka të bëjë as me gjendjen aktuale, është një iniciativë që është marrë shumë më herët, ju të gjithë e dini, nuk ka të bëjë as me momentin e tashëm politik. Kështu që edhe një herë po ju bëj thirrje, mos e hidhni këtë projektligj në komente politike, por votojeni dhe të bëjmë diçka pak më shumë për ata qytetarë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar Qerim Bajrami.

ĆERIM BAJRAMI: Zahvaljujem predsedavajuću!

Poštovani poslanici,

Pošto ne vidim ovde nikoga iz Vlade, u svakom slučaju ja mislim da u načelu možda treba podržati ovaj zakon, i slažem se sa prethodnim govornikom da trebamo učiniti sve da dođe do izmena i dopuna koja će biti u interesu svih građana na sjeveru Kosova.

Dakle u onim opštinama u kojima još imamo nekih problema, a jedan od velikih problema je upravo zapošljavanje svih građana, svih etničkih zajednica tamo.

Vi znate da sam ja i ovde u više prilika prozivao i našu ministarku Edita Tahiri i premijera i neke druge ministre vezano za nezapošljavanje Bošnjaka na sjeveru Kosova, u onim opštinama gde oni žive. Na žalost, u procesu koji se tamo događa, i u ovoj godini i u prethodnoj godini, gotovo da nemamo zaposlenih Bošnjaka u opštinama, u administraciji u opštini Leposavić i u drugim opštinama i u sjevernoj Mitrovici, tako da imamo velikih problema vezano za integraciju, neću da kažem samo jedne zajednice, ali očigledno se Briselski sporazum tumači malo na pogrešan način, umesto da se tumači na onu širinu na koju je posle potpisivanja nama ovde ukazao i sam premijer i svi oni koji su učestvovali u potpisivanju toga sporazuma.

Dakle, Zakon o osposobljavanju lica za zapošljavanje na sjeveru treba da se odnosi na sve građane i na sve etničke zajednice na sjeveru Republike Kosova. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë që kërkojnë të flasin për ligjin.

Të pranishëm janë 57 deputetë. Nuk ka kuorum për të votuar.

8. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport e ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë dhe Kuvendit i ka paraqitur raport me rekomandime.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport, zotin Nait Hasani, që të paraqesë dhe arsyetojë një raport me rekomandime. Atëherë, kryetari i Komisionit... a po flisni të dy ju, a cili po flisni... Unë e respektoj vullnetin e të dyve për të folur, por le të dihet, në emër të Komisionit flet nënkryetari i Komisionit, Morina.

SALIH MORINA: Faleminderit, nënkryetar!

Ne jemi dakorduar bashkë edhe me kryetarin, si kryesues i këtij grupi punues që kam qenë, t'i paraqes rekomandimet dhe pastaj do të diskutojë edhe kryetari i komisionit dhe anëtarët e tjerë të komisionit.

Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, në bashkëpunim me Demokracinë Plus e ka monitoruar Ligjin për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë. I tërë komisioni ka qenë i angazhuar dhe këto takime zakonisht kanë ndodhur në 13 komuna të Kosovës, ku të pranishëm në këto takime kanë qenë kryetarët e komunave, pastaj drejtoritë për kulturë, rini dhe sport, zyrtarë të rinisë dhe aktorë të tjerë që janë të sektorit të rinisë për ta diskutuar implementimin e Ligjit për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë, me të cilin ne si anëtarë të komisionit kemi hasur në disa nene, ku ligji nuk është implementuar dhe nuk është duke u implementuar siç duhet. E thashë se gjithsej kemi mbajtur 13 takime dhe njëkohësisht kemi mbajtur 3 dëgjime publike me aktorët kryesorë të këtij projektligji.

Në bazë të krejt këtyre takimeve që ne i kemi mbajtur, mbështetur nga Demokracia Plus, komisioni ka ardhur në përfundim në bashkëpunim me Demokracinë Plus që t'i nxjerrim këto rekomandime:

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport në bazë të nenit 73 të Rregullores së Kuvendi bëri mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit 03/L-145 për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë.

Komisioni, në mbledhjen e mbajtur më 13 shkurt 2017, vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

I rekomandohet Kuvendit që t'i miratojë rekomandimet, si në vijim:

1. Qeveria e Republikës së Kosovës të hartojë ligj të veçantë për punë vullnetare. Kjo ka qenë njëra prej rekomandimeve kryesore të çdo takimi që kemi mbajtur me të gjithë aktorët e rinisë, ta kemi një ligj të veçantë për punë vullnetare, pra është njëri prej rekomandimeve, numër një.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës të nxjerrë akte nënligjore sipas nenit 6, paragrafit 2, me të cilën përcaktohen ministrinë përgjegjëse për zbatimin e dispozitave të këtij ligji.
3. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve ta themelojë Komisionin për Punë Vullnetare sipas nenit 11 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2016 për punë vullnetare të të rinjve.
4. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve ta themelojë Komisionin e përhershëm për Edukimin Joformal të të Rinjve, sipas nenit 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 12/2010 për edukim joformal të të rinjve.
5. Ministria e Kulturës, në bashkëpunim me KQVR-në, të organizojë konferencë vjetore për rininë e Kosovës, sipas Udhëzimit Administrativ nr. 9/2010 për përgjegjësitë dhe procedurat e themelimit të funksionimit të këshillave të veprimit rinor në Kosovë.
6. Ministria e Financave ta bëjë në bazë të kërkesave të komunave të ndajë kod të veçantë buxhetor. Njëra prej rekomandimeve po ashtu, kyçe dhe kërkesë nga të gjithë zyrtarët për rini, po ashtu nga të gjithë aktorët për rini ka qenë që komunat ose drejtoritë përkatëse, në këtë rast, të ndajnë një kod të veçantë buxhetor, sepse shuma buxhetore, do të thotë, ndahet për drejtorinë përkatëse, në këtë rast siç është Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe këtë kod ose këto mjete financiare shumë pak i shfrytëzojnë të rinjtë e Kosovës, në përgjithësi nëpër komunat e tyre.
7. Ministria e Kulturës, Rinisë e Sportit dhe komunat të harmonizojnë strategjitë dhe planet e veprimet për çështjet rinore, me qëllim të fuqizimit të rinisë.
8. Komunat të sigurojnë financim të rregullt për qendrat rinore dhe KVRL-të. Pra, është një kërkesë imediate që qendrat rinore për të mbijetuar në komunat, të cilat janë të themeluara, duhet të mbështeten nga kuvendet komunale dhe është një kërkesë të ndahet edhe sipas ligjit për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë dhe qendrat rinore për të funksionuar duhet të kenë një buxhet më të madh.
9. Komunat të bëjnë licencimin së paku të një qendre rinore.

Ne kemi hasur gjatë monitorimit bashkë me komisionin se kemi komuna të cilat nuk kanë qendër rinore dhe është e paraparë me ligj që çdo komunë të paktën ta ketë një qendër rinore, edhe pse jo edhe më shumë qendra rinore, sepse kemi disa komuna, siç është Peja, e cila i ka 3 qendra rinore, por kemi komuna të cilat nuk kanë fare qendër rinore.

10. Komunat të shpallin konkurs për projektet rinore. Pra, një gjë të tillë e bën Ministria e Kulturës në nivel qendror, por në shumë komuna kemi gjetur se komunat nuk shpallin konkurs publik për të bërë thirrje të konkurrojnë organizatat qeveritare rinore apo qendrat e rinisë, por në shumtën e rasteve këto mjete, si subvencione, i ndajnë direkt kryetarët e komunave, prandaj kemi rekomanduar që komunat të shpallin konkurse publike për projekte dhe njëkohësisht të formohen edhe komisione përkatëse për vlerësimin e projekteve që konkurrojnë OJQ-të rinore apo edhe qendrat e rinisë.

11. Komunat të themelojnë komisione të pavarura për vlerësimin e projekteve të organizatave rinore.

Unë i ftoj të gjithë deputetët, e në këtë rast edhe anëtarët e tjerë të komisionit që kanë marrë pjesë në monitorimin e këtij ligji. Mendoj se ky ligj duhet të implementohet.

Dhe, në bazë të rekomandimeve dhe kërkesa e zyrtarëve për rini është që të pësojë edhe ndryshime, por ko mbetet të shihet në këtë rast, por unë kërkoj nga deputetët e Kuvendit që t'i miratojnë këto rekomandime dhe në bazë të rekomandimeve, të kemi një implementim më të mirë të këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI. Faleminderit! Dëgjuam raportin e Komisionit Funkcional. Nga Grupi Parlamentar i PDK-së fjalën e ka deputeti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Përsëritje, kolegë deputetë,

Komisioni e ka bërë raportin me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-145 për fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë.

Rekomandimet i lexoi nënkryetari i komisionit.

Unë do të ndalem te pikat, të cilat i ka pasur komisioni nëpër takime dhe vizita nëpër komuna, sikur që është Komuna e Skenderajt, e Mitrovicës, Shtime e Suharekë, në Prizren, në Gjakovë, në Klinë, në Kamenicë, Gjilan, në Viti, në Prishtinë, në Ministrinë e Kulturës.

Ka pasur dëgjime publike në Pejë, dëgjim publik në Ferizaj, dëgjim publik në Prishtinë dhe të gjitha këto kanë qenë pjesë e zbatueshmërisë së ligjit.

Fuqizimi dhe pjesëmarrja e të rinjve në vendimmarrje, puna vullnetare, licencimi i qendrave rinore, edukimi joformal i të rinjve.

Të gjitha këto kanë ardhur si rezultat i moszbatueshmërisë së ligjeve dhe ka dalë kërkesa që puna vullnetare, të cilën e bëjnë organizata të ndryshme, t'u numërohet.

Prandaj, është kërkuar të bëhet edhe një ligj i ri për punën vullnetare.

Në takimet e realizuara për çështjet kryesore të adresuara, çështja e vullnetarizmit, respektivisht njohja e punës vullnetare dhe mosha që ligji e përcakton për angazhimin e punëve vullnetare.

Ka pasur çështje që mosha të mos jetë as 18, por as 15-vjeçare, por as mosha më e vjetër, sepse njerëzit mund të kryejnë punë vullnetare dhe duhet t'u njihet e drejta e punës vullnetare në bazë të organizatave, ata ku e kryejnë aktivitetin.

Prandaj, ky projektligj dhe një projektligj i ri që kërkohet nga Ministria e Kulturës ta bëjë për punën vullnetare, nëse ajo nuk është e gatshme ta bëjë, duhet të angazhohen deputetët ta bëjnë, që t'u njihet e drejta e punës, sepse praktikat e ndryshme nuk po kanë mundësi të realizojnë punën vullnetare dhe angazhimet në punë po kërkojnë përvojë të punës, ndërsa puna vullnetare, kur u njihet, ata e kanë një mundësi më të lehtë edhe të angazhohen në punë. Prandaj po kërkoj nga kolegët deputetë t'i votojmë rekomandimet e komisionit dhe të japim një mundësi për zbatueshmërinë e këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Teuta Haxhiu për Grupin e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Pra, përpara deputetët e kanë një raport të Komisionit për monitorimin e Ligjit për rininë, por në fakt qysh në aprovimin e Ligjit për rininë shumë pak kohë në mandatin e kaluar është parë nevoja e plotësim-ndryshimit të këtij ligji.

Në fakt, pajtohem si anëtare e komisionit, kuptohet edhe në emër të Grupit me rekomandimet, por megjithatë, një përvojë jo e mirë e deritanishme që rekomandimet apo rezolutat që dalin nga Kuvendi fare nuk zbatohen nga institucionet përkatëse dhe nuk merren seriozisht, do të duhej të merren seriozisht, pra në këtë rast Ministria e Kulturës që vërtet të punojë në hartimin e një ligji për punën vullnetare, ashtu sikur që u tha pak më parë. Por, në veçanti problemet me të cilat sot

organizatat që merren me sektorin e rinisë, që i kanë dhe komunat, të cilat nuk kanë paraparë një kod të veçantë buxhetor sa i përket zbatimit të këtij ligji.

Në fakt, komunat edhe nuk kanë mjete buxhetore sa duhet për këtë sektor dhe do të duhej që ministria vërtet të parashohë edhe në rishikimin e buxhetit që të ndahen mjete për komunat, në mënyrë që të ndarjet të kenë një kod buxhetor, e jo të mbetet në vullnetin apo, të mos themi, në mëshirën e kryetarëve të komunave për të ndarë nga subvencionet, duke ditur që mjetet janë të pamjaftueshme, e nevojat e qytetarëve janë vërtet shumë të mëdha.

Prandaj, ndoshta problem kryesor të zbatimi i ligjeve dhe moszbatimi i tyre, do të thosha, janë pikërisht aktet nënligjore, të cilat shumë herë nuk hartohen me kohë apo ka edhe ligje, fatkeqësisht që ka shumë akte nënligjore që nxirren nga ministri të ndryshme për të njëjtën çështje dhe që janë në kundërshtim njëra me tjetrën.

Pra, ky është një problem edhe më i madh që del të zbatimi i ligjeve dhe harmonizimi i udhëzimeve administrative apo i akteve nënligjore në mes të ministrive përkatëse për çështjen e njëjtë duhet të shikohen me kujdes dhe të mos i qesin në lajthitje ata që e zbatojnë ligjin e të hasin në probleme të ndryshme dhe vërtet ky sektor i rinisë shihet më shumë vetëm kur ne, të mos themi, kemi fushatë politike, e flasim për rininë, e në anën tjetër asgjë nuk parashohim sa i përket buxhetit për të ndarë për këtë sektor dhe për të marrë seriozisht që edhe organizatat, të cilat aplikojnë me projekte të ndryshme, shpeshherë mbështeten apo u jepet përparësi atyre që kanë një përkrahje politike apo një të afërm në komunë.

Dhe, kjo nuk do të duhej të ndodhte, por të jetë një konkurrencë e mirëfilltë me projekte cilësore që vërtet të përfitojnë ata që paraqesin ide kreative për rininë. Prandaj, edhe një herë, të themi se puna vullnetare nuk do të duhej të shihej vetëm sa për të diskutuar sot në Kuvend, por vërtet të merret seriozisht dhe të hartohet një ligj për punën vullnetare dhe do t'u lejonte ose do t'u jepte një përparësi të gjithë atyre që punojnë nëpër institucione dhe t'u njihet, në radhë të parë si përvojë e punës, sepse ata në start diskriminohen kur hapen konkurse dhe kur kërkohet përvojë e punës.

Dhe, përderisa nuk u jepet mundësia kurrë që ata ta ushtrojnë profesionin për të cilin kanë kryer shkollimin, atëherë ku do ta marrin ata përvojën e punës, prandaj ky ligj do t'u mundësonte që edhe ata të jenë pjesë e garës kur ka konkurse që janë thjesht për profesionet, të cilat ata i kanë të përfunduara.

Prandaj, ky ligj do t'u ndihmonte shumë dhe do të ishin një konkurrencë e mirëfilltë dhe shumë serioze, në mënyrë që konkurrenca të jetë e drejtë dhe ta kenë mundësinë e të mos diskriminohen me konkurse, të cilat vërtet janë diskriminuese, nga se nuk u jepet mundësia asnjëherë ose u jepet mundësia atyre që janë më tepër militantë partiakë. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputeti Ismajl Kurteshi, në emër të Grupit të “Vetëvendosjes” e ka fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, nënkryetar!

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar raportin e komisionit lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për fuqizimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve dhe e përkrah raportin në përgjithësi, e veçanërisht angazhohet për hartimin e ligjit për punë vullnetare, për rëndësinë e të cilit folën edhe kolegët më herët.

Pra, ne si Grup Parlamentar e përkrahim raportin dhe angazhohemi për hartimin e këtij ligji për punë vullnetare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Shukrije Bytyqi flet në emër të Grupit “Nisma”.

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar e ka shqyrtuar raportin për monitorimin e Ligjit për fuqizimin e rinisë dhe këtë raport e përkrah.

Për ne është shumë shqetësuese, sepse realisht ne kemi shumë ligje të mira, por zbatimi i tyre në praktikë është bukur i vështirë, prandaj edhe ky ligj, sikurse ligjet e tjera, ka pengesa në zbatim.

Shqetësim yni gjatë monitorimit të këtij ligji ka qenë çështja se të rinjtë tanë nuk kanë mundësi që puna vullnetare e tyre t’u njihet të paktën si përvojë e punës, duke e ditur se në secilin konkurs të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës, një prej kriterëve për pranim në atë konkurs e kanë përvojën e punës e, në realitet, asnjë prej institucioneve të Republikës së Kosovës nuk u mundëson të rinjve tanë të bëjnë përvojë të punës.

Më e keqja është se edhe puna vullnetare e tyre nuk njihet as si përvojë e punës.

Gjatë monitorimit, disa prej shqetësimeve kanë qenë që të mos jetë kusht mosha, prandaj edhe ne jemi të fokusuar në atë që sa më shpejt Qeveria e Republikës së Kosovës të hartojë një ligj për punë vullnetare dhe kriter në atë ligj të mos jetë mosha dhe të mos kenë pengesa të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës që janë të gatshëm të kryejnë punë vullnetare ta bëjnë punën e tyre.

Ne e dimë se kemi problem, sidomos në çështjet e arsimit dhe kemi një numër të të diplomuarve, sidomos në fushat e shkencave sociale dhe me Ligjin për gjithpërfshirjen edhe të personave me aftësi të kufizuar në Republikën e Kosovës është shumë shqetësuese nëse një mësimdhënës ka në klasë një a dy nxënës me aftësi të kufizuar e nuk i lejohet një prej të diplomuarve në punën

sociale ose një studenti absolvent që të jetë si ndihmës i atij mësuesi, por edhe te kategoritë e tjera.

Prandaj, ne jemi të përkushtuar që sa më shpejt të bëhet një ligj për punë vullnetare dhe puna vullnetare të jetë e garantuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë i thërras deputetët të vijnë, nëse janë këtej për të votuar, sepse nuk ka numër të mjaftueshëm të deputetëve për të votuar.

(Ndërprerje)

Kërkoj që të ulen deputetët, sepse do të kalojmë në votim.

Të pranishëm tani janë 61 deputetë. E hedh në votim Shqyrtimin e parë të Projektligjit për riaftësimin profesional dhe punësimin e personave nga pjesët veriore të Kosovës.

Lus të bëhen gati deputetët dhe regjia, votojmë tash ligjin.

(Ndërhyrje)

59 deputetë kanë votuar, prandaj me këtë shihet se s'ka kuorum për votim dhe nuk kalon ligji, por do të votohet në një seancë tjetër, sepse për sot s'kemi pse ta përsërisim votimin.

Pra, kjo mbetet për t'u votuar në një seancë tjetër.

(Ndërhyrje)

Atëherë vë në votim Shqyrtimin e raportit të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë.

Lus deputetët dhe regjinë të bëhen gati për votim. Votojmë tash!

Kanë votuar 62 deputetë. 56 janë për, 1 kundër dhe 5 abstenojnë dhe konstatoj se aprovohet raporti i komisionit.

Me këtë mbaron punën kjo seancë e sotme. Shihemi të enjten tjetër. Faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*